

MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

PLANI DHE PROGRAMI MËSIMOR

Për klasën XII të shkollës së mesme të lartë

Prishtinë, shkurt 2005

Kryeredaktor

Isuf Zeneli

Redaktorë

Agim Bërdyna

Ramush Lekaj

Ilaz Zogaj

Arbër Salihu



UNMIK



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT,
SHKENCËS DHE
TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF
EDUCATION, SCIENCE &
TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA
OBRAZOVANJE, NAUKU I
TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Office of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Zbatimi i planit dhe programit për klasën e dymbëdhjetë

NUMËR: MASHT [I] 10 /2005

DATË: 14.02. 2005

Në bazë të nenit 1.3, pika ç), të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 për Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 6.1, paragrafi (b), dhe nenit 7.1 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 1.

Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është zbatimi i Planit dhe programit mësimor për klasën e dymbëdhjetë, si rezultat i ristrukturimit të sistemit të arsimit fillor dhe të mesëm.

Neni 2.

Plani dhe programi

Plani dhe programi i ri për klasën e dymbëdhjetë i është bashkangjitur këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 3.

Zbatimi

- 3.1.** Ky Plan dhe program për klasën e dymbëdhjetë zbatohet nga viti shkollor 2005/2006.
- 3.2.** Me zbatimin e Planit dhe të programit të klasës së dymbëdhjetë shfuqizohen planet dhe programet e deritashme të klasës së tretë të shkollës së mesme.

Neni 4.

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Ministri.


Agim Yeliu, Ministër

PËRMBAJTJA

Udhëzim administrativ, **3**

UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE, 7

I. Hyrje, **7**

II. Qëllimet, **8**

III. Objektivat e përgjithshëm, **10**

IV. Vlerësimi, **11**

V. Udhëzime metodologjike, **14**

VI. Burimet dhe mjetet mësimore, **15**

VII. Plani mësimor i lëndës, **16**

Mësimi zgjedhor, **18**

GJUHËT DHE KOMUNIKIMI

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI, **21**

ENGLISH LANGUAGE, **38**

GJUHË FRËNGE, **58**

GJUHË GJERMANE, **74**

MATEMATIKË, 101

SHKENCAT E NATYRËS

BIOLOGJI, **147**

FIZIKË, **197**

KIMI, **225**
ASTRONOMI, **261**
GJEOGRAFI, **271**

SHKENCAT SHOQËRORE

HISTORI, **325**
PSIKOLOGJI, **348**
LOGJIKË, **377**
SOCIOLOGJIA, **390**
FILOZOFI, **421**
EKONOMI, **434**

ARTET

ARTI MUZIKOR, **447**
ARTI FIGURATIV, **457**

TEKNOLOGJI

TEKNOLOGJI ME TIK, **469**

EDUKATË FIZIKE

EDUKATË FIZIKE DHE SPORT, **515**

UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PLANIT DHE TË PROGRAMIT

I. HYRJE

Arsimi përfaqëson fushëveprimtarinë prirëse të zhvillimeve shoqërore, politike dhe ekonomike të Kosovës.

Vizionin për krijimin e një shkolle bashkëkohore sipas standardeve më të avancuara ndërkombëtare, që filloi pas përfundimit të luftës, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) po e realizon duke ndërmarrë hapa të gjithanshëm dhe praktikë në të gjitha fushat e veprimit.

Në këtë ndërmarrje me rëndësi historike për zhvillimin dhe për përparimin e shoqërisë kosovare, MASHT synon të ndryshojë pikëpamjet në procesin e ndërtimit të individit me një vizion të qartë për të ardhmen e tij dhe të vendit të tij.

Kjo krijon parakushtet e nevojshme për integrimin e individit dhe të shoqërisë kosovare në lëvizjet politike, në zhvillimet ekonomike, intelektuale, shkencore e teknologjike, si dhe në zhvillimet social-kulturore të vendeve të përparuara evropiane dhe botërore.

Zhvillimi i Planit dhe programit mësimor mbështetet mbi bazën e një procedure të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së lëndës, ashtu edhe nga parashtrimi i rezultateve të të nxënimit, mjetet mësimore, metodat, teknikat dhe instrumentet e vlerësimit.

Grupet punuese profesionale për zhvillimin e planeve dhe programeve ishin vazhdimisht në rrjedhë të zhvillimeve të reja në arsim dhe në konsultim me ekspertët ndërkombëtarë. Në këtë proces të zhvillimit të planeve dhe të programeve, i cili qëndron mbi bazën e strategjisë afatgjate të MASHT-së, ndihmë të konsiderueshme kanë dhënë UNICEF-i, agjencitë dhe qeveritë e disa shteteve.

Vëmendje e veçantë gjatë zhvillimit të planeve dhe programeve mësimore në klasën XII i është kushtuar kultivimit të qëndrimit pozitiv ndaj të nxënimit, inkurajimit të nxënësve që të angazhohen në mënyrë të arsye-

shme në përmbushjen e kërkesave shkollore, zhvillimit të shkathtësive në jetën e përditshme, vlerave, qëndrimeve dhe sjelljeve. Ata në klasën e dhjetë dhe gjatë tërë shkollimit të mesëm të lartë vihen përballë njohurive akademike, bazave shkencore dhe sferave të ndryshme kulturore.

II. QËLLIMET

Plani dhe programi lëndor për klasën e dymbëdhjetë ka për qëllim:

- të sigurojë kushte të përshtatshme për zhvillimin intelektual, estetik, fizik, shoqëror, moral dhe shpirtëror të nxënësve;
- të sigurojë për nxënësit orientim të drejtë profesional dhe kompatibil me realizimin e intereseve të tyre personale për plotësimin e aspiratave përmes nxënies;
- konsolidimin e diturive, ngritjen, orientimin e prirjeve dhe të shkathtësive në ndërtimin e së ardhmes së tyre;
- që t'u mundësojë nxënësve shfrytëzimin e burimeve të shumta për sigurimin dhe përpunimin e informacioneve si dhe për zhvillimin e një qasjeje kritike ndaj informacioneve dhe fakteve që u ofrohen;
- që t'u mundësojë nxënësve në mënyrë të pavarur të marrin iniciativë dhe veprim, gjithnjë duke pasur parasysh rregullat themelore të sjelljes në grup, varësisht prej llojeve të ndryshme të veprimtarive që zhvillojnë;
- që nxënësit me prirje dhe talent për profesionin të përgatiten dhe të orientohen me kujdes përmes mënyrave të ndryshme të nxënies, duke përfillur interesimet dhe nevojat e tyre për tregun e punës si dhe zhvillimin akademik e profesional.

Grupet punuese për zhvillimin e planeve dhe të programeve në përshtatshmëri me përmbajtjen i kanë zgjedhur objektivat e përgjithshëm dhe specifike për sendërtimin e qëllimeve të lartshënuara nga të cilat në mënyrë të qartë janë përcaktuar edhe rezultatet e pritura në përfundim të klasës së dymbëdhjetë.

III. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Për të jetësuar qëllimet e këtij Plani dhe programi nevojiten shumë rezultate të të nxënit, që mund të jenë të shkallës së përgjithshme dhe specifike. Gjithherë vendosen paraprakisht rezultatet e përgjithshme të të nxënit, të cilat duhet të jenë të shkallës së nevojshme të së përgjithshmes dhe të dallohen qartë në aspektin e shkallës së ndërlikueshmërisë apo tërësisë që synojmë të arrihet.

Në bazë të qëllimeve të Planit dhe programit mësimor të klasës së dymbëdhjetë, MASHT synon që në fund të vitit mësimor nxënësi t'i arrijë këta objektiva të përgjithshëm:

A. Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat

- Të jetë kritik ndaj lëndës;
- Të jetë i hapur;
- Të jetë tolerant;
- Të gëzojë respekt;
- Të jetë i vullnetshëm.

B. Të njohë

- Fjalorin (terminologjinë);
- Faktet;
- Konceptet;
- Parimet;
- Procedurat dhe metodat.

C. Të kuptojë

- Faktet dhe parimet (të zbatojë në situata të thjeshta);
- Përmbajtjen e materialeve;
- Relacionin shkak-efekt;
- Arsyetimin e metodave dhe të procedurave.

Ç. Të zbatojë në situata të reja

- Faktet dhe parimet;
- Procedurat dhe metodat;
- Zgjidhjen e problemeve.

D. Të analizojë

- Zbërthimin e informatave;
- Krahasimin e fakteve;
- Marrëdhënien ndërmjet shkakut dhe efektit;
- Raportin e ngjarjeve në një tekst.

DH. Të sintetizojë (të menduarit kritik- kompleks)

- Njohjen e informatës relevante dhe jorelevante;
- Dallimin ndërmjet faktit dhe mendimit;
- Zbatimin e parimeve në zgjidhjen e problemeve;
- Interpretimin e materialit ilustrues;
- Njohjen e supozimeve.

Për të vlerësuar arritjen e këtyre objektivave, duhet të zhvillojmë procedurë dhe mjete adekuate të matjes (shih vlerësimi).

IV. VLERËSIMI

Vlerësimi është proces i vrojtimit, i mbledhjes sistematike, i analizimit dhe i interpretimit të informatave me qëllim të përcaktimit se deri në ç'shikullë nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëzues. Ai duhet të mbështetet në rezultatet e pritura të programit të lëndës përkatëse dhe të nivelit përkatës.

Ky proces mbështetet në disa parime themelore, siç janë:

- përcaktimi i qëllimit dhe i përparësive në procesin e vlerësimit;
- zbatimi i instrumenteve adekuate të matjes në përputhje me qëllimin, në mënyrë që të matet ajo që është synuar të matet;
- sigurimi i cilësisë së informatave për arritshmërinë e rezultateve të nxënësit përmes matjes dhe vlerësimit të vazhdueshëm;
- matja dhe vlerësimi duhet të jenë të balancuara, të përfshihet e tërë përmbajtja programore e lëndës;
- vlefshmëria e qëndrueshme e të dhënave se shkalla e arritshmërisë së nxënësit është e saktë;
- zbatimi i teknikave të vlerësimit me anë të së cilave bëjmë dallimin e qartë të arritshmërisë së nxënësve.

IV. 1. Instrumentet e vlerësimit

Mësimdhënësi i lëndës dhe shkolla duhet të zgjedhin dhe të zbatojnë një numër të mjaftueshëm instrumentesh për matje dhe vlerësim, siç janë:

- vrojtimi;
- pyetëtori (vetëvlerësimi);
- raporti me shkrim i një pune praktike apo një hulumtimi;
- të shprehurit me gojë;
- të shprehurit me shkrim;
- fleta kontrolluese (përdoret për shkathtësitë manovruese të nxënësit);
- dosja apo portofoli (vetëvlerësimi);
- testi i bazuar në kritere dhe objektiva;
- testi i arritshmërisë i ndërtuar nga kërkesa (pyetje):
 - me përgjigje alternative të shumta;
 - me përgjigje të hapuar të shkurtra;
 - me përgjigje të hapura të zgjeruara etj.

dhe çdo instrument tjetër që mësimdhënësi e vlerëson të nevojshëm.

Çdo shkollë vendos standardet apo kriteret me të cilat përcaktohet shkalla e arritshmërisë në fund të procesit mësimor për klasën e dhjetë.

IV. 2. Shkalla e përfitimit

Në fund të vitit mësimor çdo nxënës duhet të arrijë njërën prej shkallëve të përfitimit të arritshmërisë:

- shkëlqyeshëm (arritje shumë e lartë);
- shumë mirë (arritje e lartë);
- mirë (arritje mesatare);
- mjaftueshëm (arritje e kufizuar) dhe
- pamjaftueshëm (arritje e pamjaftueshme).

Shkalla e përfitimit të arritshmërisë varet drejtpërdrejt nga standardet e arritshmërisë (shiko tabelën më poshtë) të cilat bazohen në:

Objektivat e përgjithshëm	Arritje shumë e lartë 90%	Arritje e lartë 80%	Arritje e kënaqshme 60%	Arritje e kufizuar 40%	Arritje e pamjaftueshme
<i>Njohja e lëndës</i>	Aftësi shumë e lartë në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi e lartë në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi mesatare në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi e kufizuar në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.	Aftësi jo e mjaftueshme në njohjen dhe në zbatimin e njohurive të lëndës në situata të thjeshta.
<i>Të kuptuarit e proceseve shkencore</i>	Aftësi shumë e lartë e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak pasojë, mbledhjes dhe organizimit të informacioneve, të gjykuarit e thjeshtë.	Aftësi e lartë e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak pasojë, mbledhjes dhe organizimit të informacioneve, të gjykuarit e thjeshtë.	Aftësi e kënaqshme e të kuptuarit dhe e zbatimit të fakteve, parimeve, relacionit shkak pasojë, mbledhjes dhe organizimit të informacioneve, të gjykuarit e thjeshtë.	Aftësi e kufizuar e të kuptuarit të detyrave dhe të proceseve shkencore	Aftësi e pamjaftueshme e të kuptuarit të detyrave dhe të proceseve shkencore
<i>Të menduarit kritik</i>	Aftësi e lartë e të menduarit kritik në situata komplekse si: njohja me informacione relevante, zgjidhja e problemeve, duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme.	Aftësi e të menduarit kritik në situata komplekse, si: njohja me informacione relevante, zgjidhja e problemeve duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme.	Aftësi e kufizuar e të menduarit kritik në situata komplekse si: njohja me informacione relevante, zgjedhja e problemeve, duke zbatuar parimet dhe ushtrimet e interpretueshme.		
<i>Shkathësitë manovruese</i>	Shkallë e kënaqshme e përfitimit në shkathësitë manovruese.			Shkallë e ulët e përfitimit (disa) në shkathësitë manovruese.	

V. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përzgjedhja e metodave mësimore është në kompetencë të mësimitdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me veçoritë e përmbajtjes së temave mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet kombinuar, të jenë sa më të larmishme, ngase nxitin dinamikën e orës, thyejnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat dhe teknikat e mësimitdhënies janë po aq të larmishme sa edhe vetë llojet e mësimitnxënies. Mësimitdhënësi mund të përdorë disa teknika dhe metoda mësimore të kombinuara për të arritur rezultate sa më të larta gjatë procesit mësimor.

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda dhe teknika të ndryshme:

- shpjegimi dhe sqarimi;
- të shprehurit me gojë;
- të shprehurit me shkrim;
- të mësuarit problemor;
- diskutimi (debati);
- puna në grupe;
- demonstrimi dhe interpretimi;
- teknika e të menduarit kritik;
- shtrim idesh (brainstorming);
- vetëhulumtimi (kërkimi).

Për tema të caktuara që karakterizohen me informacione të bollshme gjejnë zbatim edhe ligjërata ndërvepruese të kombinuara me veprimtari praktike.

Për tema mësimore të caktuara mund të shfrytëzohen me sukses: mësimi në natyrë, eskursione të ndryshme studimore, vizita institucioneve të ndryshme etj.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo i teknikave mësimore të lartpërmendura duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.

VI. BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Që të realizohet mësimdhënia dhe mësimnxënia efektive e këtij plani dhe programi, mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burime dhe mjete të ndryshme informimi. Deri tash burim kryesor informimi ishte teksti shkollor i lëndës përkatëse.

Krahas teksteve të ndryshme shkollore, sugjerojmë të përdoren edhe materiale të tjera informimi:

- doracakë, atlasë, broshura;
- gazeta, revista profesionale dhe shkencore;
- fotografi, posterë, afishe, skema, diagrame, harta, tabela;
- modele, figura, makete;
- fotoslajde, filma, videokaseta;
- programe të kopjuterëve, interneti, CD-të etj.

Është kompetencë e arsimtarit që, varësisht nga kushtet në të cilat punon, shkolla të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave gojore, vizuele, auditive dhe audiovizuele, me theks të veçantë në atë që është qenësore për t'u mësuar.

Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësimore duhet t'i takojë edhe nxënësit.

**VII. PLANI MËSIMOR I LËNDËS
OSE PLANI I LËNDËVE MËSIMORE**

	Lëndët mësimore	Gjimnazi i përgjithshëm		Gjimnazi matematikë & informatikë		Gjimnazi i shkencave natyrore		Gjimnazi i shkencave shoqërore		Gjimnazi i gjuhëve	
		Fondi javor	Fondi vjetor	Fondi javor	Fondi vjetor	Fondi javor	Fondi vjetor	Fondi javor	Fondi vjetor	Fondi javor	Fondi vjetor
1	Gjuhë shqipe dhe letërsi	4	148	4	132	4	132	4	132	5	165
2	Gjuhë angleze	3	111	2	66	3	99	3	99	4	132
3	Gjuhë e dytë e huaj	2	74					2	66	3	99
4	Gjuhë latine										
5	Matematikë	2	74	7	231	3	99				
6	Biologji	2	74	2	66	3	99				
7	Fizikë	2	74	2	66	3	99				
8	Astronomi			2	66	2					
9	Kimi	2	74	2	66	3	99				
10	Gjeografi	2	74			2	66			2	66
11	Edukatë qytetare										
12	Histori	2	74					3	99		

13	Psikologji	2	74					2	66	2	66
14	Sociologji	2	74					3	99	2	66
15	Logjikë			2	66			2	66		
16	Filozofi							2	66	2	66
17	Ekonomi							2	66		
12	Art muzikor									1	33
13	Art figurativ									1	33
14	TIK (Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit)	2	74	4	132	2	66	1	33	2	66
15	Edukatë fizike dhe sportive	2	74	2	66	2	66	2	66	2	66
16	Pjesa sipas zgjedhjes: a Lëndë apo kurse të reja (p.sh. edukimi qytetar, etika, kurse shëndetësore, të drejtat dhe liritë e njeriut, edukimi për ndërmarrës, teknologjia e informimit dhe e komunikimit, mbrojtja e mjedisit jetësor apo çkado tjetër që është joshëse për nxënësit dhe më interes për komunitetin).	2	74	2	66	3	99	4	132	4	132
	Gjithsej	31	1147	31	1023	30	990	30	990	30	990

MËSIMI ZGJEDHOR

Quhet kështu sepse nxënësit e zgjedhin sipas dëshirës, dhuntisë, nevojës apo interesit. Lënda, kursi apo veprimtaria për mësimin zgjedhor mund të sugjerohet nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë ose në bazë të kërkesës së nxënësve, prindërve, arsimtarëve, apo kujtdo tjetër nga komuniteti. Në mënyrë të veçantë, do të ishte dashtë të konkurojnë arsimtarët e papunë me projekt komplet (lëndën, kursin apo veprimtarinë dhe planin, programin, tekstin dhe mënyrën e realizimit).

Mësimi zgjedhor mund të organizohet nga:

Lëndë apo kurse të reja (p.sh, edukimi qytetar, etika, kurse shëndetësore, të drejtat dhe liritë e njeriut, edukimi për ndërmarrës, teknologjia e informimit dhe e komunikimit, mbrojtja e mjedisit jetësor apo çkado tjetër që është joshëse për nxënësit dhe me interes për komunitetin.

Lënda, kursi apo veprimtaria për mësim zgjedhor duhet të zgjatë jo më pakë se tre muaj.

Për lëndën, kursin apo veprimtarinë duhet të deklarohen më se paku 15 (pesëmbëdhjetë) nxënës (në qoftë se klasa ka më shumë se një paralele) e në qoftë se klasa ka vetëm një paralele, atëherë është e nevojshme që për lëndën, kursin apo veprimtarinë të deklarohen gjysma e paraleles, në mënyrë që të mund të organizohet mësimi zgjedhor.

Për mësimin zgjedhor, në bazë të kërkesave të të interesuarve, vendosin organet profesionale të shkollës në bashkëpunim më Zyrën Rajonale të Arsimit para fillimit të vitit shkollor. Për mënyrën e deklarimit të nxënësve, të prindërve apo të të interesuarve të tjerë dhe kohën kur ata e bëjnë këtë, vendosin organet e shkollës, por gjithsesi e tërë procedura duhet të kryhet para fillimit të vitit shkollor.

Planet dhe programet për mësimin zgjedhor i harton shkolla në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Arsimit dhe me profesionistë të lëmenjve përkatës nga komuniteti (në qoftë se ka të tillë).

Mësimi zgjedhor kur të aprovohet nga organet profesionale të shkollës e ka statusin e mësimit të rregullt, më të vetmin përjashtim që mësimi zgjedhor do të vlerësohet me notë përshkruese (jonegative).

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

**Gjimnazi i shkencave shoqërore, gjimnazi i shkencave natyrore,
gjimnazi matematikë dhe informatikë (4 orë në javë, 132 orë në vit)
Gjimnazi i gjuhëve (5 orë në javë, 165 orë në vit)**

HYRJE

Programi i klasës së dymbëdhjetë është pjesë e programit të shkollës së mesme të lartë. Në këtë nivel zhvillohet puna e pavarur e nxënësit dhe kultivimi i mendimit kritik, në pajtim me standardet përkatëse për këtë klasë. Kërkesat themelore për këtë klasë kanë të bëjnë me formimin e mëtejshëm kulturor, letrar e gjuhësor, me përvetësimin e dijeve dhe formimin e personalitetit, duke përfshirë këtu edhe kulturën e sjelljes dhe të komunikimit.

Në këtë klasë duhet të zotërohen njohuritë gramatikore të fituara në klasët e mëparshme, të mënjanohen dobësitë morfosintaksore dhe drejtshkrimore, që pengojnë përdorimin korrekt të gjuhës, të detajeve dhe të strukturave më të përgjithshme e komplekse, duke filluar nga fjalia e deri te teksti. Duhet të njihen dukuritë që nuk janë njohur dhe të zgjerohen e të përforcohen njohuritë që nuk janë thelluar në shkollën e mesme të ulët dhe në klasën e mëparme. Po kështu duhet të njihen dhe të përforcohen lidhjet ndërmjet gramatikës, analizës së teksteve, praktikave gojore dhe punëve me shkrim të tipave të ndryshëm; të përforcohen njohuritë për njësitë themelore të gjuhës dhe lidhjet e tyre, nga fonema te fjala, nga fjala te fjalia, nga fjalia e thjeshtë te fjalia e përbërë - ndryshe nga ç'janë zhvilluar në shkollën e mesme të ulët. Po kështu, duhet të zhvillohet edhe puna me drejtshkrimin.

Në të njëjtën kohë, do të gjejë vend edhe aplikimi i dijeve të përveçsuara nga letërsia, kultura e gjuha, nëpërmjet formave të ndryshme të krijimtarisë; të eseve, punimeve të ndryshme shkollore etj. Kjo do të ndihmojë strukturimin e mendimeve, gjykimeve e të imagjinatës së nxënësve, që të jenë në gjendje të trajtojnë me gojë e me shkrim probleme të ndryshme nga këndvështrime të ndryshme kulturore, letrare, gjuhësore e

kritike. Të gjitha këto do të ndikojnë drejtpërdrejt në formimin e mirëfilltë kulturor, letrar e gjuhësor të nxënësit.

Rritja e shkallës së zotërimit të gjuhës amtare dhe formimi letrar e kulturor i nxënësit janë ndër synimet themelore për këtë klasë. Kjo pritet të realizohet nëpërmjet shkathtësive të komunikimit, leximit, analizës e vlerësimit të llojeve të ndryshme të teksteve, letrare e joletrare.

QËLLIMET

Qëllimi i mësimit të kësaj lënde është që nxënësi:

- të përforcojë të arriturat nga klasat e mëparme dhe të zhvillojë më shumë shkathtësitë e të dëgjuarit dhe të folurit, të leximit dhe të shkrimit;
- të rrisë aftësinë për analizë kritike të teksteve dhe të fenomeneve kulturore;
- të rrisë nivelin e komunikimit me tekste letrare e joletrare;
- të rrisë aftësinë e komunikimit me modele e kultura të ndryshme etj.

OBJEKTIVAT

Të njohë

- kulturën dhe autorët e letërsisë së realizmit dhe të asaj moderne;
- letërsinë nacionale dhe atë të huaj, të fundshekullit XIX dhe fillimit të XX.

Të kuptojë

- rëndësinë e kulturave të ndryshme për zhvillimin e kulturës dhe të letërsisë shqipe;
- esencat kulturore, letrare e gjuhësore që do të ndihmonin zhvillimin e mendimit individual;
- kulturën, letërsinë nacionale dhe atë të huaj.

Të analizojë

- tekste të ndryshme për nga qëllimi, struktura, përmbajtja, detajet dhe efektet;
- tekste letrare dhe joletrare, nga autorë të letërsisë moderne shqipe.

Të vlerësojë

- tekste e modele kulturore e letrare;
- autorë e tekste të ndryshme letrare;
- krijime të autorëve të ndryshëm, shqiptarë dhe të huaj, kryesisht të letërsisë moderne shqipe dhe asaj bashkëkohore.

Realizimi i këtyre objektivave nënkupton zhvillimin e këtyre **kategorive** (shkathtësive të komunikimit):

- TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT
- LEXIMI
- SHKRIMI

Ndërkaq, **nënkategoritë** ose **fushat tematike**, që lidhen me standardet e përmbajtjes për këtë klasë, janë:

- Moderniteti/Kulturat/Poetikat
- Modelet kulturore
- Tekstet letrare dhe joletrare
- Kulturë gjuhe
- Letërsia e realizmit
- Pararendësit e modernitetit
- Letërsia moderne
- Letërsia bashkëkohore

Moderniteti / Kultura / Poetikat

Hetohet konteksti i lëvizjeve moderne, kulturore e letrare, që nga gjysma e dytë e shek. XIX deri në fund të gjysmës së parë të shek. XX; dhe jepen tiparet e kulturave e të poetikave përkatëse; teksteve dhe konteksteve.

Modelet kulturore

Jepen tiparet kryesore të modeleve të ndryshme kulturore të gjysmës së dytë të shek. XIX, deri në fund të gjysmës së parë të shek. XX.

Tekstet letrare dhe joletrare

Jepen tekste letrare e joletrare nga kultura dhe letërsia shqiptare dhe ajo e huaj; në funksion të dijeve kulturore e letrare, duke njohur edhe autorë të caktuar, forma të shkrimeve e të komunikimeve kulturore.

Letërsia e realizmit

Jepen tiparet e kësaj letërsie, e këtij formacioni. Tiparet e tilla ilustrohen me autorë dhe tekste të zgjedhura.

Onore dë Balzak

O. dë Balzaku dhe romani realist - poetika
Xha Gorio - struktura /tema / personazhet
Tekste të zgjedhura për analizë dhe komente

Shembuj të tjerë nga krijimtaria e L. Tolstojit, Ç. Dikensit, F. M. Dostojevskit

Pararendësit e modernitetit

Edgar Alan Po dhe Charl Bodler

Format dhe idetë/ shembuj

Letërsia moderne

Jepen tiparet e kësaj letërsie, e këtij formacioni. Tiparet e tilla ilustrohen me autorë dhe tekste të zgjedhura.

Franc Kafka

F. Kafka
Proza e F. Kafkës
Tregimet
Procesi - struktura; tema
Tekste të zgjedhura për analizë dhe komente

Shembuj të tjerë nga krijimtaria e Xh. Xhojsit, G. Apolinerit, M. Prustit, E. Paundit.

Letërsia moderne shqipe

Moderniteti shqiptar: Poetika / Shtrirja
Format / Zhanret: Poezia, Proza poetike, Proza / Trajtat e lirikës;
Tregimi; Novela; Romani

Temat dominante
Kritika letrare/Revistat/Autorët themelorë

Ndre Mjedja

N. Mjedja - paramoderna e letrave shqipe
Juvenilia
Poemat
Andra e jetës - strukturat; idetë; koment letrar

Gjergj Fishta

Autori
Lirika - strukturat dhe temat
Lahuta e Malcís - epi nacional; struktura; këngë për komentim
Juda Makabé dhe dramat e tjera
Satira - esencat strukturore; idetë themelore
Tekste të zgjedhura për analiza e komente

Faik Konica

F. Konica - prozatori modern
Tregimet e Faik Konicës - strukturat dhe idetë; Statusi
Një Ambasadë e Zulluve në Paris - koment
Eseistika
Kritika

Fan Stilian Noli

Autori
Poezia - struktura; motivet personale / dimensionimi kontekstual
Drama - struktura dhe idetë
Autobiografia

Haki Stërmilli

Autori
Esencat e prozës
Romani sentimental (*Sikur t'isha djalë*)

Lasgush Poradeci

Lasgush Poradeci dhe moderniteti
Poezia - veçoritë themelore; strukturat dhe idetë
Vallja e yjeve
Ylli i zemrës
Kamadeva
Poezi të zgjedhura për analizë e komente

Ernest Koliqi

Autori

Gjurmata e stinve - struktura / temat

Proza tregimtare - zhanri / tema / stili

Tekste nga *Hija e maleve* për analiza e interpretime

Mitrush Kuteli

Autori

Proza e Kutelit: Oraliteti dhe Moderniteti

Rrëfenjat / Rrëfimet

Tat Tansuhi - koment

Poezia

Kritika

Tekste të zgjedhura për komente

Millesh Gjergj Nikolla - Migjeni

Migjeni dhe ekspresionizmi

Vargjet e lira - strukturat dhe temat

Novelat e Qytetit të Veriut - strukturat dhe temat

Skicat

Tekste të zgjedhura për analiza, komente e interpretime

Krahasimi i autorëve shqiptarë me ata evropianë. Poetikata e tyre/afritë dhe dallimet.

Nëpërmjet autorëve ilustrohen edhe të gjitha fushat e tjera tematike, idetë, heronjtë e nocionet që dalin në përmbajtjen e tekstit të klasës së dymbëdhjetë.

Për çështje të caktuara shihen edhe autorë të tjerë botërorë dhe shqiptarë - me zgjedhje.

Letërsia bashkëkohore

Jepen tiparet e kësaj letërsie, e këtij formacioni. Tiparet e tilla ilustrohen me autorë dhe tekste të zgjedhura.

Gabriel Garsia Marquez

Autori

Njëqind vjet vetmi – struktura, realizmi magjik

Fragmente të zgjedhura për ilustrime e komentime

Ernest Heminguej

Plaku dhe deti, struktura dhe idetë

Shembuj të tjerë nga krijimtaria e A. Kamysë, H. L. Borhesit.

Letërsia bashkëkohore shqipe

Esat Mekuli

Poezia e pas luftës së Dytë Botërore
Poezi të zgjedhura

Anton Pashku

Tregimet/ moderna shqiptare e letrave shqipe/ stili

Dritëro Agolli

Poezia dhe proza socrealiste, shembuj

Ismail Kadare

Tejkalimi i letërsisë socrealiste
“Pallati i ëndrrave”, struktura/idetë

Kasem Trebeshina

Letërsia e disidencës
Novelat: “Stina e stinëve”, “Odin Moldvalsen”

Ali Podrimja

“Lum Lumi”, struktura, ndjeshmëria

Azem Shkreli

Poezi, vargu, tematika, ndjeshmëria

Letërsia dhe kritika shqipe në Kosovë në vitet ‘70

Kulturë gjuhe

Puna me gjuhën do të përqendrohet në aspektin kuptimor dhe ka si synime themelore:

- analizën leksiko-morfologjike dhe sintaksore të teksteve;
- përdorimin e gjuhës në funksione stilistike;
- njohjen e veçorive gjuhësore që lidhen me paragrafin dhe tekstin si tërësi;
- logjika e bashkërenditjes dhe e nënrenditjes në shkrim;
- pasurimi i fjalorit, sidomos atij kritik dhe analitik.
- format e ligjërimit letrar dhe joletrar/ aplikimi dhe mospalikimi i standardit si gjuhë e letërsisë;
- marrëdhëniet sintaksore dhe efektet narrative;

- përdorimin e gjuhës në media të ndryshme;
- drejtshkrim, drejtshqiptim, përdorim kreativ i gjuhës.

Jepen tekste, ushtrime dhe detyra, duke nënkuptuar këtu edhe shkrimin e eseve, me qëllim zhvillimin e shkathtësive gjuhësore nga stilistika gjuhësore, gjuha standarde, gjuha dialektore etj. Jepen shembuj të dimensioneve stilistike të shqipes; sekuenca, stili, diskutet; gjuha kritike dhe ajo kreative.

Rezultatet e pritura

Në fund të klasës së njëmbëdhjetë, nxënësi:

- zotëron shkathtësi të veçanta individuale, njohëse dhe komunikative, për punë individuale dhe në grupe;
- analizon, vlerëson, sintetizon dhe organizon informata nga burime të ndryshme, duke i shtruar ato në nivelin e pyetjeve, problemeve e çështjeve;
- njeh formacionet e ndryshme kulturore e letrare të modernitetit;
- identifikon, njeh dhe praktikon, nëpërmjet shkrimit, format e ndryshme letrare dhe joletrare;
- kupton format dhe idetë themelore të kulturës dhe letërsisë së gjysmës së dytë të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX;
- kupton tiparet e letërsisë e të kulturës shqiptare që lidhen me modernitetin;
- zotëron shkathtësitë argumentuese dhe vlerësuese për kulturën dhe për letërsinë, sikur edhe dijet gjuhësore, duke praktikuar lloje të ndryshme të analizave e të shkrimeve; veçanërisht në aspektin semantik dhe sintaksostilistik;

QASJET NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE

Gjuha shqipe është mjet komunikimi për të gjitha lëndët. Megjithatë, lidhje të drejtpërdrejta vihen me historinë, gjeografinë, edukatën qytetare, artet etj. Disa tema nga këto lëndë ndikojnë në zhvillimin e shkathtësive të komunikimit, në formimin kulturor dhe në krijimin e individualitetit të pavarur. Përveç çështjeve ndërlëndore, p.sh. tema nga shëndetësia, për të drejtat e njeriut, për çështjet gjinore etj., temat mund të zgjedhen nga mësimdhënësi, varësisht nga rëndësia dhe aktualiteti që kanë (nga televizioni, revistat, gazetat apo nga rrethi i tyre).

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Mësimdhënësi duhet t'i zbatojë metodat më bashkëkohore të mësimdhënies: interaktiviteti. Kjo hap rrugë për mësimin aplikativ. Mësimi duhet të organizohet në seanca që bashkojnë të folurit, shkrimin dhe leximin. Seanca ndryshon varësisht nga synimet e mësimdhënësit dhe të reagimeve të nxënësve.

Do të aplikohen dy mënyra leximi: leximi analitik dhe leximi i shpejtë. Leximi analitik ka si qëllim analiza të hollësishme të objektive të caktuar dhe mund të aplikohet në tekste të gjatësive të ndryshme. Leximi i shpejtë nënkupton leximin e zakonshëm. Me të nxitet pavarësimi i nxënësve për leximin e teksteve të ndryshme. Raporti ndërmjet këtyre dy tipave të leximit duhet të jetë i ekuilibruar.

Lidhja ndërmjet leximit e shkrimit duhet të jetë e përhershme, qoftë edhe kur aplikohen shkrime kreative, imituese ose transformuese. Studimi aplikativ i gjuhës është një element i përbashkët i të gjitha aktiviteteve të parashtruara.

VLERËSIMI

Vlerësimi që duhet të bëhet gjatë klasës së dymbëdhjetë, dhe në fund të saj, lidhet me veprimtarinë dhe mjetet me të cilat gjykohen puna dhe arritjet e nxënësve për klasën përkatëse. Parimet, kushtet, metodat, teknikat dhe mjetet e vlerësimit realizohen në përputhje me standardet ndërkombëtare të vlerësimit për këtë nivel. Kjo nënkupton praktikimin e tipave të ndryshëm të vlerësimit, varësisht nga nevoja dhe situata, siç janë: vlerësimi përcaktues, formues, përmbledhës, individual, në grup, i brendshëm, i jashtëm etj.

LITERATURA

- Tekstet që do të hartohen në mbështetje të këtij plani dhe programi
- Tekste të mëhershme që kanë për objekt këtë materie
- Zejnullah Rrahmani: *Teoria e letërsisë (për shkollat e mesme)*
- Tekste të tjera alternative

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Gjimnazi i përgjithshëm (4 orë në javë, 148 orë në vit)

HYRJE

Programi i klasës së dymbëdhjetë është pjesë e programit të shkollës së mesme të lartë. Në këtë nivel zhvillohet puna e pavarur e nxënësit dhe kultivimi i mendimit kritik, në pajtim me standardet përkatëse për këtë klasë. Kërkesat themelore për këtë klasë kanë të bëjnë me formimin e mëtejshëm kulturor, letrar e gjuhësor, me përvetësimin e dijeve dhe formimin e personalitetit, duke përfshirë këtu edhe kulturën e sjelljes dhe të komunikimit.

Në këtë klasë duhet të zotërohen njohuritë gramatikore të fituara në klasët e mëparshme, të mënjanoen dobësitë morfosintaksore dhe drejtshkrimore, që pengojnë përdorimin korrekt të gjuhës, të detajeve dhe të strukturave më të përgjithshme e komplekse, duke filluar nga fjalia e deri te teksti. Duhet të njihen dukuritë që nuk janë njohur dhe të zgjerohen e të përforcohen njohuritë që nuk janë thelluar në shkollën e mesme të ulët dhe në klasën e mëparme. Po kështu duhet të njihen dhe të përforcohen lidhjet ndërmjet gramatikës, analizës së teksteve, praktikave gojore dhe punëve me shkrim të tipave të ndryshëm; të përforcohen njohuritë për njësitë themelore të gjuhës dhe lidhjet e tyre, nga fonema te fjala, nga fjala te fjalia, nga fjalia e thjeshtë te fjalia e përbërë - ndryshe nga ç'janë zhvilluar në shkollën e mesme të ulët. Po kështu, duhet të zhvillohet edhe puna me drejtshkrimin.

Në të njëjtën kohë, do të gjejë vend edhe aplikimi i dijeve të përveçsuara nga letërsia, kultura e gjuha, nëpërmjet formave të ndryshme të krijimtarisë; të eseve, punimeve të ndryshme shkollore etj. Kjo do të ndihmojë strukturimin e mendimeve, gjykimeve e të imagjinatës së nxënësve, që të jenë në gjendje t'i trajtojnë me gojë e me shkrim probleme të ndryshme nga këndvështrime të ndryshme kulturore, letrare, gjuhësore e kritike. Të gjitha këto do të ndikojnë drejtpërdrejt në formimin e mirëfilltë kulturor, letrar e gjuhësor të nxënësit.

Rritja e shkallës së zotërimit të gjuhës amtare dhe formimi letrar e kulturor i nxënësit, janë ndër synimet themelore për këtë klasë. Kjo pritet të realizohet nëpërmjet shkathtësive të komunikimit, leximit, analizës e vlerësimit të llojeve të ndryshme të teksteve, letrare e joletrare.

QËLLIMET

Qëllimi i mësimit të kësaj lënde është që nxënësi:

- të përforcojë të arriturat nga klasat e mëparme dhe të zhvillojë më shumë shkathtësitë e të dëgjuarit dhe të folurit, të leximit dhe të shkrimit;
- të rrisë aftësinë për analizë kritike të teksteve dhe fenomeneve kulturore;
- të rrisë nivelin e komunikimit me tekste letrare e joletrare;
- të rrisë aftësinë e komunikimit me modele e kultura të ndryshme etj.

OBJEKTIVAT

Të njohë

- kulturën dhe autorët e letërsisë së realizmit dhe të asaj moderne;
- letërsinë nacionale dhe atë të huaj, të fundshekullit XIX dhe fillimit të XX.

Të kuptojë

- rëndësinë e kulturave të ndryshme për zhvillimin e kulturës dhe të letërsisë shqipe;
- esencat kulturore, letrare e gjuhësore që do të ndihmonin zhvillimin e mendimit individual;
- kulturën, letërsinë nacionale dhe atë të huaj.

Të analizojë

- tekste të ndryshme për nga qëllimi, struktura, përmbajtja, detajet dhe efektet;
- tekste letrare dhe joletrare, nga autorë të letërsisë moderne shqipe.

Të vlerësojë

- tekste e modele kulturore e letrare;
- autorë e tekste të ndryshme letrare;
- krijime të autorëve të ndryshëm, shqiptarë dhe të huaj, kryesisht të letërsisë moderne shqipe dhe asaj bashkëkohore.

Realizimi i këtyre objektivave nënkupton zhvillimin e këtyre **kategorive** (shkathtësive të komunikimit):

- TË DËGJUARIT DHE TË FOLURIT
- LEXIMI
- SHKRIMI

Ndërkaq, **nënkategoritë** ose **fushat tematike**, që lidhen me standardet e përmbajtjes për këtë klasë, janë:

- Moderniteti/Kulturat/Poetikat
- Modelet kulturore
- Tekstet letrare dhe joletrare
- Kulturë gjuhe
- Letërsia e realizmit
- Pararendësit e modernitetit
- Letërsia moderne
- Letërsia bashkëkohore

Moderniteti / Kultura / Poetikat

Hetohet konteksti i lëvizjeve moderne, kulturore e letrare, që nga gjysma e dytë e shek. XIX deri në fund të gjysmës së parë të shek. XX; dhe jepen tiparet e kulturave e të poetikave përkatëse; teksteve dhe konteksteve.

Modelet kulturore

Jepen tiparet kryesore të modeleve të ndryshme kulturore të gjysmës së dytë të shek. XIX, deri në fund të gjysmës së parë të shek. XX.

Tekstet letrare dhe joletrare

Jepen tekste letrare e joletrare nga kultura dhe letërsia shqiptare dhe ajo e huaj; në funksion të dijeve kulturore e letrare, duke njohur edhe autorë të caktuar, forma të shkrimeve e të komunikimeve kulturore.

Letërsia e realizmit

Jepen tiparet e kësaj letërsie, e këtij formacioni. Tiparet e tilla ilustrohen me autorë dhe tekste të zgjedhura.

Onore dë Balzak

O. dë Balzaku dhe romani realist - poetika
Xha Gorio - struktura /tema / personazhet
Tekste të zgjedhura për analizë dhe komente

Shembuj të tjerë nga krijimtaria e L. Tolstojit, Ç. Dikensit, F. M. Dostojevskit

Pararendësit e modernitetit

Edgar Alan Po dhe Charl Bodler

Format dhe idetë/ shembuj

Letërsia moderne

Jepen tiparet e kësaj letërsie, e këtij formacioni. Tiparet e tilla ilustrohen me autorë dhe tekste të zgjedhura.

Franc Kafka

F. Kafka
Proza e F. Kafkës
Tregimet
Procesi - struktura; tema
Tekste të zgjedhura për analizë dhe komente

Shembuj të tjerë nga krijimtaria e Xh. Xhojsit, G. Apolinerit, M. Prustit, E. Paundit.

Letërsia moderne shqipe

Moderniteti shqiptar: Poetika / Shtrirja
Format / Zhanret: Poezia, Proza poetike, Proza / Trajtat e lirikës;
Tregimi; Novela; Romani

Temat dominante
Kritika letrare/Revistat/Autorët themelorë

Ndre Mjedja

N. Mjedja - paramoderna e letrave shqipe

Juvenilia

Poemat

Andra e jetës - strukturat; idetë; koment letrar

Gjergj Fishta

Autori

Lirika - strukturat dhe temat

Lahuta e Malcís - epi nacional; struktura; këngë për komentim

Juda Makabé dhe dramat e tjera

Satira - esencat strukturore; idetë themelore

Tekste të zgjedhura për analiza e komente

Faik Konica

F. Konica - prozatori modern

Tregimet e Faik Konicës - strukturat dhe idetë; Statusi

Një Ambasadë e Zulluve në Paris - koment

Eseistika

Kritika

Fan Stilian Noli

Autori

Poezia - struktura; motivet personale / dimensionimi kontekstual

Drama - struktura dhe idetë

Autobiografia

Haki Stërmilli

Autori

Esencat e prozës

Romani sentimental (*Sikur t'isha djalë*)

Lasgush Poradeci

Lasgush Poradeci dhe moderniteti

Poezia - veçoritë themelore; strukturat dhe idetë

Vallja e yjeve

Ylli i zemrës

Kamadeva

Poezi të zgjedhura për analizë e komente

Ernest Koliqi

Autori

Gjurmata e stinve - struktura / temat

Proza tregimtare - zhanri / tema / stili

Tekste nga *Hija e maleve* për analiza e interpretime

Mitrush Kuteli

Autori

Proza e Kutelit: Oraliteti dhe Moderniteti

Rrëfenjat / Rrëfimet

Tat Tansuhi - koment

Poezia

Kritika

Tekste të zgjedhura për komente

Milosh Gjergj Nikolla - Migjeni

Migjeni dhe ekspresionizmi

Vargjet e lira - strukturat dhe temat

Novelat e Qytetit të Veriut - strukturat dhe temat

Skicatat

Tekste të zgjedhura për analiza, komente e interpretime

Krahasimi i autorëve shqiptarë me ata evropianë. Poetikata e tyre/afritë dhe dallimet.

Nëpërmjet autorëve ilustrohen edhe të gjitha fushat e tjera tematike, idetë, heronjtë e nocionet që dalin në përmbajtjen e tekstit të klasës së dymbëdhjetë.

Për çështje të caktuara shihen edhe autorë të tjerë botërorë dhe shqiptarë - me zgjedhje.

Kulturë gjuhe

Puna me gjuhën do të përqendrohet në aspektin kuptimor dhe ka si synime themelore:

- analizën leksiko-morfologjike dhe sintaksore të teksteve;
- përdorimin e gjuhës në funksione stilistike;
- njohjen e veçorive gjuhësore që lidhen me paragrafin dhe tekstin si tërësi;
- logjika e bashkërenditjes dhe e nënrenditjes në shkrim;
- pasurimi i fjalorit, sidomos atij kritik dhe analitik.

- format e ligjërimit letrar dhe joletrar/ aplikimi dhe mospalikimi i standardit si gjuhë e letërsisë;
- marrëdhëniet sintaksore dhe efektet narrative;
- përdorimin e gjuhës në media të ndryshme;
- drejtshkrim, drejtshqiptim, përdorim kreativ i gjuhës.

Jepen tekste, ushtrime dhe detyra, duke nënkuptuar këtu edhe shkrimin e eseve, me qëllim zhvillimin e shkathtësive gjuhësore nga stilistika gjuhësore, gjuha standarde, gjuha dialektore etj. Jepen shembuj të dimensioneve stilistike të shqipes; sequenca, stili, diskurset; gjuha kritike dhe ajo kreative.

Rezultatet e pritura

Në fund të klasës së njëmbëdhjetë, nxënësi:

- zotëron shkathtësi të veçanta individuale, njohëse dhe komunikative, për punë individuale dhe në grupe;
- analizon, vlerëson, sintetizon dhe organizon informata nga burime të ndryshme, duke i shtruar ato në nivelin e pyetjeve, problemeve e çështjeve;
- njeh formacionet e ndryshme kulturore e letrare të modernitetit;
- identifikon, njeh dhe praktikon, nëpërmjet shkrimit, format e ndryshme letrare dhe joletrare;
- kupton format dhe idetë themelore të kulturës dhe letërsisë së gjysmës së dytë të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX;
- kupton tiparet e letërsisë e të kulturës shqiptare që lidhen me modernitetit;
- zotëron shkathtësitë argumentuese dhe vlerësuese për kulturën dhe për letërsinë, sikur edhe dijet gjuhësore, duke praktikuar lloje të ndryshme të analizave e të shkrimeve; veçanërisht në aspektin semantik dhe sintaksostilistik;

QASJET NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE

Gjuha shqipe është mjet komunikimi për të gjitha lëndët. Megjithatë, lidhje të drejtpërdrejta vihen me historinë, gjeografinë, edukatën qytetare, artet etj. Disa tema nga këto lëndë ndikojnë në zhvillimin e shkathtësive të komunikimit, në formimin kulturor dhe në krijimin e individualitetit të

pavarur. Përveç çështjeve ndërlëndore, p.sh. tema nga shëndetësia, për të drejtat e njeriut, për çështjet gjinore etj., temat mund të zgjedhen nga mësimdhënësi, varësisht nga rëndësia dhe aktualiteti që kanë (nga televizioni, revistat, gazetat apo nga rrethi i tyre).

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Mësimdhënësi duhet t'i zbatojë metodat më bashkëkohore të mësimdhënies: interaktiviteti. Kjo hap rrugë për mësimin aplikativ. Mësimi duhet të organizohet në seanca që bashkojnë të folurit, shkrimin dhe leximin. Seanca ndryshon varësisht nga synimet e mësimdhënësit dhe të reagimeve të nxënësve.

Do të aplikohen dy mënyra leximi: leximi analitik dhe leximi i shpejtë. Leximi analitik ka si qëllim analiza të hollësishme të objektivave të caktuar dhe mund të aplikohet në tekste të gjatësive të ndryshme. Leximi i shpejtë nënkupton leximin e zakonshëm. Me të nxitet pavarësimi i nxënësve për leximin e teksteve të ndryshme. Raporti ndërmjet këtyre dy tipave të leximit duhet të jetë i ekuilibruar.

Lidhja ndërmjet leximit e shkrimit duhet të jetë e përhershme, qoftë edhe kur aplikohen shkrime kreative, imituese ose transformuese. Studimi aplikativ i gjuhës është një element i përbashkët i të gjitha aktiviteteve të parashtruara.

VLERËSIMI

Vlerësimi që duhet të bëhet gjatë klasës së dymbëdhjetë, dhe në fund të saj, lidhet me veprimtarinë dhe mjetet me të cilat gjykohen puna dhe arritjet e nxënësve për klasën përkatëse. Parimet, kushtet, metodat, teknikat dhe mjetet e vlerësimit realizohen në përputhje me standardet ndërkombëtare të vlerësimit për këtë nivel. Kjo nënkupton praktikimin e tipave të ndryshëm të vlerësimit, varësisht nga nevoja dhe situata, siç janë: vlerësimi përcaktues, formues, përmbledhës, individual, në grup, i brendshëm, i jashtëm etj.

LITERATURA

- Tekstet që do të hartohen në mbështetje të këtij plani dhe programi
- Tekste të mëhershme që kanë për objekt këtë materie
- Zejnullah Rrahmani: *Teoria e letërsisë (për shkollat e mesme)*
- Tekste të tjera alternative

ENGLISH LANGUAGE CURRICULUM

**Gymnasium: Languages – 4 hours per week, total 148;
General Gymnasium, Social Sciences,
Mathematics and Information Technology - 3 hours per week, total 111;
Natural Sciences – 2 hours per week, total 74**

INTRODUCTION

Learning is a complex process of discovery, collaboration, and inquiry facilitated by language. Composed of interrelated and rule governed symbol systems, language is a social and uniquely human way of representing, exploring, and communicating meaning. Language is an essential tool for forming interpersonal relationship, understanding social situations, extending experiences, and reflecting on thought and action. Language is the principal instrument of thought and the primary basis of all communication.

PHILOSOPHY

The program for English language will emphasize the importance of experiencing language in context. Learners' background knowledge, skills and attitudes will be used as means of developing communicative abilities: interpreting, expressing and negotiating meaning through oral and written texts. As the learners develop communicative skills, they also increase their linguistic awareness and develop language learning skills and strategies.

In the English language program students will acquire various kinds of knowledge, skills and attitudes about:

- Interpreting, expressing and negotiating meaning (communication).
- Patterns of ideas, behaviours, manifestations, cultural artefacts and symbols (culture).

- Sounds, written symbols, vocabulary, grammar and discourse (language).
- Cognitive, socio-affective and meta-cognitive processes (general language education).

Learners will learn to communicate in English through the processes of ‘reception’, ‘comprehension’, ‘production’ and ‘negotiation’. **Reception** is receiving the information and decoding the message. **Comprehension** involves deriving meaning or significance from an oral or written text. **Production** is expressing meaning by creating oral and written texts to suit different participants, topics, purposes and reasons for communication. **Negotiation** is the *interaction process*: participants in the communication process must adjust to the needs and intentions of others. Integral to all three processes are the communicative intents or communicative functions, inquiring reporting, or describing and so on, which are developed in the experience / communication component. Students will also learn about the language and how to use it: the sound – symbol system, vocabulary, structures and discourse elements that are needed to convey ideas and enhance communication in an oral or written context.

AIMS

Following the long-term aims of the English Language Curriculum, in order to communicate effectively and increase their cultural understanding, in grade twelve learners should:

- Further develop, deepen and apply the four language skills;
- Deepen and broaden their linguistic and meta-linguistic knowledge;
- Use the target language for real-life purposes in order to integrate English with other learning areas;
- Develop respect and tolerance for cultures worldwide by increasing their awareness with regards to cultural similarities and differences;
- Become active participants in the learning process taking greater responsibility for their own learning and deepening their critical thinking skills;
- Increase their capability to learn independently and monitor their own progress as part of the process of becoming life-long learners.

The Scope of Grade Twelve English Language Curriculum

I COMMUNICATION Enable learners to deepen their language skills and gain ability and confidence for effective communication both with native and non-native speakers of English.		
1. Listening General objective: Enable learners to listen to a wide variety of spoken discourse, including teachers, peers, and electronic media, and gain an increasing level of comprehension of newly acquired language.		
Specific objectives	Suggested language activities	Attainment targets
Learners should be able to: <ul style="list-style-type: none"> • Listen for general meaning and respond orally or in writing; • Listen for specific information and respond; • Listen to more extended speech or lectures; • Follow more complex lines of arguments; • Listen to most TV news; • Listen to a live or taped lecture, take notes or write summary; • Listen for information or pleasure; • Listen and gather data, take notes, and outline; • Listen and raise awareness of how voice quality and intonation can convey meaning. 	<ul style="list-style-type: none"> • Following instructions; • Filling in charts; • Completing incomplete texts; • Summarising in their own words the passage they listened about; • Listening to radio/TV commercials; • Viewing a film; • Listening to telephone conversation, recorded lectures, current events discussion; • Listening to oral presentation of a poem, short story or reports on cultural events; • Listening to monologues, radio programmes, interviews and presentations; • Identifying moods; • Answering true/false questions. 	Learners can: <ul style="list-style-type: none"> • Cope with language spoken at more extensive speed with little interference and hesitancy; • Identify and note the main points ; • Understand specific details including viewpoints; • Understand the main points of radio, or TV programmes on topics of personal and professional interest when the delivery is at near normal speed; • Understand (comprehend) the majority of films, most TV news and current affairs in Standard English; • Understand extended speech and follow more complex lines of argument provided when the topic is reasonably familiar; • Understand a range of materials that contains some more complex sentences and unfamiliar language.

2. Reading General Objective: Enable learners to read a variety of texts for a wide range of purposes with an increased level of comprehension and apply their interpretation to everyday situations.		
Specific objectives	Suggested language activities	Attainment targets
Në një mësimdhënie bashkëkohore komunikimit i kushtohet vëmendje e posaçme, kjo do të thotë: Cilat mjete gjuhësore u duhen nxënësve që në situata të caktuara gjuhësore të shprehin dhe të sillen në mënyrë të duhur?

Komunikimi është mënyra më e pranueshme për arritjen e objektivave të përcaktuar. Pikënisja për një mësimdhënie të tillë nuk do të jetë një rregull gramatikore, por situatat e ndryshme gjuhësore. Kjo do të thotë se prej situatave gjuhësore nxirren rregullat dhe jo e kundërta

2. Radhitje e qartë e rrafsheve gjuhësore

Është e nevojshme, posaçërisht në nivelin fillestar të mësimdhënies, që t'u jepet një theks i veçantë rrafsheve të ndryshme gjuhësore, si

- Përpunimit të vokabularit (fjalësit)
- Përpunimit të teksteve
- Strukturat gjuhësore

e kjo do të thotë: të caktohen prioritetet brenda një njësie mësimore.

Nuk mund p.sh., të zhvillohet edhe vokabulari i ri edhe strukturat të reja gjuhësore.

Mënyra më e drejtë do të ishte që së pari të përpunohet dhe trajnohet vokabulari, i cili paraqitet në leksionet e caktuara.

Pastaj vokabulari i përpunuar do të futet në struktura të reja sintaktike.

Mësuesi, brenda mësimdhënies komunikative, zgjedh situata të tilla gjuhësore, të cilat janë të afërta me përditshmërinë, ashtu që strukturat e ushtruara të jenë natyrale e jo artificiale.

3. Realizimi i një ore përmes objektivave

Përcaktimi i qartë i objektivave është lehtësim për punën e mësuesit dhe e ndihmon atë vetë në përcaktimin e objektivave më specifike. Kur të arrihet objektivi - kjo do të thotë se nxënëset/it e zotërojnë materien e përpunuar- atëherë mësimdhënësi do të duhej të jetë i kënaqur me këtë. Nëse ende nuk ka përfunduar ora mësimore, nuk ka logjikë që të futen edhe përmbajtje të reja në orë. Në këtë rast më e logjikshme do të ishte që të përforcohet ajo që është mësuar me anë të ushtrimeve të llojllojshme, të përpunohet një këngë gjatë orës së mësimit ose të futet ndonjë lojë mësimore më qëllim të arritjes së objektivit.

Gjithashtu, është e rëndësishme që në fazën e “e njoftimit me temën e re” (Sprachbegegnung) të hyhet mundësisht shpejt në thelb të “problemit” me një motivim me të cilin arrihet objektivi dhe jo të shkohet rrugëve anësore, të cilat do t'i lejonin nxënëses/sit të hamenden rreth asaj se çka në të vërtetë mund të jetë qëllimi i orës mësimore.

4. Kufizimi i objektivave

Duke i njohur nxënësit dhe duke i pasur të qarta objektivat e përcaktuar më parë mësuesi nuk do të duhej të bëjë gabim e të përcaktojë shumë objektiva për një orë mësimi e të habitet pastaj pse nuk është arritur objektivi. Për këtë arsye mësuesi duhet të caktojë një objektiv specifik, të cilin tenton ta arrijë brenda një ore mësimi. Pëcaktimi i shumë objektivave për një orë ka për pasojë këtë:

Mbetet pak kohë për ushtrime dhe zbatim, për këtë arsye nxënëset/sit nuk mund ta bëjnë zotërimin e mjaftueshëm të materies. Në orën e ardhshme duhet të përsëritet dhe të sqarohet materia edhe një herë, sepse mund të ndodhë që të jenë përvjedhur gabime, të cilat pastaj me mund mund të korrigjohen, arsye kjo për t'u dëshpruar arsimtari dhe nxënësi.

Llogaria është e thjeshtë: një orë e stërngarkuar dhe një orë për përsëritje bëjnë dy. Në këtë rast do të ishte më e logjikshme që materia qysh nga fillimi të ndahet në dy orë.

Sipas hulumtimeve nxënëset/sit mesatarë janë në gjendje që për një orë mësimi të mbajnë në mend rreth dhjetë shprehje të reja. Ky fakt nuk duhet të lihet anash.

5. Radhitja: të dëgjuarit/ të kuptuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit

Posaçërisht në mësimin fillestar do të duhej të ruhet radha e katër shkathtësive, që d.m.th.:

- Nxënëset/sit nuk do të duhej të flasin asgjë që nuk e kanë dëgjuar më parë,
- Ata nuk do të duhej të lexojnë asgjë që nuk e kanë dëgjuar dhe folur më parë,
- Ata nuk do të duhej të shkruajnë asgjë që nuk e kanë dëgjuar, folur dhe lexuar më parë.

Për t'iu përmbajtur kësaj radhitjeje posaçërisht te fillestarët, flasin këto arsye:

- Nëse flitet një fjalë e re, logjikisht ajo do të duhej të dëgjohej më parë. Në anën tjetër, leximi i një fjale të re është më i lehtë kur ajo më parë është dëgjuar ose folur. Edhe të shkruarit do të duhej të ishte më i lehtë, kur ajo fjalë është dëgjuar, folur apo lexuar më parë.

- Grafemat e gjermanishes dhe të shqipes nuk përputhen në çdo rast. Pasi që nxënëset/sit janë mësuar me alfabetin e gjuhës shqipe, mund të paraqitet “përgjithësimi” ose interferenca, nëse fillohet herët me shkrimin në gjuhën gjermane. E mu kjo mund të shmanget, nëse mësimi fillon me të dëgjuarit dhe pastaj lëviz mbi stacionet e të folurit dhe të lexuarit në drejtim të të shkruarit.

6. Puna aktive dhe konkrete

Një dallim mes mëimit të gjuhës gjermane në Gjermani- pa marrë parasysh a bëhet fjalë për gjermanishten si gjuhë amtare ose për gjermanishten si gjuhë e dytë ose e huaj- dhe në Kosovë është ndër të tjera se mjedisi-kosovar mund të japë pak ose aspak informacione për RFGJ-në dhe, përveç orës së mëimit, pothuajse nuk ekziston ndonjë mundësi për t’u zbatuar ajo që është mësuar. Kështu që bie mundësia që ajo që është mësuar në shkollë të thellohet jashtë orëve të mëimit si përmes ekskursioneve, zhvillimit të intervistave etj. Në këtë kontekst nuk duhet mbiçmuar apo nënçmuar televizionin.

Prodhimi (krijimi) i pllakatave, mozaiqeve dhe i posterëve, prodhimi i punëdoreve të vogla janë gjithashtu të rëndësishme.

Një arsye tjetër për aktivitete të këtilla janë njohuritë nga psikologjia e të mësuarit: sipas saj rezultati (arritja) është më i madh, sa më shumë që të mbështeten veprimet gjuhësore nga veprimet konkrete.

7. Kohë e mjaftueshme për ushtrime dhe zbatim

Për nxënien dhe zotërimin e sigurt të një gjuhë nevojiten në përgjithësi tri gjëra: kohë, kohë dhe prapë kohë.

Ne e dimë se ekzistojnë 3 tipa të ndryshëm të nxënësve:

Tipat akustikë (ata e nxënë- mësojnë gjuhën më shpejt përmes dëgjimit - veshit);

Tipat vizuelë (pamorë) (ata e nxënë gjuhën në radhë të parë përmes syrit);

Tipat motorikë (ata e nxënë gjuhën më së shpejti përmes të shkruarit).

Për këtë arsye është e rëndësishme që ushtrimi të zgjedhet gjithashtu edhe përmes këtij këndvështrimi; që gjuha të mësohet njëkohësisht

përmes kanaleve të shumta, pasi që te shumica e atyre që mësojnë gjuhën bëhet fjalë për tipa të ashtuquajtur të përzier.

8. Llojlojshmëria në fazat e ushtrimeve

Secili mësues dhe mësuese e di saktësisht se në orën e gjuhës të ushtruarit monoton të strukturës së fjalisë ka më shumë ndikim negativ sesa që e arrin atë që është synuar.

Nxënësit dhe nxënset do ta humbin interesimin për mësim dhe nuk do të marrin pjesë aktivisht në të. Në anën tjetër, ne e dimë se motivimi i synuar dhe dhënia e detyrave interesante mund ta ngrisin dëshirën për mësim dhe gatishmërinë për punë (rezultate).

Ndërrimi i formave të punës (puna e veçantë, puna në çifte ose në grupe) është shumë më frytëdhënëse, por edhe lojërat në mësim, këngët dhe poezitë si dhe tregimet duhet të bëhen pjesë përbërëse të mësimin.

9. Korrigjimi i shprehjeve të nxënësve

Pothuajse asnjë çështje nuk diskutohet aq shpesh dhe në mënyrë kundërthënëse në rrethin e mësimitdhënësve se sa mënyra e korrigjimit.

Derisa korrigjimin disa e vështrojnë si pengesë të rrjedhjes gjuhësore, të tjerët mbështeten në atë se gabimet duhet korrigjohen menjëherë që të mos përvihen.

Ndoshta mund të bëhet një kompromis i arsyeshëm gjatë korrigjimit dhe ai do të dukej kështu:

- Në fazën e kontaktit të parë me temën e re, si për shembull përmes një fotografie, mësueset dhe mësuesit presin një të shprehur të lirë të nxënësve të tyre.

Po të bëjnë korrigjimin masiv gjatë kësaj faze të mësimin, nxënësit ndoshta do të tërhiqeshin menjëherë dhe në fund do të heshtin plotësisht.

Në këtë fazë është e drejtë që korrigjimet, ndër të tjera, të parashtrihen në atë mënyrë, për shembull, një fjalë e thënë gabimisht të përsëritet nga mësuesi edhe një herë, por natyrisht në mënyrë të drejtë.

- Situata në fazën e zbatimit dhe të ushtrimit është tjetër. Këtu bëhet fjalë për trainimin e vokabularit dhe të strukturave dhe këtu korrigjimi natyrisht është i pakushtëzueshëm.

S'ka diskutim se nxënësit/sit nuk bënë t'i turpërojmë para klasës, por të tregojmë takt pedagogjik.

10. Diferencimi

Ndodh shpesh që rezultatet e ndryshme gjuhësore të nxënësve në mësim të paraqesin pjesërisht vështirësi të mëdha.

Derisa një nxënës ta ketë kryer tanimë detyrën e tij, të mërzhitet në mësim apo të pengojë të tjerët, duke kryer detyrat, tjetri nuk është ende gati, edhe pse ka mjaft kohë në dispozicion.

Për mësueset dhe mësuesit ekzistojnë këtu dy mundësi: të bëjnë kinse nuk ka dallime në rezultate, por atëherë do të duhej që të merrej parasysh edhe ajo që herët apo vonë do të paraqiten vështirësitë nga ngarkesat (kërkesat tona) e vogla, përkatësisht të mëdha.

Mundësia tjetër mbështetet në praktikimin e masave të diferencimit të brendshëm, e kjo pa dyshim për nxënësen/sin do të thotë të punojë.

Dallohen forma të ndryshme të diferencimit, të cilat nuk do të diskutohen këtu, sepse ato tanimë janë të njohura.

Vetëm dy forma duhet të shikohen më për së afërmi:

Diferencimi kuantitativ dhe kualitativ

- *Diferencimi kuantitativ* do të thotë se detyrat dallohen në kuantitetin e tyre, pra në sasinë e tyre. Kjo s' do të thotë asgjë tjetër, veçse nxënësit " e shpejtë" marrin detyra plotësuese. Masa zbatohet lehtë, sepse mësueset dhe mësuesit duhet vetëm që të mendojnë detyra shtesë, të cilat pastaj, nëse është nevoja, ia japin disa nxënësve. Ky lloj i diferencimit megjithatë i ka edhe të metat e tij, sepse me an të detyrave shtesë prej nxënësve kërkohet edhe më shumë e në këtë mënyrë bëhen gjithnjë e më të mirë. Me fjalë të tjera: dallimi në mes të të mirëve dhe më pak të mirëve bëhet gjithnjë më i madh. Gjithashtu, shtrohet pyetja, mos ndoshta nxënësit më të vjetër i shohin këto detyra shtesë si një lloj dënimi për atë që kanë punuar më shpejt.

- *Diferencimi kualitativ* shtron më shumë kërkesa. Me këtë rast jepen detyra me shkallë të ndryshme vështirësie, pa e lënë anash temën e përbashkët. Të nisemi prej asaj, që brenda një klase kemi të bëjmë me tri grupe të ndryshme të rezultateve A, B, dhe C, ku me grupin A nënkuptojmë grupin me arritje më të larta, me grupin B grupin me arritje të mesme dhe me grupin C grupin me arritje më të dobëta. Skema e rrjedhës së një ore mësimore do të mund të dukej kështu:

Sprachbegegnung - Kontakti i parë me temën e re (Evokimi)		
e përbashkët për të gjithë nxënësit		
Spracherarbeitung - Përpunimi i temës (Realizimi)		
e përbashkët për të gjithë nxënësit		
Sprachübung - Ushtrimet rreth temës (Reflektimi)		
diferencimi i grupeve sipas shkallës së arritshmërisë, p.sh.		
Grupi A Përpunimi i tërë tekstit. Detyra kreative shtesë	Grupi B Përpunimi i tërë tekstit me ndihmesë, p.sh. Artikelhilfe	Grupi C Përpunimi i një pjese të tekstit me ndihmesë, p.sh. Artikelhilfe.

Shpesh dëgjohej edhe një argument që flet kundër kësaj forme të diferencimit e që është:

Tek kjo mënyrë e zhvillimit të mësimin nuk mësojnë të gjithë nxënësit të njëjtën gjë, sepse profili i kërkesave është i ndryshëm, në këtë rast trishkallësh.

- Një analizë e këtij argumenti tregon megjithatë shumë shpejt, se kjo nuk mund të vlejë gjithmonë, sepse: nxënësit nuk e arrijnë parimisht kurrë njësoj shpejt dhe mirë objektivin e orës mësimore.
- Ajo çka arrihet me anë të këtij procesi është shmangia nga kërkesa e tepërt apo e paktë, sepse aftësitë e nxënësve për të nxënë janë të ndryshme, pavarësisht nga ajo se a praktikohen masat e diferencimit apo jo.

11. Ndarja e një ore mësimore

Rrjedha e një ore mësimore do të mund të dukej kështu:

Artikulationsstufen	Methodische Absichten
1. Sprachbegegnung	Begegnung mit der neuen Sprachsituation, z.B. durch Bild, Tonaufnahme, Filmausschnitt, Lehrer- oder Schülervortrag.
2. Spracherarbeitung	Bereitstellen und Erarbeiten von neuem Wortschatz oder neuen Strukturen.
3. Sprachübung	Übungsbeispiele, möglichst in Form von realen Sprechhandlungen.

	Aufgreifen und Wiederholen von bekanntem Wortschatz mit neuen Strukturen und umgekehrt. Differenzierungsmaßnahmen Sprachlernspiele
4. <i>Sprachanwendung</i>	Übertragen des Gelernten auf neue Situationen: Im Klassenzimmer Im außerschulischen Bereich

GRADUALITETI (SHKALLËZIMI) NDËRPROGRAMOR

Para se t'i hyjmë punës për planin e detajizuar për klasë, ne kemi punuar një lloj plani të përafërt "global" për katër vjet, në mënyrë që të kemi sadopak të qartë se ku duam të arrijmë pas përfundimit të katër klasave (një nivel, d.m.th. klasat gjashtë - nëntë ose dhjetë – dymbëdhjetë (trembëdhjetë).

Arsyeja tjetër është që planet e punuara për klasa të kenë një ndërlidhje programore dhe të vazhdojnë përafërsisht aty ku janë ndërprerë vitin paraprak, të mos ketë përsëritje të objektivave të përgjithshëm ose kthim drastik prapa.

Ky plan është punuar sipas taksonomisë së Blumit dhe është i konceptuar ashtu që të mund të lexohet vertikalisht (përparimi sipas taksonomisë për një vit shkollor) dhe horizontalisht që d.m.th. përcjellja e një objekti prej vitit në vit në një shkallë më të lartë.

Për të pasur më të qartë ja në vijim paraqitja tabelare e shkallëzuar e niveleve dhe e përmbajtjeve:

	1. Lernjahr	2. Lernjahr	3. Lernjahr	4. Lernjahr
Lernziel 1	Einfache sprachliche Kontakte herstellen	Miteinander sprechen	In mündlichen und schriftlichen Kontakten persönliche Mitteilungen machen	Über Ereignisse berichten
Lernziel 2	Gegenstände und Tätigkeiten benennen und beschreiben, nach Gegenständen fragen	Über Gegenstände und Tätigkeiten Aussagen machen	Sachinformationen einholen und weitergeben	Gegenstände und Vorgänge beschreiben

Lernziel 3	Anweisungen verstehen und Fragen beantworten	Anweisungen verstehen und erteilen	Anweisungen geben und Aufforderungen äußern	Tätigkeiten und Vorgänge beschreiben
Lernziel 4	Sich orientieren und verständigen	Angaben zur örtlichen Umgebung machen	Angaben zu Zeit, Lage und Raum machen	Mitteilungen sachlichen Inhalts machen
Lernziel 5	Sprachliche Kontakte knüpfen	Wünsche und Gefühle äußern	Erlebtes und Gehörtes wiedergeben	Vorgegebene Geschichten und Erlebnisse mündlich und schriftlich darstellen
Lernziel 6	Einfache Auskünfte einholen und erteilen	Persönliche Daten erfragen und Angaben machen	Die eigene Meinung darstellen	Über Zukünftiges und Erdachtes berichten

NDËRLIDHJA NDËRLËNDORE

Në anën tjetër, gjuha që pikësëpari shërben si mjet komunikimi nuk mësohet ekskluzivisht në orët e gjuhës, por në një formë a në një tjetër të të gjitha lëndët mësimore, përderisa në to aftësitë, pikëpamjet e ndryshme e njohuritë zhvillohen përmes rrugëve gjuhësore.

Për atë që sa gjuha ndihmon të lëndët e tjera, atë mund të ndihmojnë lëndët e tjera për arritjen e objektivave brenda mësimin të gjuhës gjermane. Para së gjithash, edhe temat e zgjedhura kanë të bëjnë me shumë fusha të jetës e me këtë edhe me shumë lëndë mësimore, njohuritë e të cilave na ndihmojnë në mësimin e gjuhës gjermane.

Natyrisht se gjuha para së gjithash është e ndërlidhur me artet, sepse çdo fjalë a nocion i ri mund (duhet) të shpjegohet përmes këngës, vizatimit, fotografisë a lojës (qoftë te fëmijët (niveli II) apo te të rinjtë (niveli III)).

Edhe njohuritë nga shkencat, qoftë natyrore apo shoqërore, duhet t'i shfrytëzojmë gjatë trajtimit të temave të ndryshme të parapara për klasën e dymbëdhjetë.

Këto njohuri shfrytëzohen sidomos në fazën e parë të orës (EVOKIMI), ku varësisht nga temat që do të trajtojmë, përdorim njohuritë nga lëndët e tjera (nxënësit i parapërgatisim për temën).

Të ndërlidhura me shkencat shoqërore e që vetëdijësojnë nxënësit për çështje të shumta jetësore si dhe u ndihmojnë të arrijnë shkathtësitë e duhura jetësore e komunikative, janë temat e shumta në klasën e dymbëdhjetë (e sidomos me edukatën qytetare).

Ndërlidhja ekziston edhe me shkencat natyrore sidomos të potencuara janë ato njohuri që kanë të bëjnë me ambientin, ruajtjen e tij, shëndetin (ruajtjen e shëndetit të vet e të të tjerëve), ushqimin etj.

TEKSTET MËSIMORE

Grupi i ekspertëve për gjuhë gjermane propozon këto tekste mësimore:

Klasa 11: Deutsch international, Band 2, Cornelsen Verlag, Berlin

Klasa 12: Deutsch international, Band 3, Cornelsen Verlag, Berlin

alternativ:

Klasa 11: Blick 2, Hueber Verlag, Ismaning

Klasa 12: Blick 3, Hueber Verlag, Ismaning

MATEMATIKË

Gjimnazi i përgjithshëm (2 orë në javë, 74 orë në vit)

HYRJE

Matematika për klasën e dymbëdhjetë është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive paraprake të fituara nga lënda e matematikës në vitet paraprake. Kjo u mundëson nxënësve të fitojnë njohuri e shkathtësi për të zhvilluar të kuptuarit e botës fizike, asaj shoqërore dhe zhvillon aftësitë e nxënësit për të shtruar drejt problemet e ndryshme nga fusha e matematikës dhe nga jeta e përditshme si dhe aftësitë për t'i zgjidhur ato në mënyrë korrekte.

QËLLIMET

Të mësuarit e lëndës së matematikës ka për qëllim që të nxënësi:

- Të zhvillojë aftësitë e të menduarit e të shprehurit në mënyrë të qartë dhe precize;
- Të avancojë edhe më tej kureshtjen dhe kreativitetin e tij;
- Të zhvillojë dhe të thellojë edhe më tej shprehitë për punë të pavarur;
- Të zhvillojë aftësitë që njohuritë e fituara t'i zbatojë në zgjidhjen e disa problemeve nga lëmenjtë e tjera (fizikë, kimi, etj.) dhe jeta e përditshme;
- Të sigurojë bazë solide për shkollim të lartë.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nga përmbajtja programore e lëndës së matematikës për klasën XII nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- **Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat**
 - Në kuptimin e sjelljeve personale (të jetë kooperativ, i hapur, i sigurtë, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik etj.)
- **Të kuptojë**
 - Domethënien e termave në kontekst (matricë, përcaktor (determinantë) deri te rendi i tretë, vektor, format e ndryshme të ekuacionit të drejtëzës etj.)
 - Veprimet me matrica (mbledhjen, zbritjen, shumëzimin me skalar dhe shumëzimin e matricave).
 - Veprimet me vektorë (mbledhjen, zbritjen, shumëzimin me skalar, shumëzimin skalar, vektorial si dhe atë të përzier).
- **Të zbatojë**
 - Përcaktorët për zgjidhjen e sistemeve të ekuacioneve lineare deri me tri të panjohura (metoda e Kramerit);
 - Veprimet me vektorë (prodhimin skalar, vektorial dhe të përzier) në gjeometri;
 - Kushtin që dy drejtëza të një rrafshi të jenë paralele, normale në zgjidhjen e detyrave të ndryshme;
 - Vetitë e vijave të gradës së dytë si dhe kushtin që drejtëza e dhënë të jetë tangjente e vijave të gradës së dytë në zgjidhjen e detyrave të ndryshme;
 - Sistemet e ekuacioneve jolineare në zgjidhjen e detyrave të ndryshme në lidhje me vijat e gradës së dytë.
- **Të demonstrojë shkathtësi mendore**
 - Gjatë diskutimit dhe zgjidhjes së sistemeve të ekuacioneve lineare që përmbajnë parametra;
 - Gjatë analizës së zgjidhshmërisë së problemit në saje të të dhënave që disponon;
 - Në zbatimin e të menduarit kreativ dhe kritik për formimin e vijave të gradës së dytë, duke shfrytëzuar vetitë e veçanta të tyre, si dhe në vërtetimin e rezultateve të ndryshme matematike, duke u nisur nga supozimi i kundërt e duke arritur në ndonjë kundërtënie, apo duke sjellë kundërshebu.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES SË LËNDËS

Ndërtimi i përmbajtjes është organizuar në përputhje me qëllimet dhe objektivat e lëndës. Kategoritë e përmbajtjes së lëndës janë dhënë në tabelën nr. 1.

Tabela 1.

Lënda	Nënkategoritë e përmbajtjes		Orët	%	Gjithsëj %
Matematikë	I. Algjebër		27	36.47	100
	II. Gjeometri		28	37.84	
	III. Analizë		5	6.76	
	Provimet me shkrim		6	8.11	
	Testet		4	5.41	
	Orë rezervë		4	5.41	

PËRMBAJTJA, REZULTATET E PRITURA, LIDHJA NDËRLËNDORE

Tabela 2.

Kategoritë e përmbajtjes	Nënkategoritë e përmbajtjes	Përmbajtja	Rezultatet e pritura	Lidhja ndërlëndore
I. Analizë	I.1. Trigonometri (vazhdim)	I.1.1. Zgjidhja e trekëndëshit Teorema e sinusit, teorema e kosinusit si dhe zbatimi i tyre në zgjidhjen e trekëndëshit dhe vërtetimin e formulave të ndryshme.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: 1. të përshkruajë dhe të zbatojë teoremat e sinusit dhe kosinusit në zgjidhjen e detyrave të ndryshme;	Fizikë (zgjidhja e disa problemeve në fizikë duke shfrytëzuar sistemet e ekuacioneve lineare); informatikë (algoritmi për shumëzimin e dy matricave).
II. Algjebra	II.1. Matricat dhe përcaktorët	II.1.1. Matrica Kuptimi i matricës (deri te rendi i tretë); matricat e barabarta; veprimet me matrica (mbledhja, zbritja, shumëzimi me skalar, shumëzimi). II.1.2. Përcaktorët Kuptimi i përcaktorit (deri te rendi i tretë); llogaritja e përcaktorit (metoda e Sarusit, metoda e trekëndshit); vetitë themelore të përcaktorëve. II.1.3. Sistemet e ekuacioneve lineare dhe atyre jolineare Kuptimi i sistemit të ekuacioneve lineare (deri me tri të panjohura); diskutimi dhe zgjidhja e sistemit të	2. të përkufizojë matricat deri te rendi i tretë si tabela me elemente numra; 3. të kryejë veprimet me matrica; 4. të përshkruajë përcaktorët deri te rendi i tretë dhe të llogaritë vlerën e tyre me metodën e Sarusit, të trekëndëshit si dhe duke shfrytëzuar vetitë e tyre; 5. të dallojë sistemet lineare (deri më tri të panjohura) nëpërmjet shembujve të ndryshëm; 6. të zgjidhë sistemet lineare (deri me tri të panjohura) me metodën e	

<p>III. Gjeometria</p>	<p>II.2. Algjebër vektoriale</p> <p>III.1. Gjeometria analitike në rrafsh</p>	<p>ekuacioneve lineare (metoda e zëvendësimit, metoda e eliminimit, metoda e Kramerit); zbatimi i sistemit të ekuacioneve lineare. Sistemet e ekuacioneve lineare (me dy të panjohura), njëri prej ekuacioneve të të cilit është linear e tjetri katror, si dhe sistemet me dy të panjohura, kur të dy ekuacionet janë kuadratike.</p> <p>II.2.1. Algjebër vektoriale Kuptimet themelore mbi vektorët; trajta koordinative (në rrafsh dhe në hapësirë); Veprimet me vektorë (mbledhja, zbritja, shumëzimi me skalar); pavarësia lineare e vektorëve; prodhimi skalar, si dhe zbatimet gjeometrike të tij (distanca ndërmjet dy pikave, ndarja e segmentit në raportin e dhënë dhe syprina e trekëndëshit).</p> <p>III.1.1. Drejtëza Format e ndryshme të ekuacionit të drejtëzës; Pozita reciproke e dy drejtëzave; këndi në mes të dy drejtëzave; distanca e pikës nga drejtëza. Simetralja e këndit.</p>	<p>zëvendësimit, të eliminimit ose të përcaktorëve; 7. të zbatojë sistemet e ekuacioneve lineare në zgjidhjen e detyrave të ndryshme nga jeta praktike;</p> <p>8. të interpretojë vektorin nëpërmjet koordinatave në rrafsh dhe në hapësirë; 9. të kryejë veprimet me vektor; 10. të zbatojë vetitë e prodhimi skalar në gjeometri; 11. të dallojë format e ndryshme të ekuacionit të drejtëzës në rrafsh nëpërmjet të ekuacioneve të tyre kanonike;</p> <p>12. të shqyrtojë pozitën reciproke të drejtëzës me vijat e gradës së dytë (prerjet konike) nëpërmjet parametrave të tyre.</p>	<p>Fizikë: interpretimi vektorial i disa madhësive fizike si rruga, shpejtësia, nxitimi, forca, etj.; puna si prodhim skalar mes forcës dhe rrugës; momenti i forcës si prodhim vektorial i vektorit të rrezes dhe forcës etj.</p> <p>Fizikë: ligjet e Keplerit; gjeografi dhe astronomi: trajektoret eliptike të planeteve të sistemit diellor etj.</p>
-----------------------------------	---	--	---	--

		<p>III.1.2. Vijat e gradës së dytë në rrafsh</p> <p>Rrethi. Ekuacioni kanonik i rrethit dhe format e veçanta të tij; rrethi dhe drejtëza (tangjenta e rrethit, sekanta). Translatimi i sistemit koordinativ.</p> <p>Elipsa. Konstruktimi. Përkufizimi dhe ekuacioni i elipsës; vatrat dhe direktrisat; drejtëza dhe elipsa (tangjentja e elipsës, sekanta).</p> <p>Hiperbola. Konstruktimi. Përkufizimi dhe ekuacioni i hiperbolës; vatrat dhe direktrisat; drejtëza dhe hiperbola (tangjentja e hiperbolës, sekanta).</p> <p>Parabola. Konstruktimi. Përkufizimi dhe ekuacioni i parabolës. Drejtëza dhe parabola (tangjentja e parabolës, sekanta).</p>		
--	--	--	--	--

5. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Si në çdo lëndë, edhe në lëndën e matematikës detyra kryesore e arsimtarit është udhëheqja e veprimtarive arsimore të cilat përmbushin arrijtjen e rezultateve të të nxënësve që parashikohen në objektiva.

Praktika ka treguar se teknikat, metodat dhe strategjitë, të cilat sigurojnë një mësimdhënie produktive, janë ato të cilat i mundësojnë nxënësit të përfshihen aktivisht në ndërtimin e të kuptuarit, në zhvillimin e strategjive matematike për zgjidhjen e problemeve dhe zhvillimin e aftësive për të zbatuar njohuritë në jetën e përditshme. Detyra e shtëpisë, seminarët e ndryshme janë segmente shumë të rëndësishme që mundësojnë fillimin e ndërtimit të shprehive për punë të pavarur dhe kreative në të ardhmen.

Në vendimet që merr mësimdhënësi për zgjedhjen e metodave mësimore, krahas shumë faktorëve, duhet të ketë parasysh edhe:

- natyrën e materialit mësimor;
- tipin e të nxënësve;
- nivelin dhe kërkesat e nxënësve.

Për këtë qëllim, metodat dhe teknikat e mësimdhënies duhet të jenë të larmishme që të përshtaten me stilet e ndryshme të të nxënësve të nxënësve. Ato duhet të nxisin punën bashkëpunuese të nxënësve me qëllim të përforcimit të dimensionit shoqëror në procesin e të nxënësve.

Mësimdhënia ndërvepruese i angazhon nxënësit në marrjen e përgjegjësisë për zgjerimin e njohurive, por edhe për vlershmërinë e tyre.

Ky model përcatohet nga këto faza:

1. Përcaktohet tema apo çështja që është me interes për nxënës, që ka kuptim dhe që është e lidhur ngushtë me aspektet jetësore. Kështu, matematika nga një lëndë abstrakte dhe mjaft teorike shndërron në një lëndë të kuptueshme, e lidhur ngushtë me jetën;
2. Arsimtari inkurajon dhe nxit nxënësit të mendojnë rreth çështjeve që trajtohen në tekst apo rreth një problemi të caktuar. Në këtë fazë, ata përfshihen në hulumtime të ndryshme: vëzhgojnë, mbajnë shënime, evidencojnë probleme, marrin informacione;
3. Shtrohen shumë pyetje për sqarim, të cilave duhet dhënë përgjigje. Është e rëndësishme që pyetjet të jenë të kuptueshme për nxënësit;
4. Nxënësit zhvillojnë planet e tyre për të ndërmarrë kërkime apo hulumtime të thjeshta dhe u japin përgjigje më precize pyetjeve të shtruar në fazën e mësipërme;

5. Nxënësit së bashku me arsimtarin diskutojnë rreth praktikës së tyre- rezultateve të nxjerra nga hulumtimi apo zgjidhja e problemit. Arsimtari u ndihmon atyre të marrin në konsideratë alternativa të tjera për rezultatet dhe të planifikojnë kërkime apo hulumtime të mëtejme. Është e rëndësishme që nxënësit të përceptojnë vlerësimin e ideve të tyre, zgjidhjeve që ata japin dhe të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësitë që ata marrin.

Në vazhdim po i vëmë në spikamë disa metoda të punës.

METODAT E PUNËS

Shkolla duhet të shërbejë për ruajtjen dhe ngritjen e interesimit të nxënësve për lëndën e matematikës dhe gradualisht ta zhvillojë atë.

- Mësimi i matematikës nuk guxon të jetë abstrakt dhe verbal, sepse matematika në esencë edhe ashtu vepron me kuptime dhe relacione abstrakte. Duhet që sa më shumë t'i ofrohet nxënësit duke u shërbyer me eksperimente, paraqitje grafike dhe situata reale nga jeta e përditshme.
- Mënyra e të nxënit duhet të zhvillohet në formë të një spiraleje, sepse veprimet dhe strukturat matematike nuk është e mundshme që përnjëherë dhe në tërësi të kuptohen. Do të ishte mirë që, sa herë të jetë e mundshme, tërësitë e vogla të përmbajtjeve të lidhen me të mëdhatë në atë mënyrë që, duke futur përmbajtjen e re, të përvetësohen sa më shumë përmbajtjet e vjetra.
- Motivimi është çelës në të mësuarit e matematikës, sepse aty buron edhe mjeshtria e mësimit nxënës. Motivimi i nxënësve që të punojnë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur dhe sistematike, sa më shumë që të jetë e mundur është i një rëndësie fundamentale. Është me rëndësi zgjedhja e përmbajtjeve për ushtrime të cilat nxësin vazhdimisht të menduarit, me ç'rast shkallë-shkallë paraqiten pyetje të reja. Ushtrimet e këtilla produktive orientojnë në drejtim të një pune hulumtuese dhe ngrisin tema të reja për diskutime.
- Dallimet e nxënësve në aftësitë për të përvetësuar lëndën mund të jenë shumë të mëdha. Prandaj mësimit nxënës duhet të gjejnë mënyrën që të gjithë nxënësit të përparojnë. Është e preferueshme

që gjatë ushtrimeve të zbatohet metoda e mendimit kritik, duke ndarë nxënësit në grupe të vogla me nga dy, katër nxënës etj.

- Duhet pasur kujdes që gjatë ushtrimeve nxënësit të stimulohen të zgjidhin detyrat edhe në ndonjë mënyrë të veten (origjinale).
- Qëllimi i të mësuarit i matematikës nuk duhet të jetë të mësuarit mekanik të fakteve ose të veprimeve, por përvetësimi me themel i materies.
- Që në vitin e parë arsimtari nuk guxon të udhëheqë orët mësimore me metodën stereotipe të mësimdhënies-me mësimdhënësin në qendër duke lënë anash aktivitetin e nxënësit në të rezonuarit matematik. Duhet të zgjidhen ushtrime të përshtatshme që të zhvillohet intuita në shkallën e mjaftueshme për të lëvizur gjithmonë një hap përpara.

VLERËSIMI

Vlerësimi i rregullt i përparimit të nxënësve është pjesë e mësimdhënies dhe të nxënësve të matematikës. Përmes këtij procesi, konstatohet jo vetëm shkalla e arritshmërisë së nxënësve, por edhe vlershmëria e programit dhe e metodologjisë mësimore në përgjithësi.

Vlerësimi mundëson diagnostifikimin e përparimit të nxënësve, planifikimin e drejtë të mësimdhënies, motivimin e nxënësve dhe përcaktimet përfundimtare të rezultateve. Ai duhet të fokusohet në identifikimin e njohurive ekzistuese të nxënësve, në konceptimet e gabuara dhe strategjitë e të nxënësve. Po ashtu, përmes tij sigurohet informacion i vlefshëm, të cilin arsimtari i matematikës e shfrytëzon për të shqyrtuar aftësitë e ndryshme të nxënësve dhe njohuritë paraprake të tyre.

Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh përmbajtjen programore, objektivat e përgjithshme, objektivat specifike dhe standartet e arritshmërisë të precizuara në kurrikul të lëndës.

1. Nivelet e arritshmërisë

Shkalla e arritshmërisë së nxënësve vlerësohet duke u bazuar kryesisht në tri nivele:

Niveli I. Përfshin arritshmërinë minimale, d.m.th. paraqet minimumin e domosdoshëm, të cilin duhet ta arrijnë të gjithë nxënësit. Pra, ai

paraqet kufirin e poshtëm (të lejueshëm) të përvetësimit të përmbajtjes programore e që në përqindje do të shprehej me 40% të materialit të zhvilluar. Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet me ndihmën e mësimdhënësit me anë të një numri të kufizuar metodash, i arsyetojnë faktet e thjeshta matematike me ndihmën e arsimtarit dhe komunikojnë për njohuritë matematike, duke pasur gjithmonë këtë ndihmë.

Niveli II. Paraqitet me kufijtë e rezultateve të shprehura në përqindje (50%-80%). Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet dhe i arsyetojnë faktet matematike me ndihmën e kufizuar të mësimdhënësit, me anë të një numri jo të madh të strategjive dhe metodave, me disa gabime apo me mangësi të vogla.

Niveli III. Është niveli i avancuar i arritjes së nxënësve i shprehur në përqindje (80-90%). Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet dhe i arsyetojnë faktet matematike, me një ndihmë shumë të kufizuar të arsimtarit.

Niveli IV. Është niveli më i lartë i arritjes së nxënësve i shprehur në përqindje (mbi 90%). Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet dhe i arsyetojnë faktet matematike, në mënyrë të pavarur. Zgjidhin probleme matematike me metoda të ndryshme, analizojnë dhe komentojnë rezultatet e fituara në mënyrë të pavarur dhe të saktë, me gjuhë të qartë dhe rrjedhshmëri logjike.

2. Procedura e vlerësimit

Procedura e vlerësimit rekomandohet të bëhet në harmoni me standardet e vendosura. Tipat e vlerësimit janë të shumtë. Ata duhet të përdoren në përputhje me qëllimet dhe objektivat e lëndës, strategjitë e të nxënësve dhe moshën e kërkesat e nxënësve. Për lëndën e matematikës konsiderojmë se vlerësimi mund të bëhet duke marrë parasysh këto aktivitete:

- Puna në klasë:
 - përgjigjet me gojë;
 - aktivitetin e nxënësve nga vendi;
 - aktivitetin gjatë punës në grupe.
- Testimi
 - testet për grup temash;

- testet në fund të kategorisë së përmbajtjes;
- testet në fund të semestrit.
- Provimet me shkrim.
- Detyrat e shtëpisë dhe detyrat seminarike.

LITERATURA

1. M. Berisha, M. Demaj, *Matematika për klasën III gjimnaz*, “Libri Shkollor”, Prishtinë, 1999.
2. E. Hamiti, *Matematika për klasën III gjimnaz*, ETTM, Prishtinë, 1975.
3. Ll. Puka, E. Lulja, P. Bici, N. Perdhiku, N. Kreçi, *MATEMATIKA 4.1 për shkollat e mesme të përgjithshme*, Lezhë, 2001.
4. L. Sula, N. Kreçi, M. Gumeni, S. Llambiri, *MATEMATIKA 4.2 për shkollat e mesme të përgjithshme*, Lezhë, 2001.
5. F. Berisha, M. Kadriu, *Përmbledhje detyrash nga matematika për klasën e tretë të shkollave të mesme*, “Libri Shkollor”, Prishtinë, 2000.

MATEMATIKË

Gjimnazi i shkencave të natyrës (3 orë në javë, 99 orë në vit)

HYRJE

Matematika për klasën e dymbëdhjetë është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive paraprake të fituara nga lënda e matematikës në vitet paraprake. Kjo u mundëson nxënësve të fitojnë njohuri e shkathtësi për të zhvilluar të kuptuarit e botës fizike, asaj shoqërore dhe zhvillon aftësitë e nxënësit për të shtruar drejt problemet e ndryshme nga fusha e matematikës dhe nga jeta e përditshme si dhe aftësitë për t'i zgjidhur ato në mënyrë korrekte.

QËLLIMET

Të mësuarit e lëndës së matematikës ka për qëllim që te nxënësi:

- Të zhvillojë aftësitë e të menduarit, të shprehurit në mënyrë të qartë dhe precize dhe të avancojë edhe më tej kureshtjen dhe kreativitetin e tij;
- Të zhvillojë dhe të thellojë edhe më tej shprehitë për punë të pavarur dhe të zhvillojë aftësitë që njohuritë e fituara t' i zbatojë në lëmenjët e tjerë (fizikë, kimi, etj.) dhe jetën e përditshme;
- Të sigurojë një bazë solide për shkollim të lartë.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nga përmbajtja programore e lëndës së matematikës për klasën XII nxënësi duhet të jetë në gjendje:

□ **Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat**

- Në kuptimin e sjelljeve personale (të jetë kooperativ, i hapur, i sigurtë, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik etj.)

□ **Të kuptojë**

- Domethënien e termave në kontekst (vektor, format e ndryshme të ekuacionit të drejtëzës, elipsë, hiperbolë, parabolë, limit i vargut, limit i funksionit, derivat dhe integral etj.);
- Veprimet me vektorë (mbledhjen, zbritjen, shumëzimin me skalar dhe prodhimin skalar).

□ **Të zbatojë**

- Veprimet me vektorë (prodhimin skalar) në gjeometri;
- Kushtin që dy drejtëza të një rrafshi të jenë paralele, normale në zgjidhjen e detyrave të ndryshme;
- Vetitë e vijave të gradës së dytë si dhe kushtin që drejtëza e dhënë të jetë tangjent e vijave të gradës së dytë në zgjidhjen e detyrave të ndryshme;
- Teoremën e sinusit dhe atë të kosinusit në zgjidhjen e trekëndëshit;
- Limitin dhe derivatin e funksionit për shqyrtimin dhe paraqitjen grafike të funksionit dhe zgjidhjen e problemeve praktike;
- Integralin e caktuar për zgjidhjen e detyrave të ndryshme gjeometrike.

□ **Të demonstrojë shkathtësi mendore**

- Gjatë zgjidhjes së detyrave të ndryshme në lidhje me drejtëzën si dhe vijat e gradës së dytë;
- Gjatë shqyrtimit dhe paraqitjes grafike të funksionit;
- Gjatë analizës së zgjidhshmërisë së problemit në saje të të dhënave që disponon;
- Në zbatimin e të menduarit kreativ dhe kritik gjatë vërtetimit të rezultateve të ndryshme matematike duke u nisur nga supozimi i kundërt e duke arritur në ndonjë kundërthënie, apo duke sjellë kundërshe mbuj.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES SË LËNDËS

Ndërtimi i përmbajtjes është organizuar në përputhje me qëllimet dhe objektivat e lëndës. Kategoritë e përmbajtjes së lëndës janë dhënë në tabelën nr. 1.

Tabela 1.

Lënda	Kategoritë e përmbajtjes		Orët	%	Gjithsej %
Matematikë	I. Algjebër		10	10.10	100
	II. Gjeometri		20	20.20	
	III. Analizë		56	56.57	
	Provimet me shkrim		6	6.06	
	Testet		4	4.04	
	Orë rezervë		3	3.03	

PËRMBAJTJA, REZULTATET E PRITURA, LIDHJA NDËRLËNDORE

Kategoritë e përmbajtjes	Nënkategoritë e përmbajtjes	Përmbajtja	Rezultatet e pritura	Lidhja ndërlëndore
I. Algjebra	I.1. Algjebër vektoriale	<p>I.1.1. Algjebër vektoriale Kuptimet themelore mbi vektorët; trajta koordinative (në rrafsh dhe në hapësirë); Veprimet me vektorë (mbledhja, zbritja, shumëzimi me skalar); pavarësia lineare e vektorëve; prodhimi skalar dhe zbatimet gjeometrike të tij (distanca mes dy pikave, ndarja e segmentit në raportin e dhënë dhe syprina e trekëndëshit).</p>	<p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</p> <ol style="list-style-type: none"> të interpretojë vektorin nëpërmjet koordinatave në rrafsh dhe në hapësirë; të kryejë veprimet me vektorë; të zbatojë vetitë e prodhimi skalar në gjeometri dhe fizikë; 	<p>Fizikë: interpretimi vektorial i disa madhësive fizike si rruga, shpejtësia, nxitimi, forca etj.; puna si prodhim skalar mes forcës dhe rrugës; momenti i forcës si prodhim vektorial i vektorit të rrezes dhe forcës etj.</p>
II. Gjeometria	II.1. Gjeometria analitike në rrafsh	<p>II.1.1. Drejtëza Format e ndryshme të ekuacionit të drejtëzës; Pozita reciproke e dy drejtëzave; këndi mes dy drejtëzave; largesa e pikës nga drejtëza. Simetralja e këndit.</p> <p>II.1.2. Vijat e gradës së dytë në rrafsh</p> <p>Rrethi. Ekuacioni kanonik i rrethit dhe format e veçanta të tij; rrethi dhe drejtëza (tangjentja e rrethit, sekanta). Translatimi i sistemit koordinativ.</p> <p>Elipsa. Përkufizimi dhe ekuacioni i elipsës; vatrat dhe direktrisat; drejtëza dhe elipsa (tangjentja e elipsës, sekanta).</p>	<ol style="list-style-type: none"> të dallojë format e ndryshme të ekuacionit të drejtëzës në rrafsh; të shqyrtojë pozitën reciproke të drejtëzës me vijat e gradës së dytë (prerjet konike) nëpërmjet parametrave të tyre; të përshkruajë dhe të zbatojë teoremat e sinusit dhe kosinusit në zgjidhjen e detyrave të ndryshme; të përkufizojë vargun numerik duke përdorur kuptimin e pasqyrimit; 	<p>Fizikë: ligjet e Keplerit; gjeografi dhe astronomi:</p>

<p>III. Analiza</p>	<p>III.1. Trigonometri (vazhdim)</p> <p>III.2. Vargu numerik</p> <p>III. 3. Funkcionet</p>	<p>Hiperbola. Përkufizimi dhe ekuacioni i hiperbolës; vatrat dhe direktrisat; drejtëza dhe hiperbola (tangjentja e hiperbolës, sekanta).</p> <p>Parabola. Përkufizimi dhe ekuacioni i parabolës. Drejtëza dhe parabola (tangjentja e parabolës, sekanta).</p> <p>III.1.1. Zgjidhja e trekëndëshit Teorema e sinusit, teorema e kosinusit si dhe zbatimi i tyre në zgjidhjen e trekëndëshit dhe vërtetimin e formulave të ndryshme.</p> <p>III.2.1. Kuptimi i vargut numerik Përkufizimi i vargut numerik; vargu stacionar; vargjet monotone; vargjet e kufizuara; shembuj të rëndësishëm të vargjeve; vargu aritmetik dhe vargu gjeometrik.</p> <p>III.2.2. Limiti i vargut Kuptimi i limitit të vargut; vargu konvergjent dhe ai divergjent; faktet themelore në lidhje me vargjet konvergjente; konvergenca e vargjeve monotone; numri e (pa vërtetim).</p> <p>III.3.1. Disa kuptime të rëndësishme lidhur me funksionet</p>	<p>9. të dallojë vargun aritmetik (gjeometrik) nëpërmjet shembujve dhe të zbatojë vetitë e tyre në zgjidhjen e detyrave të ndryshme;</p> <p>10. të sjellë shembuj të vargjeve të kufizuara si dhe atyre monotone;</p> <p>11. të përkufizojë limitin e vargut nëpërmjet ε - rrethinës së pikës;</p> <p>12. të shqyrtojë natyrën (konvergjencën, divergjencën) e vargut nëpërmjet përkufizimit të limitit;</p> <p>13. të shqyrtojë konvergjencën e disa vargjeve monotone dhe të kufizuara;</p> <p>14. të zgjidhë detyra të ndryshme në lidhje me limitin e funksionit duke përdorur përkufizimin e limitit si dhe rregullat e kalimit me limit;</p> <p>15. të sjellë shembuj të funksionit të vazhdueshëm në domenën e tij si dhe shembuj të funksionit që ka këputje në një pikë dhe t'i arsyetojë</p>	<p>trajektoret eliptike të planeteve të sistemit diellor etj.</p>
----------------------------	---	---	---	---

	<p>III.4. Limiti dhe vazhdueshmëria e funksionit</p> <p>III.5. Derivati i funksionit</p>	<p>Përkufizimi i funksionit dhe e grafikut të tij, fusha e përkufizimit (domena) e funksionit, mënyra e dhënies së një funksioni real, zerot, paritetit, periodiciteti, monotonia dhe vlerat ekstreme. Funksioni i përbërë dhe funksioni invers. Funksioni fuqisë $y = x^n$, ($n \in \mathbb{N}$).</p> <p>III.4.1. Limiti i funksionit Përkufizimi i limitit të funksionit. Rregullat e kalimit me limit (pa vërtetim).</p> <p>III.4.2. Vazhdueshmëria e funksionit Përkufizimi i vazhdueshmërisë së funksionit. Vetë të funksioneve të vazhdueshme (pa vërtetim).</p> <p>III.5.1. Derivati i funksionit Problemi i shpejtësisë dhe i tangjentes. Përkufizimi i derivatit të funksionit, derivatet e funksioneve elementare (tabela e derivateve). Rregullat e derivimit. Derivati i funksionit të përbërë dhe derivati i funksionit invers (pa vërtetim). Derivatet e rendeve të larta.</p> <p>III.5.2. Shqyrtimi i funksioneve me ndihmën e derivateve Asimptotat; shqyrtimi i monotonisë me ndihmën e derivatit, vlerat ekstreme;</p>	<p>ata me përkufizimin e vazhdueshmërisë;</p> <p>16. të interpretojë kuptimin kinematik dhe gjeometrik të derivatit;</p> <p>17. të derivojë funksione të ndryshme duke përdorur përkufizimin si dhe rregullat e derivimit;</p> <p>18. të shqyrtojë monotoninë dhe ekstremet e funksionit nëpërmjet derivatit.</p> <p>19. të shqyrtojë dhe të paraqesë grafikisht funksionin;</p> <p>20. të njehsojë integralin e pacaktuar për një funksion të dhënë duke shfrytëzuar metodat e integrimit;</p> <p>21. të zbatojë integralin e caktuar për llogaritjen e syprinave të sipërfaqeve të rrafshta, gjatësisë së harqeve të ndryshme, vëllimin e trupit rrotullues dhe të syprinës së tij.</p>	
--	--	--	---	--

	<p>III.6 Integrali i pacaktuar dhe ai i caktuar</p>	<p>konkaviteti e konveksiteti, pikat e lakesës dhe paraqitja grafike e funksionit.</p> <p>III.5.3. Diferenciali i funksionit Kuptimi i diferencialit dhe lidhja e tij me derivatin. Zbatimi i diferencialit në përafrimin e funksioneve.</p> <p>III.6.1. Integrali i pacaktuar Përkufizimi i funksionit primitiv dhe i integralit të pacaktuar, vetitë e integralit të pacaktuar (pa vërtetim), tabela e integraleve.</p> <p>III.6.2. Llogaritja e integraleve Metoda e zëvendësimit, metoda e integrimit me pjesë, integrimi i funksioneve racionale dhe atyre trigonometrike.</p> <p>III.6.3. Integrali i caktuar Shuma integrale, përkufizimi i integralit të caktuar, vetitë themelore të integralit të caktuar (pa vërtetim); formula e Njutën-Lajbnic (pa vërtetim).</p> <p>III.6.4. Zbatimet e integralit të caktuar Syprina e trapezit vijëpërkulur, syprina e sipërfaqeve në rrafsh, vëllimi i trupit rrotullës, gjatësia e harkut dhe syprina e trupit rrotullës (pa vërtetim).</p>		<p>Fizikë: Shpejtësia dhe nxitimi, fuqia, puna .</p>
--	--	--	--	--

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Si në çdo lëndë, edhe në lëndën e matematikës, detyra kryesore e arsimtarit është udhëheqja e veprimtarive arsimore të cilat përmbushin arritjen e rezultateve të të nxëniet që parashikohen në objektiva.

Praktika ka treguar se teknikat, metodat e strategjitë, të cilat sigurojnë një mësimdhënie produktive, janë ato të cilat i mundësojnë nxënësit të përfshihen aktivisht në ndërtimin e të kuptuarit, në zhvillimin e strategjive matematike për zgjidhjen e problemeve dhe zhvillimin e aftësive për të zbatuar njohuritë në jetën e përditshme. Detyra e shtëpisë, seminarët e ndryshme janë segmente shumë të rëndësishme që mundësojnë fillimin e ndërtimit të shprehive për punë të pavarur dhe kreative në të ardhmen.

Në vendimet që merr mësimdhënësi për zgjedhjen e metodave mësimore, krahas shumë faktorëve, duhet të ketë parasysh edhe:

- natyrën e materialit mësimor;
- tipin e të nxëniet;
- nivelin dhe kërkesat e nxënësve.

Për këtë qëllim, metodat dhe teknikat e mësimdhënies duhet të jenë të larmishme që të përshtaten me stilet e ndryshme të të nxëniet të nxënësve. Ato duhet të nxisin punën bashkëpunuese të nxënësve me qëllim të përforcimit të dimensionit shoqëror në procesin e nxënies.

Mësimdhënia ndërvepruese i angazhon nxënësit në marrjen e përgjegjësisë për zgjerimin e njohurive, por edhe vlershmërinë e tyre.

Ky model përcatohet nga këto faza:

1. Përcaktohet tema apo çështja që është me interes për nxënësit, që ka kuptim dhe që është e lidhur ngushtë me aspektet jetësore. Kështu, matematika nga një lëndë abstrakte dhe mjaft teorike shndërron në një lëndë të kuptueshme, e lidhur ngushtë me jetën;
2. Arsimtari inkurajon dhe nxitë nxënësit të mendojnë rreth çështjeve që trajtohen në tekst apo rreth një problemi të caktuar. Në këtë fazë, ata përfshihen në hulumtime të ndryshme: vëzhgojnë, mbajnë shënime, evidencojnë probleme, marrin informacione;
3. Shtrohen shumë pyetje për sqarim të cilave duhet dhënë përgjigje. Është e rëndësishme që pyetjet të jenë të kuptueshme për nxënësit;
4. Nxënësit zhvillojnë planet e tyre për të ndërmarrë kërkime apo hulumtime të thjeshta dhe u japin përgjigje më precize pyetjeve të shtruara në fazën e mësipërme;

5. Nxënësit së bashku me arsimtarin diskutojnë rreth praktikës së tyre- rezultateve të nxjerra nga hulumtimi apo zgjidhja e problemit. Arsimtari u ndihmon atyre të marrin në konsideratë alternative të tjera për rezultatet dhe të planifikojnë kërkime apo hulumtime të mëtejme. Është e rëndësishme që nxënësit të përceptojnë vlerësimin e ideve të tyre, zgjidhjeve që ata japin dhe të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësitë që ata marrin.

Në vazhdim po i vëmë në dukje disa metoda të punës.

METODAT E PUNËS

Shkolla duhet të shërbejë për ruajtjen dhe ngritjen e interesimit të nxënësve për lëndën e matematikës dhe gradualisht ta zhvilloj atë.

- Mësimi i matematikës nuk guxon të jetë abstrakt dhe verbal, sepse matematika në esencë edhe ashtu vepron me kuptime dhe relacione abstrakte. Duhet që sa më shumë t'i ofrohet nxënësit duke u shërbyer me eksperimente, paraqitje grafike dhe situata reale nga jeta e përditshme;
- Mënyra e të nxënit duhet të zhvillohet në formë të një spiraleje, sepse veprimet dhe strukturat matematike nuk është e mundshme që përnjëherë dhe në tërësi të kuptohen. Do të ishte mirë që sa herë të jetë e mundshme, tërësitë e vogla të përmbajtjeve të lidhen më të mëdhatë në atë mënyrë që, duke futur përmbajtjen e re, të përvetësohen sa më shumë përmbajtjet e vjetra.
- Motivimi është çelës në të mësuarit e matematikës, sepse aty buron edhe mjeshtria e mësimit nxënës. Motivimi i nxënësve që të punojnë në mënyrë të vazhdueshme, të pavarur dhe sistematike, sa më shumë që të jetë e mundur është i një rëndësie fundamentale. Është me rëndësi zgjedhja e përmbajtjeve për ushtrime të cilat nxësin vazhdimisht të menduarit, me ç'rast shkallë-shkallë paraqiten pyetje të reja. Ushtrimet e këtilla produktive orientojnë në drejtim të një pune hulumtuese dhe ngrisin tema të reja për diskutime.
- Dallimet e nxënësve në aftësitë për të përvetësuar lëndën mund të jenë shumë të mëdha. Prandaj, mësimit nxënës duhet të gjejnë mënyrën që të gjithë nxënësit të përparojnë. Është e preferueshme

që gjatë ushtrimeve të zbatohet metoda e mendimit kritik, duke ndarë nxënësit në grupe të vogla me nga dy, katër nxënës etj.

- Duhet pasur kujdes që gjatë ushtrimeve nxënësit të stimulohen të zgjidhin detyrat edhe në ndonjë mënyrë të veten (origjinale).
- Qëllimi i të mësuarit të matematikës nuk duhet të jetë të mësuarit mekanik të fakteve ose të veprimeve, por përvetësimi me themel i materies.
- Që në vitin e parë arsimtari nuk guxon të udhëheqë orët mësimore me metodën stereotipe të mësimdhënies-me mësimdhënësin në qendër duke lënë anash aktivitetin e nxënësit në të rezonuarit matematik. Duhet të zgjidhen ushtrime të përshtatshme që të zhvillohet intuita në shkallën e mjaftueshme për të lëvizur gjithmonë një hap përpara.

VLERËSIMI

Vlerësimi i rregullt i përparimit të nxënësve është pjesë e mësimdhënies dhe të nxënësve të matematikës. Përmes këtij procesi konstatohet jo vetëm shkalla e arritshmërisë së nxënësve, por edhe vlerësimi i programit dhe e metodologjisë mësimore në përgjithësi.

Vlerësimi mundëson diagnostifikimin e përparimit të nxënësve, planifikimin e drejtë të mësimdhënies, motivimin e nxënësve dhe përcaktimet përfundimtare të rezultateve. Ai duhet të fokusohet në identifikimin e njohurive ekzistuese të nxënësve, në konceptimet e gabuara dhe strategjitë e të nxënësve. Po ashtu, përmes tij sigurohet informacion i vlefshëm, të cilin arsimtari i matematikës e shfrytëzon për të shqyrtuar aftësitë e ndryshme të nxënësve dhe njohuritë paraprake të tyre.

Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh përmbajtjen programore, objektivat e përgjithshme, objektivat specifike dhe standardet e arritshmërisë të precizuara në kurrikul të lëndës.

1. Nivelet e arritshmërisë

Shkalla e arritshmërisë së nxënësve vlerësohet duke u bazuar kryesisht në tri nivele:

Niveli I. Përfshin arritshmërinë minimale, d.m.th. paraqet minimumin e domosdoshëm të cilin duhet ta arrijnë të gjithë nxënësit. Pra, ai

paraqet kufirin e poshtëm (të lejueshëm) të përvetësimit të përmbajtjes programore e që në përqindje do të shprehej me 40% të materialit të zhvilluar. Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet me ndihmën e mësimdhënësit me anë të një numri të kufizuar metodash, i arsyetojnë faktet e thjeshta matematike me ndihmën e arsimtarit si dhe komunikojnë për njohuritë matematike duke pasur gjithmonë këtë ndihmë.

Niveli II. Paraqitet me kufijtë e rezultateve të shprehura në përqindje (50%-80%). Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet dhe i arsyetojnë faktet matematike me ndihmën e kufizuar të mësimdhënësit, me anë të një numri jo të madh të strategjive dhe metodeve, me disa gabime apo me mangësi të vogla.

Niveli III. Është niveli i avancuar i arritjes së nxënësve i shprehur në përqindje (80-90%). Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet dhe i arsyetojnë faktet matematike, me një ndihmë shumë të kufizuar të arsimtarit.

Niveli IV. Është niveli më i lartë i arritjes së nxënësve i shprehur në përqindje (mbi 90%). Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet dhe i arsyetojnë faktet matematike, në mënyrë të pavarur. Zgjidhin probleme matematike me metoda të ndryshme, analizojnë dhe komentojnë rezultatet e fituara në mënyrë të pavarur dhe saktë, me gjuhë të qartë dhe rrjedhshmëri logjike.

2. Procedura e vlerësimit

Procedura e vlerësimit rekomandohet të bëhet në harmoni me standardet e vendosura. Tipat e vlerësimit janë të shumtë. Ata duhet të përdoren në përputhje me qëllimet dhe objektivat e lëndës, strategjitë e të nxënësve dhe moshën e kërkesat e nxënësve. Për lëndën e matematikës konsiderojmë se vlerësimi mund të bëhet duke marrë parasysh këto aktivitete:

- Puna në klasë:
 - përgjigjet me gojë;
 - aktivitetin e nxënësve nga vendi;
 - aktivitetin gjatë punës në grupe.
- Testimi:
 - testet për grup temash;

- testet në fund të kategorisë së përmbajtjes;
- testet në fund të semestrit.
- Provimet me shkrim.
- Detyrat e shtëpisë dhe detyrat seminarike.

LITERATURA

1. M. Berisha, M. Demaj, *Matematika për klasën III gjimnaz*, “Libri Shkollor”, Prishtinë, 1999.
2. E. Hamiti, *Matematika për klasën III gjimnaz*, ETTM, Prishtinë, 1975.
3. Ll. Puka, E. Lulja, P. Bici, N. Perdhiku, N. Kreçi, *MATEMATIKA 4.1 për shkollat e mesme të përgjithshme*, Lezhë, 2001.
4. L. Sula, N. Kreçi, M. Gumeni, S. Llambri, *MATEMATIKA 4.2 për shkollat e mesme të përgjithshme*, Lezhë, 2001.
5. M. Berisha, R. Zejnullahu, R. Gjergji, D. Pupovci, *Përmbledhje detyrash të zgjidhura nga matematika për klasën e dytë të shkollave të mesme*, “Libri Shkollor”, Prishtinë, 1999.

MATEMATIKË (Analizë me teori të gjasës)

**Gjimnazi matematikë dhe informatikë
5 orë në javë, 165 orë në vit**

HYRJE

Analiza me teori të gjasës, si pjesë e matematikës për klasën e dymbëdhjetë, është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive paraprake të fituara nga lënda e matematikës. Kjo u mundëson nxënësve të fitojnë njohuri e shkathtësi për të zhvilluar të kuptuarit e botës fizike, asaj shoqërore dhe zhvillon aftësitë e nxënësit për të shtruar drejt problemet e ndryshme nga fusha e matematikës dhe nga jeta e përditshme si dhe aftësitë për t'i zgjidhur ato në mënyrë korrekte.

QËLLIMET

Të mësuarit e lëndës së Analizës me teori të gjasës ka për qëllim që te nxënësi:

- Të zhvillojë aftësitë e të menduarit, të shprehurit në mënyrë të qartë dhe precize dhe të avancojë edhe më tej kureshtjen dhe kreativitetin e tij;
- Të zhvillojë dhe të thellojë edhe më tej shprehitë për punë të pavarur dhe të zhvillojë aftësitë që njohuritë e fituara t' i zbatojë në lëmenjtë e tjerë (fizikë, kimi etj.) dhe në jetën e përditshme;
- Të sigurojë një bazë solide për shkollim të lartë.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nga përmbajtja programore e lëndës së Analizës me teori të gjasës për klasën XII nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- **Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat**
 - Në kuptimin e sjelljeve personale (të jetë kooperativ, i hapur, i sigurtë, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik etj.)
- **Të njohë**
 - Kuptimet e limitit, vazhdueshmërisë, derivatit dhe integralit të funksionit.
- **Të kuptojë**
 - Domethënien e termave: limit i funksionit, derivat dhe integral.
 - Metodat dhe procedurat gjatë zgjidhjes së problemeve;
 - Faktet themelore lidhur me limitet e funksioneve, derivateve dhe integraleve.
- **Të zbatojë**
 - Vetitë e limiteve dhe të vazhdueshmërisë së funksioneve për zgjidhjen e detyrave të ndryshme;
 - Vetitë e derivateve për zgjidhjen e detyrave të ndryshme (matematikë dhe praktikë) dhe për shqyrtimin dhe paraqitjen grafike të funksioneve;
 - Metodat e integritit (metoda e zëvendësimit, metoda e integritit me pjesë) për njehsimin e integraleve të funksioneve të ndryshme;
 - Integralin e caktuar (formulën e Njutën-Lajbnicit) për zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga gjeometria e lëmenj të tjerë;
 - Vetitë e probabilitetit, pritjen matematike, variancën, devijimin standard dhe masat e tendencës qendrore në zgjidhjen e detyrave të ndryshme.
- **Të demonstrojë shkathtësi mendore**
 - Për shfrytëzimin e fakteve, teoremave, metodave për zgjidhjen e problemeve të ndryshme nga limitet, vazhdueshmëria, derivatet, integralet si dhe nga teoria e gjasës me statistikë;
 - Gjatë analizës së zgjidhshmërisë së problemit në saje të të dhënave që disponon;
 - Gjatë zgjidhjes së detyrave nga limitet e funksioneve e derivateve duke përdorur përkufizimin e tij;

- Në zbatimin e të menduarit kreativ dhe kritik për vërtetimin e rezultateve të ndryshme nga Analiza dhe teoria e gjasës me statistikë duke u nisur nga supozimi i kundërt e duke arritur në ndonjë kundërthënie, apo duke sjellë kundërshe mbuj.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES SË LËNDËS

Ndërtimi i përmbajtjes është organizuar në përputhje me qëllimet dhe objektivat e lëndës. Kategoritë e përmbajtjes së lëndës janë dhënë në tabelën nr. 1.

Tabela 1.

Lënda	Kategoritë e përmbajtjes		Orët	%	Gjithsej %
Analizë me teori të gjasës	I. Analizë		109	66.06	100
	II. Teori e gjasës me statistikë		30	18.18	
		Provimet me shkrim	12	7.27	
		Testet	8	4.85	
		Orë rezervë	6	3.64	

PËRMBAJTJA, REZULTATET E PRITURA, LIDHJA NDËRLËNDORE

Tabela 2.

Kategoria	Nënkategoritë e përmbajtjes	Përmbajtja	Rezultatet e pritura	Lidhja ndërlëndore
I. Analiza	<p>I.1. Funksionet</p> <p>I.2. Limiti dhe vazhdueshmëria</p>	<p>I.1.1. Disa kuptime të rëndësishme lidhur me funksionet Përkufizimi i funksionit dhe i grafikut të tij, fusha e përkufizimit (domena) e funksionit, mënyra e dhënies së një funksioni real, zerot, pariteti, periodiciteti, monotonia dhe vlerat ekstreme. Funksioni i përbërë dhe funksioni invers. Funksioni fuqi $y = x^n, (n \in \mathbb{N})$.</p> <p>I.2.1. Limiti i funksionit Përkufizimi i limitit (në “gjuhën $\varepsilon - \delta$”), vetitë e limiteve, limitet e njëanshme, limitet karakteristike $(\lim_{x \rightarrow 0} \frac{\sin x}{x} = 1, \lim_{x \rightarrow 0} (1 + x)^{\frac{1}{x}} = e)$, limitet kur $x \rightarrow \pm\infty$, shprehjet e pacaktuara.</p> <p>I.2.2. Vazhdueshmëria e funksionit Përkufizimi i vazhdueshmërisë së funksionit, vetitë themelore të funksioneve të vazhdueshme, vazhdueshmëria e funksionit nga ana e majtë përkatësisht e djathtë, kriteri i vazhdueshmërisë, pikat e këputjes dhe llojet e tyre.</p>	<p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</p> <p>1. të kuptojë limitin e funksionit, si dhe të zgjidhë detyra të ndryshme duke shfrytëzuar përkufizimin e limitit të funksionit dhe vetitë e tij;</p> <p>2. t’i zbatojë limitet karakteristike në zgjidhjen e detyrave të ndryshme;</p> <p>3. të kuptojë përkufizimin e vazhdueshmërisë së funksionit dhe të zbatojë vetitë e funksioneve të vazhdueshme dhe të dallojë pikat e këputjes;</p> <p>4. të gjejë derivatin e funksioneve të ndryshme, duke përdorur përkufizimin e tij;</p> <p>5. të zbatojë vetitë e derivatit në zgjidhjen e detyrave të</p>	<p>Fizikë (përkufizimi i shpejtësisë, nxitimit).</p>

	<p>I.3. Derivati dhe diferenciali</p> <p>I.4. Njehsimi integral</p>	<p>I.3.1. Derivati i funksionit Shtesa e argumentit dhe e funksionit, problemi i shpejtësisë dhe ai i tangjentes, përkufizimi i derivatit, derivatet e njëanshme, lidhja e derivatit me vazhdueshmërinë, derivatet e funksioneve themelore elementare rregullat e derivimit, derivati i funksionit të përbërë dhe atij invers, interpretimi gjeometrik i derivatit të parë, derivatet e rendeve më të larta.</p> <p>I.3.2. Diferenciali e funksionit Diferenciali i funksionit dhe lidhja e tij me derivatin, kuptimi gjeometrik i diferencialit, tangjentja dhe normalja në një pikë të grafikut të funksionit. Zbatimi i diferencialit në përafrimin e funksioneve.</p> <p>I.3.3. Shqyrtimi dhe paraqitja grafike e funksionit Fusha e përkufizimit, zerot dhe shenja, paritetit, perioda, sjellja e funksionit në skajet e fushës së përkufizimit, asimptotat, monotonia dhe vlerat ekstreme të (përmes derivatit) konkavitetit dhe konveksitetit, pikat e lakesës (infleksive), zbatimet e derivatit.</p> <p>I.4.1. Integrali i pacaktuar Përkufizimi i funksionit primitiv dhe i integralit të pacaktuar, vetitë e integralit të pacaktuar, tabela e integraleve.</p> <p>I.4.2. Llogaritja e integraleve Metoda e zëvendësimit, metoda e inegrimit me pjesë, integrimi i funksioneve racionale dhe atyre</p>	<p>ndryshme;</p> <p>6. të kuptojë interpretimin gjeometrik dhe atë kinematik të derivatit të parë;</p> <p>7. të shfrytëzojë kuptimin e derivatit për shqyrtimin e funksionit;</p> <p>8. të zbatojë derivatin në zgjidhjen e detyrave të ndryshme nga jeta e përditshme (fizikë, zgjidhjet optimale);</p> <p>9. të gjejë primitivën për funksione të ndryshme;</p> <p>10. të njehsojë integralin e pacaktuar për një funksion të dhënë, duke shfrytëzuar metodat e integrit;</p> <p>11. të llogarisë integralin e caktuar, duke shfrytëzuar përkufizimi e tij;</p> <p>12. të zbatojë integralin e caktuar për llogaritjen e syprina-</p>	<p>Fizikë (shpejtësia, nxitimit, fuqia).</p>
--	---	--	---	--

<p>II. Teoria e gjasës me statistikë</p>	<p>II.1. Teoria e gjasës</p> <p>II.2. Statistika</p>	<p>trigonometrike.</p> <p>I.4.3. Integrali i caktuar Shuma integrale, përkufizimi i integralit të caktuar, vetitë themelore të integralit të caktuar.</p> <p>I.4.4. Llogaritja e integralit të caktuar Integrali si funksion i kufirit të sipërm, formula e Njutën-Lajbnic.</p> <p>I.4.5. Zbatimet e integralit të caktuar Syprina e trapezit vijëpërkulur, syprina e sipërfaqeve në rrafsh, vëllimi i trupit rrotullës, gjatësia e harkut dhe syprina e trupit rrotullës.</p> <p>II.1.1. Teoria e gjasës Integralet jo të vetë me kufij të pafundmë, ndryshoret e vazhdueshme (të rastit), densiteti i probabilitetit, prirja matematike, varianca dhe devijimi standard për ndryshoret e vazhdueshme, shpërndarja normale dhe ajo e Puasonit.</p> <p>II.2.1. Statistika Kuartilet dhe devijimi standard, momentet dhe asimetria (përkufizimi i momentit të rendit r, koeficienti i Pirsonit i asimetrisë, koeficienti i Bolijevit i asimetrisë, koeficienti i Kelit asimetrisë, koeficienti i asimetrisë). Analiza e korelacionit dhe e regresionit (koeficienti i Pirsonit i korelacionit, koeficienti i Spirmanit i korelacionit, gabimi standard i regresionit).</p>	<p>ve të sipërfaqeve të rrafshta, gjatësisë së harqeve të ndryshme, vëllimin e trupit rrotullës si dhe të syprinës së tij.</p> <p>13. të sjellë shembuj të ndryshoreve të rastit të cilat janë të vazhdueshme;</p> <p>14. të llogarisë prirjen matematike, variancën si dhe devijimin standard për ndryshoret e rastit të cilat janë të vazhdueshme;</p> <p>15. të shfrytëzojë shpërndarjen normale dhe atë të Puasonit në zgjidhjen e detyrave të ndryshme;</p> <p>16. të shfrytëzojë kuartilet, devijimin standard, momentet e rendit të caktuar si dhe koeficientët e asimetrisë për zgjidhjen e detyrave të ndryshme nga jeta e përditshme.</p>	<p>Fizikë (rruga, shpejtësia, puna).</p> <p>Ekonomi, demografi, mjekësi, teknikë, etj.</p>
---	--	---	---	--

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Si në çdo lëndë, edhe në lëndën e Analizës me teori të gjasës, detyra kryesore e arsimtarit është udhëheqja e veprimtarive arsimore të cilat përmbushin arritjen e rezultateve e të nxënësve që parashikohen në objektiva.

Praktika ka treguar se teknikat, metodat e strategjitë të cilat sigurojnë një mësimdhënie produktive, janë ato të cilat i mundësojnë nxënësit të përfshihet aktivisht në ndërtimin e të kuptuarit, në zhvillimin e strategjive matematike për zgjidhjen e problemeve dhe zhvillimin e aftësive për të zbatuar njohuritë në jetën e përditshme. Detyrat e shtëpisë dhe seminarët e ndryshme janë segmente shumë të rëndësishme që mundësojnë fillimin e ndërtimit të shprehive për punë të pavarur dhe kreative në të ardhmen.

Në vendimet që merr mësimdhënësi për zgjedhjen e metodave mësimore, krahas shumë faktorëve, duhet të ketë parasysh edhe:

- natyrën e materialit mësimor;
- tipin e të nxënësve;
- nivelin dhe kërkesat e nxënësve.

Për këtë qëllim, metodat dhe teknikat e mësimdhënies duhet të jenë të larmishme që të përshtaten me stilet e ndryshme të të nxënësve të nxënësve. Ato duhet të nxisin punën bashkëpunuese të nxënësve me qëllim të përforcimit të dimensionit shoqëror në procesin e të nxënësve.

Mësimdhënia ndërvepruese i angazhon nxënësit në marrjen e përgjegjësisë për zgjerimin e njohurive, por edhe vlershmërinë e tyre.

Ky model përcatohet nga këto faza:

- Përcaktohet tema apo çështja që është me interes për nxënës, që ka kuptim dhe që është e lidhur ngushtë me aspektet jetësore. Kështu, Analiza me teori të gjasës nga një lëndë abstrakte dhe mjaft teorike shndërrohet në një lëndë të kuptueshme, e lidhur ngushtë me jetën.
- Arsimtari inkurajon dhe nxit nxënësit të mendojnë rreth çështjeve që trajtohen në tekst apo rreth një problemi të caktuar. Në këtë fazë ata përfshihen në hulumtime të ndryshme: vëzhgojnë, mbajnë shënime, evidencojnë probleme, marrin informacione.
- Shtrohen shumë pyetje për sqarim, të cilave duhet dhënë përgjigje. Është e rëndësishme që pyetjet të jenë të kuptueshme për nxënësit.

- Nxënësit zhvillojnë planet e tyre për të ndërmarrë kërkime apo hulumtime të thjeshta dhe u japin përgjigje më precize pyetjeve të shtruara në fazën e mësipërme.
- Nxënësit së bashku me arsimtarin diskutojnë rreth praktikës së tyre, rezultateve të nxjerra nga hulumtimi apo zgjidhja e problemit. Arsimtari u ndihmon atyre të marrin në konsideratë alternativa të tjera për rezultatet dhe të planifikojnë kërkime apo hulumtime të mëtejme. Është e rëndësishme që nxënësit të përceptojnë vlerësimin e ideve të tyre, zgjidhjeve që ata japin dhe të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësitë që ata marrin.

Në vazhdim po i vëmë në dukje disa metoda të punës.

METODAT E PUNËS

Shkolla duhet të shërbejë për ruajtjen dhe ngritjen e interesimit të nxënësve për matematikën, pra edhe për analizën me teori të gjasës dhe gradualisht ta zhvillojë atë.

Mësimi i analizës me teori të gjasës nuk guxon të jetë abstrakt dhe verbal, sepse matematika në esencë edhe ashtu vepron me kuptime dhe relacione abstrakte. Duhet që sa më shumë të ofrohet, duke u shërbyer me eksperimente, paraqitje grafike dhe situata reale nga jeta e përditshme.

Mënyra e të nxënësve duhet të zhvillohet në formë të një spiraleje, sepse veprimet dhe strukturat matematike, pra edhe ato të analizës me teori të gjasës, nuk është e mundshme që përnjëherë dhe në tërësi të kuptohen. Do të ishte mirë që sa herë të jetë e mundshme, tërësitë e vogla të përmbajtjeve të lidhen më të mëdhatë në atë mënyrë që duke futur përmbajtjen e re të përvetësohen sa më shumë përmbajtjet e vjetra.

Motivimi është çelës në të mësuarit e analizës me teori të gjasës, si dhe e matematikës në përgjithësi, sepse aty buron edhe mjeshtria e mësimdhënësit. Motivimi i nxënësve që të punojnë në mënyrë të vazhdueshme, sa më shumë që të jetë e mundshme në mënyrë të pavarur dhe sistematike është i një rëndësie fundamentale. Është me rëndësi zgjedhja e përmbajtjeve për ushtrime të cilat nxisin vazhdimisht të menduarit, me ç'rast shkallë-shkallë paraqiten pyetje të reja. Ushtrimet e këtilla produktive orientojnë në drejtim të një pune hulumtuese dhe ngrisin tema të reja për diskutime.

Dallimet e nxënësve në aftësitë për të përvetësuar lëndën mund të jenë shumë të mëdha. Prandaj mësimdhënësit duhet të gjejnë mënyrën që

të gjithë nxënësit të përparojnë. Është e preferueshme që gjatë ushtrimeve të zbatohet metoda e mendimit kritik, duke ndarë nxënësit në grupe të vogla me nga dy, katër nxënës etj.

Duhet pasur kujdes që gjatë ushtrimeve nxënësit të stimulohen të zgjidhin detyrat edhe në ndonjë mënyrë të veten (origjinale).

Qëllimi i të mësuarit i analizës me teori të gjasës nuk duhet të jetë të mësuarit mekanik të fakteve ose të veprimeve, por përvetësimi me themel i materies.

Që në vitin e parë arsimtari nuk guxon të udhëheqë orët mësimore me metodën stereotipe të mësimdhënies, me mësimdhënësin në qendër, duke lënë anash aktivitetin e nxënësit në të rezonuarit matematik. Duhet të zgjidhen ushtrime të përshtatshme që të zhvillohet intuita në shkallën e mjaftueshme për të lëvizur gjithmonë një hap përpara.

VLERËSIMI

Vlerësimi i rregullt i përparimit të nxënësve është pjesë e mësimdhënies dhe të nxënësve të matematikës, pra edhe i analizës me teori të gjasës. Përmes këtij procesi konstatohet jo vetëm shkalla e arritshmërisë së nxënësve, por edhe vlershmëria e programit dhe e metodologjisë mësimore në përgjithësi.

Vlerësimi mundëson diagnostifikimin e përparimit të nxënësve, planifikimin e drejtë të mësimdhënies, motivimin e nxënësve dhe përcaktimet përfundimtare të rezultateve. Ai duhet të fokusohet në identifikimin e njohurive ekzistuese të nxënësve, në konceptimet e gabuara dhe strategjitë e të nxënësve. Po ashtu, përmes tij sigurohet informacion i vlefshëm, të cilin arsimtari i matematikës e shfrytëzon për të shqyrtuar aftësitë e ndryshme të nxënësve dhe njohuritë paraprake të tyre.

Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh përmbajtjen programore, objektivat e përgjithshme, objektivat specifike dhe standardet e arritshmërisë së precizuara në planin dhe programet e lëndës.

1. Nivelet e arritshmërisë

Shkalla e arritshmërisë së nxënësve vlerësohet duke u bazuar kryesisht në tri nivele:

Niveli I. Përfshin arritshmërinë minimale, d.m.th. paraqet minimumin e domosdoshëm të cilin duhet ta arrijnë të gjithë nxënësit. Pra, ai

paraqet kufirin e poshtëm (të lejueshëm) të përvetësimit të përmbajtjes programore, e që në përqindje do të shprehej me 40% të materialit të zhvilluar. Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet me ndihmën e mësimdhënësit me anë të një numri të kufizuar metodash, i arsyetojnë faktet e thjeshta matematike me ndihmën e arsimtarit si dhe komunikojnë për njohuritë matematike duke pasur gjithmonë këtë ndihmë.

Niveli II. Paraqitet me kufijtë e rezultateve të shprehura në përqindje (50%-80%). Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet dhe i arsyetojnë faktet matematike me ndihmën e kufizuar të mësimdhënësit, me anë të një numri jo të madh të strategjive dhe metodave, me disa gabime apo me mangësi të vogla.

Niveli III. Është niveli i avancuar i arritjes së nxënësve i shprehur në përqindje (80-90%). Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet dhe i arsyetojnë faktet matematike, me një ndihmë shumë të kufizuar të arsimtarit.

Niveli IV. Është niveli më i lartë i arritjes së nxënësve i shprehur në përqindje (mbi 90%). Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet dhe i arsyetojnë faktet matematike, në mënyrë të pavarur. Zgjidhin probleme matematike me metoda të ndryshme, analizojnë dhe komentojnë rezultatet e fituara në mënyrë të pavarur dhe saktë, me gjuhë të qartë dhe rrjedhshmëri logjike.

2. Procedura e vlerësimit

Procedura e vlerësimit rekomandohet të bëhet në harmoni me standardet e vendosura. Tipat e vlerësimit janë të shumtë. Ata duhet të përdoren në përputhje me qëllimet dhe objektivat e lëndës, strategjitë e të nxënësve dhe moshën e kërkesat e nxënësve. Për lëndën e Analizës me teori të gjasës konsiderojmë se vlerësimi mund të bëhet duke marrë parasysh këto aktivitete:

- Puna në klasë
 - Përgjigjet me gojë;
 - Aktivitetin e nxënësve nga vendi;
 - Aktivitetin gjatë punës në grupe;
- Testimi
 - Testet për grup temash;

- Testet në fund të kategorisë së përmbajtjes;
- Testet në fund të semestrit;
- Provimet me shkrim;
- Detyrat e shtëpisë dhe detyrat seminarike;

LITERATURA

- M. Berisha, M. Demaj, *Matematika për klasën III gjimnaz*, “Libri Shkollor”, Prishtinë, 1999.
- E. Hamiti, *Matematika për klasën III gjimnaz*, ETTM, Prishtinë, 1975.
- Ll. Puka, E. Lulja, P. Bici, N. Perdhiku, N. Kreçi, *MATEMATIKA 4.1 për shkollat e mesme të përgjithshme*, Lezhë, 2001.
- L. Sula, N. Kreçi, M. Gumeni, S. Llambiri, *MATEMATIKA 4.2 për shkollat e mesme të përgjithshme*, Lezhë, 2001.
- F. Berisha, M. Kadriu, *Përmbledhje detyrash nga matematika për klasën e tretë të shkollave të mesme*, “Libri Shkollor”, Prishtinë, 2000.

MATEMATIKË (Algjebër me gjeometri)

Gjimnazi matematikë dhe informatikë
(2 orë në javë, 66 orë në vit)

HYRJE

Algjebra me gjeometri, si pjesë të matematikës për klasën e dymbëdhjetë, është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive paraprake të fituara nga lënda e matematikës. Kjo u mundëson nxënësve të fitojnë njohuri e shkathtësi për të zhvilluar të kuptuarit e botës fizike, asaj shoqërore dhe zhvillon aftësitë e nxënësit për të shtruar drejt problemet e ndryshme nga fusha e matematikës dhe nga jeta e përditshme si dhe aftësitë për t'i zgjidhur ato në mënyrë korrekte.

Në veçanti, nëpërmjet gjuhës karakteristike – simboleve e diagrameve, kjo lëndë synon të kultivojë aftësitë për të gjykuar drejt dhe saktë, si dhe për të përmbledhur mendimet në përgjithësi.

QËLLIMET

Të mësuarit e lëndës së Algjebërës me gjeometri ka për qëllim që të nxënësi:

- Të zhvillojë aftësitë e të menduarit, të shprehurit në mënyrë të qartë dhe precize si dhe të avancojë edhe më tej kureshtjen dhe kreativitetin e tij;
- Të zhvillojë dhe të thellojë edhe më tej shprehitë për punë të pavarur si dhe të zhvillojë aftësitë që njohuritë e fituara t'i zbatojë në lëmenjtë e tjera (fizikë, kimi, etj.) dhe në jetën e përditshme.
- Të sigurojë një bazë solide për shkollim të lartë.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nga përmbajtja programore e lëndës së Algjebrës me gjeometri për klasën XII, nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- **Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat**
 - Në kuptimin e sjelljeve personale (të jetë kooperativ, i hapur, i sigurtë, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik etj).
- **Të kuptojë**
 - Domethënien e termave në kontekst (matricë, përcaktor, determinantë deri te rendi i tretë, vektor, format e ndryshme të ekuacionit të drejtëzës etj.).
 - Veprimet me matrica (mbledhjen, zbritjen, shumëzimin me skalar dhe shumëzimin e matricave).
- **Të zbatojë**
 - Përcaktorët për zgjidhjen e sistemeve të ekuacioneve lineare deri me tri të panjohura (metoda e Kramerit);
 - Veprimet me vektorë (prodhimin skalar, vektorial dhe të përzier) në gjeometri;
 - Kushtin që dy drejtëza të një rrafshi të jenë paralele, normale në zgjidhjen e detyrave të ndryshme;
 - Vetitë e prerjeve konike si dhe kushtin që drejtëza e dhënë të jetë tangjente e vijave të gradës së dytë në zgjidhjen e detyrave të ndryshme.
- **Të demonstrojë shkathtësi mendore**
 - Gjatë diskutimit dhe zgjidhjes së sistemeve të ekuacioneve lineare që përmbajnë parametra;
 - Gjatë analizës së zgjidhshmërisë së problemit në saje të të dhënave që disponon;
 - Në zbatimin e të menduarit kreativ dhe kritik për formimin e vijave të gradës së dytë, duke shfrytëzuar vetitë e veçanta të tyre, si dhe në vërtetimin e rezultateve të ndryshme matema-

tike, duke u nisur nga supozimi i kundërt e duke arritur në ndonjë kundërthënie, apo duke sjellë kundërshe mbuj.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES SË LËNDËS

Ndërtimi i përmbajtjes është organizuar në përputhje me qëllimet dhe objektivat e lëndës. Kategoritë e përmbajtjes së lëndës janë dhënë në tabelën nr. 1.

Tabela 1.

Lënda	Kategoritë e përmbajtjes		Orët	%	Gjithsej %
Algjebër me gjeometri deskriptive	I. Algjebër me gjeometri analitike		22	33.33	100
	II. Gjeometri deskriptive		30	45.46	
		Provimet me shkrim	6	9.09	
		Testet	4	6.06	
		Orë rezervë	4	6.06	

PËRMBAJTJA, REZULTATET E PRITURA, LIDHJA NDËRLËNDORE

Tabela 2.

Kategoria	Nënkategoritë e përmbajtjes	Përmbajtja	Rezultatet e pritura	Lidhja ndërlëndore
I. Algjebër me geometri analitike	I.1. Gjeometria analitike në hapësirë	<p>I.1.1. Ekuacioni i rrafshit Ekuacioni i rrafshit në formën vektoriale dhe atë skalare, format e veçanta të ekuacionit të rrafshit dhe interpretimi gjeometrik i tyre, ekuacioni i tufës së rrafsheve.</p> <p>I.1.2. Ekuacioni i drejtëzës Ekuacioni i drejtëzës në formën vektoriale dhe atë skalare, format e veçanta të ekuacionit të drejtëzës dhe interpretimi gjeometrik i tyre, pozita reciproke e dy drejtëzave, largesa e pikës nga drejtëza, rrafshi dhe drejtëza, largesa e pikës nga rrafshi.</p>	<p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</p> <ol style="list-style-type: none"> të shkruajë ekuacionin e rrafshit, kur janë dhënë elementet e tij, dhe të dallojë format e veçanta të ekuacionit të rrafshit dhe gjeometrikisht t'i interpretojë ato; të shkruajë ekuacionin (kanonik, vektorial, skalar) të drejtëzës kur janë dhënë elementet e saj dhe të dijë të kalojë nga njëra formë në tjetrën; të kuptojë pozitën reciproke ndërmjet: dy drejtëzave, dy rrafsheve, një drejtëze dhe një rrafshi; të zbatojë formulat për njehsimin e largesës së pikës së dhënë nga drejtëza, përkatësisht nga rrafshi i dhënë; 	
	I.2. Programimi linear	<p>I.1.3. Programimi linear Sistemet e jobarazimeve lineare me dy e tri të panjohura, bashkësitë konvekse, formulimi i problemeve të programimit linear, gjetja e</p>		

<p>II. Gjeometria deskriptive</p>	<p>II.1. Gjeometria deskriptive</p>	<p>zgjidhjes optimale (max ose min) për pikat e një zone konvekse, problemi i transportit.</p> <p>II.1.1. Pasqyrimet kolineare Teorema e Dezargut, pasqyrimi kolinear qendror dhe ai afín.</p> <p>II.1.2. Projektioni normal në një rrafsh Projektioni normal i pikës, drejtëzës dhe rrafshit (metoda e largesave), gjurma e drejtëzës dhe ajo e rrafshit, pozita e rrëzuar e drejtëzës (rrafshit).</p> <p>II.1.3. Projektioni normal në dy rrafsh Projektioni normal i pikës, drejtëzës dhe rrafshit, gjurmët e drejtëzës dhe ato të rrafshit, pozita e rrëzuar e drejtëzës (rrafshit), projektioni i disa trupave gjeometrikë.</p>	<p>5. të zgjidhë sisteme të jobarazimeve lineare me dy e tri të panjohura dhe bashkësinë e zgjidhjeve të tyre ta paraqesë si zonë konvekse të pikave në rrafsh, përkatësisht hapësirë;</p> <p>6. të formulojë problemin e programimit linear nga të dhënat (nga jeta praktike) dhe të gjejë zgjidhjen optimale të tij;</p> <p>7. të formulojë dhe të zgjidhë problemin e transportit;</p> <p>8. të kuptojë pasqyrimet kolineare dhe teoremën e Dezargut;</p> <p>9. të zbatojë vetitë e pasqyrimeve kolineare dhe teoremën e Dezargut në zgjidhjen e detyrave të ndryshme nga projektionet normale në një dhe dy rrafsh.</p>	
--	--	---	---	--

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Si në çdo lëndë, edhe në lëndën e Algjibrës me gjeometri, detyra kryesore e arsimtarit është udhëheqja e veprimtarive arsimore të cilat përbushin arritjen e rezultateve të të nxënësve që parashikohen në objektiva.

Praktika ka treguar se teknikat, metodat e strategjitë, të cilat sigurojnë një mësimdhënie produktive, janë ato të cilat i mundësojnë nxënësve të përfshihen aktivisht në ndërtimin e të kuptuarit, në zhvillimin e strategjive matematike për zgjidhjen e problemeve dhe zhvillimin e aftësive për të zbatuar njohuritë në jetën e përditshme. Detyra e shtëpisë dhe seminarët e ndryshme janë segmente shumë të rëndësishme që mundësojnë fillimin e ndërtimit të shprehive për punë të pavarur dhe kreative në të ardhmen.

Në vendimet që merr mësimdhënësi për zgjedhjen e metodave mësimore, krahas shumë faktorëve, duhet të ketë parasysh edhe:

- natyrën e materialit mësimor;
- tipin e të nxënësve;
- nivelin dhe kërkesat e nxënësve.

Për këtë qëllim, metodat dhe teknikat e mësimdhënies duhet të jenë të larmishme që të përshtaten me stilet e ndryshme të të nxënësve të nxënësve. Ato duhet të nxisin punën bashkëpunuese të nxënësve me qëllim të përfundimit të dimenzionit shoqëror në procesin e të nxënësve.

Mësimdhënia ndërvepruese i angazhon nxënësve në marrjen e përgjegjësive për zgjerimin e njohurive, por edhe vlershmërinë e tyre.

Ky model përcaktohet nga këto faza:

1. Përcaktohet tema apo çështja që është me interes për nxënës, që ka kuptim dhe që është e lidhur ngushtë me aspektet jetësore. Kështu, Algjebra me gjeometri nga një lëndë abstrakte dhe mjaft teorike shndërrohet në një lëndë të kuptueshme, e lidhur ngushtë me jetën.
2. Arsimtari inkurajon dhe nxit nxënësve të mendojnë rreth çështjeve që trajtohen në tekst apo rreth një problemi të caktuar. Në këtë fazë ata përfshihen në hulumtime të ndryshme: vëzhgojnë, mbajnë shënime, evidencojnë probleme, marrin informacione.
3. Shtrohen shumë pyetje për sqarim, të cilave duhet dhënë përgjigje. Është e rëndësishme që pyetjet të jenë të kuptueshme për nxënësve.

4. Nxënësit zhvillojnë planet e tyre për të ndërmarrë kërkime apo hulumtime të thjeshta dhe u japin përgjigje më precize pyetjeve të shtruara në fazën e mësipërme.
5. Nxënësit së bashku me arsimtarin diskutojnë rreth praktikës së tyre, rezultateve të nxjerra nga hulumtimi apo zgjidhja e problemit. Arsimtari u ndihmon atyre të marrin në konsideratë alternativa të tjera për rezultatet dhe të planifikojnë kërkime apo hulumtime të mëtejme. Është e rëndësishme që nxënësit të përceptojnë vlerësimin e ideve të tyre, zgjidhjeve që ata japin dhe të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësitë që ata marrin.

Në vazhdim po i vëmë në dukje disa metoda të punës.

METODAT E PUNËS

Shkolla duhet të shërbejë për ruajtjen dhe ngritjen e interesimit të nxënësve për matematikën, pra edhe për Algjebrën me gjeometri dhe gradualisht ta zhvillojë atë.

- Mësimi i Algjebrës me gjeometri nuk guxon të jetë abstrakt dhe verbal, sepse matematika në esencë edhe ashtu vepron me kuptime dhe relacione abstrakte. Duhet që sa më shumë të ofrohet, duke u shërbyer me eksperimente, paraqitje grafike dhe situata reale nga jeta e përditshme.
- Mënyra e të nxënit duhet të zhvillohet në formë të një spiraleje, sepse veprimet dhe strukturat ike, pra edhe ato të Algjebrës me gjeometri, nuk është e mundshme që përnjëherë dhe në tërësi të kuptohen. Do të ishte mirë që sa herë të jetë e mundshme, tërësitë e vogla të përmbajtjeve të lidhen me të mëdhatë në atë mënyrë që duke futur përmbajtjen e re të përvetësohen sa më shumë përmbajtjet e vjetra.
- Motivimi është çelës në të mësuarit e Algjebrës me gjeometri, si dhe e matematikës në përgjithësi, sepse aty buron edhe mjeshtria e mësimdhënësit. Motivimi i nxënësve që të punojnë në mënyrë të vazhdueshme, sa më shumë që të jetë e mundshme në mënyrë të pavarur dhe sistematike është i një rëndësie fundamentale. Është me rëndësi zgjedhja e përmbajtjeve për ushtrime të cilat nxënësit vazhdimisht të menduarit, me ç'rast shkallë-shkallë paraqiten

pyetje të reja. Ushtrimet e këtilla produktive orientojnë në drejtim të një pune hulumtuese dhe ngrisin tema të reja për diskutime.

- Dallimet e nxënësve në aftësitë për të përvetësuar lëndën, mund të jenë shumë të mëdha. Prandaj, mësimit duhet të gjejnë mënyrën që të gjithë nxënësit të përparojnë. Është e preferueshme që gjatë ushtrimeve të zbatohet metoda e mendimit kritik, duke ndarë nxënësit në grupe të vogla me nga dy, katër nxënës etj.
- Duhet pasur kujdes që gjatë ushtrimeve, nxënësit të stimulohen të zgjidhin detyrat edhe në ndonjë mënyrë të veten (origjinale).
- Qëllimi i të mësuarit i Algjebrës me gjeometri nuk duhet të jetë të mësuarit mekanik të fakteve ose të veprimeve, por përvetësimi me themel i materies.
- Që në vitin e parë arsimtari nuk guxon të udhëheqë orët mësimore me metodën stereotipe të mësimit, me mësimit në qendër, duke lënë anash aktivitetin e nxënësit në të rezonuarit matematik. Duhet të zgjidhen ushtrime të përshtatshme që të zhvillohet intuita në shkallën e mjaftueshme për të lëvizur gjithmonë një hap përpara.

VLERËSIMI

Vlerësimi i rregullt i përparimit të nxënësve është pjesë e mësimit dhe të nxënësve të matematikës, pra edhe i Algjebrës me gjeometri. Përmes këtij procesi konstatohet jo vetëm shkalla e arritshmërisë së nxënësve, por edhe vlerësimi i programit dhe e metodologjisë mësimore në përgjithësi.

Vlerësimi mundëson diagnostifikimin e përparimit të nxënësve, planifikimin e drejtë të mësimit, motivimin e nxënësve dhe përcaktimet përfundimtare të rezultateve. Ai duhet të fokusohet në identifikimin e njohurive ekzistuese të nxënësve, në konceptimet e gabuara dhe strategjitë e të nxënësve. Po ashtu, përmes tij sigurohet informacion i vlefshëm, të cilin arsimtari i matematikës e shfrytëzon për të shqyrtuar aftësitë e ndryshme të nxënësve dhe njohuritë paraprake të tyre.

Mësimit gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh përmbajtjen programore, objektivat e përgjithshme dhe rezultatet e pritura të precizuara në planin dhe programin e lëndës.

1. Nivelet e arritshmërisë

Shkalla e arritshmërisë së nxënësve vlerësohet duke u bazuar kryesisht në tri nivele:

Niveli I. Përfshin arritshmërinë minimale, d.m.th. paraqet minimumin e domosdoshëm të cilin duhet ta arrijnë të gjithë nxënësit. Pra, ai paraqet kufirin e poshtëm (të lejueshëm) të përvetësimit të përmbajtjes programore, e që në përqindje do të shprehej rreth 40% të materialit të zhvilluar. Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet me ndihmën e mësimdhënësit me anë të një numri të kufizuar metodash, i arsyetojnë faktet e thjeshta matematike me ndihmën e arsimtarit si dhe komunikojnë për njohuritë matematike, duke pasur gjithmonë këtë ndihmë.

Niveli II. Paraqitet me kufijtë e rezultateve të shprehura në përqindje (50%-80%). Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet dhe i arsyetojnë faktet matematike me ndihmën e kufizuar të mësimdhënësit, me anë të një numri jo të madh të strategjive dhe të metodave, me disa gabime apo me mangësi të vogla.

Niveli III. Është niveli i avancuar i arritjes së nxënësve i shprehur në përqindje (80-90%). Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet dhe i arsyetojnë faktet matematike, me një ndihmë shumë të kufizuar të arsimtarit.

Niveli IV. Është niveli më i lartë i arritjes së nxënësve i shprehur në përqindje (mbi 90%). Në këtë nivel duhet të përfshihen nxënësit të cilët i zgjidhin problemet dhe i arsyetojnë faktet matematike, në mënyrë të pavarur. Zgjidhin probleme matematike me metoda të ndryshme, analizojnë dhe komentojnë rezultatet e fituara në mënyrë të pavarur dhe saktë, me gjuhë të qartë dhe rrjedhshmëri logjike.

2. Procedura e vlerësimit

Procedura e vlerësimit rekomandohet të bëhet në harmoni me standardet e vendosura. Tipat e vlerësimit janë të shumtë. Ata duhet të përdoren në përputhje me qëllimet dhe objektivat e lëndës, strategjitë e të nxënësve dhe moshën e kërkesat e nxënësve. Për lëndën e Algjebërës me gjeometri konsiderojmë se vlerësimi mund të bëhet duke marrë parasysh këto aktivitete:

- Puna në klasë:

- përgjigjet me gojë;
- aktivitetin e nxënësit nga vendi;
- aktivitetin gjatë punës në grupe.
- Testimi:
 - testet për grup temash;
 - testet në fund të kategorisë së përmbajtjes;
 - testet në fund të semestrit.
- Provimet me shkrim.
- Detyrat e shtëpisë dhe detyrat seminarike.

LITERATURA

1. M. Berisha, M. Demaj, *Matematika për klasën III gjimnaz*, “Libri Shkollor”, Prishtinë, 1999.
2. E. Hamiti, *Matematika për klasën III gjimnaz*, ETTM, Prishtinë, 1975.
3. Ll. Puka, E. Lulja, P. Bici, N. Perdhiku, N. Kreçi, *MATEMATIKA 4.1 për shkollat e mesme të përgjithshme*, Lezhë, 2001.
4. L. Sula, N. Kreçi, M. Gumeni, S. Llambiri, *MATEMATIKA 4.2 për shkollat e mesme të përgjithshme*, Lezhë, 2001.
5. F. Berisha, M. Kadriu, *Përmbledhje detyrash nga matematika për klasën e tretë të shkollave të mesme*, “Libri Shkollor”, Prishtinë, 2000.
6. R. Musa, *Gjeometria deskriptive*, Prishtinë.
7. S. Vukadinović: *Problemi i transportit i programimit linear*, Beograd.

BIOLOGJI

Gjimnazi: shkencat e natyrës (3 orë në javë, 99 orë në vit)

HYRJE

Ky program parashikon që lënda e biologjisë për kl. 12 të zhvillohet për 99 orë. Për fleksibilitet, në program të këtij profili të gjimnazit të kësaj klase janë parashikuar më shumë se më parë orë praktike dhe orë në dispozicion (gjithsej 19 orë). Me këtë synohet që arsimtarit t'i jepet më shumë hapësirë për të përshtatur mësimin, varësisht nga kushtet që ofron klasa, shkolla etj. Në trungun e përmbajtjes lënda ka dy kategori dhe pesë nënkategori. Kategoria e parë (Proceset jetësore) përfshin dy nënkategori: 1. Inxhinieria gjenetike dhe 2. Gjenetika e njeriut. Kategoria e dytë (Qeniet e gjalla dhe mjedisi) përmban tri nënkategori: 1. Ekologji-etologji. 2. Njeriu dhe mjedisi. 3. Evolucionin organik. Duke i sublimuar informacionet e marra nga programet e kohës në rajon e më gjerë, jemi përpjekur që në fushën e programeve të biologjisë, sipas kurrikulit të ri në përgjithësi, e në veçanti për kl.12, të sigurojmë "rrjedhën" e koncepteve nga niveli i dytë në nivelin e tretë. Kjo prirje është shoqëruar me një përzgjedhje të kujdesshme të lëndës, p.sh. inxhinieria gjenetike dhe gjenetika e njeriut, njeriu dhe mjedisi etj., me synim që përmbajtja programore e biologjisë të jetë koherente, logjike dhe e aplikuar konform kërkesave të mileniumit të ri. Veçori tjetër e programit të reformuar të biologjisë në përgjithësi, e në veçanti të kl. 12, është "përzjerja" e temave mësimore. Për dallim prej programeve tradicionale, ku, p.sh. njohuritë nga botanika, zoologjia, fiziologjia, ekologjia etj. jepeshin të "izoluara" nga njëra tjetra, me "përzjerjen" e temave synohet të jepet parashtrim i integruar i njohurive nga fushat specifike të biologjisë me shkencat e tjera. Kjo qasje u mundëson nxënësve të fitojnë njohuri të nevojshme për jetën e përditshme konform kërkesave të kohës dhe hap rrugën e përvetësimit më të lehtë të koncepteve të tjera që do shpalosen në vazhdim të shkollimit, studimeve.

Në fund po theksojmë se ngjashmëritë që vihen re në emërtimin e kategorive dhe nënkategorive në nivelin e parë, të dytë dhe të tretë të shkollimit, me zbërthimin e tyre tematik për çdo orë mësimore kanë ndryshime të dukshme në përmbajtje dhe në qasje.

QËLLIMET

Programi mësimor i lëndës së biologjisë për klasën e dymbëdhjetë ka për qëllim:

- Zhvillimin e aftësive të nxënësit për të njohur dhe për të kuptuar ligjshmëritë themelore të proceseve jetësore, në kontekstin historik dhe në nivel molekular, të individës dhe të popullatës (evolucioni, inxhinieria gjenetike, gjenetika e njeriut).
- Zhvillimin e njohurive për qeniet e gjalla dhe mjedisin (ekologji, evolucion) dhe aftësive për të zbatuar njohuritë si dhe për t'u ndeshur me problemet mjedisore në mënyrë konstruktive dhe rehabilituese (njeriu dhe mjedisi).
- Zhvillimin e shkathtësive të përhershme për mbledhjen , përpunimin e të dhënave relevante shkencore dhe zbatimin e shkathtësive të fituara në situata konkrete për të mirën e njeriut dhe mjedisit (monitorimi biologjik, këshillat gjenetike etj..)

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nga përmbajtja programore e klasës së 12 nxënësi duhet të jetë në gjendje :

O Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat

- Në kontest të ndërgjegjësimit dhe të ngritjes së përgjegjësisë etike ndaj mjedisit human dhe natyror dhe pjesëmarrjes aktive në zgjidhjen e problemeve mjedisore;
- Në kuptim të kultivimit të sjelljeve personale (të jetë kooperativ, i hapur, tolerant, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik etj. (10 njerëz të vullnetshëm punojnë më shumë se 1000 njerëz të detyruar).

O Të njohë

- Fjalorin (terminologjinë biologjike nga inxhinieria gjenetike, bioteknologjia, ekologjia etj.);

- Faktet, konceptet dhe parimet biologjike;
- Procedurat dhe metodat në biologji.

O Të kuptojë

- Faktet dhe parimet biologjike dhe të bëjë ndërlidhjen logjike të tyre (p.sh. biologjinë me teknikën, farmacinë etj.);
- Relacionin shkak – efekt (psh. efekti i serros dhe ngrohja globale, pasojat);
- Arsyejojë metodat dhe procedurat.

O Të zbatojë në situata të reja

- Faktet dhe parimet biologjike;
- Procedurat dhe metodat në biologji;
- Zgjidhjen e problemeve të natyrës biologjike.

O Të komunikojë informatat në kontekste të ndryshme

- Shkrimi i raportit nga një punë praktike ose hulumtim:
- Të prezantojë rezultatet e hulumtimit duke konsultuar shumë burime të informacionit;
- Informacionin për problemet biologjike (inxhinieria gjenetike, gjenetika e njeriut, etj. e përshkruan dhe e interpreton në mënyrë gojore, me tabela, grafikone etj.;
- Të kontribuojë me pjesëmarrje (OJQ mjedisore) debate dhe diskutime për çështje biologjike e mjedisore “mendo globalisht vepro lokalisht,” p.sh. efekti” green haus”.

O Të zhvillojë të menduarit kritik për biologjinë; pra jo vetëm të kuptojë se çka ndodhur, por të shtrojë pyetje si dhe pse kanë ndodhur?

- Të njohë informatën relevante nga ajo jorelevante;
- Të dallojë faktin nga gjykimi;
- Të zbatojë parimet biologjike në zgjidhjen e problemeve në mjekësi, veterinë, bujqësi, energjetike (p.sh. nafta artificiale, poliploidia etj.);
- Të interpretojë materialin ilustrues.”një figurë vlen sa 1000 fjalë”.

PËRMBAJTJA PROGRAMORE

Kategoria	Nënkategoria	Nr. orëve	%
I. Proceset jetësore	I.1.1. Inxhinieria gjenetike	10	10.1
	I.1.2. Gjenetika e njeriut	12	12.1
II. Qeniet e gjalla dhe mjedisi	II.1. Ekologjia	20	20.2
	II.1.2. Etologjia	7	7.1
	II.1.3. Njeriu dhe mjedisi jetësor	22	22.2
	II.2. Evolucioni	10	10.1
	Punë praktike	12	12.1
	Orë në dispozicion	6	6.0
Gjithsej:		99	100

KATEGORIA	NËNKATEGORIA	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	REZULATET E PRITSHME	LIDHJA NDËRLËNDORE
Proceset jetësore	Inxhinieria gjenetike	<ul style="list-style-type: none"> • Manipulimi me material gjenetik (inxhinieria gjenetike) në nivel të gjeneve, kromozomeve dhe gjenomit ka bërë të mundur të fitohen “makina gjenetike”, sisteme të gjalla, veçoritë e të cilave kanë ndryshuar dhe u janë përshtatur nevojave të njeriut në shumë fusha të jetës së tij, p.sh.: industrinë ushqimore, energjetikë, bujqësi, farmaci, industrinë e pijeve, spastrimin e ujërave të ndotur, mjekësi etj • Klonimi është proces i prodhimit të qelizave ose i organizmave gjenetikisht identikë. 	<ul style="list-style-type: none"> • definon termin inxhinieri gjenetike; • shpjegon si fitohen gjenet e caktuara me procesin e transkriptimit të kthyeshëm; • përshkruan teknikën e rikombinimit të ADN-ës dhe rolin e enzimeve (endonukleazave të restriksionit dhe ligazave) të ADN-ës në këtë proces; • vlerëson rolin e vektorëve (plazmoideve dhe bakteriofagëve) në inxhinierinë gjenetike; • arsyeton pse operacionet në inxhinierinë kromozomale mund të përcillen vizuelisht me mikroskop.; • përshkruan teknikat e këputjes, fragmentimit, të materialit kromozomal (këputja e kromozomeve të tëra ose fragmenteve të kromozomeve, me veprim të enzimeve të restriksionit); • ndërlidh inxhinierinë kromozomale me transferin e fragmenteve kromozomale, kromozomeve të tëra si dhe ndërtimin e kromozomeve artificiale. • arsyeton pse kromozomi artificial ka aftësi të kryejë funksionet e kromozomit natyror (p.sh. si dyfishohet, si i shkëputen kromatidet e kromozomeve etj.); • vlerëson rëndësinë e manipulimit me kromozome për kontrollin biologjik të shumëzimit të insekteve të dëmshme; 	

			<ul style="list-style-type: none"> • përshkruan etapat si kryhet klonimi në shembullin e bretkosës, miut dhe deles së Dolit dhe analizon problemet praktike dhe etike lidhur me të; • kupton se manipulimi direkt me garniturën complete të kromosomeve të qelizës quhet inxhinieri e gjenomit; • shpjegon hibridizimin e qelizave bimore dhe shtazore; • definon termin poliploidi dhe përshkruan shkaqet e shfaqjes së saj (spontane, stresi, temperatura, kolhicina etj.). • vlerëson rolin e poliploidisë për fitimin e varieteteve të reja të bimëve dhe të kafshëve më cilësi të kërkuara nga njeriu dhe kupton se poliploidia e indukuar mund të konsiderohet lëmë e inxhinierisë së gjenomit; • analizon rolin e inxhinierisë gjenetike në revolucionin teknik dhe vlerëson rolin e bioteknologjisë për prodhimin e barnave, proteinave me rëndësi mjekësore, hormoneve, djathit, birrës, jogurtit , resurseve energjetike (p.sh. biogasi etj.). 	
Proceset jetësore	Gjenetika e njeriut	<ul style="list-style-type: none"> • Në gjenetikën e njeriut janë zhvilluar metoda të veçanta për vrojtimin dhe analizën e trashëgimisë së veçorive të ndryshme, si p.sh.metoda e hibridizimit,metoda gjenealogjike, 	<ul style="list-style-type: none"> • definon termin gjenetikë e njeriut; • tregon si formohet pema farefisnore; – filogrami (heredogrami); • arsyeton pse janë të dëmshme martesat ndërmjet individëve që janë në farefisëri; • përshkruan si vërtetohet shkalla e farefisërisë; 	Fizikë, kimi, matematikë, biokimi,

	<p>metoda e bineqve etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sëmundjet trashëguese janë gjendje patologjike e organizmit të lidhura me ndryshime në nivel të gjeneve (sëmundjet monogjenike autosomale dominante dhe recesive); kromozomeve (ndryshime numerike dhe strukturore të kromozomeve autosomale dhe të seksit.). • Disa sjellje të njeriut dhe sëmundje mentale ndërlidhen me bazën trashëguese. <p>PRAKTIKUM</p> <ul style="list-style-type: none"> • Trashëgimia e tipareve të lidhura me seksin. • Pema gjenealogjike (farefisnore . • Trashëgimia e sëmundjeve të lidhura me seksin. • Kromatini seksual. 	<ul style="list-style-type: none"> • shpjegon koeficientin e kryqëzimit në farefisëri dhe arsyeton rëndësinë e caktimit të tij; • emërton dhe përshkruan disa sëmundje monogjenike që trashëgohen në mënyrë autosomale dominante (polidaktilia, adaktilia, sindaktilia, brahidaktilia, ahandroplazia (shkurtabiqët) dhe recesive (alkaptonuria, fenilketonuria, albinizmi etj.); • emërton dhe përshkruan disa kromozomopati të lidhura me kromozomet e seksit (daltonizmi, hemofilia), që trashëgohen në mënyrë recesive, ndryshim të numrit të kromozomeve autosomale (sindromi i Downit) si dhe i kromozomeve të seksit (sindromi i Klinefelterit); • përshkruan sëmundjen gjenetike “të qajturit e macës (“Cri du chat”) si pasojë e ndryshimeve strukturore në kromozome; • numëron metodat me ndihmën e të cilave gjatë zhvillimit embrional mund të zbulohen disa sëmundje; • përshkruan detyrat kryesore të gjenetikës humane gjatë hulumtimit të veçorive të sjelljes. • Ndërlidh faktorin trashëgues dhe sëmundjet mentale (shizofrenia, sëmundja e Parkinsonit); • ndërlidh koeficientin e inteligjencës (QI) me faktorët trashëgues; • kupton se termi inteligjencë është i ngjashëm me termin elektricitet, pra lehtë matet, por vështirë definohet; 	
--	---	---	--

		<ul style="list-style-type: none"> • Vrojtimi me mikroskopik i kromozomeve në majë të rrënjës së qepës ose në gjëndrat pështymore të mizës së verës <i>Drosophila melanogaster</i>. 	<ul style="list-style-type: none"> • identifikon simbolet që përdoren për studimin e trashëgimisë së një tipari; • përpilon skemën e trashëgimisë së seksit të njeriu dhe përshkruan rolin e kromozomeve seksuale në këtë proces; • zgjedh detyra lidhur me trashëgiminë e grupeve të gjakut të sistemit MN, ABO dhe Rezus; • përpilon pemën gjenealogjike të dy familjeve me tiparin e daltonizmit dhe jep shpjegime lidhur me to; • përpilon pemën gjenealogjike të përcjelljes së hemofilisë në shembullin e pjesëtarëve të një familje, arsyeton pse kryesisht meshkujt vuajnë nga hemofilia dhe shpjegon pse nuk lejohen martesat në farefisëri; • përgatit preparate të freskëta të mukozës së gojës (meshkujt dhe femrat), ngjyrosin ato me karmin-acid-acetik dhe identifikojnë kromatinën seksuale ose trupthin e Barit që gjendet paralel me mbështjellësin bërthamor; • krahason preparatet ku gjendet trupthi i Barit dhe përfundon se ai është dukuri përcjellëse e qelizave të seksit femëror; 	
Qeniet e gjalla dhe mjedisi	Ekologjia	<ul style="list-style-type: none"> • Për të kuptuar se si funksionon një ekosistem duhet kuptuar konceptin e sistemit dhe duhet parafytyruar modele të ndryshme të sistemeve. • Për të analizuar ndërveprimet që 	<ul style="list-style-type: none"> • vrojtojnë dhe identifikojnë organizmat e zakonshëm në ekosisteme dhe mbledhin, regjistrojnë dhe paraqesin grafikisht të dhëna lidhur me ndërveprimet e këtyre organizmave (nga vrojtimit, burimet e literaturës dhe 	Gjeologji, gjeografi, fizikë, kimi

		<p>rezultojnë në rrjedhën e energjisë dhe të qarkullimit të materies nëpër ekosistem, duhet identifikuar elementet përbërëse të ekosistemit dhe duhet interpretuar se si shfrytëzohet energjia dhe materia nga çdo organizëm.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shumë komponime dhe elemente të rëndësishme qarkullojnë nëpër komponentet e gjalla dhe jo të gjalla të mjedisit në formë të një cikli dhe vazhdimisht përsëriten. • Energjia hyn në ekosistem përmes procesit të fotosintezës dhe rrjedh nëpër ekosistem pasi që organizmi në ekosistem han dhe hahet prej të tjerëve. Kjo rrjedhë e energjisë mund të modelohet përmes marrëdhënieve të shprehura në zinxhirët e ushqimit. • Materiet riciklohen dhe shndërrohen në formë të përshtatshme për shfrytëzim të sërishëm përmes veprimit të shpërbërësve • Sasia e energjisë në dispozicion në secilin nivel trofik (prodhues, konsumatorë të rendit të parë, të dytë dhe të tretë zvogëlohet). Kjo mund të modelohet përmes një 	<p>elektronike);</p> <ul style="list-style-type: none"> • klasifikojnë organizma të gjetur në ekosistemet lokale si prodhues, konsumatorë të rendit të parë, të dytë dhe të tretë. Dizajnojnë dhe konstruktojnë modele të rrjeteve ushqimore me këta organizma; • vrojtojnë ekosistemet lokale dhe identifikojnë, masin dhe klasifikojnë komponentet e gjalla dhe jo të gjalla të tyre; • dallojnë proceset kyçe në ciklin e ujit, karbonit dhe azotit dhe analizojnë se si funksionojnë në këto cikle organizmat prej baktereve dhe kërpudhave deri te konsumatorët e rendit të tretë; • identifikojnë shembuj të ndërvarshmërisë në ekosisteme tokësore, të ujërave tokësore dhe deteve; • zbatojnë konceptet e zinxhirëve të ushqimit, rrjeteve të ushqimit dhe piramidave energjetike për të analizuar se si materia qarkullon dhe energjia rrjedh nëpër ekosistem; • interpretojnë, analizojnë dhe vlerësojnë të dhënat lidhur me ndërveprimet e popullatave në një ekosistem; • dallojnë tipat e ndryshëm të simbiozës dhe japin shembuj për secilën prej tyre (mutualizmi, komensalizmi, parazitizmi); • ndërlidhin kuptimin e nishës ekologjike me karakteristikat fizike të organizmit. 	
--	--	--	--	--

		<p>piramide të energjisë, në të cilën prodhuesit sigurojnë bazë të gjerë të materies dhe të energjisë për anëtarët e tjerë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërveprimi mes një konsumatori, i cili gjuan konsumatorin tjetër për t'u ushqyer, me të është në marrëdhënie grabitës-gjah (predator-pre). • Popullatat e një lloji mund të hyjnë në konkurrencë me popullatat e llojit tjetër për burime të ndryshme. • Popullatat e një lloji mund, gjithashtu, të bashkëveprojnë me popullatat e llojit tjetër për burimet e mjedisit. • Marrëdhënia simbiotike mund të ekzistojë mes dy ose më shumë organizmave kur jetojnë ose veprojnë së bashku. • Marrëdhëniet simbiotike përfshijnë mutualizmin (në të cilin të dy organizmat përfitojnë), komensalizmin (në të cilin njëri organizëm përfiton, kurse tjetri është neutral) dhe parazitizmin (në të cilin një organizëm përfiton, kurse tjetri dëmtohet). • Çdo organizëm luan një rol 		
--	--	--	--	--

	<p>specifik ose plotëson një nishë në bashkësinë jetësore ku jeton.</p> <p>EKSKURSION</p> <p>- Veçoritë ekologjike të ekosistemit të pyllit</p> <p>PRAKTIKUM</p> <p>- Metoda e drejtpërdrejtë e përcaktimit të rritjes vëllimore</p> <p>Njohja me ekosistemet e ujërave tokësore</p>	<p>Dallon bimët drunore, shkurret dhe barsishtoret e pyllit, duke përcaktuar karakteristikat e vendosjes në kate dhe ato stinore të prodhimit të parë në to; - emërton dhe shënon llojet tipike të çdo kati; - arsyeton pse pjesa më e madhe e bimëve të katit të parë pluhërohen me anë të erës; - shpjegon pse bimët e katit të parë lulëzojnë para çeljes së gjetheve.</p> <p>Vlerëson rritjen e biomasës së një trungu në varësi nga diamteri i trungut ose trashësia e rathëve vjetorë të matur pas prerjes; - din se zonat me ngjyrë të çelur të këtyre rathëve përfaqësojnë drurin pranveror; - përshkruan karakteristikat fiziografike dhe biocenologjike të ujërave rrjedhëse (përrockave, përrenjve, lumenjëve etj.); - mbledh shtazë dhe bimë ujore dhe përmes tyre përcakton gjendjen ekologjike të ekosistemit; - përshkruan si merret planktoni nga moçali ose kënetat me ndihmën e rrjetit planktonik dhe bën markimin e tij; - analizon materialin e mbledhur me mikroskop, vizaton algjet që i vrojton dhe përcakton cilat algje janë ato.</p>	
--	---	---	--

<p>Qeniet e gjalla dhe mjedisi</p>	<p>Biologjia e sjelljes</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Sjellja është një veprim ose seri veprimesh të shtazës si përgjigje në zëglat e mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm. • Për të siguruar kontinuitetin e jetës dhe ushqimin, për t'u mbrojtur nga rreziqet e mjedisit rrethues, për të zënë vend në hierarki të grupit, për të markuar territorin etj., te gjallesat shfaqen forma të ndryshme të sjelljes, p.sh. sjellja shoqërore, sjellja martesore, lidhjet familjare, jeta në tufa etj. • Sjellja e shtazëve determinohet nga baza gjenetike, kurse zhvillimi i sjelljes përmes përvojës quhet sjellje e mësuar. Gjenet dhe të mësuarit ndërveprojnë për të formësuar sjelljen e shtazëve. • Aftësia e njeriut për të kontrolluar sjelljen bën që sjellja shoqërore e tij të dallohet kualitativisht nga sjellja e kafshëve. Sjelljen e njeriut e karakterizon instinkti social, kooperimi, frika, agresiviteti, territori, format devijante të sjelljes etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • Definojnë termin sjellje dhe arsyet pse sjellja realizohet në kufijtë që përcaktohen nga mundësia e sistemit receptor, efektor dhe nervor; • përshkruan tipat e ndryshëm të sjelljes së shtazëve si: kujdesi prindor, sjellja martesore, sjellja mbrojtëse, sjellja për sigurimin e ushqimit, sjellja migratore, sjellja territoriale; • përshkruan format e bashkëlidhjes midis prindërve dhe pasardhësve; • kupton se takimi i individëve të sekseve të ndryshme bëhet si rezultat i reaksionit në sinjale kimike (ferromoneve), tingujve (insektet, bretkosat, shpendët) të dhëna nga njeri prej partnerëve të ardhshëm; • sjell shembuj që vërtetojnë se ferromonet e vertebrorëve shërbejnë jo vetëm që të tërhiqet individi i seksit të kundërt, por edhe për të shënuar territorin; • përshkruan sjelljen martesore te peshqit, bretkorët, shpendët dhe gjitarët; • arsyeton përparësitë e organizmit të jetës në grupe të shtazëve dhe shpjegon se grupimi bëhet në bazë të sinjaleve të shikimit, zërave dhe sinjaleve kimike; • përshkruan format e ndryshme të organizimit të jetës shoqërore të shtazëve të ndryshme; • përshkruan format e shënimit të territorit te llojet e ndryshme të shtazëve; • përshkruan dallimet kualitative të sjelljes së 	<p>Ekologjinë, fiziologjinë, psikobiologjinë krahasuese, sociologjinë dhe zoosociologjinë</p>
---	-----------------------------	--	--	---

			<p>njerëzve dhe të kafshëve dhe arsyeton pse njeriu ka aftësi të kontrollojë e të modifikojë sjelljen;</p> <ul style="list-style-type: none"> • definojnë termin instikt social; • ndërlidh bazën trashëguuese të njeriut me kuptimin biologjik të instinktit • dallojnë sjelljen instiktive të njeriut të sotëm nga njeriu i hominizimit të hershëm; • shpjegon si rregullohet sjellja paternale te njeriu; • gjykon deri në ç' masë njeriu kontrollon instinktete agresive. • ndërlidh sjelljen kooperative dhe agresive të njeriut me territorin e tij; • analizon bazën trashëguuese të disa sjelljeve devijante të njeriut; 	
Qeniet e gjalla dhe mjedisi	Njeriu dhe mjedisi	<ul style="list-style-type: none"> • Mjedisin jetësor të njeriut e përbëjnë dy botëra; njëra botë është natyra (bimët dhe shtazët, toka, uji, ajri) e cila ekziston milionë vjet para njeriut, pjesë përbërëse e së cilës është edhe vetë njeriu dhe bota tjetër është bota e objekteve, e lëndëve, institucioneve të cilat njeriu i krijoi për vete duke përdorur shkencën, teknikën dhe teknologjinë, për të krijuar një mjedis jetësor që u përgjigjet nevojave dhe synimeve të tij; 	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan ndryshimet e kushteve fizike dhe kimike në mjedis si pasojë e veprimit të faktorit njeri; • numëron burimet kryesore të ndotjes në përmasa globale dhe lokale; • sjell shembuj për ndikimin e njeriut në mjedis në nivel lokal dhe global; • interpreton mjedis në këndvështrimin fizik, gjeografik, biologjik, ekonomik, politik, sociologjik, teknologjik, estetik, shpirtëror etj.; • shpjegon ndryshimet e përbërjes së botës së gjallë si pasojë e veprimit të faktorit njeri; • vlerëson ndikimin e urbanizimit dhe të 	

		<ul style="list-style-type: none"> • Sot biosfera në përgjithësi dhe mjedisi jetësor në veçanti karakterizohet me rritjen e ekosistemeve atropogjene (agrare, rurale dhe urbane) dhe zvogëlim të sipërfaqeve të ekosistemeve natyrore. • Si pasojë e veprimit të faktorit antropogjen formë më e dukshme e degradimit të biosferës është ndotja e ajrit, tokës, ujit. Pasojat janë të shumta, që nga hollimi i filtrit ozonik mbi Antarktik, ngrohja globale, vdekja e pasqaruar e pyjeve (shirat acidike) dhe e shumë llojeve bimore dhe shtazore. • Njeriu për të fituar rendimente më të larta nga ekosistemet agrare gjithnjë e më tepër po përdor agrokimikate, si pasojë po shtohet rreziku i kontaminimit të ushqimit dhe po rrezikohet shëndeti dhe e ardhmja e njeriut. • Sot njeriu ndërmerr masa për mbrojtje dhe rehabilitim të natyrës së degraduar-mbrojtja e natyrës. 	<p>industrializimit në mjedis;</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndotjes fizike, kimike, termike dhe biologjike të ujit, ajrit, tokës (dhe ushqimit) për gjallesat dhe biosferën; • përshkruan masat ekoteknologjike të transformimit të biomasës në lëndë djegëse.; • vlerëson rëndësinë e përdorimit të plehrave mikrobiale në vend të atyre minerale dhe përshkruan si bëhet inokulimi (mbjellja) në tokë e llojeve mikrobiologjike, p.sh. mikrobet azotofiksatorë, kërpudhat mikorizës, që rrisin asimilimin e fosfateve dhe të mikroelementeve nga toka; • sjell shembuj të përdorimit të insekticideve mikrobiale; • kupton se një ndryshim në një sistem ekologjik sjell ndryshime të vazhdueshme në të derisa të vendoset ekuilibri i ri ekologjik; • sjell shembuj për pasojat shëndetësore dhe gjenetike të mjedistit të ndotur për gjallesat dhe njeriun; • definon termin monitoring dhe përshkruan rëndësinë e monitoringut kimik, radioaktiv dhe biologjik për përcjelljen e shkallës së kontaminimit të mjedistit jetësor. • dallon monitoringun biologjik aktiv prej atij pasiv dhe vlerëson rolin e organizmave bioindikatorë në sistemin monitoring; • vlerëson rëndësinë e regjistrimit floristik dhe faunistik, librit të kuq, rezervateve natyrore, 	
--	--	--	---	--

		<p>PRAKTIKUM</p> <ul style="list-style-type: none"> - automobili dhe ndotja termale e mjedisit - të reshurat acidike - flora si indikator i ndotjes së ajrit 	<p>kopshteve botanike, zoologjike dhe parqeve nacionale për ruajtjen e natyrës;</p> <ul style="list-style-type: none"> • numëron masat e përgjithshme ligjore, teknike, kërkimore, arsimore dhe monitoruese për ruajtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor; • punon në zgjidhjen e problemeve mjedsore në mënyrë konstruktive dhe rehabilituese. • mban qëndrim dhe aplikon njohuri, kuptime dhe vlera për të mbrojtur dhe për të përmirësuar mjedisin; • propagon krijimin e modeleve të reja të sjelljes individuale e kolektive ndaj mjedisit, për të ruajtur e për të mos atakuar atë; • merr pjesë aktive në zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar; • analizon informacinet mjedisore dhe zhvillon qëndrim kritik ndaj tyre; • informacionin për problemet mjedisore e përshkruan dhe e interpereton në mënyrë gojore, me tabela, grafikone me synim të zgjidhjes së mundshme. <ul style="list-style-type: none"> • mat temperaturën e ajrit në afërsi të drejtpërdrejtë të semaforit gjatë verës dhe 200-330 metra larg tij (me rrathë koncentrikë) dhe arsyeton pse temperatura afër semaforëve është më e lartë; • me ndihmën e letrës së lakmusit cakton vlerën PH të mostrave të të reshurave atmosferike (shiu, borës) dhe dheut (të marrë) afër repartit 	
--	--	--	---	--

		- dendësia e popullacionit të skrajës së shiut si indikator i ndotjes	<p>industrial dhe në vendbanim me pak të ndotura;</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon pasojat e ndryshimit të vlerës pH të tokës (shirave acidike) për bimët; • emërton bimët (likenet dhe myshqet) që shërbenë si indikatorë i ndotjes së ajrit me dioksid të sulfurit; • përshkruan ndryshimet në gjethet e duhanit si pasojë e ndotjes së mjedisit me ozon; • dallon rrathët vjetorë në kërcell të bimës shumëvjeçare dhe arsyeton pse në kushte të ndotjes zvogëlohet trashja sekondare e kërcellit; • krahason vjetakët në kërcell të bimës dhe në bazë të trashësisë së tyre cakton kohën e rritjes së ndotjes në atë regjion; • cakton dendësinë e popullacionit të skrajave të shiut në regjion të ndotur dhe jo të ndotur dhe arsyeton ndryshimet eventuale në dendësinë e popullatave ndërmjet këtyre dy regjioneve. 	
Qeniet e gjalla dhe mjedisi	Evolucioni	<ul style="list-style-type: none"> • Bota organike e sotme, bimë dhe kafshë, për rjedhim edhe njeriu, janë produkt i procesit të zhvillimit evolutiv që ka zgjatur milionë vjet. • Historia evolutive e shumë bimëve dhe e kafshëve në mënyrë të hollësishme është fiksuar në të ashtuquajturat prova evolutive: kronikë paleontologjike-fosile, prova biogeografike, embriologjike etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • definon termin evolucion; • përshkruan shfaqjen dhe mbizotërimin e grupeve kryesore të gjallesave gjatë historisë së jetës në Tokë në periudhat e ndryshme gjeologjike; • vlerëson rolin e provave anatomiko-krahasuese, embriologjike, biogeografike, biokimike, fiziologjike dhe fosileve për evolucionin; • krahason ngjasimet midis embrioneve të kurrizorëve të ndryshëm si provë për prejardhjen e përbashkët të tyre; • përshkruan pikëpamjet e natyralistëve dhe të 	

		<ul style="list-style-type: none"> • Procesi jo i kthyeshëm natyror i zëvendësimit të disa llojeve me të tjera ka ndodhur pa pushim dhe ka çuar në lindjen e llojeve të bimëve dhe të kafshëve që ekzistojnë sot duke përfshirë edhe njeriun. Në këtë proces të gjatë rol të rëndësishëm ka lufta për ekzistencë e qenieve të gjalla në varësi nga njëra-tjetra si dhe përzgjedhja natyrore. • Njeriu është produkt i zhvillimit të natyrës me prejardhje shtazore. Për këtë flasin provat paleontologjike dhe etapat kryesore të antropogjenezës. Rol themelor në formimin e tij ka luajtur puna, e cila nuk është faktor biologjik, por shoqëror. • Si rrjedhim i reaksioneve të ndërlikuara që ndodhën gjatë evolucionit të Tokës, në oqeanin e parë dhe veprimin të rrezatimeve të shumta, shkallë-shkallë nga molekulat e thjeshta u formuan molekulat komplekse (proteinat, acidet nukleike, përkatësisht koacervatet). Formimi i acideve nukleike dhe vetëdyfishimi kanë qenë dukuri të pandara në rrugën e formimit të gjallesave të para heterotrofe, e 	<p>filozofëve të lashtësisë për zhvillimin e botës së gjallë dhe vlerëson rëndësinë shkencore të teorisë së Darvinit për evolucionin;</p> <ul style="list-style-type: none"> • arsyeton rolin e përzgjedhjes natyrore si forcë kryesore të evolucionit të botës së gjallë; • sjell shembuj të përzgjedhjes natyrore dhe artificiale; • përshkruan mënyrat e formimit të llojit-speciacionit; • dallon mënyrën e formimit simpatik dhe aloptarik (gjeografik) të llojit; • përcakton pozitën sistematike të njeriut në botën shtazore; • përshkruan pemën gjenealogjike të primatëve; • numëron tiparet e mirëfillta të njeriut që nuk i gjen te majmunët; • përshkruan fazat e zhvillimit evolutiv të llojit njeri; • shpjegon si kanë lindur racat njerëzore dhe interpreton pikëpamjet pseudoshkencore për racat, shpjegon se njeriu është produkt i natyrës dhe produkt shoqëror; • përshkruan pikëpamjet e shkencëtarëve të lashtë grekë për prejardhjen e jetës në TOKË; • shpjegon vlerat praktike të eksperimenteve të Luj Pasterit që hodhën poshtë teorinë “genera spontanum” (lindjes së vetëvetishme të gjallesave); • sjell shembuj për të vërtetuar se mikroorganizmat nuk mund të lindin në mënyrë të 	
--	--	---	---	--

		<p>më vonë edhe autotrofe</p> <p>- PRAKTIKUM DHE DEMONSTRIME</p> <p>- Variabiliteti si faktor i evolucionit në shembullin e gëzhojave të kërmillit të vreshtit</p> <p>Organet homologe dhe analoge</p>	<p>vetëvetishme;</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan atmosferën primitive të Tokës dhe përbërjet organike para lindjes së jetës; • përshkruan eksperimentin e Mullerit, i cili imiton në laborator kushtet e atmosferës primitive; • analizon ecurinë e proceseve që ndihmuan evolucionin e materieve organike të bazeneve ujore drejt lindjes së formave të jetës; • numëron tiparet e ndërtimit dhe funksionet jetësore të koacervateve dhe kupton se format e para jetësore kanë qenë heterotrofe. <p>* Nxënësit sjellin në klasë shumë gëzhoja të kërminjve të vreshtit, radhisin ato në një kuti dhe vrojtojnë dallimet në ngjyrë (prej ngjyrës së ndritshme, deri te ngjyra e errët si dhe tipat kalues me vija të zeza të ngushta deri të ato të gjera) si dhe dallimet në formë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • arsyetojnë shkaqet e ndryshimeve të tilla; • krahasojnë (në modele) planin unik të ndërtimit të ekstremiteteve të përparme te njeriu, zogu, zvarraniku dhe lakuriqi, analizojnë funksionet që kryejnë ato dhe emërtojnë dukurinë e tillë në evolucion (organet homologe); • nga atlas krahasojnë planin e ndërtimit të krahut të insektit, të shpendit dhe të lakuriqit, përshkruajnë funksionet që kryejnë dhe emërtojnë dukurinë e tillë në evolucion (organet analoge). 	
--	--	---	---	--

BIOLOGJI

Gjimnazi i përgjithshëm (2 orë në javë – 74 orë në vit)

HYRJE

Ky program parashikon që lënda e biologjisë për kl. 12 në gjimnazin e përgjithshëm të zhvillohet për 74 orë. Për fleksibilitet, në programin e biologjisë të kësaj klase janë parashikuar më shumë se më parë orë praktike dhe orë në dispozicion (gjithsej 17 orë). Me këtë synohet që arsimtarit t'i jepet më shumë hapësirë për të përshtatur mësimin varësisht nga kushtet që ofron klasa, shkolla etj. Në trungun e përmbajtjes lënda ka **dy kategori** dhe katër **nënkategori**. Kategoria e parë (**Proceset jetësore**) përfshin një nënkategori: **1. Inxhinieria gjenetike dhe bioteknologjia**. Kategoria e dytë (**Qeniet e gjalla dhe mjedisi**) përmban tri nënkategori: **1. Bionika dhe bioarkitektura**, **2. Ekologjia humane** dhe **3. Evolucioni organik**. Duke i sublimuar informacionet e marra për programet e kohës në rajon e më gjerë, jemi përpjekur që në fushën e programeve të biologjisë sipas kurrikulit të ri të sigurojmë "rrjedhën" e koncepteve nga niveli i dytë në nivelin e tretë. Kjo prirje është shoqëruar me një përzgjedhje të kujdesshme të lëndës, p.sh. inxhinieria gjenetike dhe bioteknologjia, bionika, ekologjia humane etj.), me synim që përmbajtja programore e biologjisë të jetë koherente, logjike dhe e aplikuar. Veçori tjetër e programit të reformuar të biologjisë në përgjithësi, e në veçanti të kl. 12, është "përzjerja" e temave mësimore. Për dallim prej programeve tradicionale, ku p.sh. njohuritë nga botanika, zoologjia, fiziologjia, ekologjia etj. jepeshin të veçuara nga njëra-tjetra, me "përzjerjen" e temave ato jepen në mënyrë të integruar. Kjo qasje u mundëson nxënësve që të fitojnë njohuri të nevojshme për jetën e përditshme konform kërkesave të mileniumit të ri si dhe hap rrugën e përvetësimit më të lehtë të koncepteve të tjera që shpalosen në vazhdim të shkollimit-studime.

Në fund po theksojmë se ngjashmëritë që vihen re në emërtimin e kategorive dhe të nënkategorive në nivelin e parë, të dytë dhe të tretë të

shkollimit, me zberthimin e tyre tematik për çdo orë mësimore kanë ndryshime të dukshme në përmbajtje dhe qasje.

QËLLIMET

Programi mësimor i lëndës së biologjisë për klasën e dymbëdhjetë ka për qëllim:

- Zhvillimin e **aftësive** të nxënësit për **të njohur** dhe kuptuar ligjshmëritë themelore të proceseve jetësore, në kontekstin historik dhe në nivel molekular, të individës dhe popullatës.
- Zhvillimin e **njohurive** për qeniet e gjalla dhe mjedisin (ekologji, evolucion) dhe aftësive për të zbatuar njohuritë (bionika, bioarkitektura) si dhe për t'u ndeshur me problemet mjedisore në mënyrë konstruktive dhe rehabilituese (ekologjia humane).
- Zhvillimin e **shkathtësive** të përhershme për mbledhjen, përpunimin e të dhënave relevante shkencore dhe zbatimin e shkathtësive të fituara në situata konkrete për të mirën e njeriut dhe mjedisit (hidroponika, monitorimi biologjik etj.).

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nga përmbajtja programore e klasës së 12 nxënësi duhet të jetë në gjendje:

O Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat

- Në kontest të ndërjegjësimit dhe ngritjes së përgjegjësisë etike ndaj mjedisit human dhe natyror dhe pjesëmarrjes aktive në zgjidhjen e problemeve mjedisore;
- Në kuptim të kultivimit të sjelljeve personale (të jetë kooperative, i hapur, tolerant, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik etj. (10 njerëz të vullnetshëm punojnë më shumë se 1000 njerëz të detyruar, më mirë inteligjent e i guximshëm se geni e i ndrojtur).

O Të njohë

- Fjalorin (terminologjinë biologjike nga inxhinieria gjenetike, gjenetika e popullatave, ekologjia etj.);
- Faktet, konceptet dhe parimet biologjike;

- Procedurat dhe metodat në biologji.
- O **Të kuptojë**
- Faktet dhe parimet biologjike dhe të bëjë ndërlidhjen logjike të tyre (p.sh. biologjinë me teknikën, farmacinë etj.);
 - Relacionin shkak – efekt (p.sh. efekti green hous dhe ngrohja globale, pasojat);
 - Të arsyetojë metodat dhe procedurat.
- O **Të zbatojë në situata të reja**
- Faktet dhe parimet biologjike (hidroponika, sistemet miniaturale ekologjike në kushte jo të përshtashme, p.sh. nëndetëse, anije kozmike, vise polare etj.);
 - Procedurat dhe metodat në biologji;
 - Zgjidhjen e problemeve të natyrës biologjike.
- O **Të komunikojë informatat në kontekste të ndryshme**
- Shkrimi i raportit nga një punë praktike ose hulumtim;
 - Të prezantojë rezultatet e hulumtimit duke konsultuar shumë burime të informacionit;
 - Informacionin për problemet biologjike (inxhinieria gjenetike, ekologjia humane etj. e përshkruan dhe e interpreton në mënyrë gojore, me tabela, grafikone etj.;
 - Të kontribuojë me pjesëmarrje (OJQ mjedisore), debate dhe diskutime për çështje biologjike e mjedisore (“mendo globaleisht vepro lokalisht,” p.sh. Lidhur me efektin ” e serros”.
- O **Të zhvillojë të menduarit kritik për biologjinë;** pra, jo vetëm të kuptojë se **çka** ndodhur, por të shtrojë pyetje **si** dhe **pse** ka ndodhur;
- Të njohë informatën relevante nga ajo jorelevante;
 - Të dallojë faktin nga gjykimi;
 - Të zbatojë parimet biologjike në zgjidhjen e problemeve në mjekësi, veterinë, bujqësi, energjetike (p.sh. nafta artificiale, poliploidia etj.;
 - Të interpretojë materialin ilustrues.”një figurë vlen sa 1000 fjalë”.

PËRMBAJTJA PROGRAMORE

Kategoria	Nënkategoria	Nr. i orëve	%
I. Proceset jetësore	I.1. Inxhinieria gjenetike dhe bioteknologjia	15	20
II. Qeniet e gjalla dhe mjedisi	II.1. Bionika dhe bioarkitektura	6	8
	II.2. Bazat e ekologjisë dhe ekologjia humane	32	43
	II.3. Evolucioni organik	8	11
	Punë praktike	8	11
	Orë në dispozicion	5	7
	Gjithsej	74	100

KATEGORIA	NËNKATEGORIA	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	REZULTATET E PRITSHME	LIDHJA NDËRKURRIKULARE
I. PROCESET JETËSORE	I.1. Inxhinieria gjenetike dhe bioteknologjia	<ul style="list-style-type: none"> • Prodhimi i produkteve të ndryshme me rëndësi për njeriun bazohet në veprimin e qenieve të gjalla, pjesëve të tyre ose produkteve të tyre, bioteknologjia. • Manipulimi me material gjenetik (inxhinieria gjenetike) ka bërë të mundur që të fitohen sisteme të gjalla, veçoritë e të cilave kanë ndryshuar dhe u janë përshtatur nevojave të njeriut në shumë fusha të jetës së tij, p.sh.: industrinë ushqimore, energjetikë, bujqësi, farmaci, industrinë e pijeve, spastrimin e ujërave të ndotur etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • Definon termin bioteknologji dhe emërton disiplinat themelore të bioteknologjisë; • përshkruan metodat, fazat dhe operimet në inxhinierinë gjenetike; • bën dallimin ndërmjet proceseve spontane (natyrore) dhe bioteknologjike; • vlerëson rolin e biomasës si material themelor në proceset bioteknologjike (p.sh. kashtës, drurit) në prodhimin e polisaharideve, aminoacideve etj.; • përshkruan rolin e mikroorganizmave si “fabrika kimike” që posedojnë gati me të gjitha veprimet dhe metodat bioteknologjike; • analizon nivelin në të cilin intervenon inxhinieria gjenetike (gjene, grupe gjenesesh, kromozome, gjenom); • numëron fazat e operacionit në inxhinierinë gjenetike; duke përfshirë edhe fitimin e materialit trashëgues me veti të dëshirueshme); • përshkruan mënyrat e bartjes së materialit trashëgues prej një sistemi të gjallë në tjetrin, inkorporimin e këtij materiali në qelizën recipiente si dhe fitimin e materialit trashëgues artificial që nuk ekziston në natyrë; • shpjegon se klonimi është prodhim i 	

		<p>- kromatini seksual</p> <p>- vrojtimi me mikroskop i kromosomeve në majë të rrënjës së qepës</p>	<p>qelizave ose i organizmave gjenetikiisht identikë dhe vlerëson pasojat e manipulimit me material gjenetik në aspektin praktik dhe etik;</p> <ul style="list-style-type: none"> • vlerëson rëndësinë e aplikimit të bioteknologjisë në industrinë e bukës, të pijeve, industrinë farmaceutike, në përpunimin e ujërave të ndotur, nxjerrjen e naftës nga burimet e varfëra etj.; • përshkruan rëndësinë ekonomike të transplantimit të gjeneve nga bakteret që fiksojnë azotin atmosferik te kulturat bimor; • përgatisin preparate të freskëta të mukozës së gojës (meshkujt dhe femrat), ngjyrosin ato me karmin-acid-acetik dhe identifikojnë kromatinin seksual ose trupthin e Barit që gjendet paralel me mbështjellësin bërthamor; • krahason preparatet ku gjendet trupthi i Barit dhe përfundon se ai është dukuri përcjellëse e qelizave të seksit femëror. 	
II. Qeniet e gjalla dhe mjedisi	II.1. Bionika dhe bioarkitektura	<ul style="list-style-type: none"> • Duke zbatuar principin e ndërtimit të organizmave bimorë dhe shtazorë, indeve dhe organeve të tyre (bionika) janë konstruktuar instrumente optike, aparate elektronike, detektorë, fluturake, nëndetëse, etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • Definon termin bionikë dhe përshkruan lëndën e studimit të saj; • ndërlidh bionikën me ndërtimin e instrumenteve optike, aparateve fluturuese, nëndetëseve etj.; • krahason konstruktimin e aeroplanëve me aparatën fluturues të shpendëve dhe të insekteve; 	

		<ul style="list-style-type: none"> • Imitimi i ndërtimit të qenieve të gjalla, produkteve të tyre ka gjetur aplikim në ndërtimtari dhe arkitekturë- bioarkitektura. • Njeriu për ekzistencë në kushte ekstreme të mjedisit në mungesë të tokës pjellore aplikon sisteme miniaturale ekologjike ujore - hidroponike 	<ul style="list-style-type: none"> • ndërlidh konstruksionin dhe funksionin e nëndetëseve me delfinin dhe parimin e zhytjes dhe daljes së tij nga uji; • përshkruan parimin e ndërtimit dhe funksionit të detektorëve për qëllime ushtarake me organet ndijore të shtazëve dhe krahason radarin natyror (lakuriqin) me atë artificial; • shpejgon termin eholokator dhe analizon mundësinë e përdorimit të eholokatorëve të modifikuar e të sofistikuar për t'u ndihmuar njerëzve të verbër; • krahason ndërtimin e veshit të fokës me hidrofoni për kapjen e zërit nën ujë, ndërtimin e një organi të meduzës me një aparat teknik i cili mund të parashikojë stuhi 15 orë para shfaqjes së saj; • vlerëson rëndësinë e imitimit të ndërtimit të qenieve të gjalla dhe produkteve të tyre- bioarkitekturës (p.sh. hojeve të bletës, strukturës dhe radhitjes së indeve mekanike të bimëve) për ndërtimin e urave, kupolave, rrokaqiejve, tuneleve etj. të qëndrueshëm në levizje seizmike. • definojnë termin hidroponikë dhe përshkruan rëndësinë e saj për ekzistencën e njeriut në kushte ekstreme (nëndetëse, vise polare, ujdhesa shkëmbore, anije kosmike etj.). 	
--	--	---	--	--

<p>Qeniet e gjalla dhe mjedisi</p>	<p>Bazat e ekologjisë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ekosistemi përbëhet nga të gjitha llojet e qenieve të gjalla të cilat ndërveprojnë mes vete dhe me mjedisin jetësor abiotik në një hapësirë të caktuar gjeografike. • Lëndët ushqyese qarkullojnë nëpër ekosistem. Shembujt më të zakonshëm të qarkullimit të lëndëve të tilla janë karboni, oksigjeni, azoti, dhe uji. • Rrjedha e energjisë ndodh ndërmjet niveleve trofike në të gjitha ekosistemet dhe mund të përshkruhet si vijon: <ul style="list-style-type: none"> - zinxhiri ushqimor - rrjeti ushqimor - piramida e energjisë - piramida e biomasës - piramida e numrave. • Suksesioni ekologjik është një seri e ndryshimeve në një bashkësi jetësore (biocenoza) në të cilën popullatat e reja i zëvendësojnë ato 	<ul style="list-style-type: none"> • Definon termin ekologji, biosferë dhe ekosferë; • emërton dhe përshkruan faktorët ekologjikë abiotikë dhe biotikë • definon termin ekosistem, përshkruan elementet e ekosistemit dhe klasifikon ekosistemet; • arsyeton pse akuariumi konsiderohet sistem miniatural ekologjik; • arsyeton pse element bazë të ekosistemeve në natyrë nuk janë individët, por popullatat dhe ndërlidh strukturën dhe dinamikën e popullatave me faktorët biotikë dhe abiotikë; • definon termin valencë ekologjike; • shpjegon pse gjerësia e përhapjes ekologjike kushtëzohet nga kërkesa që ka lloji ndaj faktorëve ekologjikë të natyrës fizike, kimike dhe biologjike; • bën dallimin mes ekosistemeve, biocenoza, popullatave dhe organizmave; • përshkruan qarkullimin e ujit, karbonit, oksigjenit dhe azotit në natyrë; • shpjegon ligjshmëritë e rrjedhës së energjisë nëpër nivele të caktuara trofike; • përshkruan se si transferohet energjia prej një anëtari të biocenzës në tjetrin, përkatësisht prej një niveli trofik në tjetrin në shembullin e zinxhirit trofik, rrjetit trofik, piramidës së biomasës, piramidës së 	
---	---------------------------	--	---	--

<p>Qeniet e gjalla dhe mjedisi</p>	<p>Ekologji humane</p>	<p>ekzistuese. Ekzitojnë lloje të ndryshme të suksesioneve ekologjike si : autoktone, alohtone, antropogjene, parësore, dytësore, klimatike.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Stadiumi i klimaksit është shkalla më e lartë e zhvillimit të bashkësisë jetësore. Në stadiumin e klimaksit janë p.sh. pyjet gjethegjera të Kosovës. • Si pasojë e mosnjohjes dhe e moszbatimit të ligjeve të natyrës, njeriu me aktivitetin e tij suksesivisht ka shkatuar pasoja negative për planetin dhe të ardhmen e vetë njerëzimit (si p.sh. ngrohja globale, shirat acidike, ndotja e ajrit,ujit, tokës, zvogëlimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, rrezikimi dhe zhdukja e shumë llojeve të gjallesave etj.). 	<p>numrave, piramidës energjetike;</p> <ul style="list-style-type: none"> • definojnë termin suksesion ose njëpasnjëshmëri ekologjike; • përshkruan tipat e ndryshëm të suksesioneve dhe mënyrën e zhvillimit të tyre; • definojnë kuptimin e konceptit klimaks dhe përshkruan karakteristikat e bashkësive jetësore të cilat kanë arritur stadiumin e klimaksit; • krahason shkallën e ndryshueshmërisë ndërmjet ekosistemeve natyrore dhe artificiale; • përshkruan pasojat e dominimit të njeriut në biosferë dhe kualitetin e jetës së tij; • sjell shembuj për pasojat shëndetësore, gjenetike, trashëguese të mjedisit të ndotur; • analizon pasojat e ndikimit të jetës bashkëkohore dhe mjedisit të ndotur në shëndetin mental dhe numëron masat për ruajtjen e shëndetit; • përshkruan pasojat e ndryshimit të kushteve jetësore për zoocenoza dhe fitocenoza, p.sh. prerja e pyjeve, shirat acidike, gjuajtja e pakontrolluar e peshqve dhe e egërsirave etj.; • përshkruan parimet ekologjike për rregullimin e qyteteve (modeli progresiv dhe kulturor i qyteteve); • numëron shkaqet e shfaqjes së problemeve 	
---	------------------------	--	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> • Ekosistemet urbane,urbanizimi dhe megalopoliset po shoqërohen me shumë probleme: si:mbeturinat, zhurma, ”ndotje psikologjike “, mungesa e sipërfaqeve të gjelbëruara etj. • Për ruajtjen e mjedisit, njeriu ndërmer masa ligjore, monitoruese etj. 	<p>në vendbanimet njerëzore, p.sh. mbeturinat, zhurma, gjelbërimi,“sindromi i sëmundjeve në qytet”, “ndotjen psikologjike” etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> • shpjegon shkaqet e stresit të jetës në qytet; agresiviteti i vozitësit të automobilin, kalorësit në vendkalim, aksidentet e shumta etj, sëmundjet psikike etj.; • vlerëson rëndësinë e involvimit të dimensionit ekologjik gjatë planifikimit të gjelbërimit, mbrojtjes nga zhurma, largimit dhe përpunimit të hedhurinave nga vendbanimet urbane; • analizon ndikimin e urbanizimit në vlerën hapësinore të peizazhit; • përshkruan pasojat e ajrit të ndotur për vlerat materiale dhe sjell shembuj për ndikimin e vibrimeve në vlerat materiale; • vlerëson rëndësinë ekologjike të shfrytëzimit direkt dhe indirekt të energjisë solare. • arsyeton rëndësinë e involvimit të komponentës ekologjike gjatë planifikimit hapësinor dhe urbanistik; • numëron masat e përgjithshme ligjore, teknike, kërkimore, arsimore dhe monitoruese etj. për ruajtjen e mjedisit; • është i aftë për t’u ndeshur me problemet mjedisore në mënyrë konstruktive dhe rehabilituese; • përshkruan karakteristikat fiziografike dhe 	
--	--	---	---	--

		<p>Praktikum dhe ushtrime</p> <p>- njohja e ekosistemeve të ujërave tokësore</p> <p>- automobili dhe ndotja termale e mjedisit</p> <p>- te reshurat acidike</p>	<p>biocenologjike të ujërave tokësore;</p> <ul style="list-style-type: none"> • mbledh shtazë dhe bimë ujore dhe me ndihmë tyre si indikatorë biologjikë përcakton gjendjen ekologjike të ekosistemeve të ndryshme ujore; • përshkruan si merret planktoni nga moçali ose kënetat me ndihmën e rrjetit planktonik, mbledh plankton dhe bën markimin e tij; • analizon materialin e mbledhur me mikroskop , vizaton algjet që i vrojton dhe përcakton cilat algje janë ato; • mat temperaturën e ajrit në afërsi të drejtpërdrejtë të semaforit gjatë verës dhe 200-300 metra larg tij (me rrrathë koncentrik); • arsyeton pse temperatura afër semaforëve është më e lartë; • me ndihmën e letrës së lakmusit cakton vlerën PH të mostrave të të reshurave atmosferike (shiu, borës) dhe dheut (të marra) afër repartit industrial dhe në vendbanim rural; • shpjegon pasojat e ndryshimit të vlerës pH të tokës (shirave acidike) për bimët 	
II. Qeniet e gjalla dhe mjedisi	II.4. Evolucioni organik	<ul style="list-style-type: none"> • Si rrjedhim i reaksioneve të ndërlikuara që ndodhën gjatë evolucionit të Tokës, në oqeanin e parë dhe veprimet të rrezatimeve të shumta, shkallë-shkallë nga 	<ul style="list-style-type: none"> • Definojnë termin evolucion; • përshkruan pikëpamjet e shkencëtarëve të lashtë grekë për prejardhjen e jetës në TOKË; • shpjegon vlerat praktike të eksperimenteve të Luj Pasterit që hodhën poshtë teorinë 	

		<p>molekulat e thjeshta u formuan molekulat komplekse (proteinat, acidet nukleike përkatësisht koacervatet). Formimi i acideve nukleike dhe vetëdyfishimi kanë qenë dukuri të pandara në rrugën e formimit të gjallesave të para heterotrofe, e më vonë edhe autotrofe.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bota organike e sotme, bimë dhe shtazë, për rjedhim edhe njeriu, janë produkt i procesit të zhvillimit evolutiv që ka zgjatur milionë vjet. • Njeriu është produkt i zhvillimit të natyrës me prejardhje shtazore. Për këtë flasin provat paleontologjike dhe etapat kryesore të antropogenezës. Rol themelor në formimin e tij ka luajtur puna, e cila nuk është faktor biologjik por shoqëror. 	<p>“genera spontanum” (lindjes së vetëvetishme të gjallesave);</p> <ul style="list-style-type: none"> • sjell shembuj për të vertetuar se mikroorganizmat nuk mund të lindin në mënyrë të vetëvetishme; • përshkruan atmosferën primitive të Tokës dhe përbërjet organike para lindjes së jetës; • përshkruan eksperimentin e Mullerit i cili imiton në laborator kushtet e atmosferës primitive; • analizon ecurinë e proceseve që ndihmuan evolucionin e materieve organike të bazeneve ujore drejt lindjes së formave të jetës.; numëron tiparet e ndërtimit dhe funksionet jetësore të koacervateve; • kuptojnë se format e para jetësore kanë qenë heterotrofe; • përshkruan shfaqjen dhe mbizotërimin e grupeve kryesore të gjallesave gjatë historisë së jetës në Tokë në periudhat e ndryshme gjeologjike; • vlerëson rolin e provave anatomiko-krahasuese, embriologjike ,biogjeografike, biokimike, fiziologjike, dhe fosileve për evolucionin; • vlerëson rëndësinë shkencore të teorisë së Darvinit për evolucionin; • përcakton pozitën sistematike të njeriut në botën shtazore; 	
--	--	---	---	--

		<p>Praktikum dhe demonstrime:</p> <p>- Variabiliteti si faktor i evolucionit në shembullin e gëzhjave të kërmillit të vreshtit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • përshkruan pemën gjenealogjike të primateve dhe numëron tiparet e mirëfillta të njeriut që nuk i gjen te majmunët; • përshkruan fazat e zhvillimit evolutiv të llojit njeri, shpjegon si kanë lindur racat njerëzore dhe interpreton pikëpamjet pseudoshkencore për racat; • nxënësit sjellin në klasë shumë gëzhjoja të kërminjve të vreshtit, radhisin ato në një kuti dhe vrojtojnë dallimet në ngjyrë (prej ngjyrës së ndritshme deri te ngjyra e e errët si dhe tipat kalues me vija të zeza të ngushta deri tek ato të gjera) si dhe dallimet në formë; • arsyetojnë shkaqet e ndryshimeve të tilla. 	
--	--	--	--	--

BIOLOGJI

Gjimnazi - matematikë dhe informatikë
(2 orë në javë, 66 orë në vit)

HYRJE

Ky program parashikon që lënda e biologjisë për kl. 12 në gjimnazin e përgjishmëm të zhvillohet për 74 orë. Për fleksibilitet, në programin e biologjisë të kësaj klase janë parashikuar më shumë se më parë orë praktike dhe orë në dispozicion (gjithsej 17 orë). Me këtë synohet që arsimtarit t'i jepet më shumë hapësirë për të përshtatur mësimin varësisht nga kushtet që ofron klasa, shkolla etj. Në trungun e përmbajtjes lënda ka **dy kategori** dhe katër **nënkategori** Kategoria e parë (**Proceset jetësore**) përfshinë një nënkategori: **1. Inxhinieria gjenetike dhe bioteknologjia**. Kategoria e dytë (**Qeniet e gjalla dhe mjedisi**) përmban tri nënkategori: **1. Bionika dhe bioarkitektura**, **2. Ekologjia humane** dhe **3. Evolucionin organik**. Duke i sublimuar informacionet e marra për programet e kohës në rajon e më gjerë, jemi përpjekur që në fushën e programeve të biologjisë sipas kurrikulit të ri të sigurojmë “rrjedhën” e koncepteve nga niveli i dytë në nivelin e tretë. Kjo prirje është shoqëruar me një përzgjedhje të kujdesshme të lëndës p.sh. inxhinieria gjenetike dhe bioteknologjia, bionika, ekologjia humane etj), me synim që përmbajtja programore e biologjisë të jetë koherente, logjike dhe e aplikuar. Veçori tjetër e programit të reformuar të biologjisë në përgjithësi, e në veçanti të kl. 12, është “përzjerja” e temave mësimore. Për dallim prej programeve tradicionale, ku p.sh. njohuritë nga botanika, zoologjia, fiziologjia , ekologjia etj. jepeshin të veçuara nga njëra tjetra, me” përzjerjen “ e temave ato jepen në mënyrë të integruar. Kjo qasje u mundëson nxënësve të fitojnë njohuri të nevojshme për jetën e përditshme konform kërkesave të mileniumit të ri si dhe hap rrugën e përvetësimit më të lehtë të koncepteve të tjera që shpalosen në vazhdim të shkollimit-studime.

Në fund po theksojmë se ngjashmëritë që vihen re në emërtimin e kategorive dhe të nënkategorive në nivelin e parë, të dytë dhe tretë të shkollimit, me zbërthimin e tyre tematik për çdo orë mësimore kanë ndryshime të dukshme në përmbajtje dhe qasje.

QËLLIMET

Programi mësimor i lëndës së biologjisë për klasën e dymbëdhjetë ka për qëllim:

- Zhvillimin e **aftësive** të nxënësit për **të njohur** dhe kuptuar ligjshmëritë themelore të proceseve jetësore, në kontekstin historik dhe në nivel molekular, të individës dhe populatës.
- Zhvillimin e **njohurive** për qeniet e gjalla dhe mjedisin (ekologji, evolucion) dhe aftësive për të zbatuar njohuritë (bionika, bioarkitektura) si dhe për t'u ndeshur me problemet mjedisore në mënyrë konstruktive dhe rehabilituese (ekologjia humane)
- Zhvillimin e **shkathtësive** të përhershme për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave relevante shkencore si dhe zbatimin e shkathtësive të fituara në situata konkrete për të mirën e njeriut dhe mjedisit (hidroponika, monitorimi biologjik etj.)

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Nga përmbajtja programore e klasës së 12 nxënësi duhet të jetë në gjendje:

O Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat

- Në kontest të ndërgjegjësimit dhe të ngritjes së përgjegjësisë etike ndaj mjedisit human dhe natyror dhe pjesëmarrjes aktive në zgjidhjen e problemeve mjedisore
- Në kuptim të kultivimit të sjelljeve personale (të jetë kooperativ, i hapur, tolerant, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik etj (10 njerëz të vullnetshëm punojnë më shumë se 1000 njerëz të de-tyruar, më mirë inteligjent e i guximshëm sesa gjeni e i ndrojtur).

O Të njohë

- Fjalorin (terminologjinë biologjike nga inxhinieria gjenetike, gjenetika e popullatave, ekologjia etj.)

- Faktet, konceptet dhe parimet biologjike
 - Procedurat dhe metodat në biologji
- **Të kuptojë**
- Faktet dhe parimet biologjike dhe të bëjë ndërlidhjen logjike të tyre (p.sh. biologjinë me teknikën, farmacinë etj.)
 - Relacionin shkak – efekt (p.sh. efekti i serros dhe ngrohja globale, pasojat)
 - Të arsyetojë metodat dhe procedurat
- **Të zbatojë në situata të reja**
- Faktet dhe parimet biologjike (hidroponika, sistemet miniaturale ekologjike në kushte jo të përshtashme, p.sh. nëndetëse, anije kozmike, vise polare etj.)
 - Procedurat dhe metodat në biologji
 - Zgjidhjen e problemeve të natyrës biologjike
- **Të komunikojë informatat në kontekste të ndryshme**
- Shkrimi i raportit nga një punë praktike ose hulumtim
 - Prezantojë rezultatet e hulumtimit, duke konsultuar shumë burime të informacionit
 - Informacionin për problemet biologjike (inxhinieria gjenetike, ekologjia humane etj. e përshkruan dhe e interpreton në mënyrë gojore, me tabela, grafikone etj.)
 - Kontribuojë me pjesëmarrje (OJQ mjedisore), debate dhe diskutime për qështje biologjike e mjedisore (“mendo globalisht vepro lokalisht,” p.sh. lidhur me efektin ” e serros”
- **Të zhvillojë të menduarit kritik për biologjinë;** pra jo vetëm të kuptojë se ç’ka ndodhur, por të shtrojë pyetje **si** dhe **pse ka** ndodhur?
- Të njohë informatën relevante nga ajo jorelevante
 - Të dallojë faktin nga gjykimi
 - Të zbatojë parimet biologjike në zgjidhjen e problemeve në mjekësi, veterinë, bujqësi, energjetikë (p.sh. nafta artificiale, poliploidia etj.).
 - Të interpretoj materialin ilustrues.”një figurë vlen sa 1000 fjalë”.

PËRMBAJTJA PROGRAMORE

Kategoria	Nënkategoria	Nr. orëve	%
I. Proceset jetësore	I.1. Inxhinieria gjenetike dhe bioteknologjia	13	19.7
II. Qeniet e gjalla dhe mjedisi	II.1. Bionika dhe bioarkitektura	4	6.1
	II.2. Bazat e ekologjisë dhe ekologjia humane	29	43.9
	II.3. Evolucioni organik	7	10.6
	Punë praktike	8	12.1
	Orë në dispozicion	5	7.6
	Gjithsej	66	100

KATEGORIA	NËNKATEGORIA	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	REZULTATET E PRITSHME	LIDHJA NDËRKURRIKULARE
I. PROCESET JETËSORE	I.1. Inxhinieria gjenetike dhe bioteknologjia	<ul style="list-style-type: none"> • Prodhimi i produkteve të ndryshme me rëndësi për njeriun bazohet në veprimin e qenieve të gjalla, pjesëve të tyre ose produkteve të tyre-bioteknologjia. • Manipulimi me material gjenetik (inxhinieria gjenetike) ka bërë të mundur që të fitohen sisteme të gjalla, veçoritë e të cilave kanë ndryshuar dhe u janë përshtatur nevojave të njeriut në shumë fusha të jetës së tij, si p.sh.: industrinë ushqimore, energjetikë, bujqësi, farmaci, industrinë e pijeve, spastrimin e ujërave të ndotura etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • Definon termin bioteknologji dhe emërton disiplinat themelore të bioteknologjisë • përshkruan metodat, fazat dhe operimet në inxhinierinë gjenetike; • bënë dallimin ndërmjet proceseve spontane (natyrore) dhe bioteknologjike). • vlerëson rolin e biomasës si material themelor në proceset bioteknologjike (p.sh. kashës, drurit) në prodhimin e polisaharideve, aminoacideve etj.; • përshkruan rolin e mikroorganizmave si “fabrika kimike” që posedojnë gati me të gjitha veprimet dhe metodat bioteknologjike; • analizon nivelin në të cilin intervenon inxhinieria gjenetike (gjene, grupe gjeneshe, kromozome, gjenom); • përshkruan mënyrat e bartjes së materialit trashëgues prej një sistemi të gjallë në tjetrin, inkorporimin e këtij materiali në qelizën recipiente si dhe fitimin e materialit trashëgues artificial që nuk ekziston në natyrë; • shpjegon se klonimi është prodhim i 	

		<p>- kromatini seksual</p> <p>- vrojtimi me mikroskop i kromozomeve në majë të rrënjës së qepes</p>	<p>qelizave ose i organizmave gjenetikisht identikë dhe vlerëson pasojat e manipulimit me material gjenetik në aspektin praktik dhe etik;</p> <ul style="list-style-type: none"> • vlerëson rëndësinë e aplikimit të bioteknologjisë në industrinë e bukës, të pijeve, industrinë farmaceutike, në përpunimin e ujërave të ndotura, nxjerrjen e naftës nga burimet e varfëra etj.; • përgatit preparate të freskëta të mukozës së gojës (meshkujt dhe femrat), dhe identifikojnë kromatinin seksual ose trupthin e Bari që gjendet paralel me mbeshjtjellësin bërthamor. • krahason preparatet ku gjendet trupthi i Barit dhe përfundon se ai është dukuri përcjellëse e qelizave të seksit femëror 	
<p>II. Qeniet e gjalla dhe mjedisi</p>	<p>II.1. Bionika dhe bioarkitektura</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Duke zbatuar principin e ndërtimit të organizmave bimore dhe shtazorë, indeve dhe organeve të tyre (bionika), janë konstruktuar instrumente optike, aparate elektronike, detektorë, fluturake, nëndetëse etj.; • Imitimi i ndërtimit të qenieve të gjalla, produkteve të tyre ka gjetur aplikim në ndërtimtari dhe arkitekturë-bioarkitektura. 	<ul style="list-style-type: none"> • definon termin bionikë dhe përshkruan lëndën e studimit të saj; • ndërlidhë bionikën me ndërtimin e instrumenteve optike, aparateve fluturuese, nëndetëseve etj.; • krahason konstruktimin e aeroplanëve me aparatën fluturuese të shpendëve dhe insekteve; • ndërlidh konstruksionin dhe funksionin e nëndetëseve me delfinin 	<p>Teknikën, arkitekturën, elektronikën etj.</p>

		<ul style="list-style-type: none"> • Njeriu për ekzistencë në kushte ekstreme të mjedisit në mungesë të tokës pjellore aplikon sisteme miniaturale ekologjike ujore-hidroponika 	<p>dhe parimin e zhytjes dhe daljes së tij nga uji;</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan parimin e ndërtimit dhe funksionit të detektorëve për qëllime ushtarake me organet ndijore të shtazëve dhe krahason radarin natyror (lakuriqin) me atë artificial; • shpjegon termin eholokator dhe analizon mundësinë e përdorimit të eholokatorëve të modifikuar e sofistikuar për t'u ndihmuar njerëzve të verbër; • vlerëson rëndësinë e imitimit të ndërtimit të qenieve të gjalla dhe produkteve të tyre-bioarkitekturës (p.sh. hojeve të bletës, strukturës dhe radhitjes së indeve mekanike të bimët) për ndërtimin e urave, kupolave, rrokaqiejve, tuneleve etj. të qëndrueshëm në lëvizje seizmike. 	
Qeniet e gjalla dhe mjedisi	Bazat e ekologjisë	<ul style="list-style-type: none"> • Ekosistemi përbëhet nga të gjitha llojet e qenieve të gjalla të cilat ndërveprojnë mes vete dhe me mjedisin jetësor abiotik në një hapësirë të caktuar gjeografike. • Lëndët ushqyese qarkullojnë nëpër ekosistem . Shembujt më të zakonshëm të qarkullimit të lëndëve të tilla janë karboni, oksigjeni, azoti, dhe uji. • Rrjedha e energjisë ndodh ndërmjet 	<ul style="list-style-type: none"> • definojnë termin ekologji, biosferë dhe ekosferë; • emërton dhe përshkruan faktorët ekologjikë abiotikë dhe biotikë; • definojnë termin ekosistem, përshkruan elementet e ekosistemit dhe klasifikon ekosistemet; • definojnë termin valencë ekologjike; • shpjegon pse gjerësia e përhapjes 	

<p>Qeniet e gjalla dhe mjedisi</p>	<p>Ekologjia humane</p>	<p>niveleve trofike në të gjitha ekosistemet dhe mund të përshkruhet si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zinxhiri ushqimor - rrjeti ushqimor - piramida e energjisë - piramida e biomasës - piramida e numrave. <ul style="list-style-type: none"> • Suksesioni ekologjik është një seri e ndryshimeve në një bashkësi jetësore (biocenoze) në të cilën popullatat e reja i zëvendësojnë ato ekzistuese. Ekzitojnë lloje të ndryshme të suksesioneve ekologjike si: autoktone, alohtone, antropogjene, parësore, dytësore, klimatike. • Si pasojë e mosnjohjes dhe e moszbatimit të ligjeve të natyrës, njeriu me aktivitetin e tij suksesivisht ka shkaktuar pasoja negative për planetin dhe të ardhmen e vetë njerëzimit (si p.sh. ngrohja globale, shirat acidike, ndotja e ajrit, ujit, tokës, zvogëlimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, rrezikimi dhe zhdukja e shumë llojeve të gjallesave etj.). • Ekosistemet urbane,urbanizimi dhe megalopoliset po shoqërohen me shumë probleme: si: mbeturinat, zhurma, ”ndotje psikologjike”, mungesa e sipërfaqeve të gjelbëruara etj. 	<p>ekologjike kushtëzohet nga kërkesa që ka lloji ndaj faktorëve ekologjikë të natyrës fizike, kimike dhe biologjike;</p> <ul style="list-style-type: none"> • bën dallimin mes ekosistemeve, biocenozeve, popullatave dhe organizmave; • përshkruan qarkullimin e ujit, karbonit, oksigjenit dhe azotit në natyrë; • shpjegon ligjshmëritë e rrjedhës së energjisë nëpër nivele të caktuara trofike; • definon termin suksesion ose njëpasnjëshmëri ekologjike. • përshkruan tipat e ndryshëm të suksesioneve dhe mënyrën e zhvillimit të tyre; • krahason shkallën e ndryshueshmërisë ndërmjet ekosistemeve natyrore dhe artificiale; • përshkruan pasojat e dominimit të njeriut në biosferë dhe kualitetin e jetës së tij; • sjell shembuj për pasojat shëndetësore, gjenetike, trashëguese të mjedisit të ndotur; • analizon pasojat e ndikimit të jetës bashkëkohore dhe të mjedisit të ndotur në shëndetin mental dhe 	
---	--------------------------------	---	---	--

		<ul style="list-style-type: none"> • Për ruajtjen e mjedisit, njeriu ndërmer masa ligjore, monitoruese etj. <p>Praktikum dhe ushtrime</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohja e ekosistemeve të ujërave tokësore - automobili dhe ndotja termale e mjedisit - te reshurat acidike 	<p>numëron masat për ruajtjen e shëndetit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan pasojat e ndryshimit të kushteve jetësore për zoocenoza dhe fitocenoza, si p.sh. prerja e pyjeve, shirat acidike, gjuajtja e pakontrolluar e peshqeve dhe e egërsirave etj.; • numëron shkaqet e shfaqjes së problemeve në vendbanimet njerëzore, si p.sh. mbeturinat, zhurma, gjelbërimi, “sindromi i sëmundjeve në qytet”, “ndotjen psikologjike” etj.; • vlerëson rëndësinë e involvimit të dimensionit ekologjik gjatë planifikimit të gjelbërimit, mbrojtjes nga zhurma, largimit dhe përpunimit të hedhurinave nga vendbanimet urbane; • përshkruan pasojat e ajrit të ndotur për vlerat materiale dhe sjell shembuj për ndikimin e vibrimeve në vlerat materiale; • vlerëson rëndësinë ekologjike të shfrytëzimit direkt dhe indirekt të energjisë solare; • arsyeton rëndësinë e involvimit të komponentes ekologjike gjatë planifikimit hapësinor dhe urbanistik; 	
--	--	---	---	--

			<ul style="list-style-type: none"> • është i aftë për t'u ndeshur me problemet mjedisore në mënyrë konstruktive dhe rehabilituese; • përshkruan karakteristikat fiziografike dhe biocenologjike të ujërave tokësore; • mbledh shtazë dhe bimë ujore dhe me ndihmën e tyre si indikatorë biologjikë përcakton gjendjen ekologjike të ekosistemeve të ndryshme ujore; • përshkruan si merret planktoni nga moçali ose kënetat me ndihmën e rrjetës planktonike, mbledh plankton dhe bën markimin e tij; • analizon materialin e mbledhur me mikroskop, vizaton algjet që i vrojton dhe përcakton cilat algje janë ato; • mat temperaturën e ajrit në afërsi të drejtpërdrejtë të semaforit gjatë verës dhe 200-300 metra larg tij (me rrathë koncentrikë); • arsyeton pse temperatura afër semaforëve është më e lartë; • me ndihmën e letres së lakmusit cakton vlerën PH të mostrave të reshurave atmosferike (shiu, borës) dhe dheut (të marrë) afër repartit industrial dhe në vendbanim rural. 	
--	--	--	---	--

<p>II. Qeniet e gjalla dhe mjedisi</p>	<p>II.4. Evolucioni organik</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Si rrjedhim i reaksioneve të ndërlikuara që ndodhën gjatë evolucionit të Tokës, në oqeanin e parë dhe veprimet të rrezatimeve të shumta, shkallë-shkallë nga molekulat e thjeshta u formuan molekulat komplekse (proteinat, acidet nukleike-përkatësisht koacervatet). Formimi i acideve nukleike dhe vetëdyfishimi kanë qenë dukuri të pandara në rrugën e formimit të gjallesave të para heterotrofe, e më vonë edhe autotrofe. • Bota organike e sotme, bimë dhe shtazë, për rrjedhim edhe njeriu, janë produkt i procesit të zhvillimit evolutiv që ka zgjatur milionë vjet. • Njeriu është produkt i zhvillimit të natyrës me prejardhje shtazore. Për këtë flasin provat paleontologjike dhe etapat kryesore të antropogjenezës. Rol themelor në formimin e tij ka luajtur puna, e cila nuk është faktor biologjik por shoqëror. <p>Praktikum:</p> <p>- Variabiliteti si faktor i evolucionit në</p>	<ul style="list-style-type: none"> • definon termin evolucion; • përshkruan pikpamjet e shkencëtarëve të lashtë grekë për prejardhjen e jetës në TOKË; • shpjegon vlerat praktike të eksperimenteve të Luj Pasterit që hodhën poshtë teorinë “genera spontanum” (lindjes së vetëvetishme të gjallesave); • përshkruan atmosferën primitive të Tokës dhe përbërjet organike para shfaqjes së jetës; • përshkruan eksperimentin e Mullerit i cili imiton në laborator kushtet e atmosferës primitive; • analizon ecurinë e proceseve që ndihmuan evolucionin e materieve organike të bazeneve ujore drejt lindjes së formave të jetës; • numëron tiparet e ndërtimit dhe funksionet jetësore të koacervateve; • kuptojnë se format e para jetësore kanë qenë heterotrofe; • përshkruan shfaqjen dhe mbizotërimin e grupeve kryesore të gjallesave gjatë historisë së jetës në Tokë në periudhat e ndryshme gjeologjike; • vlerëson rolin e provave anatomiko-krahasuese, embriologjike, 	
---	--	---	---	--

		shembullin e gëzhjave të kërmillit të vreshtit.	biogeografike, biokimike, fiziologjike, dhe fosileve, për evolucionin; <ul style="list-style-type: none"> • vlerëson rëndësinë shkencore të teorisë së Darvinit për evolucionin; • përcakton pozitën sistematike të njeriut në botën shtazore; • përshkruan pemën gjenealogjike të primatëve dhe numëron tiparet e mirëfillta të njeriut që nuk i gjen te majmunët; • përshkruan fazat e zhvillimit evolutiv të llojit njeri, shpjegon si kanë lindur racat njerëzore dhe interpreton pikëpamjet pseudoshkencore për racat; • nxënësit sjellin në klasë shumë gëzhjoja të kërmijve të vreshtit, radhisin ato në një kuti dhe vrojtojnë dallimet në ngjyrë (prej ngjyrës së ndritshme, deri te ngjyra e errët si dhe tipat kalues me vija të zeza të ngushta deri tek ato të gjera) si dhe dallimet në formë; • arsyetojnë shkaqet e ndryshimeve të tilla. 	
--	--	---	---	--

METODOLOGJIA

Mësimi në biologji si dhe në çdo lëmë tjetër mund të kryhet në disa mënyra, d.m.th mund të shfrytëzohen disa metoda mësimore. Praktika ka treguar se është i suksesshëm vetëm ai mësim i cili realizohet me metoda të ndryshme, ku secila sosh ka rol dhe rëndësi të veçantë metodike.

Çdo lëndë, përpos metodave të përgjithshme mësimore, i ka edhe metodat e veçanta. Prej metodave të shumta që mund të përdoren në mësimet e biologjisë po përmendim:

- Metodën e të shprehurit me gojë (monologu);
- Metodën e bashkëbisedimit (dialogu);
- Metodën e leximit dhe të punës me tekst;
- Metodën e punës praktike në laboratorin biologjik apo në terren (ekskursionet);
- Metodën e të mësuarit dhe të nxënimit ndërveprues (p.sh. programe simuluese kompjuterike).

Çdo metodë mësimore i ka anët pozitive dhe negative. Kjo do të thotë se me zbatimin e një metode të vetme mësimore nuk mund të realizohen të gjitha qëllimet dhe detyrat e mësimimit të lëndës së biologjisë. Prandaj, ato patjetër duhet të kombinohen në varësi nga përmbajtja, qëllimet dhe objektivat të cilët synohen të realizohen.

Është kompetencë e arsimtarit, duke zbatuar strukturën ERR të orës, të zgjedhë materiale të llojllojshme didaktike, metoda dhe strategji më të përshtatshme të mësimdhënies dhe nxënies, me synim të realizimit të qëllimeve dhe objektivave specifike, me nxënësin në qendër (p.sh. **klaster, kubimi, insert, tabela e koncepteve, diagrami i Venit, brainstorming, xhigsou I dhe II etj.**).

Për detalet e këtyre formave të punës me nxënës dhe teknikave të mësimdhënies shih tekstet:

B. Musai; Modele të mësimdhënies së suksesshme; Tiranë; e-mail: rëct ara@aedp-soros.al.

M. Mula; Modele të mësimdhënies sipas strukturës ERR të orës, Prishtinë 2003. Email: office @ kec-ks.org ,<http://www.kec-ks.org>

Plani dhe programi mësimor për kl. 9 dhe 10, Prishtinë, 2002 dhe 2003, f. 11 –14 dhe f. 167-169.

Në praktikë thuajse nuk ekziston orë e biologjisë në të cilën aplikohet vetëm një metodë mësimore. Me zbatimin e disa metodave mësimore në të njëjtën orë të mësimimit, ora bëhet më dinamike, thyhet monotonia dhe ngritet interesimi i nxënësve për mësim.

Çdo ndryshim në punë, pra edhe zbatimi i metodave të ndryshme mësimore e freskon mësimin, e bën shumë më interesant, me çka arrihet që rezultatet në nxënie të jenë më të mira.

Për realizimin sa më të mirë të qëllimeve të parashtruara në orën mësimore duhet të punojmë në frymën e parimeve didaktike: prej të njohurës kah e panjohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmja, prej makronivelit kah mikroniveli (p.sh. organi, indi, qeliza, infrastrukturat qelizore).

Me fjalë të tjera, arsimtari i udhëheq nxënësit ashtu që ata me aktivitetet e tyre në klasë, shkollë, laborator, natyrë etj., jo vetëm të memorizojnë, por të mund të: njohin, vrojtojnë, radhisin, masin, shënojnë, mbledhin të dhënat, eksperimentojnë, mbikëqyrin. Pra, të kuptojë përmbajtjet programore duke vrotuar e punuar. Ajo që e dëgjon harrohet, ajo që e sheh mbahet në mend, ajo që e sheh dhe e punon kuptohet. Për të realizuar këtë synim, arsimtarit i ndihmojnë vivariumet, akvariumet, terrariumet, puna në terren-ekskursionet shkencore dhe puna në laborator. Për klasifikim të bimëve dhe të shtazëve të mjedisit ku jeton nxënësi, arsimtari e udhëzon atë se si duhet të përdoren çelësat për determinim.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE TEKSTET DHE BURIMET E TJERA MËSIMORE

Për implementimin e suksesshëm të mëimit në biologji për klasën XII, burime të informacionit propozojmë:

Tekstet:

- Biologjia, kl.XI, gjimnazi i përgjithshëm dhe TIK, grup autorësh, 2004.
- Biologjia kl. X, gjimnazi natyror, grup autorësh, Libri Shkollor, 2003.
- Biologjia për klasën e parë të shkollës së mesme të mjekësisë, Q. Pajazitaj, et. al., Libri Shkollor, 2000.
- Biologjia për klasën IV gjimnaz, Libri Shkollor, grup autorësh, 2000.
- Biologjia 9,10,11, E. Ruka, Tiranë.

Krahas tekstit shkollor, burim tradicional i informacionit për zbatimin e suksesshëm të përmbajtjeve mësimore sugjerojmë përdorimin e

doracakëve (atlas botanik, zoologjik, anatomik, fjalori terminologjik, burime nga interneti etj.), p.sh.:

- Atlas i përgjithshëm i zoologjisë, I. Zeneli, Prishtinë.
- Atlas i anatomisë, D. Rexhepi dhe H. Qerimi, 2002, Prishtinë.
- Atlas i biologjisë, A.Gashi, K. Abdullahu, 2002, Prishtinë.

Fjalorë me shpjegime terminologjike dhe përkufizime të zgjeruara, p.sh.:

- Fjalor i biologjisë, E. Ruka, Zyri Bajrami, Botime Toena, Tiranë, 1999.
- Fjalor i emrave të bimëve, F. Krasniqi et.al. 2004. Tiranë-Prishtinë.
- Celësi i ilustruar me fotografi për determinimin e bimëve, kërpu-dhave dhe shtazëve.

Koleksione të literaturës së rëndësishme lidhur me temat e veçanta:

- Gazeta, revista profesionale dhe shkencore, pastaj fotografi, posterë, skema, diagrame, harta, tabela, preparate, CD, videokaseta, burime nga interneti etj.

Videokaseta me tema nga biologjia të titulluara në gjuhën shqipe mund t'i siguroni në qendrat didaktike në: Ferizaj, Prizren, Pejë, Gjakovë dhe Gjilan.

Burime nga interneti:

<http://vector.cshl.org/dnaftb/DNA> , *acidet nukleike*

http://www.biology.arizona.edu/cell_bio.html cell cycle tutorial, *reproduktimi*

<http://www.stg.broen.edu/eebs/Mendelëeb/links> to mendels,

trashëgimi

<http://www.massinteraction.org/html/genome/sickle> cell information-

trashëgimi

http://www.naturalia.org/ZOO/in_dexing.html. This is a virtual zoo site, *biodiversiteti*

<http://arbl.cvmb.colostate.edu/hbooks/pathphys/endocrine/basics/control.html>, endokrinologji, feedback,

<http://www.psych.umn.edu/psylabs/mtfs/special.htm>.

Zhvillimi i bimëve, shtazëve, zigota, embrioni, fetusit, fara.

Është kompetencë e arsimit që në vartësi prej kushteve në të cilat punon shkolla të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave gojore, vizuale, auditive dhe audiovizuale, me theks të veçantë në atë që është qenësore për t'u mësuar.

PUNËT PRAKTIKE NË LABORATOR DHE NË TERREN

Për klasën XII (gjimnazi i përgjithshëm dhe gjimnazi matematikë me TIK), krahas punës në laborator, është paraparë edhe mësimi në terren (ekskursionit mësimor). Punët praktike dhe në terren janë pjesë e obligueshme e programit. Përmes punëve praktike në laborator dhe terren nxënësi integron njohuritë teorike me praktikën.

Ekskursionit mësimor

Është një nga metodat më të efektshme për përvetësimin aktiv të njohurive teorike. Organizimi i mirë i ekskursionit zhvillon te nxënësi aftësinë e përvetësimit, vëzhgimit, analizës, sintezës, kujtesës logjike, intuitës, të menduarit të pavarur dhe krijues, që ndikojnë drejtpërdrejt në përvetësimin e vetëdijshëm dhe të qëndrueshëm të njohurive shkencore biologjike.

Që të mos merret nga nxënësit ekskursionit si *një shëtitje thjesht në natyrë*, ai duhet të përgatitet mirë nga arsimtari. Kjo nënkupton se edhe arsimtari paraprakisht duhet të përgatitet për ekskursion, duhet të ketë përgatitje komplete profesionale biologjike dhe orientime të qarta didaktike. Puna përgatitore e arsimit për ekskursion.

Masat organizative dhe metodike

- arsimtari duhet të njihet paraprakisht me terrenin e ekskursionit dhe në përputhje me qëllimet e temës së ekskursionit cakton lokacionin (p.sh. lumë, livadh, pyll, agrokulturë, park nacional etj.);
- të njohë mirë terrenin ku zhvillohet ekskursionit; botën bimë dhe shtazore të tij, konfiguracionin e terrenit etj. Për shkaqe didaktike është mirë që rruga e kthimit të mos jetë e njëjtë me atë të shkuarjes;

- nëpërmjet ekskursionit arsimtari i udhëzon nxënësit se si të zotërojnë dhe të përvetësojnë vetë një vëllim njohurish sipas temës së ekskursionit;
- përmes ekskursioneve në terren arsimtari këmbëngul që nxënësit të dallojnë thelbësoren nga jothelbësorja në dukuritë e botës bimore dhe shtazore, të zbulojnë marrëdhëniet e brendshme dhe lidhjet e varësisë së ndërsjelltë midis gjallesave ku jetojnë, të mbajnë qëndrim vëzhgues, deduktues ndaj natyrës, me një fjalë, të orinetohen drejt në temën e ekskursionit;
- pas kthimit nga ekskursioni mësimor, arsimtari jep këshilla si duhet të veprohet me materialin e mbledhur bimor apo shtazor.

Punët praktike

Në lëndën e biologjisë shumë me rëndësi është realizimi i veprimtarisë vëzhguese eksperimentale, gjatë së cilës nxënësit të stimulohen për të mbledhur e interpretuar të dhënat si dhe nxjerrjen e përfundimeve.

Për detalet e sjelljes së nxënësit dhe arsimtarit gjatë punës praktike në laborator shih **Plani dhe programi mësimor i biologjisë, Kl. 10, f. 134-171**)

Kabineti i biologjisë (laboratori) dhe laboranti

Për implementimin e suksesshëm të përmbajtjes programore në biologji, krahas burimeve të informacionit, punës në terren, duhet të ekzistojë kabineti me pajisje përkatëse si dhe biblioteka e pajisur me literaturë profesionale. Ato shkolla që kanë mundësi mund të shfrytëzojnë internetin. Për punë praktike duhet të angazhohet **laboranti** i cili mirëmban pajisjet dhe mjetet mësimore, furnizon me material të nevojshëm (**bimë, shtazë, kultivon infuzorë etj.**), bashkëpunon me arsimtarin dhe nxënësit gjatë punës në laborator (kabinet) dhe terren. Punët në laborator dhe terren i udhëheq arsimtari me pjesëmarrje të laborantit.

VLERËSIMI

Vlerësimi është proces i vrojtimit, i mbledhjes sistematike, i analizimit dhe i interpretimit të informative me qëllim të përcaktimit se deri në ç'shikallë nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëzues. Ai duhet të

mbështetet në objektivat e dijes (rezultatet e prituara) të programit të lëndës përkatëse dhe të nivelit përkatës.

Ky proces mbështetet në disa parime themelore, siç janë:

- Përcaktimi i qëllimit dhe i përparësive në procesin e vlerësimit;
- Zbatimi i instrumenteve adekuate të matjes në përputhje me qëllimin në mënyrë që të matet ajo që është synuar të matet;
- Sigurimi i cilësisë së informatave për arritshmërinë e rezultateve të nxënësve përmes matjes dhe vlerësimit të vazhdueshëm;
- Matja dhe vlerësimi duhet të jenë të balancuara, të përfshihet e tërë përmbajtja programore e lëndës;
- Vlefshmëria e qëndrueshme e të dhënave se shkalla e arritshmërisë së nxënësve është e saktë;
- Zbatimi i teknikave të vlerësimit me anë të të cilave bëjmë dallimin e qartë të arritshmërisë së nxënësve.

Instrumentet e vlerësimit

Është me rëndësi që, për veçoritë që duam t'i vlerësojmë, të përdorim mjetin apo instrumentin adekuat të matjes. Me çfarëdo mjeti që përdoret nuk mund të maten të gjitha veçoritë e arritshmërisë së nxënësve, andaj duhet përdorur sa më shumë që të jetë e mundur mjete dhe teknika të ndryshme, në mënyrë që të mbledhim informacione të mjaftueshme për të vlerësuar shkallën e arritshmërisë së nxënësve.

Mësimdhënësi i lëndës dhe shkolla duhet të zbatojnë një numër të mjaftueshëm instrumentesh për matje dhe vlerësim, siç janë:

- Vrojtimi;
- Pyetësori (vetëvlerësimi);
- Raporti me shkrim i një pune praktike apo i një hulumtimi;
- Të shprehurit me gojë;
- Të shprehurit me shkrim;
- Fleta kontrolluese (përdoret për shkathhtësitë manovruese të nxënësve);
- Dosja apo portofoli (vetëvlerësimi);
- Testi i bazuar në kritere dhe objektiva;
- Testi i arritshmërisë i ndërtuar nga kërkesa (pyetjet) me:

- përgjigje alternative të shumta;
- përgjigje të hapura të shkurta;
- përgjigje të hapura të zgjeruara etj.

dhe çdo instrument tjetër që mësimit duhet të vlerësohet në mënyrë të nevojshme.

Shkalla e përfitimit

Në fund të vitit mësimor çdo nxënës duhet të arrijë njërin prej shkallëve të përfitimit të arritshmërisë:

- shkëlqyeshëm (arritje shumë e lartë);
- shumë mirë (arritje e lartë)
- mirë (arritje mesatare)
- mjaftueshëm (arritje e kufizuar) dhe
- pamjaftueshëm (arritje e pamjaftueshme)

HYRJE

Lënda e fizikës në klasën e 11 mësohet në tri gjimnaze: në **gjimnazin e shkencave të natyrës** me nga 3 orë në javë, në **gjimnazin matematikë me informatikë** me nga 2 orë në javë dhe në **gjimnazin e përgjithshëm** me nga 2 orë në javë. Për çdo njërin gjimnaz është përpiluar program i veçantë dhe në asnjërin prej tyre nuk përsëritet ndonjë nënkategori nga klasat e mëparshme 10 dhe 11 . Këtu vazhdohet me kategori dhe nënkategori të reja disa prej të cilave nxënësi i dëgjon për herë të parë. Për këte arsye në klasën e 12 shumica e mësimeve shpjegohen në nivel të njohjes, kuptimit dhe zbatimit e ka më pak analizë, sintezë apo vlerësim. Ekziston dallim mes qasjes së shqyrtimit të dukurive fizike në dy gjimnazet e para dhe atë të përgjithshëm, duke marrë si bazë njohjen e aparatit matematik nga nxënësit.

QËLLIMET

Programi i fizikës për klasën e 12 ka për qëllim:

- Të zhvillojë aftësi të nxënësit për të njohur dhe për të kuptuar fenomenet natyrore dhe të interpretojë saktë ligjshmëritë themelore të paraqitjes së tyre.
- Të zhvillojë shkathhtësi për të kuptuar saktë formën analitike të ligjeve të fizikës bashkëkohore, rrjedhimet e tyre dhe zbatimin në zgjidhje të detyrave konkrete.
- Të fitojë aftësi për njohje të ligjeve të mikrostrukturës, t'i krahasojë me konceptet klasike dhe të njohë rolin e fizikës bashkëkohore në ngritjen e kualitetit të jetës së njeriut.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

Të njohë:

- Formën analitike të ligjeve themelore të optikës, fizikës bashkëkohore dhe rrjedhimet e tyre.
- ligjet themelore të optikës gjeometrike dhe zmadhimin e shëmbëllimit të objektit në pasqyra sferike, thjerra të holla, qelq zmadhues dhe mikroskop optik;
- dukuritë e interferencës, difraksionit, polarizimit dhe natyrën valore të dritës;
- karakterin relativist të madhësive fizike të trupave që lëvizin me shpejtësi të afërt me shpejtësinë e dritës;
- ligjshmëritë themelore të ndërtimit të strukturës së atomit dhe bërthamës së tij;
- mënyrën e bartjes së elektricitetit në gjysmëpërçues dhe ndërtimin e veglërive gjysmëpërçuese.

Të kuptojë:

- Dukuritë themelore të optikës gjeometrike dhe optikës valore, karakterin klasik e relativist të madhësive fizike dhe dukuritë në bërthamë të atomit;
- dy mënyrat e përcaktimit (analitik dhe konstruktiv) të zmadhimit të shëmbëllimit të objektit në pasqyra sferike, thjerra të holla, qelq zmadhues dhe mikroskop optik;
- natyrën duale të dritës (grimcore dhe valore) dhe grimcave të tjera elementare;
- trajtimin relativist të gjatësisë, vëllimit, kohës, masës, energjisë dhe ligjit të ruajtjes së masës –energjisë;

- radioaktivitetin natyror, zërthimet alfa, beta, gama, fisionin, fuzionin dhe vetitë e përgjithshme të reaksioneve bërthamore.

Të zbatojë:

- Njohuritë e fituara për zgjidhje të detyrave numerike në mënyrë të pavarur dhe problemeve praktike të jetës së përditshme;
- njohjen e vetive të thjerrave për përcaktimin e lagësisë vatrore të tyre, përkatësisht fuqisë, kurse dukuritë e interferencës dhe difraksionit për përcaktimin e gjatësisë valore të dritës rënëse;
- ligjet e mikrostrukturës për përcaktimin e niveleve energjetike të atomit dhe të bërthamës së tij;
- njohjen e radioizotopeve në mjekësi dhe lëmenj të tjerë të jetës së përditshme.

Të vlerësojë:

- Rrjedhimet e kërkesës së vazhdueshme të njeriut për resurse të reja të energjisë dhe teknologji të lartë;
- efektet e dobishme dhe të dëmshme të shfrytëzimit të energjisë bërthamore;
- ngritjen e kualitetit të jetës së njeriut nga zhvillimi i hovshëm i teknologjisë bashkëkohore dhe teknikës së satelitëve.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

Kategoritë	Nënkategoritë	Numri i orëve *		Përqindja
IV Optika	IV.2 Optika gjeometrike	14		14,7%
	IV.3 Optika valore	14		14,7%
V. Fizika bashkëkohore	V.1 Fizika relativiste	14		14,7%
	V.2 Rrezatimi termik dhe optika kuantike	12		12,7%
	V. Struktura e atomit	14		14,7%
	V.4 Bërthama e atomit dhe grimcat elementare	14		14,7%
	V. Fizika e trupit të ngurtë	13		13,8%
		Tërësisht	95	100%

* 4 orë planifikohen për ushtrime laboratorit.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

KATEGORIA	NËNKATEGORIA	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	REZULTATET E PRITURA	LIDHJA NDËRLËNDORE
IV. OPTIKA	IV. 2 OPTIKA GJEOMETRIKE	Ligjet themelore të optikës gjeometrike. Përcaktimi i zmadhimeve të shëmbëllimeve të objekteve në mënyrë konstruktive dhe analitike në pasqyra të rrafshta (zbatimi, rrotullimi i saj), sferike (konkave, konvekse), thjerrat të holla, (konvergjente, divergjente), qelq zmadhues dhe mikroskop optik. Aberracionet. Devijimi i rrezes rënëse në prizm dhe pllakë planparalele.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të përkufizojë me fjalë, vizatim dhe në mënyrë analitike ligjet themelore të optikës gjeometrike; - të përcaktojë në mënyrë analitike dhe me konstruksion zmadhimin në pasqyra të rrafshta (zbatimi), sferike, thjerra të holla, qelq zmadhues dhe mikroskop optik; - të njehsojë zhvendosjen e rrezes nga drejtimi rënëse, pas kalimit nëpër pllakë planparalele dhe prizm optik; - të përshkruajë lloje të ndryshme të aberracioneve dhe mundësitë e evitimit të tyre.	Matematikë: ekuacionet lineare, operimi me thyesa, vetitë e trekëndëshave.
IV. OPTIKA	IV. 3. OPTIKA VALORE	Karakteristikat e valës dhe intensiteti interferencial i dritës. Interferenca e palokalizuar. Vijat interferenciale të pjerrësisë së njëjtë, të trashësisë së njëjtë. Difraksioni i dritës (në çfarëdo rrafshi dhe në zonë të valës).	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të njehsojë intensitetin e dritës së interferuar nga dy rreze në funksion të fazëve të tyre që kalojnë rrugë të	Matematikë: Funksionet trigonometrike dhe operimet me to. Vetitë e trekëndëshave.

		Difraksioni i tufës paralele në pambarim në një dhe shumë çarje paralele. Polarizimi i dritës dhe ligjet e tij. Dikroizmi. Mënyrat e polarizimit. Holografia.	ndryshme; - të tregojë shembuj të llojeve të ndryshme të interferimit, pa lokalizim, në pambarim dhe në vetë sipërfaqen; - të shpjegojë rastet më të thjeshta të paraqitjes së difraksionit të dritës; - të përkufizojë polarizimin e valës transverzale, duke u bazuar në analogun mekanik, metodat me të cilat polarizohet vala dhe ligjet themelore të polarizimit. - të përshkruajë mënyrën e regjistrimit të hologramit të objektit dhe rekonstruktimin e tij.	
V. FIZIKA BASHKË-KOHORE	V.1 FIZIKA RELATIVISTE	Fizika në fund të shekullit XIX. (Eksperimenti i Fizos, i Majkëlsonit, aberracioni yjor). Parimi i relativitetit i Galileit dhe i Ajnshtajnit. Karakteri relativ i kohës. Transformimet e Lorencit dhe rrjedhimet e tyre. Parimi relativist e mbledhjes së shpejtësive dhe karakteri kufitar i shpejtësisë së dritës. Karakteri relativ i masës dhe i impulsit, energjia totale, energjia e qetësisë, energjia kinetike relativiste	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të përshkruajë gjendjen e fizikës në fund të shek XIX dhe zbulimet që i kanë paraprirë paraqitjes së teorisë së relativitetit; - të shkruajë formën analitike të transformimeve të Galileit, të Lorencit dhe rrjedhimeve të tyre;	Matematikë: Ekuacionet lineare, rrënjët katrore.

		dhe invarianca e lidhjes së tyre. Një ligj në vend të dy ligjeve.	<ul style="list-style-type: none"> - të dallojë me shembuj numerikë rrjedhimet e teoremave të mbledhjes së shpejtësive në fizikën klasike dhe relativiste; - të shkruajë dhe të interpretojë shprehjet për masë, impuls, energji totale, energji kinetike relativiste dhe të përfitojë invariancën e lidhjes së tyre në fizikën relativiste; - të shpjegojë me shembuj ligjin e ruajtjes së masës – energjisë. 	
V. FIZIKA BASHKË-KOHORE	V.2 RREZATIMI TERMIK DHE OPTIKA KUANTIKE	Rrezatimi termik. Ligji i Kirkoftit për rrezatim. Modeli i trupit absolut të zi dhe ligjet e rrezatimit të tij. Kuantet e dritës (dualizmi grimcoro- valor, energjia, impulsi, masa, shtypja). Verifikimi eksperimental dhe teorik i bashkëveprimit të fotoneve me elektrone.	<p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shkruajë formën analitike të të gjitha ligjeve të rrezatimit të trupit absolut të zi dhe të vizatojë lakoret e intensitetit të rrezatimit në funksion të temperaturës; - të shprehë analitikisht masën, impulsin energjinë dhe shtypjen e kuantëve të dritës dhe të tregojë cilësitë themelore të tyre; - të përfitojë shprehjet 	Matematikë: Ekuacionet lineare dhe operimi me thyesa.

			analitike për fotoefekt dhe efekt të Komptonit dhe të njoftojë për pamundësinë e shpjegimit të tyre me ligje të fizikës klasike.	
V. FIZIKA BASHKË-KOHORE	V.3 STRUKTURA E ATOMIT	Modelet e atomit. Nivelet energjetike dhe seritë spektrale të atomit të hidrogjenit. Verifikimi eksperimental i postulatit të dytë të Borit. Valët e materies dhe gjendjet stacionare në atom. Parimi i papërcaktueshmërisë (për valë klasike dhe valë të Dë Brolit). Numrat kuantikë: kryesorë, orbitalë dhe magnetikë (lidhja mes të L dhe μ). Spini i elektronit dhe verifikimi eksperimental. Parimi i Paulit, konfiguracioni themelor i elektroneve në atome dhe retë elektronike. Rrezet röntgen dhe vetitë e tyre. Lumineshenca. Emisioni spontan dhe i stimuluar i rrezatimit dhe parimi i punës së laserit.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të njehsojë në mënyrë analitike, duke shfrytëzuar postulatet e Borit, rrezet, shpejtësitë, nivelet energjetike dhe seritë spektrale të atomit të hidrogjenit; - të shprehë gjatësinë valore λ të grimcës me masën m dhe postulatit e parë të Borit për kuantizimin e momentit të sasisë së lëvizjes nga hipoteza e Dë Brolit; - të vërë në dukje përmbajtjen e relacioneve të Hajzenbergut në fizikën klasike dhe në botën e mikrogrimcave; - të tregojë çka përshkruan çdo numër kuantik në atom, të përkufizojë parimin e Paulit dhe konfiguracionin elektronik; - të përshkruajë mënyrën e	Matematikë: Thyesat dhe operimi me to.

			krijimit të rrezeve të rëntgenit, llojet e spektrave të tyre dhe dallimin nga spektrat optikë; -të shpjegojë lloje të ndryshme të lumineshencës, emetimin spontan dhe të stimuluar dhe parimin e punës së laserit.	
V. FIZIKA BASHKË-KOHORE	V.4 BËRTHAMA E ATOMIT DHE GRIMCAT ELEMENTARE	Karakteristikat themelore të bërthamës statike dhe struktura e saj. Forcat bërthamore. Radioizotopet dhe zbatimi i tyre. Ligji i zbërthimit radioaktiv dhe zbërthimi alfa, beta dhe gama. Reaksionet bërthamore. Elementet transuranike. Fisioni dhe fuzioni. Reaktorët bërthamorë. Mbrojtja nga rrezatimi. Sistemimi i grimcave elementare sipas bashkëvep- rimit. Antigrimcat. Kuarqet. Struktura e nukleoneve.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të përkufizojë përmasat, masën, ngarkesën, spinin, momenti magnetik, defektin e masës, energjinë e lidhjes dhe strukturën e bërthamës atomike; - të tregojë zbatimin e radioizotopeve në lëmenj të ndryshëm të jetës së përditshme. - të përfitojë formën analitike të ligjit të zbërthimit radioaktiv dhe të interpretojë kohën e gjysmëzbërthimit; - të përshkruajë vetitë themelore të zbërthimeve: alfa, beta, gama, mekanizmin e reaksioneve bërthamore, vlefshmërinë e ligjeve të ruajtjes, ruajtjen e numrave	Matematikë: Ekuacionet lineare, funksionet eksponenciale dhe logaritmi natyral.

			leptonikë dhe barionikë, reaksionet e fisionit, zinxhiror, të fuzionit dhe gjeometrinë dhe reaktorët bërthamorë; - të sistemojë grimcat elementare në vartësi prej llojit të bashkëveprimit dhe të njoftojë për antigrimcat, kuarqet dhe strukturën e nukleoneve.	
V. FIZIKA BASHKOHORE	V.5 FIZIKA E TRUPIT TË NGURTË	Trupat e ngurtë, lidhjet kristaline, ngacmimi termik. Rezistenca remanente, aktive në metale, varësia nga temperatura, superpërçuesit. Shpjegimi i përçueshmërisë me zonat energjetike në kristale dhe i shtesave me nivelin energjetik të donorit dhe akceptorit. Kontaktet p–n dhe karakteristika e diodës gjysmëpërçuese (teoria dhe verifikimi eksperimental). Dioda si drejtuese e rrymës alternative, qelizë diellore dhe ndriçuese. Karakteristikat e triodave kristaline. Llojet e bashkëveprimeve në natyrë.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të tregojë ndërtimin e trupave (të ngurtë dhe amorfë) dhe llojet e lidhjeve kristaline në trupa të ngurtë; - të përkufizojë përçuesit, gjysmëpërçuesit dhe veçuesit në bazë të pozitës së zonave energjetike të trupave të ngurtë; - të shpjegojë mekanizmin e përçueshmërisë vetjake të gjysmëpërçuesve me ndihmën e elektroneve dhe vrimave; - të përshkruajë gjysmëpërçuesit e tipit donorë dhe akceptorë me ndihmën e spektrit energjetik të nivelit të	Matematikë: ekuacione lineare dhe operimi me thyesa.

			<p>donorit dhe akceptorit; - të dallojë rezistencën remanente ρ_r nga rezistenca aktive R, shpjegimin klasik të R nga ai kuantum-mekanik duke u bazuar në kohën mesatare t_m në mes të goditjeve dhe varësinë e rezistencës nga temperatura në përçues dhe gjysmëpërçues; - të krahasojë parimin e punës së elementeve elektronike gjysmëpërçuese me gypin e diodës dhe të triodës klasike; - të përshkruajë rolin e gjysmëpërçuesve në zhvillimin e teknologjisë bashkëkohore dhe të satelitëve.</p>	
--	--	--	---	--

USHTRIME LABORATORI

1. Përcaktimi i largësisë së vatrës së thjerrave me metodën e drejtpërdrejtë.
2. Përcaktimi i largësisë së vatrës së thjerrave me metodën e Beselit.
3. Përcaktimi i indeksit të thyerjes së pllakës së qelqit me mikroskop.
4. Përcaktimi i këndit të zgjerimit të tufës së laserit

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

Të njohë:

- formën analitike të ligjeve themelore të optikës dhe të fizikës bashkëkohore;
- karakteristikat e pasqyrave sferike, thjerrave të holla, qelqit zmadhues, mikroskopit optik, interferencës, difraksionit dhe polarizimit të dritës;
- karakterin relativist të madhësive themelore fizike të trupave që lëvizin me shpejtësi të afërt me shpejtësinë e dritës;
- ligjshmëritë themelore të ndërtimit të strukturës së atomit dhe të bërthamës së tij;
- vetitë e gjysmëpërçuesve në procesin e bartjes së elektricitetit dhe veglëritë themelore gjysmëpërçuese.

Të kuptojë:

- dukuritë fizike të cilat shpjegohen në optikën gjeometrike dhe valore, karakterin klasik e relativist të madhësive fizike dhe dukuritë në bërthamë të atomit;
- dy mënyrat e përcaktimit (analitik dhe konstruktiv) të zmadhimit të shëmbëllimit të objektit në pasqyra sferike, thjerra të holla, qelq zmadhues dhe mikroskop optik;
- natyrën duale të dritës (grimcore dhe valore) dhe grimcave të tjera elementare;
- trajtimin relativist të gjatësisë, vëllimit, kohës, masës dhe energjisë;
- radioaktivitetin natyror, zbërthimet alfa, beta, gama, fisionin, fuzionin dhe vetitë e përgjithshme të reaksioneve bërthamore.

Të zbatojë:

- njohuritë e fituara për zgjidhje të detyrave numerike në mënyrë të pavarur dhe problemeve praktik të jetës së përditshme;
- njohjen e vetive të thjerrave për përcaktimin e lagësisë vatrore të tyre, përkatësisht fuqisë, kurse dukuritë e interferencës dhe të difraksionit për përcaktimin e gjatësisë valore të dritës rënëse;
- ligjet e mikrostrukturës për përcaktimin e përmasave të atomit dhe të bërthamës së tij;
- radioizotopet në mjekësi dhe në lëmenj të tjerë të jetës së përditshme.

Të vlerësojë:

- rrjedhimet e kërkesës së vazhdueshme të njeriut për resurse të reja të energjisë dhe teknologji të lartë;
- efektet e dobishme dhe të dëmshme të shfrytëzimit të energjisë bërthamore;
- ngritjen e kualitetit të jetës së njeriut nga zhvillimi i hovshëm i teknologjisë bashkëkohore dhe teknikës së satelitëve.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

Kategoritë	Nënkategoritë	Numri i orëve *		Përqindja
IV. Optika	IV.2 Optika gjeometrike	9		14,3%
	IV.3 Optika valore	9		14,3%
V. Fizika bashkëkohore	V.1 Fizika relativiste	9		14,3%
	V.2 Rrezatimi termik dhe optika kuantike	9		14,3%
	V. Struktura e atomit	9		14,3%
	V.4 Bërthama e atomit dhe grimcat elementare	9		14,3%
	V. Fizika e trupit të ngurtë	9		14,3%
Tërësisht		63	100 %	

* 3 orë planifikohen për ushtrime laborator.

KATEGORIA	NËNKATEGORIA	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	REZULTATET E PRITURA	LIDHJA NDËRLËNDORE
IV. OPTIKA	IV. 2. OPTIKA GJEOMETRIKE	Ligjet themelore të optikës gjeometrike. Përcaktimi i zmadhimeve të shëmbëllimeve të objekteve në mënyrë konstruktive dhe analitike në pasqyra të rrafshta, sferike, thjerra të holla, qelq zmadhues dhe mikroskop optik. Thyerja e dritës nëpër pllakë planparalele dhe nëpër prizm.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të përkufizojë me fjalë, me vizatim dhe në mënyrë analitike ligjet themelore të optikës gjeometrike; - të përcaktojë në mënyrë analitike dhe me konstruksion zmadhimin në pasqyra të rrafshta, (zbatimi i tyre) sferike, thjerra të holla, qelq zmadhues dhe mikroskop optik; - të njehsojë zhvendosjen e rrezes nga drejtimi rënës, pas kalimit nëpër pllakë planparalele dhe prizëm optik.	Matematikë: ekuacionet lineare, operimi me thyesa, vetitë e trekëndëshave.
IV. OPTIKA	IV. 3. OPTIKA VALORE	Karakteristikat e valës dhe intensiteti interferencial i dritës. Interferenca e palokalizuar. Vijat interferenciale të pjerrësisë së njëjtë dhe të trashësisë së njëjtë. Difraksioni i dritës (në çfarëdo rrafshi dhe në zonë të valës). Difraksioni i tufës paralele në pambarim në një dhe shumë çarje paralele. Polarizimi i	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të njehsojë intensitetin e dritës së interferuar nga dy burime virtuale. - të tregojë rastet më të thjeshta të paraqitjes së interferencës dhe difraksionit të dritës; - të përshkruajë metodat e polarizimit të valëve transverzale, duke u bazuar në	Matematikë: funksionet trigonometrike dhe operimet me to. Vetitë e trekëndëshave.

		dritës dhe ligjet e tij. Mënyrat e polarizimit.	analogun mekanik dhe ligjet themelore të polarizimit.	
V. FIZIKA BASHKËKOHORE	V.1. FIZIKA RELATIVISTE	Fizika në fund të shekullit XIX. (Eksperimenti i Fizos, i Majkëlsonit, aberracioni yjor). Parimi i relativitetit i Galileit dhe i Ajnshtajnit. Karakteri relativ i kohës. Transformimet e Lorencit dhe rrjedhimet e tyre. Parimi relativist e mbledhjes së shpejtësive. Karakteri relativ i masës dhe i impulsit, energjia totale, energjia e qetësisë, energjia kinetike relativiste dhe invarianca e lidhjes së tyre.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: të përshkruajë gjendjen e fizikës në fund të shek XIX dhe zbulimet që i kanë paraprirë paraqitjes së teorisë së relativitetit; - të shkruajë formën analitike të transformimeve të Galileit, të Lorencit dhe rrjedhimeve të tyre; - të dallojë me shembuj numerikë rrjedhimet e teoremave të mbledhjes së shpejtësive në fizikën klasike dhe relativiste; - të shkruajë dhe të interpretojë shprehjet për masë, impuls, energji totale, energji kinetike relativiste dhe të përfitojë invariancën e lidhjes së tyre në fizikën relativiste.	Matematikë: Ekuacionet lineare, rrënjët katrore.
V. FIZIKA BASHKËKOHORE	V.2. RREZATIMI TERMIK DHE OPTIKA KUANTIKE	Rrezatimi termik. Ligji i Kirkoftit për rrezatim. Modeli i trupit absolut të zi dhe ligjet e rrezatimit të tij. Kuantet e dritës (dualizmi grimcoro-valor, energjia, impulsi, masa,	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të shkruajë formën analitike të ligjeve të rrezatimit të trupit absolut të zi dhe të vizatojë lakoret e Plankut për intensitet të	Matematikë: Ekuacionet lineare dhe operimi me thyesa.

		shembuj të shtypjes). Verifikimi eksperimental dhe teorik i bashkëveprimit të fotoneve me elektrone.	rrezatimit në funksion të temperaturës; - të njësujë masën, impulsin, energjinë e kuantit të dritës dhe të tregojë cilësitë themelore të tyre; - të përfitojë shprehjet analitike për fotoefekt dhe efekt të Komptonit dhe të njohtojë për pamundësinë e shpjegimit të tyre me ligje të fizikës klasike.	
V. FIZIKA BASHKËKOHORE	V.3. STRUKTURA E ATOMIT	Modelet e atomit. Nivelet energjetike dhe seritë spektrale të atomit të hidrogjenit. Verifikimi eksperimental i postulatit të dytë të Borit. Valët e materies dhe gjendjet stacionare në atom. Parimi i papërcaktueshmërisë (për valë klasike dhe valë të Dë Brolit). Numrat kuantikë: kryesorë, orbitalë dhe magnetikë. Spini i elektronit dhe verifikimi eksperimental. Parimi i Paulit, konfiguracioni themelor i elektroneve në atome. Rrezet rëntgen dhe vetitë e tyre. Parimi i punës së laserit.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të njehsojë në mënyrë analitike, duke shfrytëzuar postulatet e Borit, rrezet, shpejtësitë, nivelet energjetike dhe seritë spektrale të atomit të hidrogjenit; - të shprehë gjatësinë valore λ të grimcës me masën m , dhe postulatit e parë të Borit për kuantizimin e momentit të sasisë së lëvizjes nga hipoteza e Dë Brolit; - të vërë në dukje përmbajtjen e relacioneve të Hajzenbergut në fizikën klasike dhe në botën e mikrogrimcave; - të tregojë çka përshkruan çdo	Matematikë: Thyesat dhe operimi me to.

			<p>numër kuantik në atom, parimin e Paulit dhe konfiguracionin e elektroneve;</p> <p>- të përshkruajë mënyrën e krijimit të rrezeve të rëntgenit, llojet e spektrave të tyre, dallimin nga spektrat optikë dhe parimin e punës së laserit.</p>	
V. FIZIKA BASHKËKOHORE	V.4. BËRTHAMA E ATOMIT DHE GRIMCAT ELEMENTARE	<p>Përmasat, masa, ngarkesa, spini, momenti magnetik, struktura, defekti i masës dhe energjia e lidhjes së bërthamës. Forcat bërthamore. Ligji i zbërthimit radioaktiv. Zbërthimi alfa, beta dhe gama. Reaksionet bërthamore.</p> <p>Fisioni dhe fuzioni. Reaktorët bërthamorë. Mbrojtja nga rrezatimi. Sistemimi i grimcave elementare sipas bashkëveprimit. Antigrimcat. Kuarqet. Struktura e nukleoneve.</p>	<p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</p> <p>- të përkufizojë karakteristikat themelore të bërthamës statike dhe strukturës së saj;</p> <p>- të shpjegojë mekanizmin e reaksioneve bërthamore dhe vlefshmërinë e ligjeve të ruajtjes;</p> <p>- të përfitojë formën analitike të ligjit të zbërthimit radioaktiv, të interpretojë kohën e gjysmëzbërthimit dhe të dallojë fisionin nga fuzioni bërthamor;</p> <p>- të sistemojë karakteristikat e grimcave elementare në vartësi prej llojit të bashkëveprimit.</p>	<p>Matematikë: Ekuacionet lineare, funksionet eksponenciale dhe logaritmi natyral.</p>
V. FIZIKA BASHKËKOHORE	V.5. FIZIKA E TRUPIT TË NGURTË	<p>Trupat e ngurtë, lidhjet kovalente dhe metalike kristaline, ngacmimi termik. Rezistenca remanete, aktive</p>	<p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje:</p> <p>- të përshkruajë lidhjet kovalente dhe metalike në trupa të ngurtë;</p>	<p>Matematikë: ekuacione lineare dhe operimi me thyesa.</p>

		<p>në metale, varësia nga temperatura, superpërçuesit. Shpjegimi i përçueshmërisë me zonat energjetike në kristale. Kontaktet p–n dhe karakteristika e diodës gjysmëpërçuese (teoria dhe verifikimi eksperimental). Dioda si drejtuese e rrymës alternative.</p> <p>Karakteristikat e triodave kristaline. Llojet e bashkëveprimeve në natyrë.</p>	<p>- të përkufizojë përçuesit, gjysmëpërçuesit dhe veçuesit në bazë të renditjes së zonave energjetike të trupave të ngurtë;</p> <p>- të shpjegojë mekanizmin e përçueshmërisë vetjake dhe të shtesave të gjysmëpërçuesve me ndihmën e elektroneve dhe vrimave;</p> <p>- të krahasoj parimin e punës së elementeve elektronik gjysmëpërçuese me gypin e diodës dhe të triodës klasike;</p> <p>- të përshkruaj parimin e punës së transistorit.</p>	
--	--	--	--	--

USHTRIME LABORATORI

1. Përcaktimi i largësisë së vatrës së thjerrës me metodën e Beselit.
2. Përcaktimi i këndit të zgjerimit të tufës së laseri.
3. Përcaktimi i indeksit të thyerjes së pllakës së qelqit me mikroskop.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësi duhet të jenë në gjendje:

Të njohë:

- dukuritë e optikës valore, fillet e fizikës bashkëkohore dhe astronomisë;
- karakteristikat themelore të dukurive të interferencës, difraksionit dhe polarizimit të dritës;
- karakterin relativist të madhësive themelore fizike të trupave që lëvizin me shpejtësi të afërt me shpejtësinë e dritës;
- strukturën e atomit, bërthamës së tij dhe gjysmëpërçuesve në procesin e bartjes së elektricitetit.; sferën qiellore dhe përkufizimin e pikave, vijave dhe harqeve themelore të saj.

Të kuptojë

- dukuritë themelore të optikës valore, karakterin klasik e relativist të madhësive fizike dhe dukuritë që ndodhin në bërthamë të atomit;
- paraqitjen grafike të interferencës, difraksionit dhe polarizimit;
- natyrën duale të dritës (grimcore dhe valore) dhe grimcave të tjera elementare;
- trajtimin relativist të gjatësisë, vëllimit, kohës, masës dhe energjisë, radioaktivitetin natyror, zbërthimet alfa, beta, gama dhe vetitë e përgjithshme të reaksioneve bërthamore;
- lëvizjen e dukshme vjetore të Diellit dhe rrjedhimet e saj si pasqyrim i lëvizjes së vërtetë të Tokës.

Të zbatojë:

- njohuritë e fituara për zgjidhje të detyrave numerike në mënyrë të pavarur dhe problemeve praktike të jetës së përditshme;

- njohjen e dukurive të interferencës dhe të difraksionit për përcaktimin e gjatësisë valore të dritës rënëse;
- ligjet e mikrostrukturës për përcaktimin e përmasave të atomit dhe të bërthamës së tij;
- kuptimin e sferës qiellore për orientimin në Tokë në kohë dhe hapësirë me ndihmën e Diellit dhe të yjeve.

Të vlerësojë:

- rrjedhimet e kërkesës së vazhdueshme të njeriut për resurse të reja të energjisë dhe teknologji të lartë;
- efektet e dobishme dhe të dëmshme të shfrytëzimit të energjisë bërthamore;
- ngritjen e kualitetit të jetës së njeriut nga zhvillimi i hovshëm i teknologjisë bashkëkohore dhe teknikës së satelitëve;
- ndotjen e atmosferës së Tokës në mënyra të ndryshme, krijimin e kopshtit qelqor dhe çrregullimet e përgjithshme të mjedisit të njeriut.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

Kategoritë	Nënkategoritë	Numri i orëve *		Përqindja
IV. Optika	IV.3 Optika valore	7		9.86 %
V. Fizika bashkëkohore	V.1 Fizika relativiste	8		11,26 %
	V.2 Rrezatimi termik dhe optika kuantike	7		9.86 %
	V3. Struktura e atomit	7		9.86 %
	V.4 Bërthama e atomit dhe grimcat elementare	7		9.86 %
	V. Fizika e trupit të ngurtë	7		9.86 %
VI. Astronomi	VI.1 Astronomia sferike	9		12,67 %
	VI.2 Astrofizika	9		12,67 %
	VI.3 Sistemi diellor dhe kozmologjia	10		14,00 %
	Tërësisht	71*	100 %	

* 2 orë planifikohen për ushtrime laborator.

1 orë planifikohet për vrojtim në sferën qiellore.

KATEGORIA	NËNKATEGORIA	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	REZULTATET E PRITURA	LIDHJA NDËR-LËNDORE
IV. OPTIKA	IV. 3. OPTIKA VALORE	Intensiteti interferencial i dritës. Interferenca e palokalizuar. Vijat interferenciale të pjerrësisë së njëjtë dhe të trashësisë së njëjtë. Difraksioni i dritës (në çfarëdo rrafshi dhe në zonë të valës). Difraksioni i tufës paralele në pambarim në një dhe shumë çarje paralele. Polarizimi i dritës dhe ligjet e tij. Mënyrat e polarizimit	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të njehsojë intensitetin e dritës së interferuar nga dy burime virtuale; - të tregojë rastet më të thjeshta të paraqitjes së interferencës dhe të difraksionit të dritës; - të përshkruajë dukurinë e polarizimit të valëve të dritës nga analogjia e kalimit të valëve mekanike nëpër çarje.	Matematikë: Funksionet trigonometrike dhe operimet me to. Vetitë e trekëndëshave.
V. FIZIKA BASHKË-KOHORE	V.1. FIZIKA RELATIVISTE	Eteri kozmik. Postulatet e teorisë speciale të relativitetit (TSR). Karakteri relativ i kohës. Transformimet e Lorencit. Rrjedhimet e transformimeve të Lorencit. Parimi relativist i mbledhjes së shpejtësive. Karakteri kufitar i shpejtësisë së dritës. Masa, impulsi, energjia totale, energjia e qetësisë, energjia kinetike relativiste dhe invarianca e lidhjes së tyre.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të shkruajë formën analitike të transformimeve të Lorencit; - të dallojë me shembuj numerikë rrjedhimet e teoremave të mbledhjes së shpejtësive në fizikën klasike dhe relativiste; - të shkruajë shprehjet për masë, impuls, energji totale, energji kinetike relativiste dhe të përfitojë invariancën e lidhjes së tyre në fizikën relativiste.	Matematikë: Ekuacionet lineare, rrënjët katrore.
V. FIZIKA BASHKË-	V.2. RREZATIMI TERMIK DHE	Ligji i Kirkoftit për rrezatim. Modeli i trupit absolut të zi dhe ligjet e rrezatimit të tij. Ligji i	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të shkruajë formën analitike të ligjeve të rrezatimit të trupit absolut	Matematikë: Ekuacionet lineare dhe

KOHORE	OPTIKA KUANTIKE	Plankut për rrezatim. Kuantet e dritës, (dualizmi grimcor - valor, energjia, impulsi, masa, shembuj të shtypjes). Bashkëveprimi i fotonit me elektronin.	të zi dhe t'i vizatojë lakoret e Plankut për vartësi të intensitetit të rrezatimit nga temperatura; - të njehsojë masën, impulsin dhe energjinë e kuantit të dritës (fotonit); - të shpjegojë dukuritë e bashkëveprimit të fotonit me elektron dhe mangësitë e fizikës klasike për këtë shpjegim.	operimi me thyesa.
V. FIZIKA BASHKË- KOHORE	V.3. STRUKTURA E ATOMIT	Modelet atomike. Nivelet energjetike dhe seritë spektrale të atomit të hidrogjenit. Dualizmi grimcë valë i mikrogrimcave. Valët e De Broilit dhe gjendjet stacionare në atom. Parimi i papërcaktueshmërisë (për valë klasike dhe valë të De Broilit). Numrat kuantikë: kryesorë, orbitalë dhe magnetikë. Spini i elektronit dhe verifikimi eksperimental. Parimi i Paulit, konfiguracioni themelor i elektroneve në atome. Retë kuantike elektronike. Rrezet rëntgen dhe vetitë e tyre. Parimi i punës së laserit.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të njehsojë në mënyrë analitike, duke shfrytëzuar postulatet e Borit, rrezet, shpejtësitë, nivelet energjetike dhe seritë spektrale të atomit të hidrogjenit - të shprehë gjatësinë valore të mikrogrimcës sipas hipotezës së De Broilit. - të tregojë çka përshkruan çdo numër kuantik në atom, të përkufizojë parimin e Paulit dhe konfiguracionin themelor të elektroneve. - të përshkruajë parimin e përfutimit të rrezeve rëntgen dhe parimin e punës së laserit.	Matematikë: Thyesat dhe operimi me to.
V. FIZIKA	V.4. BËRTHAMA E	Përmasat, masa, ngarkesa, spini, momenti magnetik, struktura,	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të përkufizojë veçoritë themelore të	Matematikë: Ekuacionet

BASHKË-KOHORE	ATOMIT DHE GRIMCAT ELEMENTARE	defekti i masës dhe energjia e lidhjes së bërthamës. Forcat bërthamore. Ligji i zbërthimit radioaktiv. Zbërthimi alfa, beta dhe gama. Reaksionet bërthamore. Fisioni dhe fuzioni. Reaktorët bërthamorë. Mbrojtja nga rrezatimi. Sistemimi i grimcave elementare sipas bashkëveprimit. Antigrimcat. Kuarqet. Struktura e nukleoneve.	bërthamës statike dhe strukturën e saj. - të shkruajë dhe interpretojë ligjin e zbërthimit radioaktiv, kohën e gjysmëzbërthimit, të dallojë fisionin nga fuzioni dhe zbërthimet alfa, beta dhe gama. - të emërtojë grimcat elementare në vartësi nga lloji i bashkëveprimit.	lineare, funksionet eksponenciale dhe logaritmi natyral.
V. FIZIKA BASHKË-KOHORE	V.5. FIZIKA E TRUPIT TË NGURTË	Ndërtimi i trupave të ngurtë. Lidhjet kovalente dhe metalike në trupa të ngurtë. Ngacmimi termik i elektroneve dhe vrimave të lira në gjysmëpërçues. Vartësia e rezistencës elektrike të gjysmëpërçuesve dhe përçuesve nga temperatura. Superpërçuesit. Zonat energjetike në kristale. Përçueshmëria e shtesave në gjysmëpërçues. Kontaktet p –n të gjysmëpërçuesve. Veçoria e diodës gjysmëpërçuese (teoria dhe eksperimenti). Dioda si drejtuese e rrymës alternative. Trioda kristaline.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të përshkruajë lidhjet kovalente dhe metalike të trupave të ngurtë. - të përkufizojë përçuesit, gjysmëpërçuesit dhe veçuesit në bazë të pozitës së zonave energjetike në trupa të ngurtë. - të shpjegojë mekanizmin e përçueshmërisë vetjake dhe të shtesave të gjysmëpërçuesve me ndihmën e elektroneve dhe vrimave. - të krahasojë parimin e punës së elementeve elektronikë gjysmëpërçues me gypin e diodës dhe e triodës.	Matematikë: ekuacionet lineare dhe operimi me thyesa.

VI. ASTRONOMIA	VI.1. ASTRONOMIA SFERIKE	Lënda e studimit të astronomisë. Ndarja e astronomisë. Pikat, vijat dhe harqet themelore në sferën qiellore. Yjet dhe yjësitë. Yjësitë themelore dhe orientimi në qiell. Rrotullimi i dukshëm i sferës qiellore. Lartësia e polt mbi horizont dhe gjerësia gjeografike. Rrotullimi ditor i qiellit në gjerësi të ndryshme gjeografike. Lëvizja e dukshme vjetore e Diellit dhe rrjedhimet e saj. Sistemi i Ptolemeut dhe i Kopernikut. Orientimi në Tokë me Diellin dhe me yjet.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të ilustron me vizatim pikat, vijat dhe harqet themelore në sferën qiellore. - të tregojë duke i vizatuar format e yjësave themelore që shihen nga gjerësitë tona dhe dukjen e qiellit në gjerësi të ndryshme gjeografike. - të vërtetojë lidhshmërinë mes lartësisë h_p së Yllit Polar mbi horizont dhe gjerësisë gjeografike φ të vendit të vrojtuesit. - të tregojë përparësitë e sistemit heliocentrik ndaj sistemit gjeocentrik.	Matematikë: sfera dhe prerja e saj me rrafshje që kalojnë dhe nuk kalojnë nëpër qendër të saj.
VI. ASTRONOMIA	VI.2. ASTROFIZIKA	Teleskopët. Radioteleskopët dhe radiointerferometrat. Llojet e spektrave. Përcaktimi i diametrave të yjeve sipas ligjit të rrezatimit. Lëvizjet vetjake të yjeve. Klasifikimi spektral i yjeve dhe përbërja kimike e tyre. Natyra fizike e yjeve. Yjet e ndryshueshme. Yjet shpërthyesë dhe yjet e reja. Yjet super të reja.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të shpjegojë përhapjen e rrezeve të dritës në teleskopët refraktorë, reflektorë dhe të përzier. - të tregojë me fjalë tipat spektralë të yjeve, temperaturat në sipërfaqe, ngjyrën dhe përbërjen kimike të tyre. - të paraqet të dhëna për natyrën fizike të yjeve (ngjyrën, përcaktimin e temperaturës, dritësinë, masën dhe dendësinë e materies yjore)	Optikë gjeometrike: reflektimi i rrezeve të dritës nga pasqyrat dhe thyerja e tyre në thjerra.
VI. ASTRONOMIA	VI.3. SISTEMI	Të dhëna themelore për Diellin (vrojtimi, rrotullimi, përmasat,	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: - të tregojë të dhënat themelore për	Optikë: ndriçimi si madhësi

	DIELLOR DHE KOZMOLOGJIA	përcaktimi i temperaturës efektive dhe përbërjes kimike). Struktura e atmosferës së Diellit. Burimet e energjisë diellore. Planetët e grupit të Tokës. Toka dhe struktura e brendshme e saj. Hëna si satelit i Tokës. Fazat e Hënës. Natyra e Hënës. Sipërfaqja e Hënës. Planetët gjigantë. Veçoritë e trupave të vegjël të sistemit diellor. Galaktika jonë. Grumbullimet yjore. Materia ndëryjore. Galaktikat e tjera. Llojet e bashkëveprimeve në natyrë.	Diellin, Hënën dhe planetët e tipit të Tokës në sistem diellor. - të përshkruajë veçoritë themelore të planetëve gjigantë dhe të trupave të vegjël të sistemit diellor. - të dallojë lloje të ndryshme galaktikash, grumbullimesh të hapura dhe sferike yjore dhe materies ndëryjore.	fotometrike.
--	--------------------------------	---	---	--------------

USHTRIME LABORATORI DHE VROJTIME

1. Përcaktimi i largësisë së vatrës së thjerrës me metodën e Beselit.
2. Përcaktimi i këndit të zgjerimit të tufës së laserit.
3. Vrojtimi i yjësive themelore cirkumpolare dhe orientimi në qiell.

PUNA PRAKTIKE

Pa verifikim eksperimental nuk mund të flasim për njohuri të mirëfilltë të fizikës. Rëndom eksperimentet udhëhiqen në laboratorin shkollor, por në mungesë të tij arsimtari duhet të sjellë në klasë paraprakisht materialin dhe mjetet e punës të parapara për punë praktike, të cilat edhe mund të huazohen nga ndonjë shkollë tjetër. Për disa punë praktike arsimtari paraprakisht duhet të instalojë tërësisht veglërinë me të cilën duhet të kryhen matjet sasiore apo ndërlidhjet mes madhësive.

Për **gjimnazin e shkencave të natyrës** në klasën 12 janë paraparë **4 punë praktike** të cilat zgjasin nga një orë, në **gjimnazin matematikë me informatikë (TIK)**, janë paraparë 3 punë praktike, kurse për **gjimnazin e përgjithshëm** janë paraparë **2 punë praktike** dhe **vrojtime sipas mundësisë të yjësive dhe trupave të tjerë në qiell** për të cilin vendos arsimtari kur e lejojnë kushtet atmosferike.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Për realizimin e përmbajtjes programore të klasës 12, për të tri gjimnazet e cekura shpresohet se do të ekzistojnë tesktet përkatëse të cilat do të botohen sipas këtyre programeve. Përveç librit shkollor si burim tradicional i mësimnxënies preferohet edhe qasja në internet. Në internet mund të gjenden metodat e të nxënimit me anë të demonstrimeve, përkatësisht organizimi i ndonjë pune eksperimentale.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Mësimi i fizikës duhet të kryhet, duke shfrytëzuar disa metoda mësimore. Do të cekim disa prej tyre:

- Metoda e të shprehurit me gojë (monologu),
- Metoda e bashkëbisedimit (dialogu),
- Metoda e demonstrimit,
- Metoda e punës eksperimentale.

Përveç metodave të cekura sipas mundësisë mund të zbatohen edhe teknikat e mësimdhënies bashkëkohore përmes punës në grupe me nxënës në qendër. Kombinimi i disa metodave mësimore në vartësi nga përmbajtja ngrit dinamikën e orës dhe interesimin e nxënësve. P.sh., nëse

pas shpjegimit analitik, pason verifikimi demonstrues i ndonjë dukurie dhe zbatimi praktik me zgjidhje të detyrave përkatëse, te nxënësi do të krijojë kujtesë të pashlyeshme.

Ora mësimore duhet të udhëhiqet nga dy ecuri të mundshme:

- Induktive
- Deduktive

Në mësimin induktiv fillojnë nga e thjeshta kah e përbëra, nga e njohura kah e panjohura, nga e afërta kah e largëta, nga konkretja kah abstrakja. P.sh., Shpjegimi i ekzitimit të dukurive të polarizimit të dritës fillon nga analogjia e kalimit të litarit lëkundës nëpër një çarje në kuti dërrase dhe me analogji pason arsyetimi edhe për valë të dritës. Si shembull tjetër të zbatimit të kësaj ecurie të shpjegimit mund të cekim difraksionin në rrjetë optike, duke u mbështetur në difraksionin në një dy apo më shumë çarje. Mësimi deduktiv rëndom ka të bëjë me analizën e të përgjithshmes kah e veçanta. P.sh. përftimi i difraksionit të Fraunhoferit në një çarje nga specializimi i difraksionit në rrjetë optike vetëm për një çarje.

VLERËSIMI I DITURIVE TË NXËNËSVE

Për vlerësim të diturisë së nxënësve duhet të merren parasysh rezultatet e treguara në:

I. Provim me shkrim

Nga fundi i gjysmëvjetorit parashikohet të mbahet një provim me shkrim, në të cilin do të jepen detyra dhe probleme, të cilat nxënësi do të përpiqet t'i zgjidhë. Arsimtari do të jep disa detyra të zgjidhura dhe të pazgjidhura në klasë, të cilat janë përpunuar apo nuk janë përpunuar më parë në orët e ushtrimeve.

II. Projektet: paraqitje e hulumtimit të pavarur të nxënësit, ose punë praktike

Vlerësimi i diturive të nxënësve kryhet edhe nga përcjellja e aktivitetit të tyre në punë praktike individuale dhe në grupe. Nxënësit do të marrin nga arsimtari detyra konkrete të cilat mund të jenë: zgjidhje e pavarur e ndonjë detyre, shpjegim i pavarur i ndonjë dukurie, ndonjë vizatim interesant apo ndonjë tabelë me të dhëna.

III Intervistat (pyetje me gojë)

Ka nxënës të tillë që janë mjaft të përgatitur, por edhe të papërgatur, të tërhequr në vetvete, inertë dhe nuk tregojnë ndonjë aktivitet në orën e mësimit. Për këtë arsye arsimtari duhet këta nxënës t'i thërrasë dhe t'i intervistojë që të kuptojë nivelin e arritshmërisë së tyre. Kjo mënyrë realizohet në formë bashkëbisedimi në mënyrë të qetë, pa imponim dhe nuk duhet t'i nënshtrohet e tërë klasa.

IV. Testi përfundimtar. Testi përfundimtar mbahet javën e fundit të gjysmëvjetorit dhe bëhet me libra mbyllur. Përmban tërë lëndën e kaluar të atij programi. Nxënësi nuk guxon të ketë qasje në asnjë nga materialet e kursit. Për numrin e pyetjeve të testit vendos arsimtari.

V. Detyrat e shtëpisë

Arsimtari duhet të jep vazhdimisht detyra të shtëpisë me qëllim që nxënësi të mbahet në vazhdimësi. Këto mund të jenë formash të ndryshme si: zgjidhje të detyrave numerike, vendosja e të dhënave në ndonjë tabelë, ndonjë vizatim apo punë praktike etj.

VI. Aktiviteti në klasë

Në radhë të parë, arsimtari duhet ta pranojë nxënësin si partner të bashkëbisedimit. Prandaj, duke provuar që nxënësin ta kyç në bashkëbisedim gjatë procesit të shpjegimit, njëkohësisht do ta çmojë sa është në gjendje të përvetësojë njësinë mësimore të shpjeguar. Kësisoj, nxënësi së bashku me arsimtarin do të jetë vazhdimisht aktiv në nxjerrjen e përfundimeve për ligjshmëritë që shpjegohen. Nxënësit e ndryshëm, për të njëjtën problematikë mund të arrijnë në përfundime të ndryshme. Ky aktivitet i tyre për nxjerrje të përfundimeve së bashku me arsimtarin apo edhe në mënyrë të pavarur duhet të merret si parametër i vlerësimit të diturisë. Po ashtu gjatë zgjidhjes së detyrave numerike të parapara me program në orët e ushtrimeve, disa nxënës janë vazhdimisht aktivë dhe kyçen në zgjidhjen e tyre në tabelë ose në fletore. Edhe ky aktivitet duhet të merret si parameter tjetër për vlerësim të diturisë së tyre.

VII. Aktiviteti në laboratorin e shkollës

Në ato shkolla ku ekziston kabineti i fizikës, arsimtari sipas programit do të shpjegojë dukurinë, duke demonstruar ose do të kryejë matje të ndonjë ligjshmërie fizike. Pikërisht, gjatë këtij angazhimi të arsimtarit, disa nxënës nga kureshtja do të jenë më aktivë se të tjerët. Ata do t'i ndihmojnë arsimtarit në procesin e demonstrimit apo matjes, apo do ta

kryejnë në mënyrë të pavarur atë demonstrim, ashtu që edhe ky aktivitet merret si një nga parametrat për vlerësimin e diturive të tyre.

VIII. Vrojtimet

Në **gjimnazin e përgjithshëm** është paraparë me program edhe një pjesë e lëndës së astronomisë, sepse nxënësit këtë lëndë nuk e dëgjojnë si në dy gjimnazet e tjera si lëndë të veçantë. Arsimtarët e këtij gjimnazi duhet të organizojnë vrojtme në sferë qiellore në çfarëdo kohe kur qielli është i hapur dhe mundësojnë kushtet klimatike. Nxënësit me kënaqësi e preferojnë vrojtimin qiellor dhe njohjen e objekteve qiellore. Në bazë të aktivitetit në vrojtim arsimtarët do të vlerësojnë diturinë e nxënësit. Preferohet që vrojtmet të kryhen veçanërisht gjatë fundit të dimrit dhe në pranverën e hershme sepse atëherë objektet qiellore që shihen janë më atraktive.

Vlerësimi i përgjithshëm i njohurive të fituara të nxënësve do të mbështetet në këto tetë pika të cekura më lart.

KIMIA

**Gjimnazi i shkencave natyrore
(3 orë në javë, 99 orë në vit)**

HYRJE

Në këtë klasë do të përfshihen përmbajtjet nga kimia e komponimeve të karbonit. Konkretisht do të shtjellohen hidrokarburet, komponimet organike me oksigjen, me azot dhe ato me rëndësi të veçantë për jetë.

QËLLIMET

Nxënësit të:

- Zhvillojnë njohuritë për komponimet e karbonit dhe vetitë karakteristike të tyre përmes qasjeve të ndryshme të hulumtimit të problemeve, aktiviteteve të ndryshme dhe punëve eksperimentale.
- Vlerësojnë shumëllojshmërinë dhe rëndësinë fundamentale e praktike të komponimeve të karbonit si pjesë e jetës sonë, të cilat kanë rol të rëndësishëm në cilësinë e jetës.
- Zhvillojnë dhe të kultivojnë shprehitë dhe shkathtësitë për punë të pavarur teorike, eksperimentale e praktike dhe të krijojnë kulturën për mbrojtjen e mjedisit.
- Formohen në rrafshin teoriko-praktik si personalitet me qëndrim autonom, kritik dhe me kulturë për bashkëpunim të ndërsjelltë, me arsimtarë, prindër dhe komunitet shkollor dhe jashtëshkollor për avancimin e të menduarit kritik e të pavarur të veprimtarisë dhe funksionit të shkollës.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË:

Nxënësit duhet:

Të njohin:

- Vetitë e karbonit dhe të komponimeve të tij.
- Metodatat e përfitimt dhe të përdorimit të komponimeve organike

Të kuptojnë:

- Parimet dhe ligjshmëritë në bazë të të cilave zhvillohen reaksionet organike.
- Formulatat e komponimeve të thjeshta dhe të përbëra organike.

Të zbatojnë:

- Rregullat e Unionit Ndërkombëtar për Kimi të Pastër dhe të Zbatuar (IUPAC, UNKPZ) për emërtimin e komponimeve organike.
- Ndërtimin e modeleve molekulare për paraqitjen e strukturës së komponimeve organike.

Të analizojnë:

- Vetitë fizike dhe kimike të elementeve dhe të komponimeve organike.
- Shndërrimet kimike dhe mekanizmin e zhvillimit të reaksioneve organike.

Të sintetizojnë:

- Komponimet e thjeshta organike.
- Komponimet organike me përdorim në jetën e përditshme.

Të vlerësojnë:

- Përdorimin e komponimeve organike për nevojat industriale dhe jetësore.
- Rëndësinë e komponimeve organike për proceset jetësore në organizëm.
- Efektet eventuale negative të disa komponimeve organike për mjedisin dhe ruajtjen e tij.

PËRMBAJTJA PROGRAMORE			
<i>Kategoritë</i>	<i>Nënkategoritë</i>	<i>Numri i orëve</i>	<i>%</i>
I. Komponimet e karbonit	1. Hidrokarburet	30	
	2. Komponimet organike me oksigjen	32	
	3. Komponimet organike me azot	27	
	4. Polimerët	10	

<i>Kategoria</i>	<i>Nënkategoria</i>	<i>Përmbajtja programore</i>	<i>Rezultatet e pritshme</i>	<i>Lidhjet ndërlëndore</i>
I. Komponimet e karbonit	I. 1. Hidrokarburet	<p>I. 1. 1. Ndërtimi i atomit të karbonit-hibridizimi (konfiguracioni elektronik, hibridizimi sp^3, sp^2 dhe sp)</p> <p>I. 1. 2. Lidhjet kimike në komponimet organike (lidhjet kovalente, lidhjet në vargje karbonike dhe në cikle)</p> <p>I. 1. 3. Veçoritë e komponimeve organike dhe klasifikimi i tyre (konstantat fizike dhe vetitë e tjera, klasifikimi sipas strukturës dhe grupeve funksionore)</p> <p>I. 1. 4. Izomeria e komponimeve</p>	<p><i>Nxënësit do të jenë në gjendje:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> Të përshkruajnë strukturën elektronike të atomit të karbonit. Të përshkruajnë llojet e lidhjeve kimike në komponimet e karbonit Të dallojnë komponimet organike nga ato inorganike sipas vetive të tyre fizike e kimike. Të klasifikojnë komponimet organike në bazë të elementeve përbërëse. Të klasifikojnë komponimet organike në bazë 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fizikë (vetitë fizike të komponimeve organike, caktimi i konstantave fizike.) ▪ Informatikë (shfrytëzimi i informatave nga interneti për hidrokarbure) ▪ Industri

	<p>organike Stereoizomerët dhe aktiviteti optik (izomeria strukturale, gjeometrike dhe optike) I. 1. 5. Llojet e reaksioneve të komponimeve organike (reaksionet e substituimit, eliminimit, adiconimit, reaksionet homolitike dhe heterolitike) I. 1. 6. Klasifikimi i hidrokarbureve (hidrokarburet e ngopura dhe të pangopura) I. 1. 7. Alkanet (struktura, klasifikimi, emërtimi, vetitë, përfitimi, përdorimi, reaksionet) I. 1. 8. Alkenet (struktura, klasifikimi, emërtimi, vetitë, përfitimi, polimerizimi dhe reaksionet e tjera) I. 1. 9. Alkinet dhe dienët (struktura, klasifikimi, emërtimi, vetitë, përfitimi, reaksionet) I. 1. 10. Hidrokarburet aromatike (struktura, emërtimi, vetitë, përfitimi, reaksionet) I. 1. 11. Derivatet halogjene të hidrokarbureve (struktura, emërtimi, vetitë, përfitimi, reaksionet)</p>	<p>të grupeve funksionore.</p> <p>6. Të dallojnë izomerinë strukturale, gjeometrike dhe optike.</p> <p>7. Të analizojnë strukturën e komponimeve me aktivitet optik.</p> <p>8. Të dallojnë llojet e reaksioneve të komponimeve organike</p> <p>9. Të klasifikojnë hidrokarburet sipas vetive të tyre dhe sipas strukturës së vargut karbonik.</p> <p>10. Të emërtojnë hidrokarburet sipas nomenklaturës “IUPAC”</p> <p>11. Të sintetizojnë hidrokarburet dhe të vlerësojnë rëndësinë dhe përdorimin e tyre.</p>	<p>(përdorimi i hidrokarbureve në industri)</p>
--	--	---	---

<p>I. Komponentet e karbonit</p>	<p>I. 2. Komponentet organike me oksigjen</p>	<p>I. 2. 1. Alkoolet (struktura, klasifikimi, emërtimi, vetitë, përfitimi, reaksionet)</p> <p>I. 2. 2. Fenolet (fenoli dhe derivatet e tij, vetitë, reaksionet)</p> <p>I. 2. 3. Eteret (struktura, emërtimi, vetitë)</p> <p>I. 2. 4. Aldehidet dhe ketonet (struktura, emërtimi, përfitimi, reaksionet)</p> <p>I. 2. 5. Acidet karboksilike dhe derivatet e tyre (struktura, emërtimi, klasifikimi, vetitë, reaksionet, derivatet)</p> <p>I. 2. 6. Esteret dhe lipidet (vetitë, reaksionet, klasifikimi i lipideve, vetitë e lipideve, përdorimi)</p> <p>I. 2. 7. Sapunët dhe deterxhentet (Përfitimi, vetitë, klasifikimi, përdorimi)</p> <p>I. 2. 8. Karbohidratet dhe</p>	<p>Nxënësit do të jenë në gjendje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të paraqesin alkoolet me ndihmën e formulave strukturale. 2. Të dallojnë alkoolet sipas strukturës së vargut karbonik. 3. Të klasifikojnë alkoolet sipas numrit të grupeve hidroksile. 4. Të përshkruajnë vetitë fizike të alkooleve 5. Të emërtojnë alkoolet në bazë të nomenklaturës "IUPAC". 6. Të sintetizojnë alkoolet nga substancat e tjera organike. 7. Të paraqesin reaksionet e oksidimit, dehidratimit dhe substituitimit të alkooleve. 8. Të paraqesin strukturën e fenoleve. 9. Të dallojnë fenolet nga alkoolet në bazë të vetive të tyre. 10. Të përshkruajnë vetitë dhe reaksionet karakteristike të fenoleve. 11. Të paraqesin eteret me ndihmën e formulave strukturale. 12. Të emërtojnë eteret sipas nomenklaturës "IUPAC". 13. Të përshkruajnë vetitë dhe reaksionet e etereve. 14. Të dallojnë aldehidet nga ketonet në bazë të strukturës së tyre. 15. Të emërtojnë aldehidet dhe ketonet sipas nomenklaturës "IUPAC". 16. Të përshkruajnë strukturën e acideve 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fizikë (vetitë fizike të komponimeve organike me oksigjen, ▪ Informatikë (shfrytëzimi i informatave nga interneti për komponimet organike me oksigjen) ▪ Biologji (përhapja dhe funksioni i komponimeve organike me oksigjen në organizmat e gjallë) ▪ Industri (prodhimi dhe përdorimi i komponimeve organike me oksigjen në industri
---	--	--	--	---

		<p>klasifikimi i tyre (struktura, klasifikimi, stereozomerët)</p> <p>I. 2. 9. Monosakaridet (klasifikimi, vetitë, reaksionet)</p> <p>I. 2. 10. Disakaridet (struktura, vetitë, përdorimi)</p> <p>I. 2. 11. Polisakaridet (amidoni, celuloza, glikogjeni, struktura, vetitë, përhapja, përdorimi)</p>	<p>karboksilike dhe derivateve të tyre.</p> <p>17. Të emërtojnë acidet karboksilike dhe derivatet e tyre sipas nomenklaturës klasike dhe “IUPAC”.</p> <p>18. Të klasifikojnë acidet karboksilike sipas numrit të grupeve funksionore.</p> <p>19. Të paraqesin strukturën e karbohidrateve me formula të Fisherit dhe ato ciklike.</p> <p>20. Të klasifikojnë karbohidratet në bazë të vargut karbonik dhe numrit të njësive përbërëse.</p> <p>21. Të dallojnë stereozomerët e karbohidrateve dhe të paraqesin ata me formula strukturale dhe me modele molekulare.</p> <p>22. Të përshkruajnë vetitë e karbohidrateve dhe reaksionet e tyre.</p> <p>23. Të paraqesin strukturën e disakarideve dhe të polisakarideve me formula kimike dhe modeleve molekulare.</p> <p>24. Të dallojnë sheqernat reduktues dhe joreduktues, në bazë të vetive të tyre.</p>	
I. Komponentet e karbonit	I. 3. Komponentet organike me azot	<p>I. 3. 1. Nitrokomponimet (struktura, emërtimi, përfitimi, vetitë)</p> <p>I. 3. 2. Aminat (struktura, emërtimi, klasifikimi, vetitë)</p>	<p><i>Nxënësit do të jenë në gjendje:</i></p> <p>1. Të paraqesin nitrokomponimet me ndihmën e formulave strukturale.</p> <p>2. Të përshkruajnë vetitë fizike të nitrokomponimeve</p> <p>3. Të emërtojnë nitrokomponimet në bazë të nomenklaturës “IUPAC”.</p> <p>4. Të paraqesin reaksionet e reduktimit të</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fizikë (vetitë fizike të komponimeve organike me azot, ▪ Informatikë (shfrytëzimi i informatave

		<p>I. 3. 3. Komponimet heterociklike (struktura, emërtimi, vetitë)</p> <p>I. 3. 4. Alkaloidet dhe vitaminat (struktura, vetitë e përgjithshme, veprimi fiziologjik në organizëm)</p> <p>I. 3. 5. Aminoacidet dhe proteinat (struktura, emërtimi, klasifikimi, vetitë, reaksionet, veprimi fiziologjik në organizëm)</p> <p>I. 3. 6. Acidet nukleike (struktura, klasifikimi, veprimi fiziologjik në organizëm)</p> <p>I. 3. 7. Enzimet (vetitë, klasifikimi, veprimi katalitik në organizëm)</p>	<p>nitrokomponimeve.</p> <p>5. Të paraqesin aminat me formula strukturale.</p> <p>6. Të klasifikojnë aminat sipas strukturës së tyre.</p> <p>7. Të emërtojnë aminat sipas nomenklaturës “IUPAC”.</p> <p>8. Të përshkruajnë vetitë dhe reaksionet karakteristike të aminave.</p> <p>9. Të klasifikojnë alkaloidet sipas veprimit të tyre.</p> <p>10. Të përshkruajnë veprimin fiziologjik të alkaloidëve në organizëm.</p> <p>11. Të vlerësojnë rëndësinë e alkaloidëve dhe vitaminave për funksionimin normal të organizmit dhe për mbrojtjen e tij.</p> <p>12. Të përshkruajnë strukturën e aminoacideve dhe proteinave.</p> <p>13. Të klasifikojnë aminoacidet sipas pozitës së grupeve funksionore.</p> <p>14. Të përshkruajnë strukturën parësore, dytësore, tretësore dhe kuaternere të proteinave.</p> <p>15. Të vlerësojnë rëndësinë e proteinave për zhvillimin e proceseve jetësore.</p> <p>16. Të përshkruajnë strukturën e ADN-së me modele (ose skicime) të thjeshta.</p> <p>17. Të vlerësojnë rëndësinë e ADN-së për bartjen e vetive trashëguese.</p> <p>18. Të përshkruajnë funksionin katalitik të enzimeve.</p> <p>19. Të klasifikojnë enzimet sipas veprimit të tyre</p>	<p>nga interneti për komponimet organike me azot)</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Biologji (funksioni i komponimeve organike me azot në organizmat e gjallë) ▪ Industri (prodhimi dhe përdorimi i alkaloidëve dhe vitaminave.
--	--	---	--	--

			<p>katalitik.</p> <p>20. Të numërojnë faktorët që ndikojnë në veprimin katalitik të enzimeve.</p> <p>21. Të vlerësojnë funksionin e enzimeve në proceset jetësore.</p>	
I. Komponimet e karbonit	I. 4. Polimerët sintetikë	<p>I. 4. 1. Plastmasat (struktura, përfitimi, vetitë, përdorimi)</p> <p>I. 4. 2. Fijet sintetike (struktura, përfitimi, vetitë, përdorimi)</p> <p>I. 4. 3. Zbatimi i polimerëve (përdorimi i polimerëve sintetikë në industri dhe në jetën e përditshme)</p>	<p><i>Nxënësit do të jenë në gjendje:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të paraqesin polimerët me ndihmën e formulave strukturale. 2. Të përshkruajnë përdorimin e polimerëve sintetikë. 3. Të paraqesin reaksionet e polimerizimit dhe të polikondensimit. 4. Të dallojnë plastmasat sipas përbërjes dhe vetive të tyre. 5. Të identifikojnë fijet sintetike dhe metodat e përfitimit të tyre 6. Të vlerësojnë rëndësinë e polimerëve sintetikë për prosperitetin e përgjithshëm. 7. Të vlerësojnë ndikimin e produkteve polimere në ndotjen e mjedisit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fizikë (vetitë fizike të polimerëve sintetikë, ▪ Informatikë (shfrytëzimi i informatave nga interneti për polimerët sintetikë) ▪ Industri (prodhimi dhe përdorimi i produkteve polimere. ▪ Ekologji (ndikimi i polimerëve në ndotjen e mjedisit)

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për realizimin me sukses të Planit dhe programit të kimisë është e domosdoshme të zbatohen metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks të tërë procedurash (informacion i ri, përsëritje, përforsim, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike, mjete materiale teknike siç janë: vizatime, diagrame, modele, grafikë, kimikate, enë laboratorike, instrumente dhe mjete të tjera teknike bashkëkohore, kompjuter etj).

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimitdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe me kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, nga se nxitin dinamikën e orës, thyejnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat, teknikat dhe format e punës me nxënës janë po aq të shumëllojta sa edhe llojet e mësimnxënies. Ato duhet të jenë në funksion të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore dhe zbatimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, shprehive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të kimisë e veçanërisht të atyre që nevojiten për zgjidhjen e problemeve të përditshme.

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore sugjerohen disa metoda, forma të punës dhe teknika të ndryshme:

- Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (përmes shpjegimit, sqarimit, ushtrimeve praktike dhe shembujve);
- Mësimdhënie e tërthortë (përmes shqyrtimit, zbulimit, zgjidhjes së problemeve)
- Konstruktivizmi dhe mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënësve në bashkëpunim (përmes grupeve të vogla, grupeve më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie përmes të menduarit (të menduarit kritik, krijues, zgjidhjes së problemeve me kompjuter);
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes demonstrimit dhe eksperimentit;

- Të mësuarit dhe të nxënësve përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Vetëhulumtimi;
- Të mësuarit në natyrë dhe objekte industriale;

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritshme.

VLERËSIMI

Vlerësimi është veprimtari dhe instrument që përdoret për të gjykuar për punën dhe arritjet e nxënësve. Ai luan rolin e një aparati matës që bën të qartë situatën në të cilën ndodhet nxënësi. Vlerësimi si një sistem i gjerë që mbështetet në procesin e të nxënësve përfshin këto kategori vlerësimi:

- formues
- diagnostikues
- përmbledhës dhe
- motivues

Vlerësimi i vazhdueshëm pas çdo temë mësimore jep rezultate më të mira. Ai nuk mat vetëm njohuritë e fituara, por edhe vlerëson shkallën në të cilën ka arritur një veprim edukativ, i cili lë gjurmë në personalitetin e nxënësit. Vlerësimi përfundimtar përfshin aktivitetin e përgjithshëm të të nxënësve e nxënësit (përgjigjet me gojë, projektet, punimet seminarike, sjelljet në grup, aftësitë që i fitojnë gjatë punës eksperimentale, detyrat e shtëpisë, rezultatet e testimeve dhe provimeve etj.).

Vlerësimi i nxënësve përfshin tri fusha kryesore:

- aftësitë njohëse (kognitive);
- aftësitë emocionale (afektive) dhe
- aftësitë psikomotorike.

Mësimdhënësi përzgjedh dhe përdor mjete e teknika të shumëllojta vlerësimi dhe pas zhvillimit të përmbajtjeve të programit, nxënësit

vlerësohen me nota (për një temë, për një tërësi temash, për një semestër ose gjysmëvjetor dhe në fund të vitit shkollor). Vlerësimi duhet të jetë transparent ndaj nxënësve, prindërve, administratorëve të arsimit dhe komunitetit.

Përfundimet e vlerësimi i shërbejnë mësimdhënësit për arritjen e qëllimeve të ndryshme:

1. Të sigurojë informacione rreth përparimit të nxënësve;
2. T'u sigurojë nxënësve informacion mësimit;
3. Për motivimin e nxënësve;
4. Të shënojnë përparimin e nxënësve;
5. Të sigurojë realizimin e objektivave aktualë;
6. Të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen;
7. Të reflektojnë për përmirësimin e mësimdhënies bazuar në vlerësimin e të tjerëve dhe në vetëvlerësim.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Që të realizohet me sukses mësimdhënia dhe mësimnxënia e Planit dhe programit të kimisë, mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burime dhe mjete të ndryshme informimi:

- 1) Laboratori (kabineti) i kimisë ose laborator mobil.
- 2) Teksti i kimisë, doracak për mësimdhënësin, praktikume, fletore pune dhe libra të tjerë të ngjashëm në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaja.
- 3) Revista profesionale dhe shkencore, fjalorë, enciklopedi.
- 4) Sistem periodik të elementeve, fotografi, modele, skema, diagrame, makete, koleksionar të mineraleve.
- 5) Pajisje multimediale (programe të kompjuterëve, interneti, CD).
- 6) Aparat TV me videorekorder, grafoskop, fotoslajde, videokaseta që përmbajnë materiale të ndryshme shkencore me interes për nxënësit.
- 7) FJALORI I KIMISË, SH.B. '8 Nëntori' Tiranë.

- 8) Bardhyl Musai, METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES, Tiranë, 2003.
- 9) Grup autorësh, METODAT E MËSIMDHËNIES, (Manual për mësuesit e rinj).
- 10) Literatura tjetër e nevojshme që ekziston në biblioteka dhe mjetet e tjera që gjenden në treg.

Është kompetencë dhe liri e mësimit që në vartësi nga kushtet në të cilat punon shkolla, të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave eksperimentale, gojore, vizuale, e me theks të veçantë në atë që është qenësore për të mësuar. Kjo përzgjedhje gjithnjë duhet të bëhet duke e ruajtur dhe duke e ngritur nivelin e cilësisë së mësimit dhe të mësimit.

Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësimore duhet t'i takojë edhe nxënësit.

KIMIA

Gjimnazi i përgjithshëm
(2 orë në javë, 74 orë në vit)

HYRJE

Lënda kimia 12, paraqet vazhdimësi të lëndës që është trajtuar në kiminë 10 dhe 11. Në këtë klasë do të përfshihen përmbajtjet nga Kimia e komponimeve të karbonit. Konkretisht do të shtjellohen hidrokarburet, komponimet organike me oksigjen, me azot dhe ato me rëndësi të veçantë për jetë.

QËLLIMET

Nxënësit të:

- Zhvillojnë njohuritë për komponimet e karbonit dhe vetitë karakteristike të tyre përmes qasjeve të ndryshme të hulumtimit të problemeve, aktiviteteve të ndryshme dhe punëve eksperimentale.
- Vlerësojnë shumëllojshmërinë dhe rëndësinë fundamentale e praktike të komponimeve të karbonit si pjesë e jetës sonë, të cilat kanë rol të rëndësishëm në cilësinë e jetës.
- Zhvillojnë dhe të kultivojnë shprehitë dhe shkathtësitë për punë të pavarur teorike, eksperimentale e praktike dhe të krijojnë kulturën për mbrojtjen e mjedisit.
- Formohen në rrafshin teoriko-praktik si personalitet me qëndrim autonom, kritik dhe me kulturë për bashkëpunim të ndërsjelltë, me arsimtarë, prindër dhe komunitet shkollor dhe jashtëshkollor për avancimin e të menduarit kritik dhe të pavarur të veprimtarisë dhe të funksionit të shkollës.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësit duhet:

Të njohin:

- Vetitë e karbonit dhe të komponimeve të tij.
- Metodatat e përfutimit dhe përdorimit të komponimeve organike.

Të kuptojnë:

- Parimet dhe ligjshmëritë në bazë të të cilave zhvillohen reaksionet organike.
- Formulatat e komponimeve të thjeshta dhe të përbëra organike.

Të zbatojnë:

- Rregullat e Unionit Ndërkombëtar për Kimi të Pastër dhe të Zbatuar (IUPAC, UNKPZ) për emërtimin e komponimeve organike.
- Aplikimin e ndërtimit të modeleve molekulare për paraqitjen e strukturës së komponimeve organike.

Të analizojnë:

- Vetitë fizike dhe kimike të elementeve dhe të komponimeve organike.
- Shndërrimet kimike dhe mekanizmin e zhvillimit të reaksioneve organike.

Të sintetizojnë:

- Komponimet e thjeshta organike.
- Komponimet organike me përdorim në jetën e përditshme.

Të vlerësojnë:

- Përdorimin e komponimeve organike për nevojat industriale dhe jetësore.
- Rëndësinë e komponimeve organike për proceset jetësore në organizëm.
- Efektet eventuale negative të disa komponimeve organike për mjedisin dhe ruajtjen e tij.

PËRMBAJTJA PROGRAMORE			
<i>Kategoritë</i>	<i>Nënkategoritë</i>	<i>Numri i orëve</i>	<i>%</i>
I. Komponimet e karbonit	1. Hidrokarburet	23	
	2. Komponimet organike me oksigjen	24	
	3. Komponimet organike me azot	20	
	4. Polimeret	7	

<i>Kategoria</i>	<i>Nënkategoria</i>	<i>Përmbajtja programore</i>	<i>Rezultatet e pritshme</i>	<i>Lidhjet ndërlëndore</i>
I. Komponimet e karbonit	I. 1. Hidrokarburet	<p>I. 1. 1. Ndërtimi i atomit të karbonit-hibridizimi (konfiguracioni elektronik, hibridizimi sp^3, sp^2 dhe sp)</p> <p>I. 1. 2. Lidhjet kimike në komponimet organike (lidhjet kovalente, lidhjet në vargje karbonike dhe në cikle)</p> <p>I. 1. 3. Veçoritë e komponimeve organike dhe klasifikimi i tyre (konstantet fizike dhe vetitë tjera, klasifikimi sipas strukturës dhe grupeve funksionore)</p> <p>I. 1. 4. Izomeria e komponimeve</p>	<p><i>Nxënësit do të jenë në gjendje:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> Të paraqesin konfiguracionin elektronik të atomit të karbonit. Të përshkruajnë llojet e lidhjeve kimike në komponimet e karbonit Të dallojnë komponimet organike nga ato inorganike sipas vetive të tyre fizike e kimike. Të klasifikojnë komponimet organike në bazë të elementeve përbërëse. Të klasifikojnë komponimet organike në bazë të grupeve funksionore. Të paraqesin izomerinë strukturore, gjeometrike dhe optike. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fizikë (vetitë fizike të komponimeve organike, caktimi i konstanteve fizike.) ▪ Informatikë (shfrytëzimi i informatave nga interneti për hidrokarbure) ▪ Industri (përdorimi i

		<p>organike Stereoizomerët dhe aktiviteti optik (izomeria strukturore, gjeometrike dhe optike) I. 1. 5. Llojet e reaksioneve të komponimeve organike (reaksionet e substituimit, eliminimit, adiconimit, reaksionet homolitike dhe heterolitike) I. 1. 6. Klasifikimi i hidrokarbureve (hidrokarburet e ngopura dhe të pangopura) I. 1. 7. Alkanet (struktura, klasifikimi, emërtimi, vetitë, përftimi, përdorimi, reaksionet) I. 1. 8. Alkenet (struktura, klasifikimi, emërtimi, vetitë, përftimi, polimerizimi dhe reaksionet e tjera) I. 1. 9. Alkinet dhe dienët (struktura, klasifikimi, emërtimi, vetitë, përftimi, reaksionet) I. 1. 10. Hidrokarburet aromatike (struktura, emërtimi, vetitë, përftimi, reaksionet) I. 1. 11. Derivatet halogjene të hidrokarbureve (struktura, emërtimi, vetitë, përftimi, reaksionet)</p>	<p>7. Të identifikojnë komponimet me aktivitet optik. 8. Të numërojnë llojet e reaksioneve të komponimeve organike. 9. Të klasifikojnë hidrokarburet sipas vetive të tyre dhe sipas strukturës së vargut karbonik. 10. Të emërtojnë hidrokarburet sipas nomenklaturës "IUPAC" 11. Të sintetizojnë hidrokarburet dhe të vlerësojnë rëndësinë dhe përdorimin e tyre. 12. Të analizojnë përbërjen e alkilhalogjenureve dhe përdorimin e tyre.</p>	<p>hidrokarbureve në industri)</p>
--	--	---	---	------------------------------------

<p>I. Komponentet e karbonit</p>	<p>I. 2. Komponentet organike me oksigjen</p>	<p>I. 2. 1. Alkoolet (struktura, klasifikimi, emërtimi, vetitë, përftimi, reaksionet)</p> <p>I. 2. 2. Fenolet (fenoli dhe derivatet e tij, vetitë, reaksionet)</p> <p>I. 2. 3. Eteret (struktura, emërtimi, vetitë)</p> <p>I. 2. 4. Aldehidet dhe ketonet (struktura, emërtimi, përftimi, reaksionet)</p> <p>I. 2. 5. Acidet karboksilike dhe derivatet e tyre (struktura, emërtimi, klasifikimi, vetitë, reaksionet, derivatet)</p> <p>I. 2. 6. Esteret dhe lipidet (vetitë, reaksionet, klasifikimi i lipideve, vetitë e lipideve, përdorimi)</p> <p>I. 2. 7. Sapunet dhe deterxhentet (përftimi, vetitë, klasifikimi, përdorimi)</p> <p>I. 2. 8. Karbohidratet dhe klasifikimi i tyre</p>	<p>Nxënësit do të jenë në gjendje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të paraqesin alkoolet me ndihmën e formulave strukturore. 2. Të dallojnë alkoolet sipas strukturës së vargut karbonik. 3. Të numërojnë llojet e alkooleve sipas numrit të grupeve hidroksile. 4. Të përshkruajnë vetitë fizike të alkooleve. 5. Të emërtojnë alkoolet në bazë të nomenklaturës "IUPAC". 6. Të sintetizojnë alkoolet nga substancat e tjera organike. 7. Të paraqesin reaksionet e oksidimit, dehidratimit dhe substituimit të alkooleve. 8. Të paraqesin strukturën e fenoleve. 9. Të dallojnë fenolet nga alkoolet në bazë të vetive të tyre. 10. Të përshkruajnë vetitë dhe reaksionet karakteristike të fenoleve. 11. Të paraqesin eteret me ndihmën e formulave struktore. 12. Të emërtojnë eteret sipas nomenklaturës "IUPAC". 13. Të përshkruajnë vetitë dhe reaksionet e etereve. 14. Të dallojnë aldehidet nga ketonet në bazë të strukturës së tyre. 15. Të emërtojnë aldehidet dhe ketonet sipas nomenklaturës "IUPAC". 16. Të paraqesin acidet karboksilike dhe 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fizikë (vetitë fizike të komponimeve organike me oksigjen, ▪ Informatikë (shfrytëzimi i informatave nga interneti për komponimet organike me oksigjen) ▪ Biologji (përhapja dhe funksioni i komponimeve organike me oksigjen në organizmat e gjallë) ▪ Industri (prodhimi dhe përdorimi i komponimeve organike me oksigjen në industri)
---	--	--	--	--

		<p>(struktura, klasifikimi, stereoizomeret)</p> <p>I. 2. 9. Monosakaridet (klasifikimi, vetitë, reaksionet)</p> <p>I. 2. 10. Disakaridet (struktura, vetitë, përdorimi)</p> <p>I. 2. 11. Polisakaridet (amidoni, celuloza, glikogjeni, struktura, vetitë, përhapja, përdorimi)</p>	<p>derivatet e tyre me ndihmën e formulave strukturore.</p> <p>17. Të emërtojnë acidet karboksilike dhe derivatet e tyre sipas nomenklaturës klasike dhe “IUPAC”.</p> <p>18. Të klasifikojnë acidet karboksilike sipas numrit të grupeve funksionore.</p> <p>19. Të paraqesin strukturën e karbohidrateve me formula të Fisherit dhe ato ciklike.</p> <p>20. Të klasifikojnë karbohidratet në bazë të vargut karbonik dhe numrit të njësive përbërëse.</p> <p>21. Të paraqesin stereoizomeret e karbohidrateve me formula strukturore dhe me modele molekulare.</p> <p>22. Të përshkruajnë vetitë e karbohidrateve dhe reaksionet e tyre.</p> <p>23. Të paraqesin strukturën e disakarideve dhe të polisakarideve, me formula strukturore dhe me modele molekulare.</p> <p>24. Të dallojnë sheqernat reduktuese dhe joreduktuese sipas strukturës dhe reaksioneve të tyre.</p>	
I. Komponimet e karbonit	I. 3. Komponimet organike me azot	<p>I. 3. 1. Nitrokomponimet (struktura, emërtimi, përfitimi, vetitë)</p> <p>I. 3. 2. Aminat (struktura, emërtimi, klasifikimi,</p>	<p><i>Nxënësit do të jenë në gjendje:</i></p> <p>1. Të paraqesin nitrokomponimet me ndihmën e formulave strukturore.</p> <p>2. Të emërtojnë nitrokomponimet në bazë të nomenklaturës “IUPAC”.</p> <p>3. Të paraqesin reaksionet e reduktimit të</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fizikë (vetitë fizike të komponimeve organike me azot) ▪ Informatikë

		<p>vetitë)</p> <p>I. 3. 3. Komponentet heterociklike (struktura, emërtimi, vetitë)</p> <p>I. 3. 4. Aminoacidet dhe proteinat (struktura, emërtimi, klasifikimi, vetitë, reaksionet, veprimi fiziologjik në organizëm)</p> <p>I. 3. 5. Acidet nukleike (struktura, klasifikimi, veprimi fiziologjik në organizëm)</p> <p>I. 3. 6. Alkaloidet dhe vitaminat (struktura, vetitë e përgjithshme, veprimi fiziologjik në organizëm)</p> <p>I. 3. 7. Enzimet (vetitë, klasifikimi, veprimi katalitik në organizëm)</p>	<p>nitrokomponimeve.</p> <p>4. Të paraqesin aminat me formula strukturore.</p> <p>5. Të klasifikojnë aminat sipas strukturës së tyre.</p> <p>6. Të emërtojnë aminat sipas nomenklaturës “IUPAC”.</p> <p>7. Të përshkruajnë vetitë dhe reaksionet karakteristike të aminave.</p> <p>8. Të përshkruajnë strukturën e aminoacideve dhe të proteinave.</p> <p>9. Të klasifikojnë aminoacidet në bazë të pozitës së grupeve funksionore.</p> <p>10. Të paraqesin strukturën primare, sekondare, terciare dhe kuaternere të proteinave në shembuj të thjeshtë.</p> <p>11. Të vlerësojnë rëndësinë e proteinave për zhvillimin e proceseve jetësore.</p> <p>12. Të përshkruajnë strukturën e ADN-së me modele (ose skicime) të thjeshta.</p> <p>13. Të vlerësojnë rëndësinë e ADN-së për bartjen e vetive trashëguese.</p> <p>14. Të klasifikojnë alkaloidet sipas veprimit të tyre.</p> <p>15. Të përshkruajnë veprimin fiziologjik të alkaloidëve në organizëm.</p> <p>16. Të vlerësojnë rëndësinë e alkaloidëve dhe vitaminave për funksionimin normal të organizmit dhe për mbrojtjen e tij.</p> <p>17. Të përshkruajnë funksionin katalitik të enzimeve.</p> <p>18. Të klasifikojnë enzimet sipas veprimit të tyre</p>	<p>(shfrytëzimi i informatave nga interneti për komponentet organike me azot)</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Biologji (funksioni i komponimeve organike me azot në organizmat e gjallë) ▪ Industri (prodhimi dhe përdorimi i alkaloidëve dhe vitaminave.
--	--	---	--	--

			<p>katalitik.</p> <p>19. Të numërojnë faktorët që ndikojnë në veprimin katalitik të enzimeve.</p> <p>20. Të vlerësojnë funksionin e enzimeve si biokatalizatorë në proceset jetësore.</p>	
I. Komponimet e karbonit	I. 4. Polimeret sintetike	<p>I. 4. 1. Plastmasat (struktura, përfitimi, vetitë, përdorimi)</p> <p>I. 4. 2. Fijet sintetike (struktura, përfitimi, vetitë, përdorimi)</p> <p>I. 4. 3. Zbatimi i polimereve (përdorimi i polimereve sintetike në industri dhe në jetën e përditshme)</p>	<p><i>Nxënësit do të jenë në gjendje:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të paraqesin polimeret me ndihmën e formulave strukturore. 2. Të përshkruajnë përdorimin e polimereve sintetike. 3. Të paraqesin reaksionet e polimerizimit dhe të polikondensimit. 4. Të dallojnë plastmasat sipas përbërjes dhe vetive të tyre. 5. Të identifikojnë fijet sintetike dhe metodat e përfitimit të tyre 6. Të vlerësojnë rëndësinë e polimereve sintetike për prosperitetin e përgjithshëm. 7. Të vlerësojnë ndikimin e produkteve polimere në ndotjen e mjedisit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fizikë (vetitë fizike të polimereve sintetike, ▪ Informatikë (shfrytëzimi i informatave nga interneti për polimeret sintetike) ▪ Industri (prodhimi dhe përdorimi i produkteve polimere). ▪ Ekologji (ndikimi i polimereve në ndotjen e mjedisit)

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për realizimin me sukses të planit dhe programit të kimisë është e domosdoshme të zbatohen metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks të tërë procedurash (informacion i ri, përsëritje, përforcim, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike, mjete materiale teknike, siç janë: vizatime, diagrame, modele, grafikone, kimikate, enë laboratorike, instrumente dhe mjete të tjera teknike bashkëkohore, kompjuter etj).

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimit të nxënësve të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, ngase nxitin dinamikën e orës, thyejnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat, teknikat dhe format e punës me nxënës janë po aq të shumëllojta sa edhe llojet e mësimnxënies. Ato duhet të jenë në funksion të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore dhe zbatimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, shprehive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të kimisë e veçanërisht të atyre që u nevojiten për zgjedhjen e problemeve të përditshme.

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma të punës dhe teknika të ndryshme:

- Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (përmes shpjegimit, sqarimit, ushtrimeve praktike dhe shembujve);
- Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (përmes shqyrtimit, zbulimit, zgjidhjes së problemeve);
- Konstruktivizmi dhe mësimdhënia përmes pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënësve në bashkëpunim (përmes grupeve të vogla, grupeve më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie përmes të menduarit (të menduarit kritik, krijues, zgjidhjes së problemeve me kompjuter);
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes demonstrimit dhe eksperimentit;

- Të mësuarit dhe të nxënësve përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Vetë hulumtimi;
- Të mësuarit në natyrë dhe në objekte industriale;

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo i teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatese didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritura.

VLERËSIMI

Vlerësimi është veprimtari dhe instrument që përdoret për të gjykuar për punën dhe arritjet e nxënësve. Ai luan rolin e një aparati matës që bën të qartë situatën në të cilën ndodhet nxënësi. Vlerësimi si një sistem i gjerë që mbështetet në procesin e të nxënësve përfshin këto kategori të vlerësimit:

- formues
- diagnostikues
- përmbledhës dhe
- motivues

Vlerësimi i vazhdueshëm pas çdo teme mësimore jep rezultate më të mira. Ai nuk mat vetëm njohuritë e fituara, por edhe vlerëson shkallën në të cilën ka arritur një veprim edukativ i cili lë gjurmë në personalitetin e nxënësit. Vlerësimi përfundimtar përfshin aktivitetin e përgjithshëm të të nxënësve të nxënësve (përgjigjet me gojë, projektet, punimet seminarike, sjelljet në grup, aftësitë që i fitojnë gjatë punës eksperimentale, detyrat e shtëpisë, rezultatet e testeve dhe provimeve etj.).

Vlerësimi i nxënësve përfshinë tri fusha kryesore:

- aftësitë njohëse (kognitive);
- aftësitë emocionale (afektive) dhe
- aftësitë psikomotorike.

Mësimdhënësi përzgjedh dhe përdor mjete e teknika të shumëllojta të vlerësimit dhe pas zhvillimit të përmbajtjeve të programit nxënësit

vlerësohen me nota (për një temë, për një tërësi temash, për një semestër ose gjysmëvjetor dhe në fund të vitit shkollor). Vlerësimi duhet të jetë transparent ndaj nxënësve, prindërve, administratorëve të arsimit dhe komunitetit.

Përfundimet e vlerësimi i shërbejnë mësimdhënësit për arritjen e qëllimeve të ndryshme:

1. Të sigurojë informacione rreth përparimit të nxënësve;
2. T'u sigurojë nxënësve informacion mësimor;
3. Për motivimin e nxënësve;
4. Të shënojnë përparimin e nxënësve;
5. Të sigurojë realizimin e objektivave aktualë;
6. Të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen;
7. Të reflektojnë për përmirësimin e mësimdhënies, bazuar në vlerësimin e të tjerëve dhe në vetëvlerësim.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Që të realizohet me sukses mësimdhënia dhe mësimnxënia e planit dhe programit të kimisë, mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burime dhe mjete të ndryshme të informimi:

- 1) Laboratori (kabineti) i kimisë ose laborator mobil.
- 2) Teksti i kimisë, doracak për mësimdhënë, praktikume, fletore pune dhe libra të tjerë të ngjashëm në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja.
- 3) Revista profesionale dhe shkencore, fjalorë, enciklopedi.
- 4) Sistemin periodik të elementeve, fotografi, modele, skema, diagrame, makete, koleksionarë të mineraleve.
- 5) Pajisje multimediale (programe të kompjuterëve, interneti, CD).
- 6) Aparat TV me videorekorder, grafoskop, fotoslajde, videokaseta që përmbajnë materiale të ndryshme shkencore me interes për nxënësit.
- 7) FJALORI I KIMISË, SH.B. ‘8 Nëntori’, Tiranë.

- 8) Bardhyl Musai, METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES, Tiranë, 2003.
- 9) Grup autorësh, METODAT E MËSIMDHËNIES (Manual për mësuesit e rinj).
- 10) Literatura tjetër e nevojshme që ekziston në biblioteka dhe mjetet e tjera që gjenden në treg.

Është kompetencë dhe liri e mësimit që, varësisht nga kushtet në të cilat punon shkolla, të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave eksperimentale, gojore, vizuale, e me theks të veçantë në atë që është qenësore për të mësuar. Kjo përzgjedhje gjithnjë duhet të bëhet duke e ruajtur dhe duke e ngritur nivelin e cilësisë së mësimit dhe të mësimit.

Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësimore duhet t'i takojë edhe nxënësit.

KIMIA

**Gjimnazi matematikë-informatikë
(2 orë në javë, 66 orë në vit)**

HYRJE

Në këtë klasë do të përfshihen përmbajtjet nga kimia e komponimeve të karbonit. Konkretisht do të shtjellohen hidrokarburet, komponimet organike me oksigjen, me azot dhe ato me rëndësi të veçantë për jetë.

QËLLIMET

Nxënësit të:

- Zhvillojnë njohuritë për komponimet e karbonit dhe vetitë karakteristike të tyre përmes qasjeve të ndryshme të hulumtimit të problemeve, aktiviteteve të ndryshme dhe punëve eksperimentale.
- Vlerësojnë shumëllojshmërinë dhe rëndësinë fundamentale e praktike të komponimeve të karbonit si pjesë e jetës sonë, të cilat kanë rol të rëndësishëm në cilësinë e jetës.
- Zhvillojnë dhe të kultivojnë shprehitë dhe shkathtësitë për punë të pavarur teorike, eksperimentale e praktike dhe të krijojnë kulturën për mbrojtjen e mjedisit.
- Formohen në rrafshin teoriko-praktik si personalitete me qëndrim autonom, kritik dhe me kulturë për bashkëpunim të ndërsjelltë, me arsimtarë, prindër dhe komunitet shkollor dhe jashtëshkollor për avancimin e të menduarit kritik dhe të pavarur të veprimtarisë dhe funksionit të shkollës.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësit duhet:

Të njohin:

- Vetitë e karbonit dhe komponimeve të tij.
- Metodatat e përfutimit dhe përdorimit të komponimeve organike.

Të kuptojnë:

- Parimet dhe ligjshmëritë në bazë të të cilave zhvillohen reaksionet organike.
- Formulatat e komponimeve të thjeshta dhe të përbëra organike

Të zbatojnë:

- Rregullat e Unionit Ndërkombëtar për Kimi të Pastër dhe të Zbatuar (IUPAC, UNKPZ) për emërtimin e komponimeve organike.
- Aplikimin e ndërtimit të modeleve molekulare për paraqitjen e strukturës së komponimeve organike.

Të analizojnë:

- Vetitë fizike dhe kimike të elementeve dhe të komponimeve organike.
- Shndërrimet kimike dhe mekanizmin e zhvillimit të reaksioneve organike.

Të sintetizojnë:

- Komponimet e thjeshta organike.
- Komponimet organike me përdorim në jetën e përditshme.

Të vlerësojnë:

- Përdorimin e komponimeve organike për nevojat industriale dhe jetësore.
- Rëndësinë e komponimeve organike për proceset jetësore në organizëm.
- Efektet eventuale negative të disa komponimeve organike për mjedisin dhe ruajtjen e tij.

PËRMBAJTJA PROGRAMORE			
<i>Kategoritë</i>	<i>Nënkategoritë</i>	<i>Numri i orëve</i>	<i>%</i>
I. Komponimet e karbonit	1. Hidrokarburet	20	
	2. Komponimet organike me oksigjen	21	
	3. Komponimet organike me azot	18	
	4. Polimerët	7	

<i>Kategoria</i>	<i>Nënkategoria</i>	<i>Përmbajtja programore</i>	<i>Rezultatet e pritshme</i>	<i>Lidhjet ndërlëndore</i>
I. Komponimet e karbonit	I. 1. Hidrokarburet	<p>I. 1. 1. Ndërtimi i atomit të karbonit-hibridizimi (konfiguracioni elektronik, hibridizimi sp^3, sp^2 dhe sp)</p> <p>I. 1. 2. Lidhjet kimike në komponimet organike (lidhjet kovalente, lidhjet në vargje karbonike dhe në cikle)</p> <p>I. 1. 3. Veçoritë e komponimeve organike dhe klasifikimi i tyre (konstantet fizike dhe vetitë e tjera, klasifikimi sipas strukturës dhe grupeve funksionore)</p>	<p><i>Nxënësit do të jenë në gjendje:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> Të paraqesin konfiguracionin elektronik të atomit të karbonit. Të përshkruajnë llojet e lidhjeve kimike në komponimet e karbonit Të dallojnë komponimet organike nga ato inorganike sipas vetive të tyre fizike e kimike. Të klasifikojnë komponimet organike në bazë të elementeve përbërëse. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fizikë (vetitë fizike të komponimeve organike, caktimi i konstanteve fizike.) ▪ Informatikë (shfrytëzimi i informatave nga interneti për hidrokarbure) ▪ Industri

	<p>I. 1. 4. Izomeria e komponimeve organike Stereoizomerët dhe aktiviteti optik (izomeria strukturale, gjeometrike dhe optike)</p> <p>I. 1. 5. Llojet e reaksioneve të komponimeve organike (reaksionet e substituimit, eliminimit, adicionimit, reaksionet homolitike dhe heterolitike)</p> <p>I. 1. 6. Klasifikimi i hidrokarbureve (hidrokarburet e ngopura dhe të pangopura)</p> <p>I. 1. 7. Alkanet (struktura, klasifikimi, emërtimi, vetitë, përftimi, përdorimi, reaksionet)</p> <p>I. 1. 8. Alkenet (struktura, klasifikimi, emërtimi, vetitë, përftimi, polimerizimi dhe reaksionet e tjera)</p> <p>I. 1. 9. Alkinet dhe dienët (struktura, klasifikimi, emërtimi, vetitë, përftimi, reaksionet)</p> <p>I. 1. 10. Hidrokarburet aromatike (struktura, emërtimi, vetitë, përftimi, reaksionet)</p> <p>I. 1. 11. Derivatet halogjene të hidrokarbureve (struktura, emërtimi, vetitë, përftimi, reaksionet)</p>	<p>5. Të klasifikojnë komponimet organike në bazë të grupeve funksionore.</p> <p>6. Të paraqesin izomerinë strukturale, gjeometrike dhe optike.</p> <p>7. Të identifikojnë komponimet me aktivitet optik.</p> <p>8. Të numërojnë llojet e reaksioneve të komponimeve organike</p> <p>9. Të klasifikojnë hidrokarburet sipas vetive të tyre dhe sipas strukturës së vargut karbonik.</p> <p>10. Të emërtojnë hidrokarburet sipas nomenklaturës "IUPAC".</p> <p>11. Të sintetizojnë hidrokarburet dhe të vlerësojnë rëndësinë dhe përdorimin e tyre.</p> <p>12. Të analizojnë përbërjen e alkilhalogjenureve dhe përdorimin e tyre.</p>	<p>(përdorimi i hidrokarbureve në industri)</p>
--	--	---	---

<p>I. Komponimet e karbonit</p>	<p>I. 2. Komponimet organike me oksigjen</p>	<p>I. 2. 1. Alkoolet (struktura, klasifikimi, emërtimi, vetitë, përfçimi, reaksionet)</p> <p>I. 2. 2. Fenolet (fenoli dhe derivatet e tij, vetitë, reaksionet)</p> <p>I. 2. 3. Eteret (struktura, emërtimi, vetitë)</p> <p>I. 2. 4. Aldehidet dhe ketonet (struktura, emërtimi, përfçimi, reaksionet)</p> <p>I. 2. 5. Acidet karboksilike dhe derivatet e tyre (struktura, emërtimi, klasifikimi, vetitë, reaksionet, derivatet)</p> <p>I. 2. 6. Esteret dhe lipidet (vetitë, reaksionet, klasifikimi i lipideve, vetitë e lipideve, përdorimi)</p> <p>I. 2. 7. Sapunët dhe deterxhentet (Përfçimi, vetitë, klasifikimi, përdorimi)</p>	<p><i>Nxënësit do të jenë në gjendje:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të paraqesin alkoolet me ndihmën e formulave strukturale. 2. Të dallojnë alkoolet sipas strukturës së vargut karbonik. 3. Të numërojnë llojet e alkooleve sipas numrit të grupeve hidroksile. 4. Të përshkruajnë vetitë fizike të alkooleve. 5. Të emërtojnë alkoolet në bazë të nomenklaturës “IUPAC”. 6. Të sintetizojnë alkoolet nga substancat e tjera organike. 7. Të paraqesin reaksionet e oksidimit, dehidratimit dhe substituit të alkooleve. 8. Të paraqesin strukturën e fenoleve. 9. Të dallojnë fenolet nga alkoolet në bazë të vetive të tyre. 10. Të përshkruajnë vetitë dhe reaksionet karakteristike të fenoleve. 11. Të paraqesin eteret me ndihmën e formulave strukturale. 13. Të emërtojnë eteret sipas nomenklaturës “IUPAC”. 14. Të përshkruajnë vetitë dhe reaksionet e etereve. 15. Të dallojnë aldehidet nga ketonet në bazë të strukturës së tyre. 16. Të emërtojnë aldehidet dhe ketonet sipas nomenklaturës “IUPAC”. 17. Të paraqesin acidet karboksilike dhe derivatet e 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fizikë (vetitë fizike të komponimeve organike me oksigjen, ▪ Informatikë (shfrytëzimi i informatave nga interneti për komponimet organike me oksigjen) ▪ Biologji (përhapja dhe funksioni i komponimeve organike me oksigjen në organizmat e gjallë) ▪ Industri (prodhimi dhe përdorimi i komponimeve organike me oksigjen në industri)
--	---	--	--	--

		<p>I. 2. 8. Karbohidratet dhe klasifikimi i tyre (struktura, klasifikimi, stereoizomerët)</p> <p>I. 2. 9. Monosakaridet (klasifikimi, vetitë, reaksionet)</p> <p>I. 2. 10. Disakaridet (struktura, vetitë, përdorimi)</p> <p>I. 2. 11. Polisakaridet (amidoni, celuloza, glikogjeni, struktura, vetitë, përhapja, përdorimi)</p>	<p>tyre me ndihmën e formulave strukturale.</p> <p>18. Të emërtojnë acidet karboksilike dhe derivatet e tyre sipas nomenklaturës klasike dhe “IUPAC”.</p> <p>19. Të klasifikojnë acidet karboksilike sipas numrit të grupeve funksionore.</p> <p>20. Të paraqesin strukturën e karbohidrateve me formula të Fisherit dhe ato ciklike.</p> <p>21. Të klasifikojnë karbohidratet në bazë të vargut karbonik dhe numrit të njësisë përbërëse.</p> <p>22. Të paraqesin stereoizomerët e karbohidrateve me formula strukturale dhe me modele molekulare.</p> <p>23. Të përshkruajnë vetitë e karbohidrateve dhe reaksionet e tyre.</p> <p>24. Të paraqesin strukturën e disakarideve dhe të polisakarideve me formula strukturale.</p> <p>25. Të dallojnë sheqernat reduktues dhe joreduktues sipas strukturës dhe reaksioneve të tyre.</p>	
I. Komponentet e karbonit	I. 3. Komponentet organike me azot	<p>I. 3. 1. Nitrokomponimet (struktura, emërtimi, përfitim, vetitë)</p> <p>I. 3. 2. Aminat (struktura, emërtimi, klasifikimi, vetitë)</p> <p>I. 3. 3. Komponentet heterociklike (struktura, emërtimi, vetitë)</p>	<p><i>Nxënësit do të jenë në gjendje:</i></p> <p>1. Të paraqesin nitrokomponimet me ndihmën e formulave strukturale.</p> <p>2. Të emërtojnë nitrokomponimet në bazë të nomenklaturës “IUPAC”.</p> <p>3. Të paraqesin reaksionet e reduktimit të nitrokomponimeve.</p> <p>4. Të paraqesin aminat me formula strukturale.</p> <p>5. Të klasifikojnë aminat sipas strukturës së tyre.</p> <p>6. Të emërtojnë aminat sipas nomenklaturës “IUPAC”.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fizikë (vetitë fizike të komponimeve organike me azot, ▪ Informatikë (shfrytëzimi i informatave nga interneti për komponimet organike me

		<p>I. 3. 4. Aminoacidet dhe proteinat (struktura, emërtimi, klasifikimi, vetitë, reaksionet, veprimi fiziologjik në organizëm)</p> <p>I. 3. 5. Acidet nukleike (struktura, klasifikimi, veprimi fiziologjik në organizëm)</p> <p>I. 3. 6. Alkaloidet dhe vitaminat (struktura, vetitë e përgjithshme, veprimi fiziologjik në organizëm)</p> <p>I. 3. 7. Enzimet (vetitë, klasifikimi, veprimi katalitik në organizëm)</p>	<p>7. Të përshkruajnë vetitë dhe reaksionet karakteristike të aminave.</p> <p>8. Të përshkruajnë strukturën e aminoacideve dhe proteinave.</p> <p>9. Të klasifikojnë aminoacidet në bazë të pozitës së grupeve funksionore.</p> <p>10. Të paraqesin strukturën parësore, dytësore, tretësore dhe kuaternare të proteinave në shembuj të thjeshtë.</p> <p>11. Të vlerësojnë rëndësinë e proteinave për zhvillimin e proceseve jetësore.</p> <p>12. Të përshkruajnë strukturën e ADN-së me modele (ose skicime) të thjeshta.</p> <p>13. Të vlerësojnë rëndësinë e ADN-së për bartjen e vetive trashëguese.</p> <p>14. Të klasifikojnë alkaloidet sipas veprimit të tyre.</p> <p>15. Të përshkruajnë veprimin fiziologjik të alkaloidëve në organizëm.</p> <p>16. Të vlerësojnë rëndësinë e alkaloidëve dhe vitaminave për funksionimin normal të organizmit dhe për mbrojtjen e tij.</p> <p>17. Të përshkruajnë funksionin katalitik të enzimeve.</p> <p>18. Të klasifikojnë enzimet sipas veprimit të tyre katalitik.</p> <p>19. Të numërojnë faktorët që ndikojnë në veprimin katalitik të enzimeve</p> <p>20. Të vlerësojnë funksionin e enzimeve në proceset jetësore.</p>	<p>azot)</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Biologji (funksioni i komponimeve organike me azot në organizmat e gjallë) ▪ Industri (prodhimi dhe përdorimi i alkaloidëve dhe i vitaminave).
--	--	---	--	--

<p>I. Komponentet e karbonit</p>	<p>I. 4. Polimerët sintetikë</p>	<p>I. 4. 1. Plastmasat (struktura, përftimi, vetitë, përdorimi)</p> <p>I. 4. 2. Fijet sintetike (struktura, përftimi, vetitë, përdorimi)</p> <p>I. 4. 3. Zbatimi i polimerëve (përdorimi i polimerëve sintetikë në industri dhe në jetën e përditshme)</p>	<p><i>Nxënësit do të jenë në gjendje:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të paraqesin polimerët me ndihmën e formulave strukturale. 2. Të përshkruajnë përdorimin e polimerëve sintetikë. 3. Të paraqesin reaksionet e polimerizimit dhe të polikondensimit. 4. Të dallojnë plastmasat sipas përbërjes dhe vetive të tyre. 5. Të identifikojnë fijet sintetike dhe metodat e përfimit të tyre 6. Të vlerësojnë rëndësinë e polimerëve sintetikë për prosperitetin e përgjithshëm. 7. Të vlerësojnë ndikimin e produkteve polimere në ndotjen e mjedisit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fizikë (vetitë fizike të polimerëve sintetikë), ▪ Informatikë (shfrytëzimi i informatave nga interneti për polimerët sintetikë) ▪ Industri (prodhimi dhe përdorimi i produkteve polimere). ▪ Ekologji (ndikimi i polimerëve në ndotjen e mjedisit).
---	---	---	---	--

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Për realizimin me sukses të Planit dhe programit të kimisë është e domosdoshme të zbatohen metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës dhe një kompleks i tërë procedurash (informacion i ri, përsëritje, përforsim, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike, mjete materiale teknike siç janë: vizatime, diagrame, modele, grafikë, kimikate, enë laboratorike, instrumente dhe mjete të tjera teknike bashkëkohore, kompjuter etj).

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimitdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe me kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Metodat dhe teknikat e punës me nxënës duhet të jenë të kombinuara dhe të shumëllojta, nga se nxisin dinamikën e orës, thyejnë monotoninë dhe motivojnë nxënësit për mësim.

Metodat, teknikat dhe format e punës me nxënës janë po aq të shumëllojta sa edhe llojet e mësimnxënies. Ato duhet të jenë në funksion të përvetësimit më të lehtë të përmbajtjeve mësimore dhe zbatimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, shprehive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të kimisë e veçanërisht të atyre që nevojiten për zgjidhjen e problemeve të përditshme.

Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore sugjerohen disa metoda, forma të punës dhe teknika të ndryshme:

- Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (përmes shpjegimit, sqarimit, ushtrimeve praktike dhe shembujve);
- Mësimdhënie e tërthortë (përmes shqyrtimit, zbulimit, zgjidhjes së problemeve);
- Konstruktivizmi dhe mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënësve në bashkëpunim (përmes grupeve të vogla, grupeve më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie përmes të menduarit (të menduarit kritik, krijues, zgjidhjes së problemeve me kompjuter);
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes demonstrimit dhe eksperimentit;

- Të mësuarit dhe të nxënësve përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Vetëhulumtimi;
- Të mësuarit në natyrë dhe objekte industriale;

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultatet e pritshme.

VLERËSIMI

Vlerësimi është veprimtari dhe instrument që përdoret për të gjykuar për punën dhe arritjet e nxënësve. Ai luan rolin e një aparati matës që bën të qartë situatën në të cilën ndodhet nxënësi. Vlerësimi si një sistem i gjerë që mbështetet në procesin e të nxënësve përfshin këto kategori vlerësimi:

- formues
- diagnostikues
- përmbledhës dhe
- motivues

Vlerësimi i vazhdueshëm pas çdo teme mësimore jep rezultate më të mira. Ai nuk mat vetëm njohuritë e fituara, por edhe vlerëson shkallën në të cilën ka arritur një veprim edukativ i cili lë gjurmë në personalitetin e nxënësit. Vlerësimi përfundimtar përfshin aktivitetin e përgjithshëm të të nxënësve të nxënësve (përgjigjet me gojë, projektet, punimet seminarike, sjelljet në grup, aftësitë që i fitojnë gjatë punës eksperimentale, detyrat e shtëpisë, rezultatet e testeve dhe provimeve etj.).

Vlerësimi i nxënësve përfshin tri fusha kryesore:

- aftësitë njohëse (kognitive);
- aftësitë emocionale (afektive) dhe
- aftësitë psikomotorike.

Mësimdhënësi përzgjedh dhe përdor mjete e teknika të shumëllojta të vlerësimit dhe pas zhvillimit të përmbajtjeve të programit, nxënësit

vlerësohen me nota (për një temë, për një tërësi temash, për një semestër ose gjysmëvjetor dhe në fund të vitit shkollor). Vlerësimi duhet të jetë transparent ndaj nxënësve, prindërve, administratorëve të arsimit dhe komunitetit.

Përfundimet e vlerësimit i shërbejnë mësimdhënësit për arritjen e qëllimeve të ndryshme:

1. Të sigurojë informacione rreth përparimit të nxënësve;
2. T'u sigurojë nxënësve informacion mësimor;
3. Për motivimin e nxënësve;
4. Të shënojnë përparimin e nxënësve;
5. Të sigurojë realizimin e objektivave aktualë;
6. Të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen;
7. Të reflektojnë për përmirësimin e mësimdhënies bazuar në vlerësimin e të tjerëve dhe në vetëvlerësim.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Që të realizohet me sukses mësimdhënia dhe mësimnxënia e Planit dhe programit të kimisë, mësimdhënësit dhe nxënësit duhet të shfrytëzojnë burime dhe mjete të ndryshme informimi:

- 1) Laboratori (kabineti) i kimisë ose laborator mobil.
- 2) Teksti i kimisë, doracak për mësimdhënësit, praktikume, fletore pune dhe libra të tjerë të ngjashëm në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja.
- 3) Revista profesionale dhe shkencore, fjalorë, enciklopedi.
- 4) Sistem periodik të elementeve, fotografi, modele, skema, diagrame, makete, koleksionar të mineraleve.
- 5) Pajisje multimediale (programe të kompjuterëve, interneti, CD).
- 6) Aparat TV me videorekorder, grafoskop, fotoslajde, videokaseta që përmbajnë materiale të ndryshme shkencore me interes për nxënësit.
- 7) FJALORI I KIMISË, SH.B. "8 Nëntori", Tiranë.

- 8) Bardhyl Musai, METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES, Tiranë, 2003.
- 9) Grup autorësh, METODAT E MËSIMDHËNIES, (Manual për mësuesit e rinj).
- 10) Literatura tjetër e nevojshme që ekziston në biblioteka dhe mjetet e tjera që gjenden në treg.

Është kompetencë dhe liri e mësimitdhënësit që, në vartësi nga kushtet në të cilat punon shkolla, të zgjedhë burimin e informacionit dhe mjetet ndihmëse mësimore, duke i kushtuar vëmendje baraspeshës së të dhënave eksperimentale, gojore, vizuale, e me theks të veçantë në atë që është qenësore për të mësuar. Kjo përzgjedhje gjithnjë duhet të bëhet duke e ruajtur dhe duke e ngritur nivelin e cilësisë së mësimitdhënies dhe të mësimitdhënies.

Kjo liri e të zgjedhurit të burimeve mësimore duhet t'i takojë edhe nxënësit.

ASTRONOMIA

**Gjimnazi i shkencave të natyrës dhe matematikë me informatikë
(2 orë në javë, 33 javë, 66 orë në vit)**

HYRJE

Për këto dy gjimnaze është përpiluar program identik. Programi është përpiluar në pajtim me nivelin e përgatitjes paraprake të nxënësve nga lëmi i fizikës dhe matematikës dhe nuk paraqet kurrfarë pengese në njohje, kuptim dhe vërtetim të ligjshmërive në lëmin e astronomisë. Pjesë e pandarë e programit është edhe vërtetimi i objekteve qiellore. Në shkolla që nuk kanë teleskop shkollor, zbatimi i njohurive të fituara reduktohet vetëm në nivel të vërtimit pasiv dhe përcaktimit të pozitës të yjësive apo planetëve në sferën qiellore, kurse në shkolla që kanë teleskop, vërtimet kanë karakter të njohjeve të hollësive të trupave të afërt qiellore.

QËLLIMET

Programi i astronomisë ka për qëllim:

- të zhvillojë aftësi të nxënësve për të njohur dhe kuptuar pozitën e njeriut në kohë dhe në hapësirë, Tokës ku jeton dhe raportet mes trupave të tjerë në Gjithësi.
- të zhvillojë shkathtësi për të përshkruar saktësisht formën analitike të ligjshmërive të trupave qiellore, pozitën, lëvizjet e dukshme dhe të vërteta, përcaktimin e largësive, masave, dimensioneve, përbërjen kimike dhe natyrën fizike, lindjen dhe zhvillimin e tyre dhe të Gjithësisë në përgjithësi.
- të fitojë aftësi për arritje deri te ligjshmëritë kozmike me ndihmën e gjykimit vetjak dhe të kyçet në metodat elementare të përcaktimit të lidhjeve funksionale të dukurive me anë të vërtimit.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

Të njohë:

- llojet e trupave qiellorë, dallimet dhe vendosjen reciproke të tyre në hapësirë.
- trupat e sistemit diellor, renditjen reciproke të tyre dhe rrjedhimet e rrotullimit të Tokës rreth boshtit dhe rreth Diellit.
- dallimet mes yjeve, planetëve, asteroidëve, satelitëve, kometave, meteorëve, meteoritëve, bolidëve dhe lidhshmërinë materiale mes tyre.
- krijimin e yjeve normale, yjeve të reja dhe super të reja, yjeve neutronike, vrimave të zeza, vetitë e yjeve të ndryshueshme dhe evolucionin e yjeve në përgjithësi.
- të dhëna për galaktikën tonë, për grumbullimet yjore në të, materien ndëryjore, ekzistimin e shumë e shumë galaktikave të tjera dhe klasifikimin e tyre sipas Hablit.

Të kuptojë:

- natyrën e trupave të sistemit diellor dhe vetitë fiziko-kimike me të cilat karakterizohen trupat e tjerë qiellorë.
- ekzistimin e njollave në Diell, rrotullimin, temperaturën efektive dhe temperaturën në brendi, përbërjen kimike, strukturën e atmosferës dhe burimet e energjisë diellore.
- natyrën fizike të trupave të sistemit diellor, atmosferat, sipërfaqet, veçoritë e ndërtimit të planetëve gjigantë dhe unazat e tyre.
- numrin e satelitëve që i përkasin çdo planeti, vetitë e tyre, lëvizjen dhe veçoritë fizike të asteroidëve dhe atyre që kaluan pranë Tokës më 2002.
- formën, strukturën, natyrën dhe zbulimin e kometave, meteoritëve, bolidëve, rrebesheve meteorikë dhe lidhshmëritë mes tyre.

Të zbatojë:

- njohuritë e fituara për zgjidhje të detyrave numerike dhe problemeve praktike të vrojtimit, në mënyrë të pavarur.
- në zgjidhje të detyrave numerike nga astrometria dhe astrofotometria, përcaktimi i largësive dhe madhësive të trupave qiellore me ndihmën e paralaksit.
- ligjin e tretë të Keplerit dhe të dhënat e nevojshme tabelare për përcaktimin e masave të planetëve që kanë satelit natyror, kurse nga kuptimi i qendrës së masës së sistemit Tokë- Hënë të përcaktojë masën e Hënës.
- për përfitimin e ligjit të Njutonit për gravitet nga ligjet e Keplerit, kurse ligjin e dytë të Keplerit nga ligji për ruajtjen e momentit të sasisë së lëvizjes.
- për llogaritjen e dendësisë kritike të materies në Gjithësi dhe nga rezultati i fituar të përfundojë për dy modelet e Gjithësisë.

Të analizojë:

- të kombinojë metodat analitike, analizën numerike, vrojtimet dhe hartat qiellore për
- nxjerrje të përfundimeve të drejta për dukuritë kozmike.
- lloje të trupave qiellore, llojet e ndryshme të yjeve, planetëve dhe satelitëve për nga vetitë fiziko – kimike të tyre, temperaturës efektive, masës, ngjyrës, vëllimit dhe spektrit.
- evolucionin e yjeve duke u bazuar në diagramin H-R dhe në veçanti evolucionin e Diellit.

Të sintetizojë:

- përfytyrim për krijimin e sistemit diellor në të kaluarën e largët, duke u bazuar në llojllojshmërinë e trupave përbërës të këtij sistemi.
- veçoritë e përbashkëta të teorive bashkëkohore të krijimit të Diellit, planetëve dhe trupave të vegjël të sistemit diellor nga i njëjti material i ftohtë ndëryjor.
- teoritë e krijimit të yjeve dhe galaktikave nga i njëjti material ndëryjor dhe ndërlidhjen e krijimit të tyre me evolucionin e yjeve.

Të vlerësojë:

- paraqitjen e njeriut në Tokë dhe raportet me trupat e tjerë qiellorë të Gjithësisë.
- rolin e Diellit si burim i pashtershëm i energjisë në paraqitjen dhe vazhdimin e jetës në Tokë.
- rolin e fushës magnetike të Tokës në ruajtjen e jetës në Tokë, dëmtimet e shtresës së ozonit në atmosferë, ngritjen e ngadalshme të temperaturës nga efekti i kopshtit qelqor dhe katastrofat e tjera që e përcjellin jetën e njeriut në Tokë.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

Kategoria	Nënkategoritë	Numri i orëve		Përqindja
VI. Astronomia	VI.1 Astronomia sferike	30		45,5 %
	VI.2 Astrofizika	14		21,2 %
	VI.3	22		33,3 %
	Sistemi diellor dhe kozmologjia	Tërësisht	66	100%

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

KATEGORIA	NËNKATEGORIA	PËRMBAJTJA PROGRAMORE	REZULTATET E PRITURA	LIDHJA NDËRLËNDORE
VI. ASTRONOMI	VI.1 ASTRONOMIA SFERIKE	Lënda e studimit të astronomisë. Astronomia dhe shkencat e tjera. Ndarja e astronomisë. Pasqyrë e shkurtër e zhvillimit historik të astronomisë. Astronomia në internet. Pikat, vijat dhe harqet themelore në sferë qiellore. Yjet dhe yjësitë. Yjësitë themelore dhe orientimi në qiell. Rrotullimi i dukshëm i sferës qiellore. Dita yjore. Vërtetimet e rrotullimit të Tokës. Sistemi i koordinatave të: horizontit, ekuatorit të vendit dhe ekuatorit qiellor. Koha yjore. Lartësia e polt mbi horizont dhe gjerësia gjeografike. Rrotullimi ditor i qiellit në gjerësi të ndryshme gjeografike. Kalimi i trupave qiellorë nëpër meridian (lidhja mes koordinatave). Lëvizja e dukshme vjetore e Diellit dhe rrjedhimet e saj. Brezat klimatikë në Tokë. Sistemi i koordinatave të ekliptikës. Lëvizja e dukshme vjetore e Diellit si pasqyrim i lëvizjes së vërtetë të Tokës rreth tij. Orientimi në Tokë me ndihmën e Diellit. Koha e vërtetë, mesatare diellore, yjore dhe lidhja mes tyre.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: 1. të gjejë në internet të gjitha të dhënat për probleme astronomike për të cilat shpreh interesim, duke u shërbyer me sajtet që do t'i ofrohen. 2. të përkufizojë pikat, vijat dhe harqet themelore në sferën qiellore. 3. të përshkruajë rrjedhimet e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të vet dhe rreth Diellit. 4. të dallojë të metat e sistemit të Ptolemeut ndaj përparësive që ofron sistemi i Kopernikut në astronominë bashkëkohore. 5. të lokalizojë në qiell pozitën e yjësisë themelore dhe nga përcaktimi i pozitës së Yllit Polar të përcaktojë kahet e horizontit të vendit ku jeton. 6. të tregojë brezat klimatikë në Tokë si rrjedhim i kalimit të Diellit nëpër meridian qiellor dhe dukjen e qiellit në gjerësi të	Matematikë: Funksionet lineare, kuadratike dhe kubike. Prerjet konike në koordinata polare dhe vetitë gjeometrike të elipsës. Histori: Evolimi i mendimit shkencor për Gjithësinë nga antika deri më sot. Gjoografi: koordinatat gjeografike.

		<p>Sistemet e matjes së kohës. Kalandari. Ndikimi i atmosferës së Tokës në vrojtime astronomike. Lëvizja e dukshme e planetëve. Sistemi i Ptolemeut dhe i Kopernikut. Zbulimet e Galileit. Konfiguracioni i planetëve. Periodat sinodike dhe siderike të rrotullimit të planetëve. Ligjet e Keplerit. Përcaktimi i masave të planetëve dhe trupave qiellorë. Përfitimi i ligjit të gravitetit nga ligjet e Keplerit. Elementet e orbitave. Problemi i shumë trupave. Trazirat. Baticat dhe zbatikat. Precesioni dhe nutacioni. Shpejtësitë kozmike. Paralaksi ditor dhe vjetor. Njësitë astronomike për largësi. Përcaktimi i madhësive të trupave qiellorë. Paralaksi vjetor si vërtetim i rrotullimit të Tokës rreth Diellit.</p>	<p>ndryshme gjeografike. 7. të llogaritë masën e Hënës dhe masat e planetëve që kanë satelit me metoda përkatëse. 8. të zbatojë përkufizimin e paralaksit ditor dhe vjetor për përcaktimin e parsekut dhe madhësive të trupave të afërt qiellorë.</p>	
VI. ASTRONOMI	VI.2 ASTROFIZIKA	<p>Teleskopët. Llojet e spektrave. Spektroskopi. Madhësitë e dukshme dhe absolute yjore. Përcaktimi i madhësive yjore. Fotometrat. Përcaktimi i diametrave të yjeve sipas ligjit të rrezatimit. Radioteleskopët dhe radiointeferometrat. Lëvizjet vetjake të yjeve, shpejtësitë tangjenciale dhe rrezore. Tipat spektralë të yjeve dhe vetitë fiziko-kimike të tyre. Yjet e</p>	<p>Nxënësi duhet të jetë në gjendje: 1. të përkufizojë në mënyrë analitike vetitë themelore të teleskopëve dhe t'i zbatojë për njehsime të nevojshme. 2. të zbatojë ligjin e rrezatimit termik për përcaktimin e diametrit, dritësisë apo temperaturës efektive të yjeve.</p>	<p>Fizikë: analiza spektrale, ligjet e rrezatimit termik (Plankut, Vinit), reaksionet bërthamore të fuzionit dhe grimcat elementare.</p>

		dyfishta. Yjet e ndryshueshme. Yjet e reja dhe super të reja. Pulsarët dhe vrimat e zeza. H-R diagrami. Burimet e energjisë yjore. Evolucionin e yjeve.	3. të përshkruajë vetitë fiziko-kimike të yjeve në funksion të temperaturës, ngjyrës apo tipit spektral, llojet dhe evolucionin e tyre.	
VI. ASTRONOMI	VI.3 SISTEMI DIELLOR DHE KOZMO-LOGJIA	Të dhëna themelore për Diellin. Struktura e atmosferës së Diellit. Burimet e energjisë dhe struktura e brendshme e Diellit. Planetët e grupit të Tokës. Fillet e gjeofizikës. Hëna si satelit i Tokës. Fazat dhe rrotullimi i Hënës. Eklipsi i Diellit dhe i Hënës. Natyra e Hënës. Planetët gjigantë. Trupat e vegjël të sistemit diellor. Origjina e krijimit të sistemit diellor. Galaktika jonë. Sistemi i koordinatave të Galaktikës. Grumbullimet yjore. Materia ndëryjore. Rrezet kozmike dhe fusha magnetike ndëryjore. Rrotullimi i Galaktikës. Galaktikat e tjera. Ligji i Hablit. Llojet e galaktikave. Galaktikat me bërthamë aktive. Kuazarët. Metagalaktika dhe zgjerimi i saj. Teoria e eksplozimit të madh. Paradoksi i Olbersit. Ngadalësimi gravitues i zgjerimit të Gjithësisë. Dendësia kritike e materies në Gjithësi.	Nxënësi duhet të jetë në gjendje: 1. të tregojë të dhënat themelore për Diellin, veçoritë themelore të atmosferës dhe të brendësisë së tij dhe burimet e energjisë diellore. 2. të përshkruajë veçoritë themelore të planetëve, Hënës, trupave të vegjël të sistemit diellor dhe origjinën e tërë sistemit. 3. të shpjegojë veçoritë themelore të Galaktikës sonë, llojet e galaktikave të tjera, dhe në bazë të përcaktimit të dendësisë kritike të përfundojë për modelet e Gjithësisë së sotme.	Matematikë: Funksionet lineare. Fizikë: teoria e relativitetit.

VROJTIMET

Astronomia është shkencë teorike dhe vrojtuese. Saktësia e të gjitha metodave analitike duhet t'i nënshtrohet gjyqit shkencor që është vrojtimi. Pa verifikim të njohurive me vrojtim, nuk mund të flasim për njohuri të mirëfilltë. Rëndon, vrojtimit udhëhiqen nga arsimitari i lëndës, nga vendi i ndriçuar shumë dobët në çfarëdo nate të kthjellët dhe të qetë kur këtë e mundësojnë kushtet atmosferike. Nuk duhet pritur që vrojtimit të bëhen paralelisht me zhvillimin e lëndës, por duhet shfrytëzuar kushtet klimatike të nevojshme për këtë qëllim. Se çka do të vrojtojë në qiell do të vendosë arsimitari. Preferohet të sigurohet një teleksop shkollor me të cilin mund të kryhen shumë vrojtme interesante dhe një hartë qiellore me njësi të vizatuara. Në mungesë të teleskopit, atë duhet huazuar nga shkollat që e kanë atë. Në të kundërtën nuk mund të flasim për ndonjë rezultat të mësimit. Astronomia është interesante pikërisht nga mundësia e vrojtimit.

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

Për realizimin e përmbajtjes programore të astronomisë në klasën 12 për të dy gjimnazet përveç tekstit shkollor si burim tradicional i mësimit nxënies preferohet edhe qasja në internet. Për këtë qëllim, në këtë program një mësime të astronomisë është emërtuar **astronomia në internet**, në të cilin jepen sajtet për problemet më karakteristike të astronomisë. Si burim plotësues sugjerohet edhe përdorimi i tekstit të **astronomisë për universitet** në të cilin gjenden shumë të dhëna në pajtim me programin e ri të përpiluar. Në internet mund të gjenden edhe metoda të ndryshme shpjegimi dhe zbulime të reja nga observatorët e ndryshëm.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përvoja ka treguar se mësime të cilat realizohen me metoda të ndryshme është më e suksesshme, prandaj mësime të astronomisë duhet të kryhet duke shfrytëzuar tri metoda mësimore të cilat janë:

- Metoda e të shprehurit me gojë (monologu),
- Metoda e bashkëbisedimit (dialogu),
- Metoda e vrojtimit.

Ora mësimore duhet të udhëhiqet nga dy ecuri të mundshme:

- Induktive,
- Deduktive.

Në mësimin induktiv fillojnë nga e thjeshta kah e përbëra, nga e njohura kah e panjohura, nga e afërta kah e largëta, nga konkretja kah abstrakja. Mësimi deduktiv rëndom ka të bëjë me analizën e të përgjithshmes kah e veçanta. P.sh., këtë ecuri e zbatojmë te rrjedhimet e ligjeve të Keplerit, rregullat e përcaktimit të masës së planetit që ka satelit, nga njohja e paralaksit, apo përcaktimit të masës së Hënës nga qendra e përbashkët e rëndësis në sistemin Tokë- Hënë etj.

VLERËSIMI I DITURIVE TË NXËNËSVE

Për vlerësim të diturisë së nxënësve duhet të merren parasysh rezultatet e treguara në:

I. Provim me shkrim

Nga fundi i çdonjërit gjysmëvjetor parashikohet të mbahet nga një provim me shkrim, në të cilin do të jepen mësimet, detyra dhe probleme, të cilat nxënësi do të përpikët t'i zgjidhë. Arsimitari do të jep ndonjë mësim që është shpjeguar, detyra të zgjidhura dhe të pazgjidhura në klasë, të cilat janë përpunuar apo nuk janë përpunuar më parë në orët e mësimet. Qëllimi i paraqitjes së detyrave të pazgjidhura në provim me shkrim qëndron në vlerësimin e aftësive kreative të nxënësve, sepse pikërisht nga ecuria e zgjidhjes së këtyre detyrave vlerësohet mënyra e të menduarit të tyre.

II. Projektet: paraqitje e hulumtimit të pavarur të nxënësit, ose punë praktike

Vlerësimi i diturive të nxënësve kryhet edhe nga përcjellja e aktivitetit të tyre në punë praktike individuale dhe në grupe. Nxënësit do të marrin nga arsimtari detyra konkrete, të cilat mund të jenë: zgjidhje e pavarur e ndonjë detyre, shpjegim i pavarur i ndonjë dukurie, vrojtim i pavarur sipas interesit të tij ose ndonjë vizatim që në astronomi janë me interes të veçantë.

III. Intervistat (pyetje me gojë)

Ka nxënës të tillë që janë mjaft të përgatitur, por edhe të papërgatitur, të tërhequr në vetvete, inert dhe nuk tregojnë ndonjë aktivitet në orën e

mësimit. Për këtë arsye arsimtari duhet këta nxënës t'i thërrasë dhe t'i intervistojë që të kuptojë nivelin e arritshmerisë së tyre. Kjo mënyrë realizohet në formë bashkëbisedimi dhe nuk duhet t'i nënshtrohet e tërë klasa.

IV. Testi përfundimtar

Testi përfundimtar mbahet në javën e fundit të gjysmëvjetorit dhe bëhet me libra mbyllur. Përmban tërë lëndën e kaluar të atij semestri. Nxënësi nuk guxon të ketë qasje në asnjë nga materialet e kursit. Për numrin e pyetjeve të testit vendos arsimtari.

V. Detyrat e shtëpisë

Arsimtari duhet të jep vazhdimisht detyra të shtëpisë me qëllim që nxënësi të mbahet në vazhdimësi. Këto mund të jenë formash të ndryshme si: zgjidhje të detyrave numerike, vendosja e të dhënave në ndonjë tabelë apo ndonjë vizatim që në astronomi ka mjaft.

VI. Aktiviteti në klasë

Në radhë të parë, arsimtari duhet të pranojë nxënësin si partner të bashkëbisedimit. Prandaj, duke provuar që nxënësin ta kyç në bashkëbisedim gjatë procesit të shpjegimit, njëkohësisht do ta çmojë sa është në gjendje të përvetësojë njësinë mësimore të shpjeguar. Kësisoj, nxënësi së bashku me arsimtarin do të jetë vazhdimisht aktiv në nxjerrjen e përfundimeve për ligjshmëritë që shpjegohen. Nxënësit e ndryshëm, për të njëjtën problematikë mund të nxjerrin përfundime të ndryshme. Ky aktivitet i tyre për arritje përfundimisht së bashku me arsimtarin apo edhe në mënyrë të pavarur, duhet të merret si parametër i vlerësimit të diturisë. Po ashtu gjatë zgjidhjes së detyrave numerike të parapara me program në orët e ushtrimeve, disa nxënës janë vazhdimisht aktivë dhe kyçen në zgjidhjen e tyre në tabelë ose fletore. Edhe ky aktivitet duhet të merret si parameter tjetër për vlerësim të diturisë së tyre.

VII. Aktiviteti gjatë vrotimit

Në ato shkolla ku ekziston teleskopi, arsimtari sipas programit, duhet të kryejë edhe vrotime, por vrotimet duhet të bëhen edhe në mungesë të teleskopit. Pikërisht, gjatë këtij angazhimi të arsimtarit, disa nxënës nga kureshtja do të jenë më aktivë se të tjerët. Ata do t'i ndihmojnë arsimtarit në procesin e vrotimit apo leximit të hartës qiellore, ashtu që ky aktivitet merret si një nga parametrat për vlerësimin e diturive të tyre. Vlerësimi i përgjithshëm i njohurive të fituara të nxënësve do të mbështetet në këto shtatë pika të cekura më lart.

GJEOGRAFIA

Gjimnazi i gjuhëve (2 orë në javë, 66 orë në vit)

HYRJE

Plani dhe programi lëndor për klasën 11, ndërtohet mbi bazën e nivelit II-të, klasa VI, VII dhe IX dhe ruan lidhjet përmbajtësore me to. Ajo nxënësve u ofron njohuri për **mjedisin fizik**(ndërtimin gjeologjik, format e relievit, klimën, ujërat, tokat, botën bimore e shtazore), **mjedisin human** (popullsinë, vendbanimet dhe aktivitetet ekonomike) dhe **ndarjen regjionale e administrative-politike** të Kosovës dhe vendeve përreth.

Plani dhe programi lëndor, **synon** të bëjë sqarimin e lidhjeve të **tipareve fizike dhe humane**, duke i interpretuar si dukuri dhe fenomene të veçanta dhe në ndërlidhje në suaza të komplekseve natyore – regjioneve si sistem ndërlidhjesh. Ajo **synon** që nxënësit të nxiten të eksplorojnë dhe të zhvillojnë dije, **shkathësi, shprehi, kompetenca, qëndrime dhe vlera**. Lënda e gjeografisë për klasën 11 përmbajtjet lëndore i trajton në përshtatje me moshën e nxënësve. Struktura e lëndës përqendrohet në parimet dhe konceptet e gjeografisë së Kosovës dhe vendeve përreth. Gjeografia e Kosovës, duke ofruar njohuri për tiparet e natyrës, pasuritë natyrore, popullsinë dhe aktivitetet e saj zhvillon ndjenjen e përkatësisë nacionale, atdhedashurisë dhe ndikon në krijimin e qytetarit të ndërgjegjshëm për ruajtjen, mirëkuptimin, bashkëpunimin dhe tolerancën në vend dhe në regjion.

QËLLIMET

Mësimi i Gjeografisë së Kosovës dhe vendeve përreth ka për qëllim:

- Zhvillimin e aftësive të nxënësit për **të njohur** pozitën gjeografike, veçoritë e natyrës (ndërtimin gjeologjik, relievin, klimën, ujërat,

botën bimore dhe shtazore), veçoritë humane (popullsia, vendbanimet dhe veprimtaritë ekonomike).

- Zhvillimin e aftësive të nxënësit për **të kuptuar** lidhjet ndërmjet veçorive natyrore dhe shoqërore dhe ndikimin e tyre për aktivitetet njerëzore, sfidat dhe perspektivat.
- Zhvillimin e aftësive të nxënësit për **të çmuar** trashëgiminë kulturore dhe natyrore të Kosovës dhe të vendeve përreth.
- Zhvillimin e aftësive të nxënësit për të fituar **shkathtësi** dhe **shprehi** për përdorimin e të dhënave verbale, sasiore dhe simbolike të tekstit, fotografive, imazheve, grafikëve, tabelave, diagrameve dhe hartave.
- Zhvillimin e aftësive të nxënësit për të krijuar **gatishmëri** për të përdorur drejt dhe me përgjegjësi njohuritë, shkathtësitë dhe shprehitë e fituara nga mësimi i gjeografisë së Kosovës dhe vendeve përreth.
- Zhvillimin e aftësive të nxënësit për **të respektuar** të drejtat njerëzore në Kosovë dhe vendet përreth, barazi kombëtare, fetare, gjuhësore, kulturore, gjinore dhe angazhim për të kërkuar zgjidhje të problemeve lokale, kombëtare dhe rajonale etj.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE TË VEÇANTË

- **Të njohë**
 - Faktet për veçoritë natyrore e humane të Kosovës dhe vendet përreth.
 - Konceptet për karakteristikat natyrore e humane të Kosovës dhe vendet për rreth.
- **Të kuptojë**
 - Për specifikat gjeografike të Kosovës dhe të vendeve përreth (specifikat natyrore, shoqërore, ekonomike dhe politike të tyre).
- **Të zbatojë**
 - Përdorimin e: grafikëve, diagrameve, hartave tematike etj., nga të dhënat statistikore për Kosovën dhe vendet përreth.
 - Punimin e hartave, grafikëve, diagrameve etj., nga të dhënat statistikore për Kosovën dhe vendet përreth.

- **Të analizojë**
 - Ndikimin e faktorëve natyrorë, shoqërorë dhe politikë në Kosovë dhe vendet përreth.
 - Rolin e faktorëve natyrorë dhe shoqërorë në zhvillimin shoqëror-ekonomik të Kosovës dhe të vendeve përreth.
- **Të vlerësojë**
 - Rolin e faktorëve natyrorë dhe shoqërorë në zhvillimin e ulët ekonomik të Kosovës dhe të vendeve përreth.
 - Ndikimin e veprimtarive njerëzore në mjedisin jetësor.
- **Të zhvillojë qëndrime dhe vlera**
 - Për larminë e veçorive natyrore, njerëzore dhe kulturore të Kosovës dhe të vendeve përreth, vlerësimin e resurseve natyrore dhe njerëzore.
 - Në kuptimin e sjelljeve personale (të jetë kooperativ, i hapur, tolerant, i ndershëm, i vullnetshëm, kritik, i aftë për punë në grupe, çifte, përdorimin e literaturës, leksikoneve, enciklopedive, internetit, programeve arsimore televizive, aftësi për punë në bashkëpunim me komunitetet etj.

PLANIFIKIMI I PËRMBAJTJEVE PROGRAMORE NË BAZË TË PÛRKATËSISË NACIONALE

Kategoria	Nënkatëgoria	Tërësitë mësimore	Shqiptarët		Serbët dhe Malaziasit		Boshnjakët		Turqit		Kroatët			
			Nr. orë	%	Nr. orë	%	Nr. orë	%	Nr. orë	%	Nr.orë	%		
Rajoni-regjioni	Kosova dhe vendet përreth	Siurdhesa Ballkanike	2+1	4.55	2+1	4.55	2+1	4.55	2+1	4.55	2+1	4.55		
		Kosova	27+8	53.0 3	27+8	53.0 3	27+8	53.0 3	27+8	53.0 3	27+8	53.03		
		Shqipëria	10+3	19.7	4+2	9.09	4+2	9.09	4+2	9.09	4+2	9.09		
		Maqedonia	3+1	6.06	3+1	6.06	3+1	6.06	3+1	6.06	3+1	6.06		
		Serbia dhe Mali i Zi	2+1	4.55	8+2	15.1 5	2+1	4.55	2+1	4.55	2+1	4.55		
		Greqia	1+0	1.52	1+0	1.52	1+0	1.52	1+0	1.52	1+0	1.52		
		Bosnja dhe Hercegovina	2+1	4.55	2+1	4.55	8+2	15.1 1	2+1	4.55	2+1	4.55		
		Kroacia	1+0	1.52	1+0	1.52	1+0	1.52	1+0	1.52	6+2	12.12		
		Turqia	2+1	4.55	2+1	4.55	2+1	4.55	8+2	15.1 5	2+1	4.55		
		Gjithsej	50+16	100	50+16	100	50+16	100	50+16	100	50+16	100	49+17	100

Planifikimi i përmbajtjeve programore

Kategoria	Nënkategoria	Tërësitë mësimore	Nr.orëve	Gjithsej nr. orëve	%	
Rajoni Regjioni	Gjeografia e Kosovës dhe vendeve përreth	Siujdhesa Ballkanike	2+1	2+1	4.29	
		Kosova				
		Pozita dhe madhësia	1+0			
		Natyra e Kosovës	9+3			
		Popullsia dhe vendbanimet	4+1			
		Ekonomia	8+2			
		Regjionet e Kosovës	5+2	27+8	53.03	
		Shqipëria				
		Pozita dhe veçoritë natyrore	3+1			
		Popullsia dhe vendbanimet	2+0			
Ekonomia	3+1					
Regjionet e Shqipërisë	2+1	10+3	19.70			
Shqipëria (për minoritetet)						
Pozita gjeografike dhe veçoritë natyrore	1+0					
Popullsia dhe vendbanimet	1+1					
Ekonomia	1+0					
Regjionet e Shqipërisë	1+1	(4+2)				
Maqedonia						
Pozita dhe veçoritë natyrore	1+0					
Popullsia dhe ekonomia	1+0					
Regjionet e Maqedonisë	1+1	3+1	6.06			

		Serbia dhe Mali i Zi Pozita dhe veçoritë natyrore Popullsia dhe ekonomia	1+0 1+1	2+1	4.55
		Serbia dhe Mali i Zi (Serbët dhe Malaziasit) Pozita dhe veçoritë natyrore Popullsia dhe vendbanimet Ekonomia Regjionet	2+0 2+1 2+0 2+1	(8+2)	
		Greqia Pozita,veçoritë natyrore, Popullsia dhe ekonomia	1+0	1+0	1.52
		Bosnja dhe Hercegovina Pozita dhe veçoritë natyrore Popullsia dhe ekonomia	1+0 1+1	2+1	4.55
		Bosnja dhe Hercegovina (Boshnjakët) Pozita dhe veçoritë natyrore Popullsia dhe vendbanimet Ekonomia Regjionet	2+0 2+1 2+0 2+1	(8+2)	
		Kroacia Pozita, veçoritë natyrore, popullsia dhe ekonomia	1+0	1+0	1.52

		Kroacia (Kroatët)			
		Pozita dhe veçoritë natyrore	1+0		
		Popullsia dhe vendbanimet	1+1		
		Ekonomia	2+0		
		Regjionet në Kroaci	2+1	(6+2)	
		Turqia			
		Pozita dhe veçoritë natyrore	1+0		
		Popullsia dhe ekonomia	1+1	2+1	4.55
		Turqia (Turqit)			
		Pozita dhe veçoritë natyrore	1+0		
		Popullsia dhe vendbanimet	2+1		
		Ekonomia	3+0		
		Regjionet e Turqisë	2+1	(8+2)	
		Gjithsej		50+16	100%

Vërejtje: Orët e paraqitura në kllapa kanë të bëjnë për pakicat kombëtare të cilat jetojnë në Kosovë. Të gjitha pakicat për Shqipërinë mësojnë me fondin 4+2 orë. Serbët dhe malaziasit për Serbi dhe Mal të Zi mësojnë me fond të orëve 8+2, sikurse edhe boshnjakët për Bosnjën e Hercegovinën (8+2), turqit për Turqinë (8+2) dhe kroatët për Kroacinë (6+2).

KATEGORIA	NËNKATEGORIA	PËRMBAJTJET PROGRAMORE	REZULTATET E PRITSHME	LIDHJA NDËRLËNDORE
REGJIONI	GJEOGRAFIA E KOSOVËS DHE VENDEVE PËR RETH	Gadishulli Ballkanik	<ul style="list-style-type: none"> - Të shpjegojë pozitën gjeografike dhe veçoritë natyrore të Gadishullit Ballkanik - Të tregojë ndarjen politike të G. Ballkanik - Të shpjegojë veçoritë demografike dhe ekonomike të G. Ballkanik 	Gjeopolitik, demografi, ekonomi
		Kosova Pozita gjeografike, shtrirja territoriale, madhësia dhe kufijtë	<ul style="list-style-type: none"> - Të tregojë përparësitë e pozitës gjeografike të Kosovës në G. Ballkanik - Të argumentojë lidhjet transfersale mes bregdetit dhe brendisë kontinentale - Të shpjegojë shtrirjen territoriale dhe kufizimin me vendet fqinje 	Gjeopolitik, ekonomi, matematikë, histori, sociologji
		Natyra e Kosovës: ndërtimi dhe zhvillimi gjeologjik, relievi, klima, ujërat, tokat (dherat), bota bimore dhe shtazore	<ul style="list-style-type: none"> - Të dallojë veçoritë kryesore gjeologjike - Të shpjegojë llojet e shkëmbinjve dhe pasuritë minerale - Të shpjegojë format kryesore të relievit dhe veçoritë e tyre - Të argumentojë rolin e relievit në aktivitetet njerëzore - Të shpjegojë faktorët klimatikë dhe tipat klimatikë - Të argumentojë vlerat mesatare dhe ekstreme të elemeneve klimatike dhe lëkundjet kohore e shtrirjet territoriale të tyre - Të vlerësojë pasuritë ujore dhe dallimet territoriale - Të dallojë veçoritë hidrologjike të pellgjeve 	Gjeologji, gjeomorfologji, klimatologji, hidrologji, biogjeografi, pedologji, fizikë, kimi, biologji

			<p>kryesore detare</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të dallojë llojet e liqeneve dhe veçoritë e tyre - Të vlerësojë rëndësinë e klimës dhe ujërave në aktivitete njerëzore - Të shpjegojë tipat kryesorë të tokave (dherave) dhe veçoritë e tyre - Të argumentojë shkaqet e degradimit, erozionit, ndotjes dhe keqpërdorimit të tokave. - Të shpjegojë shkaqet e biodiversitetit të theksuar 	
		<p>Popullsia dhe vendbanimet: rrjedhat historike të popullimit, numri, përhapja gjeografike, lëvizja e popullsisë, struktura e popullsisë, migrimet, diaspora dhe vendbanimet</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Të shpjegojë pse Kosova ka qenë herët e banuar - Të shpjegojë shtrirjen gjeografike të Dardanisë antike - Të shpjegojë pse Kosova gjatë historisë ishte mozaik etnik, kulturor, gjuhësor, fetar dhe vatër konfliktesh dhe luftërash të ndryshme - Të argumentojë shkaqet e ndryshimit të numrit të popullatës shqiptare dhe popujve të tjerë gjatë periudhave të ndryshme historike - Të shpjegojë ndryshimet hapësinore të dendësisë së popullsisë - Të dallojë faktorët që ndikojnë në shkallën e natalitetit dhe shtimit natyror të popullsisë - Të argumentojë shkaqet e natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror - Të vlerësojë strukturën moshore, ekonomike, gjinore, fetare, arsimore, nacionale dhe veçoritë e tyre 	<p>Arkeologji, Etnologji, Histori, Sociologji, Art, Demografi, Urbanizëm, Edukatë Qytetare</p>

			<ul style="list-style-type: none"> - Të shpjegojë faktorët që ndikojnë në migrimet e popullsisë dhe fazat kryesore - Të shpjegojë kriteret e ndarjes së vendbanimeve dhe funksionet e tyre - Të dallojë tiparet kryesore të qyteteve - Të argumentojë lidhjet mes industrializimit, urbanizimit dhe deagrarizimit 	
		<p>Ekonomia: faktorët e zhvillimit të ekonomisë, bujqësia, pylltaria, industria, faktorët e zhvillimit, burimet energjetike dhe pasuritë minerale, degët e industrisë, zhvillimi dhe shtrirja hapësinore, transporti, tregtia dhe turizmi</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Të dallojë faktorët natyrorë dhe shoqërorë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik - Të shpjegojë degët kryesore të bujqësisë dhe nivelin e zhvillimit të tyre - Të vlerësojë pyjet si pasuri kombëtare dhe rolin e tyre - Të dallojë faktorët që ndikojnë në zhvillimin e industrisë - Të dallojë degët kryesore të industrisë dhe zhvillimin e tyre - Të shpjegojë rolin e industrisë në transformimin e përgjithshëm ekonomik në Kosovë - Të vlerësojë burimet energjetike - Të dallojë llojet, rezervat dhe prodhimtarinë e xeheve kryesore - Të vlerësojë degët kryesore industriale: prodhimtarinë, lëndët e para, shpërndarjen gjeografike dhe nivelin e zhvillimit të tyre - Të dallojë faktorët të cilët ndikojnë në zhvillimin e transportit - Të përshkruajë llojet kryesore të transportit dhe 	Ekonomi, Sociologji, Histori, Gjeologji

			<ul style="list-style-type: none"> - nivelin e zhvillimit të tyre - Të vlerësojë bazën natyrore, kulturore dhe shoqërore në zhvillimin e turizmit - Të argumentojë potencialet turistike të Kosovës 	
		Regjionet e Kosovës	<ul style="list-style-type: none"> - Të shpjegojë kriteret e ndarjes regjionale të Kosovës - Të dallojë regjionet kryesore dhe veçoritë e tyre (natyrore, popullore dhe ekonomike) 	Gjeologji, pedologji, klimatologji, demografi ekonomi
		Shqipëria: Pozita gjeografike, veçoritë natyrore, popullore, ekonomike dhe ndarja regjionale	<ul style="list-style-type: none"> - Të shpjegojë pozitën gjeografike - Të shpjegojë veçoritë kryesore natyrore, - Të dallojë tiparet themelore popullore - Të tregojë veçoritë e vendbanimeve të Shqipërisë - Të dallojë faktorët natyrorë dhe shoqërorë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik - Të shpjegojë degët kryesore të bujqësisë dhe nivelin e zhvillimit të tyre - Të dallojë faktorët që ndikojnë në zhvillimin e industrisë - Të dallojë degët kryesore të transportit dhe zhvillimin e tyre - Të vlerësojë burimet energjetike - Të dallojë llojet, rezervat dhe prodhimtarinë e xeheve kryesore - Të vlerësojë degët dhe rajonet kryesore industriale - Të argumentojë potencialet turistike të 	gjeologji, pedologji, klimatologji, demografi, hidrologji, histori, sociologji, ekonomi

			<p>Shqipërisë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të dallojë regjionet kryesore të Shqipërisë dhe veçoritë e tyre - Të shpjegojë ndarjen administrative të Shqipërisë 	
	AMERIKA VERIORE	<p>- Pozita gjeografike, faktorët natyrorë-ekonomikë, popullsia, ndarja regjionale, grupimi ekonomik-politik</p> <p>(6+3)</p>	<p>- Të vlerësojë pozitën gjeografike dhe përthyerjen bregdetare</p> <p>- Të krahasojë dhe të dëshmojë për ngjashmëritë dhe ndryshimet mes zonave klimatike në Evropë dhe në Amerikën Veriore</p> <p>- Të shpjegojë dhe të krahasojë bregdetin atlantik evropian dhe ameriko-verior</p> <p>- Të gjykojë për ndryshimet në sasinë e reshjeve mes pjesës perëndimore (O.Paqësor) dhe asaj lindore (O. Atlantik)</p> <p>- Të dallojë tërësitë kryesore natyrore</p> <p>- Të shpjegojë veçoritë e zhvillimit ekonomik të SHBA</p> <p>- Të analizojë pse regjioni skaj Atlantikut, Liqeneve të Mëdha dhe O. Paqësor janë me popullsi dhe ekonomi më të përquendruar</p>	<p>Gjeologji, gjeomorfologji, klimatologji, ekonomi, demografi, biologji, histori, sociologji</p>
		<p>- Amerika e Mesme, veçoritë natyrore-</p>	<p>- Të vlerësojë ngjashmëritë dhe dallimet e elementeve natyrore dhe humane mes A.</p>	

		ekonomike, ndarja politike	Veriore, A. Qendrore dhe A. Jugore - Të shpjegojë veçoritë natyrore, populatave dhe ekonomike të Meksikos	
	AMERIKA JUGORE	- Pozita gjeografike, aktorët natyrorë, ekonomikë, popullsia, ndarja regjionale, grupimi ekonomik-politik (4+2)	- Të shpjegojë pozitën dhe veçoritë natyrore të A. Jugore - Të krahasojë formacionet bimore mes Amerikës Jugore dhe Afrikës - Të dallojë shtetet kryesore nga sipërfaqja dhe potencialet ekonomike - Të dëshmojë se me cilat prodhime dallohet ky regjion ndaj ekonomisë botërore - Të dallojë veçoritë ekonomike dhe populatave të Brazilit dhe Argjentinës	Gjeologji, gjeomorfologji, klimatologji, ekonomi, demografi, biologji, histori, sociologji
	AUSTRALIA DHE OQEANIA	- Australia dhe Oqeania, (2+1)	- Të dallojë veçoritë natyrore dhe shoqëro-ekonomike - Të shpjegojë se me cilat degë ekonomike Australia zë vend të rëndësishëm në ekonominë botërore - Të dallojë ishujt kryesorë të Oqeanisë dhe shtrirjen e tyre - Të analizojë zhvillimin ekonomik të Oqeanisë duke u mbështetur në pozitën gjeografike dhe kushtet natyrore	Gjeologji, gjeomorfologji, klimatologji, ekonomi, demografi, biologji, histori, sociologji

* **Vërejtje:** Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Greqia dhe Turqia nuk mësohen në klasën XII, sepse janë paraparë të mësohen në kl. XIII në suaza të lëndës Kosova dhe vendet përreth.

METODOLOGJIA E TË MËSUARIT

Zbatimi i metodave, teknikave, strategjive dhe formave të ndryshme të organizimit të procesit është një e drejtë profesionale e mësuesve.

Rekomandohet që për aspektet e shumta të rrafshit metodologjik, teorik edhe aplikativ të tregohet kujdesi i vaçantë. Metodologjia duhet të zgjidhet paraprakisht në përshtatje me përmbajtjen e temës që do të zhvillohet, por edhe në varësi të bazës didaktike dhe nivelit të formimit gjeografik të nxënësve.

Metodologjia është mirë të jetë tërësisht në shërbim të përvetësimit dhe përdorimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, shprehive, shkathtësive dhe vlerave gjeografike, në radhë të parë të atyre që duhen për t'u zgjidhur problemet e jetës së përditshme.

Metodat didaktike është mirë të ndërthuren me njëra-tjetrën gjatë gjithë orës së mësimi, në përputhje me karakterin e dijeve, të objektivave lëndorë si dhe në funksion të teknologjive të reja që mund të përdoren nga mësuesit dhe nxënësit.

Në grupin e metodave verbale rekomandohet të përdoren: metoda e shpjegimit, bashkëbisedimit, demonstrimit, diskutimit të lirë etj. Mësimdhënia me qendër nxënësin është shumë e kërkuar për t'i zbatuar në klasë, me qëllim që të ndodhë të nxënët aktiv dhe afatgjatë. Diskutimet mund të bëhen me gjithë klasën në dyshe, në grupe etj., ndërsa të nxënët në bashkëpunim mund të bëhet përmes teknikave të ndryshme si: stuhi mendimesh, pema e mendjes (klaster), leksikon i avancuar, xhigsou, ditari dypjesësh, di-dua të di- mësoj, termat paraprakë, diagrami i Venit, diskutimi që zgjidh problemin, pesëvargëshi, kubimi etj.

FORMAT E PUNËS NË MËSIMIN E GJEOGRAFISË

Në procesin mësimor të realizimit të përmbajtjeve programore të gjeografisë regjionale të botës aplikohen forma të ndryshme të punës:

- individuale
- në çifte
- në grupe
- me tërë klasën etj.

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

Verifikimi dhe vlerësimi i shkallës së përvetësimit të dijeve gjeografike nga nxënësit është një proces tepër i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të këtij programi. Për këtë arsye rekomandojmë që vlerësimet të përqendrohen më tepër në aspektet sasiore e cilësore të nivelit të arritjes nga nxënësit të objektivave të përgjithshëm e specifikë të paracaktuar. Prandaj, më të frytshme janë verifikimet, notimi dhe vlerësimet sistematike e të përditshme, mundësisht për të gjithë masën e nxënësve.

VLERËSIMI

Vlerësimi kërkon:

- Objektiva të çartë mësimorë
- Motivim të nxënësve
- Njohjen e përvojës dhe e aftësive të nxënësve
- Kërkesa të qarta të nxënësve dhe metoda e teknika mësimore efikase.

Vlerësimi bazohet në:

- Ç'thonë, Ç'shkruajnë dhe Ç'bëjnë nxënësit?

Instrumentet e vlerësimit

Mësimdhënësi i lëndës dhe shkolla duhet të zgjedhin dhe të zbatojnë një numër të mjaftueshëm instrumentesh për matje dhe vlerësim, siç janë:

- vrojtimi;
- pyetësi (vetëvlerësimi);
- raporti me shkrim i një pune praktike apo një hulumtimi;
- të shprehurit me gojë;
- të shprehurit me shkrim;
- fleta kontrolluese (përdoret për shkathhtësitë manovruese të nxënësit);
- dosja apo portofoli (vetëvlerësimi);
- testi i bazuar në kritere dhe objektiva;
- testi i arritshmërisë i ndërtuar nga kërkesa (pyetje);
 - me përgjigje alternative të shumta;
 - me përgjigje të hapura të shkurtra;
 - me përgjigje të hapura të zgjedhura etj.

dhe çdo instrument tjetër që mësimitdhënësi e vlerëson të nevojshëm.

Etapat e vlerësimit:

- Kontrolli, p.sh. ç'din (ç'është arritur) dhe ç'farë nuk din nxënësit (ç'nuk është arritur);
- Matja, ajo që kontrollohet matet;
- Vlerësimi, nënkupton vendosjen e një vlere gjykimi, sasior ose cilësor bazuar në matje me notë.

Kategoritë e vlerësimit:

- formuese
- diagnostifikues
- përmbledhës(testimi)
- motivues

Shkalla e përfitimit

Në fund të vitit mësimor çdo nxënës duhet të arrijë një të njënjën prej shkallëve të përfitimit të arritshmërisë:

- shkëlqyeshëm (arritje shumë e lartë);
- shumë mirë (arritje e lartë);
- mirë (arritje mesatare);
- mjaftueshëm (arritje e kufizuar) dhe
- pamjaftueshëm (arritje e pamjaftueshme)

**PËRDORIMI I TEKSTEVE
DHE I BURIMEVE TË TJERA MËSIMORE**

- Libri i klasës
- Doracakët
- Globi
- Atlasi
- Harta të ndryshme
- Broshura
- Gazeta, revista profesionale dhe shkollore
- Fotografí, postere, skema, diagrame, tabela, grafikone, imazhe satelitore etj.
- Fotoslajde, filma, videokaseta
- Programet e kompjuterëve, interneti, CD etj.

HISTORIA

Gjimnazi i përgjithshëm (2 orë në javë, 74 orë në vit)

HYRJE

Në lëndën e historisë synohet që nxënësit të avancojnë njohuritë për rrjedhojat e zhvillimeve të përgjithshme shoqërore historike dhe të zhvillojnë shkathtësitë për jetën e tyre të përditshme. Pretendohet që përmes lëndës së historisë të formësohet personaliteti i nxënësve në aspektin shoqëror, politik, kulturor, fetar, human, demokratik etj.

QËLLIMET

Programi mësimor i lëndës së historisë ka për qëllim:

- Zhvillimin e aftësive të nxënësve për të kuptuar dhe analizuar ligjshmëritë e proceseve shoqërore, organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e shoqërisë njerëzore nga Kongresi i Vjenës (1814) deri në fundin e Luftës së Parë Botërore.
- Aftësimin e nxënësve për të analizuar dhe krahasuar mënyrën e jetesës, të menduarit, zhvillimin ekonomik, politik, shoqëror, të arriturat shkencore në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX.
- Aftësimin e nxënësve për të analizuar rolin e personaliteteve që kanë lënë gjurmë në histori si dhe veprave të mëdha që ndikuan në kahet e zhvillimit të shoqërisë njerëzore.
- Zhvillimin e të menduarit kritik për shkaqet dhe pasojat e luftërave dhe ngjarjeve të tjera të rëndësishme që e karakterizojnë këtë periudhë.
- Aftësimin e nxënësve mbi rolin dhe rëndësinë e burimeve historike, interpretimin dhe përpunimin e tyre si vlerë më e lartë arsimore për lëndën e historisë, për të arritur rezultate të dobishme dhe afatgjata.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësit duhet të jetë në gjendje:

Të njohin

- Zhvillimet e përgjithshme shoqërore dhe ligjshmëritë e këtyre zhvillimeve gjatë shekullit XIX dhe në dekadat e para të shekullit XX.

Të kuptojnë

- Domethëniet e termave dhe konceptet kryesore për ngjarjet e kësaj periudhe dhe mënyrën se si ato janë interpretuar nga ana e historianëve, shkrimtarëve, politikanëve, mediave etj.

Të identifikojnë

- Personalitetet më të shquara politike, kulturore, arsimore, shkencore etj., të këtyre periudhave nga historia kombëtare, rajonale e botërore.

Të analizojnë

- Format e organizimeve shoqërore dhe shtetërore, jetën e njerëzve, zhvillimin e kulturave dhe besimeve në vend, rajon, Evropë e më gjerë.
- Pikëpamjet e ndryshme për çështje të ndryshme historike dhe të nxjerrin përfundime të vërteta për çështjet kontrastive me qëllim të krijimit të një pikëpamje më të balancuar për të tashmen dhe perspektivë reale për të ardhmen.

Të vlerësojnë

- Rolin e shteteve dhe institucioneve vendore e ndërkombëtare në avancimet e proceseve shoqërore.
- Ngjarjet historike që ndikuan negativisht në zhvillimin shoqëror, në mënyrë që ato të mos përsëriten.

Të zhvillojnë qëndrime dhe vlera

- Të çmojnë të arriturat dhe vlerat humane të shoqërisë njerëzore gjatë shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.
- Sendëtojnë ndjenjën dhe nevojën e mirëkuptimit, bashkëpunimit dhe kultivimit të marrëdhënieve demokratike.
- Respektimin e dallimeve (klasore, gjinore, etnike, kulturore, religjioze etj.) në shoqëri.
- Për ruajtjen e trashëgimisë arkeologjike, ruajtjen e monumenteve kulturo-historike, muzeve, arkivave, bibliotekave etj., si pasuri kombëtare e njerëzore në përgjithësi.

GJIMNAZI I PËRGJITHSHËM

2 x 37 = 74 orë në vit (55 orë zhvillim, 4 orë në dispozicion dhe 15 orë përsëritje)

Kategoria	Nënkategoria	Përmbajtjet programore	Rezultatet e pritshme	Ndërlidhjet programore
IV. KOHA E RE	3. Evropa gjatë Kohës së Re	<i>Nxënësit duhet të mësojnë për:</i> Evropa në shekullin XIX , deri në Krizën Lindore Kongresi i Vjenës dhe Lidhja e Shenjtë. Anglia në vitet 1815-1871. Franca në vitet 1815-1871. Gjermania në vitet 1815-1871. Italia në vitet 1815-1871 Austro-Hungaria nga Kongresi i Vjenës e deri te Kriza Lindore. Rusia në shekullin XIX deri te Kriza Lindore. (7 orë)	<i>Nxënësit:</i> - Njohin vendimet e Kongresit të Vjenës dhe rrjedhojat e tyre për vendet evropiane. - Kuptojnë rrethanat dhe zhvillimet e përgjithshme në vendet kryesore evropiane në atë kohë. - Analizojnë shkaqet, rrjedhojat dhe ndikimin e Revolucionit të vitit 1848 në Evropë. - Analizojnë dhe vlerësojnë ndryshimet në Francë dhe rëndësinë e bashkimit të Gjermanisë dhe të Italisë.	<i>Me:</i> Gjeografinë, ekonominë, filozofinë, letërsinë etj.
IV. KOHA E RE	6. Arsimi, kultura shkenca dhe teknika	Idetë liberale Zhvillimi i ideve liberale në Evropë. Të arriturat në: shkencë, teknikë dhe kulturë në shekullin XIX. (2 orë)	- Kuptojnë rrethanat e zhvillimit të ideve liberale dhe ndikimin e tyre. - Çmojnë dhe vlerësojnë të arriturat shkencor-teknike dhe kulturore të shekullit XIX.	Gjeografinë, ekonominë, filozofinë, sociologjinë, letërsinë etj.

<p>IV. KOHA E RE</p>	<p>4. Perandoria Osmane dhe Ballkani gjatë Kohës së Re</p>	<p>Perandoria Osmane dhe Ballkani gjatë Kohës së Re Perandoria Osmane në shekullin XIX deri më 1878. Luftërat çlirimtare në: Greqi, Serbi e Mal të Zi. Luftërat çlirimtare në Rumani dhe në Bullgari. Shqipëria në periudhën e Tanzimatit. Fillet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Kriza Lindore e viteve `70 dhe rreziku i copëtimit të tokave shqiptare. Formimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Lufta e Lidhjes për ruajtjen e tërësisë së tokave shqiptare. Qeveria e Përkohshme e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Lidhja Shqiptare e Pejës.</p> <p>(10 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kuptojnë rrethanat e gjithmbarshme të zhvillimit politik e ekonomik të Perandorisë Osmane dhe reflektimet e saj në Ballkan. - Analizojnë rrethanat e luftërave çlirimtare të popujve të Ballkanit për liri kombëtare. - Mund të flasin në mënyrë të argumentuar për pozitën e popullit shqiptar në atë kohë. - Analizojnë rrethanat që rrezikonin copëtimin e tokave shqiptare. - Çmojnë dhe vlerësojnë Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, Lidhjen e Pejës. - Kuptojnë dhe vlerësojnë rolin e personaliteteve kombëtare në Lëvizjen Kombëtare. 	<p>Gjeografinë, ekonominë, fiziofinë, letërsinë, artin etj.</p>
<p>IV. KOHA E RE</p>	<p>6. Arsimi, kultura shkenca dhe teknika</p>	<p>Arsimi dhe kultura Arsimi dhe kultura gjatë fazës së parë të Lëvizjes Kombëtare. Arsimi dhe kultura shqiptare gjatë Lidhjes së Prizrenit. Përhapja e shkollës kombëtare dhe</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Identifikojnë të arriturat kryesore në lëmin e arsimit dhe të kulturës kombëtare gjatë asaj kohe. - Krahasojnë zhvillimet arsimore e kulturore dhe ndikimet e tyre të popullit shqiptar. 	<p>Gjeografinë, ekonominë, filozofinë, letërsinë, artin etj.</p>

		<p>letërsisë shqiptare pas Lidhjes së Prizrenit.</p> <p>Monumentet kulturo-historike të shekullit XIX dhe të fillimit të shekullit XX.</p> <p>(4 orë)</p>	<p>- Identifikojnë monumentet kulturo-historike kryesore të asaj periudhe dhe vlerësojnë rëndësinë e tyre.</p>	
IV. KOHA E RE	5. Azia, Afrika dhe Amerika gjatë Kohës së Re	<p>Azia, Afrika dhe Amerika gjatë Kohës së Re</p> <p>Lufta civile në SHBA.</p> <p>SHBA-të pas luftës civile.</p> <p>Amerika Latine në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX.</p> <p>Kina , Japonia dhe India në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.</p> <p>Afrika në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.</p> <p>(5 orë)</p>	<p>- Njohin zhvillimet e përgjithshme në SHBA, Amerikën Latine, Azi dhe Afrikë në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX.</p> <p>- Dallojnë veçoritë kryesore të këtyre vendeve.</p> <p>- Krahasojnë rrjedhojat ekonomike politike në këto vende me ato evropiane.</p>	Gjeografinë, artinë, filozofinë, letërsinë etj.
IV. KOHA E RE	3. Evropa gjatë Kohës së Re	<p>Evropa në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.</p> <p>Gjermania, Anglia, Franca, Rusia, Austro-Hungaria dhe Italia në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.</p> <p>(5 orë)</p>	<p>- Kuptojnë rrethanat e përgjithshme në vendet kryesore evropiane në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.</p> <p>- Analizojnë veçoritë dalluese zhvillimore në këto vende.</p>	Gjeografinë, ekonominë, shkencat juridike, sociologjinë, filozofinë, artin, letërsinë etj.

IV. KOHA E RE	4. Perandoria Osmane dhe Ballkani gjatë Kohës së Re	Perandoria Osmane dhe Ballkani në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Perandoria Osmane në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Greqia në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Bullgaria dhe Rumania në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX (4 orë)	- Mund të diskutojnë me argumente për rrethanat e përgjithshme në Perandorinë Osmane dhe pozitën e popujve dhe shteteve të Ballkanit në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.	Gjeografinë, ekonominë, shkencat juridike, artin, muzikën, letërsinë, gjuhën etj.
IV. KOHA E RE	6. Arsimi, kultura shkenca dhe teknika	Arsimi dhe kultura Arsimi dhe kultura te popujt e Ballkanit në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. (1 orë)	- Identifikojnë të arriturat kryesore në arsim dhe kulturë te popujt e Ballkanit.	Edukatën qytetare, gjuhën, letërsinë, artin, muzikën etj.
V. KOHA BASHKËKOHORE	1. Bota në fillim të shekullit XX	Shqiptarët në fillim të shekullit XX Lëvizja Kombëtare në vitet 1901-1908 Lëvizja Kombëtare në vitet 1909-1911.	- Dallojnë fazat e zhvillimeve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe kryengritjet antiosmane që karakterizojnë vitet e para të shekullit	Gjeografinë, ekonominë, shkencat juridike, artin, muzikën,

		<p>Kryengritja e përgjithshme shqiptare e vitit 1912. Luftërat Ballkanike (1912-1913). Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë dhe veprimtaria kombëtare e Qeverisë së Vlorës. Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe pasojat e saj për shqiptarët. Shqipëria gjatë regjimit të Princ Vilhem Vidit. Lëvizja atdhetare në mërgim.</p> <p>(8 orë)</p>	<p>XX. - Analizojnë shkaqet dhe pasojat e Luftërave Ballkanike. - Kuptojnë rrethanat dhe vlerësojnë rëndësinë e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë për popullin shqiptar. - Gjykojnë rreth vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër dhe pasojat që patën ato për popullin shqiptar. - Mund të përshkruaj karakteristikat e regjimit të Princ Vidit dhe arsyet e largimit të tij nga Shqipëria.</p>	<p>letërsinë, gjuhën etj.</p>
<p>V. KOHA BASHKËKOHORE</p>	<p>1. Bota në fillim të shekullit XX</p>	<p>Lufta e Parë Botërore Marrëdhëniet ndërkombëtare në prag të Luftës së Parë Botërore. Lufta e Parë Botërore (1914-1916). Hyrja e SHBA-ve në luftë dhe përfundimi i saj (1917-1918). Shqipëria gjatë Luftës së Parë Botërore. Kosova dhe viset e tjera shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore.</p> <p>(5 orë)</p>	<p>- Janë në gjendje të interpretojnë arsyet e shpërthimit të Luftës së Parë Botërore. - Dallojnë veprimet kryesore ushtarake, politike e diplomatike të Fuqive të Mëdha gjatë Luftës së Parë Botërore. - Përshkruajnë pozitën e shqiptarëve gjatë Luftës së Parë Botërore. - Analizojnë dëmet që solli Lufta e Parë Botërore për njerëzimin në përgjithësi dhe për shqiptarët në veçanti.</p>	<p>Gjeografinë, edukatën qytetare, shkencat juridike, artin, letërsinë etj.</p>

V. KOHA BASHKËKOHORE	5. Të arriturat në: kulturë, shkencë e teknikë gjatë shekullit XX	Arsimi, kultura, shkenca, teknika Të arriturat në: kulturë, shkencë e teknikë në fillim të shekullit XX. Zhvillimi i arsimit te shqiptarët në fillim të shekullit XX. Letërsia dhe arti shqiptar në fillim të shekullit XX. (4 orë)	- Vlerësojnë të arritura në kulturë, shkencë e teknikë në aspektin e përgjithshëm dhe kombëtar që pati në fillim të shekullit XX.	Gjeografinë, ekonominë, filozofinë, sociologjinë, letërsinë, artin, muzikën, teknologjinë etj.
-------------------------------------	--	---	---	--

Vërejtje: 4 orë mësimore janë në dispozicion të arsimtarit që sipas dëshirës dhe interesimit të nxënësve të kenë mundësi për të zgjedhur ndojnë njësi mësimore në kuadër të përmbajtjeve programore, historisë lokale etj. Mund të realizohet edhe vizitë ndonjë institucioni-vendi kulturo-historik (arkivave, muzeve, bibliotekave, instituteve, monumenteve etj.

HISTORI

Gjimnazi i shkencave shoqërore (3 orë në javë, 99 orë në vit)

QËLLIMET

Programi mësimor i historisë ka për qëllim:

- Aftësimin e nxënësve për të kuptuar dhe analizuar ligjshmëritë e proceseve shoqërore, organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e shoqërisë njerëzore nga Lufta e Parë Botërore deri më sot.
- Zhvillimin e aftësive të nxënësve për të analizuar dhe krahasuar mënyrën e jetesës, të menduarit, zhvillimit ekonomik, politik, shoqëror, të arriturve shkencore të njerëzimit gjatë shekullit XX.
- Aftësimin e nxënësve për të kuptuar rolin e personaliteteve dhe ndikimin e tyre në kahet e zhvillimit të shoqërisë njerëzore.
- Të gjykuarit drejt për shkaqet, rrjedhojat dhe pasojat e luftërave, ndryshimet shoqërore që sollën revolucionet etj.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësi duhet të jenë në gjendje:

Të njohë

- Kronologjinë e zhvillimeve të ngjarjeve më kryesore nga historia e vendit, rajonit dhe e botës Lufta e Parë Botërore deri më sot.
- Proceset dhe ligjshmëritë e zhvillimeve të përgjithshme shoqërore ekonomike, politike, kulturore, religjioze etj.

Të kuptojë

- Shkaqet dhe faktorët kryesorë që ndikuan në thyerjet e mëdha shoqërore dhe avancimet demokratike gjatë kësaj periudhe.
- Rëndësinë e të arriturave shkencore dhe teknike dhe ndikimin e tyre për përparimin e përgjithshëm të shoqërisë njerëzore në këtë periudhë.

Të analizojnë

- Faktorët që ndikuan në zhvillimet e proceseve shoqërore gjatë kësaj periudhe.
- Pikëpamjet e ndryshme për ngjarjet me rëndësi të veçantë, duke u mbështetur në burime historike.

Të vlerësojnë

- Rolin e shteteve dhe të institucioneve vendore e ndërkombëtare në avancimet e proceseve shoqërore.
- Ngjarjet historike që ndikuan negativisht në zhvillimin shoqëror, në mënyrë që ato të mos përsëriten.
- Kontributin e personaliteteve kryesore të vendit, të rajonit dhe të botës.

Të zhvillojnë qëndrime dhe vlera

- Të çmojnë të arriturat dhe vlerat e shoqërisë njerëzore gjatë shekullit XX.
- Sendërtojnë ndjenjën dhe nevojën e mirëkputimit, bashkëpunimit dhe kultivimit të marrëdhënieve demokratike.
- Respektimin e dallimeve (klasore, gjinore, etnike, kulturore, religjioze etj.) në shoqëri
- Për ruajtjen e trashëgimisë arkeologjike, ruajtjen e monumenteve kulturo-historike, muzeve, arkivave, bibliotekave etj., si pasuri kombëtare e njerëzore në përgjithësi.

GJIMNAZI I SHKENCAVE SHOQËRORE

3 x 33 = 99 orë në vit (81 orë zhvillim, 4 orë në dispozicion dhe 14 orë përsëritje)

Kategoria	Nënkategoria	Përmbajtjet programore	Rezultatet e pritshme	Ndërlidhjet programore
V. KOHA BASHKËKOHORE	1. Bota në fillim të shekullit XX	<p><i>Nxënësit duhet të mësojnë për:</i></p> <p>Lufta e Parë Botërore Marrëdhëniet ndërkombëtare para Luftës së Parë Botërore. Lufta e Parë Botërore (1914-1916). Hyrja e SHBA-ve në luftë dhe përfundimi i luftës (1917-1918). Revolucioni i Tetorit dhe ndikimi i tij. Shqipëria gjatë Luftës së Parë Botërore. Kosova dhe viset e tjera shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore. Shqipëria në mbarim të Luftës së Parë Botërore. Lufta për çlirimin e krahinave të pushtuara nga Italia dhe Mbretëria Serbo-Kroato-Sllovene (SKS). Kongresi Kombëtarë i Lushnjës. Ripushtimi serb i Kosovës dhe lufta për çlirim dhe bashkim kombëtar.</p> <p>(10 orë)</p>	<p><i>Nxënësit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Janë në gjendje të interpretojnë rrethanat që çuan në shpërthimin e Luftës së Parë Botërore. - Dallojnë veprimet kryesore ushtarake, politike e diplomatike të Fuqive të Mëdha gjatë Luftës së Parë Botërore. - Përshkruajnë pozitën e shqiptarëve gjatë Luftës së Parë Botërore. - Shpjegojnë arsyet e shpërthimit të Revolucionit të Tetorit në Rusi dhe ndikimet që pati ai. - Kuptojnë rëndësinë e Kongresit të Lushnjës dhe luftërave për ruajtjen e trojeve shqiptare nga copëtimi. - Vlerësojnë pozitën e Kosovës në fundin e Luftës së Parë Botërore. - Analizojnë dëmet që solli Lufta e Parë Botërore për njerëzimin në përgjithësi dhe për shqiptarët në veçanti. 	<p><i>Me:</i></p> <p>Gjeografinë, fizikën, matematikën, biologjinë etj.</p>

<p>V. KOHA BASHKËKOHORE</p>	<p>2. Bota midis dy luftërave botërore</p>	<p>Bota midis Dy Luftërave Botërore Paqja e Versajës dhe Lidhja e Kombeve. Evropa midis dy luftërave botërore (Britania e Madhe në vitet 1918-1939, Franca në vitet 1918-1939, Italia në vitet 1918-1925, Italia në vitet 1926-1939, Gjermania në vitet 1918-1933, Gjermania në vitet 1934-1939, Spanja në vitet 1918-1939, Turqia midis dy luftërave botërore, Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike-BRSS 1918-1939, Vendet Skandinave midis dy luftërave botërore). Amerika, Azia dhe Afrika midis dy luftërave botërore (SHBA midis dy luftërave botërore, Amerika Latine midis dy luftërave botërore, Kina dhe Japonia midis dy luftërave botërore, India midis dy luftërave botërore, Vendet Afrikane në vitet 1918-1939). (16 orë)</p>	<p>- Kuptojnë vendimet e Konferencës së Paqes në Versajë dhe rrjedhojat e tyre. - Vlerësojnë rolin e Lidhjes së Kombeve. - Analizojnë situatën e brendshme dhe rolin ndërkombëtar të shteteve kryesore botërore si (SHBA, Britania e Madhe, Franca, Italia, Gjermania, Spanja, Turqia, BRSS). - Kanë njohuri dhe mund të diskutojnë me argumente për pozitën dhe rolin e vendeve skandinave, Kinës, Indisë, Japonisë, vendeve të Amerikës Latine e të vendeve të Afrikës. - Dallojnë të arriturat kryesore ekonomike mes dy luftërave botërore.</p>	<p>Gjeografinë, edukatën qytetare, artin etj.</p>
<p>V. KOHA BASHKËKOHORE</p>	<p>5. Të arriturat në: kulturë, shkencë e teknikë gjatë shekullit XX</p>	<p>Të arriturat shkencore, teknike e kulturore Të arriturat në shkencë e teknikë. Zhvillimi i arsimit, kulturës dhe artit mes dy luftërave botërore. (2 orë)</p>	<p>- Kuptojnë për të arriturat kryesore shkencoro-teknike dhe kulturore mes dy luftërave botërore. - Vlerësojnë të arriturat shkencoro-teknike dhe kulturore mes dy luftërave botërore.</p>	<p>Letërsinë, gjeografinë, edukatë qytetare etj.</p>

<p>V. KOHA BASHKËKOHORE</p>	<p>2. Bota midis dy luftërave Botërore</p>	<p>Balkani midis dy luftërave botërore Shqipëria në vitet 1920-1923. Revolucioni i vitit 1924 në Shqipëri. Shqipëria gjatë sundimit të Ahmet Zogut. Shqipëria në vitet e Krizës Ekonomike Botërore (1929-1933) Jugosllavia midis dy luftërave botërore. Pozita e shqiptarëve në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi midis dy luftërave botërore. Qëndresa e shqiptarëve kundër dhunës jugosllave. Greqia midis dy luftërave botërore. Rumania dhe Bullgaria midis dy luftërave botërore. (9 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kuptojnë pozitën e popujve të Ballkanit mes dy luftërave botërore në përgjithësi dhe të popullit shqiptar në veçanti. - Analizojnë rrjedhojat e përgjithshme të shteteve ballkanike në atë periudhë. - Mund të diskutojnë me argumente për periudhën e sundimit të Ahmet Zogut në Shqipëri. - Vlerësojnë rrethanat në të cilat u zhvillua, dhe ndikimet që pati Revolucioni i Qershorit 1924. - Përshkruajnë pozitën e Kosovës në atë kohë, gjendjen e popullsisë shqiptare dhe luftën e tyre për ruajtjen e identitetit dhe integritetit nga përpjekjet për shkombëtarizim. 	<p>Letërsinë, gjeografinë, edukatën qytetare, artin, muzikën, filozofinë, teknologjinë etj.</p>
<p>V. KOHA BASHKËKOHORE</p>	<p>5. Të arriturat në: kulturë, shkencë e teknikë gjatë shekullit XX</p>	<p>Arsimi dhe kultura Arsimi dhe kultura në Shqipëri mes dy luftërave botërore. Arsimi dhe kultura në Kosovë mes dy luftërave botërore. (2 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kuptojnë për të arriturat kryesore arsimore e kulturore të popullit shqiptar mes dy luftërave botërore. - Vlerësojnë dhe çmojnë ato të arritura. 	<p>Gjeografinë, letërsinë, edukatën qytetare etj.</p>
<p>V. KOHA BASHKËKOHORE</p>	<p>3. Bota gjatë Luftës së Dytë Botërore</p>	<p>Lufta e Dytë Botërore Bota në prag të Luftës së Dytë Botërore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Janë në gjendje të interpretojnë rrethanat që çuan në shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore. 	<p>Gjeografinë, letërsinë, edukatën</p>

		<p>Fillimi dhe zhvillimet e Luftës së Dytë Botërore në vitet 1939-1941. Lufta e Dytë Botërore 1941-1943. Lufta e Dytë Botërore 1944-1945. Pushtimi italiano- fashist i Shqipërisë dhe lufta e popullit shqiptar kundër tij (1939-1943). Pushtimi gjermano- nazist i Shqipërisë dhe lufta e popullit shqiptar kundër tij. Çlirimi i Shqipërisë. Lufta antifashiste në Kosovë (1941-1943). Lufta antifashiste në Kosovë (1943-1944). Ripushtimi jugosllav i Kosovës (1945). Pasojat e Luftës së Dytë Botërore. Holokausti.</p> <p>(12 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Dallojnë veprimet kryesore ushtarake, politike e diplomatike të Fuqive të Mëdha gjatë Luftës së Dytë Botërore. - Përshkruajnë pozitën e Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore, pushtimin Italiano-fashist dhe gjermano-nazist. - Vlerësojnë dhe çmojnë rolin e Luftës Nacional Çlirimtare të popullit shqiptar. - Dallojnë qëndrimet dhe pikëpamjet e forcave kryesore politike e ushtarake të shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore. - Vlerësojnë pozitën e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe luftën antifashiste. - Kuptojnë dhe nxjerrin përfundime për ripushtimin jugosllav të Kosovës. - Analizojnë dëmet që solli Lufta e Dytë Botërore për njerëzimin në përgjithësi dhe për shqiptarët në veçanti. - Mund të diskutojnë me argumente për tmerret e Holokaustit dhe ndikimin e saj në vetëdijen e njerëzimit për angazhimin kundër luftërave. 	<p>qytetare, artin, ekonominë etj.</p>
--	--	---	---	---

V. KOHA BASHKËKOHORE	5. Të arriturat në: kulturë, shkencë e teknikë gjatë shekullit XX	Arsimi, kultura Arsimi dhe kultura në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore. (1 orë)	- Përshkruajnë situatën në të cilën pati zhvillime në arsim e kulturë në atë kohë.	Gjeografinë, letërsinë, edukatën qytetare, artin etj.
V. KOHA BASHKËKOHORE	4. Bota pas Luftës së Dytë Botërore	Bota pas Luftës së Dytë Botërore Situata ndërkombëtare dhe Lufta e Ftohtë. SHBA në vitet 1945-1990. Britania e Madhe në vitet 1945-1990. Franca në vitet 1945-1990. Gjermania në vitet 1945-1990. Italia në vitet 1945-1990. BRSS në vitet 1945-1990. Vendet e Evropës Lindore pas Luftës së Dytë Botërore. Azia dhe Afrika pas Luftës së Dytë Botërore. Amerika Latine pas Luftës së Dytë Botërore. Forcimi i paqes dhe i sigurisë në Evropë (OKB, OSBE, BE, KE, NATO etj.). Lëvizjet demokratike të viteve '90 në Evropën Lindore. Kriza e sistemit komunist dhe shpërbërja e BRSS. Globalizmi dhe problemet globale.	- Kuptojnë gjendjen ndërkombëtare pas Luftës së Dytë Botërore. - Mund të shpjegojnë arsyet që sollën Luftën e Ftohtë. - Kuptojnë zhvillimet e gjithmbar- shme në vendet kryesore botërore (në Evropë dhe kontinentet e tjera) dhe rolin e tyre në marrëdhëniet ndërkombëtare. - Shpjegojnë me argumente ndryshimet pozitive që ndikuan në ndryshimet demokratike në Evropë. - Mund të interpretojnë mënyrën e organizimit e funksionimit të organizatave dhe institucioneve të rëndësishme ndërkombëtare si OKB, OSBE, BE, KE, NATO etj. dhe rolin e tyre të rëndësishëm për paqe, siguri e zhvillim. - Çmojnë rëndësinë e ngadhënjimit të proceseve demokratike ndaj komunizmit në Evropën Lindore. - Vlerësojnë rëndësinë e rënies së sistemit komunist në BRSS dhe	Edukatën qytetare, gjeografinë, artin etj

		(15 orë)	ndikimet pozitive që pati. - Kuptojnë tendencat globalizuese dhe problemet e ndryshme globale (terrorizmi, ndotja e mjedisit etj.).	
V. KOHA BASHKËKOHORE	4. Bota pas Luftës së Dytë Botërore	Ballkani pas Luftës së Dytë Botërore Jugosllavia gjatë viteve 1945-1990. Bullgaria dhe Rumania në vitet 1945-1990. Greqia dhe Turqia pas Luftës së Dytë Botërore. Vendosja e regjimit komunist në Shqipëri (1944-1948). Shqipëria gjatë regjimit komunist (1948-1990). Përmbysja e diktaturës komuniste dhe fitorja e demokracisë në Shqipëri. Kosova dhe viset e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi gjatë viteve 1945-1948. Kosova dhe shqiptarët deri te Plenumi i Brioneve (1949-1966). Kosova dhe shqiptarët pas Plenumit të Brioneve (1966-1974). Kosova element konstituiv i Federatës Jugosllave (1974 -1981). Demonstratat e vitit 1981 dhe rritja e represionit ndaj shqiptarëve. Lëvizja demokratike në Kosovë (1989-1997). Lufta e UÇK-së, ndërhyrja e NATO-së	- Kuptojnë gjendjen e përgjithshme të popujve dhe shteteve ballkanike pas Luftës së Dytë Botërore. - Mund të shpjegojnë arsyet dhe momentet kryesore të vendosjes së sistemit komunist në Shqipëri. - Analizojnë gjithanshëm periudhën e sistemit komunist në Shqipëri. - Vlerësojnë arsyet që çuan në përmbysjen e sistemit komunist në Shqipëri dhe rëndësinë e kësaj për popullin shqiptar në përgjithësi. - Analizojnë dhe mund të komentojnë fazat e ndryshme nëpër të cilat kaluan Kosova dhe viset e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi. - Kuptojnë politikën e shtetit jugosllav ndaj shqiptarëve. - Çmojnë veprimet e personaliteteve shqiptare për liri e përparim kombëtar. - Përshkruajnë eskalimin e situatës dhe likuidimin e autonomisë së Kosovës nga regjimi serb. - Analizojnë dhe çmojnë	Edukatën qytetare, gjeografinë, letërsinë artin, filozofinë, sociologjinë etj

		<p>dhe çlirimi i Kosovës. Diaspora shqiptare në Evropë, SHBA dhe vendet e tjera 1945-1990.</p> <p>(14 orë)</p>	<p>vetorganizimin e shqiptarëve dhe vendimet e tyre për liri dhe pavarësi. - Vlerësojnë dhe çmojnë shkaqet e daljes së UÇK-së në skenë, luftën e saj për liri, intervenimin ndërkombëtar të NATO-së dhe çlirimin e Kosovës. - Identifikojnë veprimtarinë e diasporës shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore dhe rolin e saj të rëndësishëm për kombin.</p>	
<p>V. KOHA BASHKËKOHORE</p>	<p>5. Të arriturat në: kulturë, shkencë e teknikë gjatë shekullit XX</p>	<p>Arsimi, kultura, shkenca Zhvillimi i arsimit dhe kulturës në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore. Zhvillimi i arsimit dhe kulturës në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore.</p> <p>(2 orë)</p>	<p>- Vlerësojnë të arriturat në arsim, shkencë e kulturë të shqiptarët pas Luftës së Dytë Botërore.</p>	<p>Gjeografinë, letërsinë, artin etj.</p>

Vërejtje: 4 orë mësimore janë në dispozicion të arsimtarit që sipas dëshirës dhe interesimit të nxënësve të kenë mundësi për të zgjedhur ndonjë njësi mësimore në kuadër të përmbajtjeve programore, historisë lokale etj. Mund të realizohet edhe vizitë ndonjë institucioni-vendi kulturo-historik (arkivave, muzeve, bibliotekave, instituteve, monumenteve etj.

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Metodologjia e mësimdhënjes përcakton suksesin e realizimit të qëllimeve dhe objektivave që mësimdhënësi ia paracakton vetes në bazë të përmbajtjeve programore.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies janë po aq të larmishme sa edhe vetë stilet dhe mënyrat e nxënies së vetë nxënësve. Prandaj, gjatë një ore mësimore, mësimdhënësi mund të përdorë disa forma, teknika, dhe metoda mësimore të kombinuara me njëra-tjetrën në mënyrë që të arrijë rezultate optimale gjatë procesit mësimor. Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxënie cilësore me nxënësin në qendër sugjerohen, metoda, forma dhe teknika të tilla si:

Format kryesore të organizimit të procesit mësimor janë:

Puna me gjithë klasën,

Puna me grupe (të mëdha ose të vogla)

Puna me çifte

Puna individuale

Metodat:

E mësimdhënies - (kallëzimi, shpjegimi, ligjërata, biseda, demonstrimi etj.)

E të mësuarit - është metodë e punës së përbashkët e mësimdhënësit dhe nxënësve dhe përdoret për arritjen e qëllimeve, synimeve, qëllimeve, objektivave etj,

E të nxënit - (vrojtimi i pavarur, ushtrimet, diskutimet, debatet, shfrytëzimi i literaturës,shkëmbimi i mendimeve etj.)

Kërkimore - është metodë që mundëson të bëhen kërkime historike nëpërmjet burimeve dhe analizave lidhur me saktësinë dhe interpretimin e fakteve të gjetura.

Teknikat:

Ekziston një numër i madh teknikash të mësimdhënies dhe të nxënies. Këtu sugjerohen vetëm disa prej tyre.

- **Brainstormingu** (“stuhi, mendimesh“, **gjenerim ideshë**)- është teknikë efektive që më tepër përdoret në fillim të orës mësimore.

- **Klasteri (grumbulli apo pema e mendimeve)** - nxit nxënësit për të menduar rreth një teme të caktuar. Rëndom shërben për të krijuar lidhje midis fakteve.

- **Insert-i (është sistem ndërveprues i shënimit për të menduarit dhe leximin e efektshëm)**. Kjo teknikë përdoret në pjesën kryesore dhe është efektive, sepse nxënësi është gjithmonë aktiv dhe mban qëndrim kritik ndaj asaj që e lexon.

- **Pesëvargëshi** – është teknikë e veçantë e cila ka pesë vargje, e cila kërkon përmbledhjen e informacionit në shprehjet të cilat përshkruajnë apo reflektojnë rreth idesë kryesore të temës.

- **Xhigsou (Ndërthurja)** – është teknikë e të lexuarit në bashkëpunim, leximi i njësisë mësimore nuk bëhet në tërësi nga ana e të gjithë nxënësve, por nxënës të caktuar janë përgjegjës për pjesë të caktuara.

Teknika të tjera janë: *ditari dypjesësh, di dua të dijë mësova, ese, pesëvargëshi, rrjeti i diskutimit, diagrami i Venit shkrimi i lirë etj.*

Historia gojore është gjithashtu ndër mënyrat bashkëkohore të të mësuarit të lëndës së historisë.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo teknikave mësimore të lartpërmendura duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultate e dëshiruara. Për tema mësimore të caktuara mund të shfrytëzohen me sukses muzetë, galeritë, bibliotekat, arkivat, ekskursionet në vendet dhe monumentet kulturo-historike etj.

VLERËSIMI

Vlerësimi është proces i mbledhjes sistematike, analizimit dhe interpretimit të informatave me qëllim të përcaktimit se në çfarë shkalle nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëheqës.

Vlerësimi është proces i vazhdueshëm dhe u shërben disa qëllimeve të ndryshme.

Ndër qëllimet kryesore të vlerësimit janë:

1. Të sigurojë informacion rreth përparimit të nxënësve.
2. T'u sigurojë nxënësve informacion mësimor.
3. T'i motivojë nxënësit.
4. Të sigurojë realizimin e objektivave të përcaktuara.
5. Të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen.

Tipat e vlerësimit

Ekzistojnë tipa të larmishëm vlerësimi si:

- **Vlerësimi diagnostikues** përcakton te nxënësit dobësitë, vështirësitë, problemet dhe identifikon nxënësit me nevoja të veçanta.

- **Vlerësimi formues** ka për qëllim ta udhëzojë mësuesin në planifikim dhe te nxënësit të identifikojë vështirësitë gjatë nxënies (punës) me qëllim që t'u ndihmojë dhe të plotësojë nevojat e tyre për nxënie më të suksesshme.

- **Vlerësimi klasifikues** ka për qëllim të caktojë pozitën e nxënësit në raport me shkathtësitë e zotuara paraprake dhe objektivat e parashikuara.

- **Vetëvlerësimi** është proces i mbledhjes, analizimit, interpretimit të informatave dhe veprimtarisë që nxënësi e bënë vet me anë të ndonjë mjeti vlerësues.

- **Vlerësimi përmbledhës** bëhet me qëllim që të zbulojë shkallën e arritjes së objektivave pas një periudhe të caktuar të mësimdhënies p.sh., pas një kapitulli, gjysmëvjetori, viti...etj.

- **Vlerësimi në bazë të kriterëve** kupton vlerësimin e çdo nxënësi që përmbush kriteret e caktuara p.sh., krahasimi i pikëve të testit me një standard të caktuar. Ky vlerësim i siguron informacion mësimdhënësit që të identifikojë vështirësitë e nxënësit dhe të ndihmojë në përmirësimin e tyre.

Vlerësimi formues dhe diagnostikues nuk vlerëson me nota, por në bazë të tyre mësimdhënësi planifikon punën e tij.

- **Vlerësimi i brendshëm** përfshin planin mësimor. Veprimtaria vlerësuese formulohet, zhvillohet dhe vlerësohet nga mësuesi.

- **Vlerësimi i jashtëm.** Veprimtaritë vlerësuese hartohen jashtë shkollës (specialistë të nivelit të lartë).

- **Vlerësimi i përditshëm** bazohet në kontrollin e punës së nxënësit në klasë.

- **Vlerësimi paraprak** bëhet para testimit vlerësues.

- **Vlerësimi përfundimtar** bëhet në fund të vitit dhe bazohet në vlerësimin përfundimtar të një lënde të caktuar.

- **Vlerësimi në proces** bazohet në vlerësimin e mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë gjatë kryerjes së një pune ose detyre në zhvillim etj.

Veprimtaritë kryesore të vlerësimit në klasë

- *Kontrolli i rëndomtë i veprimtarive në klasë*
- *Detyrat e shtëpisë*
- *Testet*

- Mësimdhënësi gjatë orës mësimore i **kontrollon** rregullisht nxënësit, u jep informacione për të lehtësuar nxënien dhe vazhdimisht kupon përparimin e nxënësve dhe vështirësitë e tyre.

- Rëndësia e **detyrave të shtëpisë** është se përmes tyre sigurojmë informacione për vazhdimin dhe zgjerimin e njohurive të nxënësve në mënyrë të pavarur dhe për përvetësimin e njësive të mësuara gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë. Në rast të paraqitjes së vështirësive ndihma e prindit është e dobishme, por njëherësh mund të jetë edhe e padobishme në rast se në vend që të hulumtojë për zgjidhjen e detyrës nxënësi i merr të gatshme nga prindi.

Format e testeve janë:

- Me gojë
- Me shkrim
- Përmes paraqitjes grafike etj.

Testimet janë të rëndësishme për të siguruar informacione për përparimin e nxënësit, por në raste të veçanta mund të ketë edhe anët negative për arsye se te nxënësit shkaktojnë ankth, stres, frikë etj. Gjatë zbatimit të testimit, sistemi i poentimit zgjidhet nga vetë mësimdhënësi.

Për vlerësimin e njohurive të nxënësve përdorim edhe veprimtari të tjera, p.sh.,

- Vlerësimi i eseve
- Vlerësimi me dosje
- Vetëvlerësimi etj

BURIMET DHE MJETET MËSIMORE

1. Aspekte të mësimdhënies së historisë, Prishtinë, 1997.
2. Aspekte të mësimdhënies së historisë, Tiranë, 1995.

3. Bardhyl Musai, Psikologjia e Edukimit, Shtëpia Botuese: Pegi, Tiranë, 1999
4. Bardhyl Musai, Metodologjia e Mësimdhënies, Tiranë, 2003.
5. Grup autorësh, Të kuptojmë të kaluarën e përbashkët për të ndër-
tuar të ardhmen, Ndryshime dhe vazhdimësi të jetës së përditshme
në Shqipëri, Bullgari dhe Maqedoni 1945 – 2000, botues:
EUROCLIO, Shoqata e Mësuesve të Historisë të Shqipërisë,
Shoqata Bullgare e Mësuesve të Historisë, Shoqata e Historianëve
të Republikës së Maqedonisë, Tiranë, 2003.
6. Historia e Popullit Shqiptar I, Tiranë, 2001.
7. Historia e Popullit Shqiptar II, Tiranë, 2001.
8. Dr. Bep Jubani, Dr. Isa Bicaj, Dr. Vilson Kuri, HISTORIA për
klasën e parë të shkollave të mesme, Shtëpia Botuese: Libri
Shkollor, Prishtinë, 2001.
9. Dr. Fehmi Rexhepi, Dr. Isa Bicaj, HISTORIA për klasën e parë të
shkollave të mesme profesionale, Shtëpia Botuese: Libri Shkollor,
Prishtinë, 2001.
10. Fehmi Rexhepi, Frashër Demaj, Histori 10, për Gjimnazin e
përgjithshëm dhe për Gjimnazin e shkencave shoqërore, Shtëpia
Botuese: Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.
11. Jusuf Bajraktari, Fehmi Rexhepi, Frashër Demaj, Histori 10, për
Gjimnazin matematikë dhe informatikë dhe Gjimnazin e shken-
cave natyrore, Shtëpia Botuese: Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.
12. Isa Bicaj, Arbër Salihu Histori 10, për Gjimnazin e gjuhëve,
Shtëpia Botuese: Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.
13. Fehmi Rexhepi, Frashër Demaj, Histori 11, për Gjimnazin e
gjuhëve, Shtëpia Botuese: Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.
14. Jusuf Bajraktari, Isa Bicaj, Histori 11, për Gjimnazin e për-
gjithshëm, Shtëpia Botuese: Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.
15. Grup autorësh, Historia e popullit shqitar, për shkolla të mesme,
botoi : Libri Shkollor, Prishtinë, 1998.
16. Grup autorësh, Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve, nën
redaktimin e prof. Dr. Hysni Myzyrit, botoi: Siprinti, Prizren,
2000.
17. Dr. Agron Gani, Dr. Hysni Myzyri, Dr. Jusuf Bajraktari, Historia
për klasën e dytë të shkollave të mesme. botoi : Libri Shkollor,
Prishtinë, 2001.

18. Mikel Pjetrushi, Atlas historik i botës, Shtëpia Botuese: Camaj – Pipa, Shkodër, 2001.
19. MASHT, Plani dhe programi mësimor 9, Libri Shkollor, Prishtinë, 2002.
20. MASHT, Plani dhe programi mësimor 10, Libri Shkollor, Prishtinë, 2003.
21. MASHT, Plani dhe programi mësimor 11, Libri Shkollor, Prishtinë, 2004.

BURIMET NË INTERNET

1. www.dadalos.org
2. www.historyplace.com
3. www.see-educoop.net
4. www.eurocliohistory.org
5. www.euroclio.net

PSIKOLOGJI

Gjimnazi i përgjithshëm dhe Gjimnazi i gjuhëve (2 orë në javë, 66orë në vit)

HYRJE

Psikologjia si shkencë gëzon sot një popullaritet të madh te njerëzit, sidomos midis nxënësve të shkollave të mesme. Psikologjia renditet si një ndër profesionet më premtuese të shekulli që sapo ka filluar. Duke mos qenë të befasuar me këtë fakt, mund të thuhet se psikologët u ndihmojnë njerëzve të ruajnë burimet planetare, të zvogëlojnë paragjykimet dhe diskriminimin, promovojnë vlera të forta familjare dhe standardit të jetesës dhe të ballafaqohen shëndetshëm me ndryshimet e shpejta teknologjike dhe shoqërore. Për nxënësit e shkollave të mesme mësimi i psikologjisë paraqet një mundësi të mirë për të mësuar mbi ngjashmëritë dhe dallimet e sjelljes njerëzore në të gjitha dimensionet në të cilat paraqiten dallimet, gjë që nuk kanë mundësi ta përfitojnë në komunitetin ku jetojnë.

Plani dhe programi i lëndës së psikologjisë për shkollat të mesme është ndërtuar që të japë njohuri adekuatë mbi shkencën e psikologjisë. Më tej, dizajni i këtij plani dhe programi mundëson rritjen dhe zhvillimin e nxënësve, duke zgjeruar botëkuptimet e tyre mbi individin dhe shoqërinë. Gjithashtu, ky plan dhe program vendos pritshmëri të larta dhe të qarta për nxënësit, duke i nxitur ata për një pjesëmarrje aktive gjatë procesit mësimor. Kjo është arsyeja që qasja e këtij plani dhe programi bëhet nga dy plane: (1) prezantimi i koncepteve dhe i termave kryesorë të psikologjisë dhe (2) reflektimet dhe shpjegimet personale të nxënësit për temat dhe informacionin e trajtuar.

Ky plan dhe program vendos qëllime dhe objektiva të qartë për lëndën e psikologjisë, që do të duhet të zbatohen gjatë orëve të mësimi. Ai përqendrohet në zbërthimin praktik të proceseve mendore dhe sjelljes individuale njerëzore. Gjithashtu, ky plan dhe program nuk përfshin vetëm dhënien e njohurive mbi koncepte themelore të psikologjisë, por

fokusohet edhe në shkathtësi të caktuara, me të cilat duhet të pajiset nxënësi në përfundim të lëndës. Parë nga ky prizëm, thelbësore për zbatimin e këtyre ideve gjatë procesit mësimor do të ishin të mësuarit aktiv dhe ndërveprues dhe nxitja e aktiviteteve në klasë, që inkurajojnë diversitetin dhe kreativitetin e nxënësve.

QËLLIMET

Qëllimet kryesore të lëndës së psikologjisë për klasën 12 të shkollave të mesme do të ishin:

- 1) Njoftimi dhe kuptimi nga ana e nxënësve i koncepteve dhe i fushave tradicionale të psikologjisë;
- 2) Aplikimi i njohurive të marra nga nxënësit në botëkuptimet e tyre për veten dhe shoqërinë që i rrethon.

OBJEKTIVAT

Objektivat e lëndës së psikologjisë do të ishin:

- 1) Të demonstrojë një nivel të kënaqshëm njohurish mbi shkencën e psikologjisë**
 - Të identifikojë drejtimit kryesore të psikologjisë
 - Të bëjë dallimet midis drejtimeve kryesore të psikologjisë përsa i përket mënyrës se si e studiojnë ato psikologjinë
 - Të njihet me metodat e hulumtimit në psikologji
- 2) Të zbërthejë natyrën e koncepteve psikologjike tek individit dhe shoqëria**
 - Të përshkruajë zhvillimin njerëzor si proces
 - Të njohë disa nga teoritë mbi zhvillimin njerëzor
 - Të njohë dhe të shpjegojë procesin e të nxënësve
 - Të zbërthejë fenomenin e kujtesës dhe aspekte të veçanta të tij
 - Të shpjegojë procesin e të menduarit dhe të gjuhës dhe ndërveprimin midis tyre
 - Të identifikojë dhe të shpjegojë gjendjet kryesore të vetëdijes

3) Të shpjegojë fenomene themelore të mësuara të marrëdhënies shoqëri individ

- Të njohë dhe të shpjegojë dallimet individuale midis njerëzve
- Të përshkruajë personalitetin dhe mënyrat e vlerësimit të tij
- Të flasë mbi çrregullimet psikologjike, duke identifikuar raste konkrete
- Të përshkruajë ndikimin e dimensioneve sociale dhe kulturore mbi sjelljen

4) Të identifikojë procese bazike mendore individuale dhe ndikimin e tyre te situata të caktuara

- Të identifikojë bazat biologjike të sjelljes
- Të dijë të shpjegojë ndijimin dhe perceptimin dhe aspekte të veçanta të tyre
- Të përshkruajë motivacionin dhe emocionin në kontekstin personal psikologjik
- Të dijë të përshkruajë funksionimin seksual të njeriut dhe të thotë se si formohen rolet gjinore
- Të përshkruajë fenomenin e stresit dhe t'i aplikojë njohuritë e fituara në lidhje me të mbi jetën personale psikologjike

5) Të përshkruajë terma të caktuar psikologjikë dhe zbatimin e tyre në praktikë

PËRMBAJTJA PROGRAMORE

KATEGORITË	NËNKATEGORITË	Numri i orëve	%
Historia dhe metodat e hulumtimit në psikologji	Zhvillimi i psikologjisë si shkencë	10	16.6
	Teoritë kryesore psikologjike		
	Metodat e hulumtimit psikologjik		
Biopsikologjia	Bazat biologjike të sjelljes	19	28.78
	Ndijimi dhe perceptimi		
	Motivacioni dhe emocioni		
	Seksualiteti dhe gjinia		
	Stresi, përballimi i tij dhe shëndeti		

Zhvillimi jetësor	Zhvillimi njerëzor gjatë jetës	4	6.06
Kognitiviteti	Të nxënësit	14	21.21
	Kujtesa		
	Të menduarit dhe gjuha		
	Gjendjet e vetëdijes		
Sociokultura	Dallimet individuale	19	28.78
	Personaliteti dhe vlerësimi		
	Çrregullimet psikologjike		
	Trajtimi i çrregullimeve psikologjike		
	Dimensionet kulturore dhe sociale të sjelljes		

PËRMBAJTJA LËNDORE SIPAS KATEGORIVE ME REZULTATET E PRITURA

Historia dhe metodat e hulumtimit në psikologji (10 orë)	
<p>Përmbajtja programore:</p> <p><i>1. Ç'është psikologjia dhe ç'ndryshime ka pësuar ajo gjatë zhvillimit të saj</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Disiplinat dhe nëndisiplinat kryesore të psikologjisë • Studimi i psikologjisë nga drejtime të ndryshme të saj • Vëzhgimi natyror dhe studimi ekperimental • Hulumtimet kualitative dhe kuantitative 	<p>Rezultatet e pritura:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimi dhe krahasimi i pikëpamjeve biologjike, sjellore, kognitive dhe sociokulturale • Përshkrimi i elementëve të një eksperimenti • Shpjegimi i rëndësisë së mostrimit në hulumtimet psikologjike • Shpjegimi dhe krahasimi i strategjive të hulumtimeve kualitative dhe atyre kuantitative • Shpjegimi i qëllimit dhe disa koncepteve kryesore të statistikave • Përshkrimi i konceptit të korrelacionit dhe shpjegimi se si përdoret ky koncept në psikologji • Identifikimi i çështjeve etike në hulumtimin psikologjik • Diskutimi mbi zhvillimin e psikologjisë si një shkencë empirike

	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i dallimeve midis disa nëndisiplinave dhe teorive kryesore të psikologjisë
Biopsikologjia (19 orë)	
<p>Përmbajtja programore:</p> <p><i>1. Bazat biologjike të sjelljes</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Struktura dhe funksioni i neuronit • Organizimi i sistemit nervor • Organizimi hierarkik i strukturës së trurit dhe funksioni i tij • Funksionet specifike të hemisferave të trurit • Ndikimi i ndërveprimit të trashëgimisë me ambientin mbi sjelljen • Ndikimi i hormoneve mbi sjelljen • Ndikimi i evolucionit mbi mekanizmat psikologjikë <p><i>2. Ndijimi dhe perceptimi</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Koncepte bazike që shpjegojnë aftësitë dhe kufizimet e procesise të ndijimit • Ndërveprimi i individit me ambientin në përcaktimin e perceptimit 	<p>Rezultatet e pritura:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i neuronit si baza e komunikimit neural • Përshkrimi se si informacioni transmetohet dhe integrohet në sistemin nervor • Analiza se si procesi i neurotransmetimit mund të modifikohet nga trashëgimia dhe ambienti • Klasifikimi i ndarjeve dhe i nënndarjeve kryesore të sistemit nervor • Dallimi i funksioneve të nënndarjeve të ndryshme të sistemit nervor • Identifikimi i strukturës dhe funksionit të zonave kryesore të trurit • Njohja se funksionet specifike janë të përqendruara në lobe specifike të korteksit cerebral • Krahësimi midis hemisferës së djathtë dhe të majtë në funksionimin e trurit • Përshkrimi se si lidhen gjendrat endokrine me sistemin nervor • Vlerësimi se si ndikojnë trashëgimia dhe ambienti mbi sjelljen • Shpjegimi se si tendencat e evoluara ndërveprojnë me ambientin dhe kulturën e tanishme në përcaktimin e sjelljes <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegimi i koncepteve të pragut, adaptimit dhe konstantes • Përshkrimi i operimit të sistemeve të ndijimit • Renditja e formave të energjisë për të cilat ne kemi dhe nuk kemi receptorë ndijimi • Përshkrimi i ndikimit të ndryshoreve të ambientit, motivimit, përvojave të kaluara, kulturës dhe pritshmërive mbi perceptimin

<ul style="list-style-type: none"> • Natyra e vëmendjes <p><i>3. Motivacioni dhe emocioni</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Konceptet motivacionale • Stimuj biologjikë dhe ambientale që nxisin motive dhe forca bazike • Teoritë kryesore të motivacionit • Ndërveprimi i faktorëve biologjikë dhe faktorëve kulturorë në zhvillimin e motiveve • Roli i vlerave dhe pritshmërive në përcaktimin e zgjedhjes dhe fuqisë së motiveve • Aspekte fiziologjike, afektive, kognitive dhe sjellore të emocioneve dhe ndërveprimi midis këtyre faktorëve • Efektet e motivacionit dhe emocioneve mbi perceptimin, kognicionin dhe sjelljen <p><i>4. Seksualiteti dhe gjinia</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i dallimeve gjinore • Cikli i reagimit seksual dhe sjellja seksuale • Qëndrimet dhe sjellja seksuale 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegimi se çfarë nënkupton koncepti i vëmendjes • Përshkrimi se si ndryshon vëmendja nga detyrat e lehta tek ato të vështira <ul style="list-style-type: none"> • Aplikimi i koncepteve të motivimit të njerëzit dhe kafshët • Përshkrimi i ndërveprimit të stimujve të brendshëm dhe ambientale në përcaktimin e motivimit • Përshkrimi i stimujve situativë që rrisin frikën dhe zemërimin • Përshkrimi i stimujve situativë dhe i karakteristikave individuale që rrisin kureshtjen dhe ankthin • Përshkrimi i një ose më shumë teorive të motivacionit si për shembull, hierarkia e nevojave nga Maslov, disonanca kognitive etj. • Shpjegimi se si zhvillohen motivet e përbashkëta • Shfrytëzimi i teorisë së vlerave- pritshmërive për të shpjeguar sjelljen e vetes dhe të tjerëve • Përshkrimi i teorive të emocioneve si James-Lange, Cannon-Bard ose teorive kognitive • Përshkrimi i dallimeve në perceptime midis individëve që kanë motivim të ndryshëm • Shpjegimi se si të nxënit, kujtesa, zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja ndikohen nga motivacioni dhe emocioni. <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegimi i bazës biologjike të motivit seksual • Përshkrimi i ndikimit të faktorëve kulturorë dhe sociale mbi seksualitetin • Renditja e disa çrregullimeve të seksualitetit
--	--

<p>5. <i>Stresi, përballimi i tij dhe shëndeti</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Burimet e stresit • Reagime fiziologjike ndaj stresit • Reagime psikologjike ndaj stresit • Strategji kognitive dhe sjellore për përballimin e stresit dhe promovimin e shëndetit 	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi dhe shpjegimi i burimeve të stresit • Renditja dhe shpjegimi i reagimeve të mundshme fiziologjike ndaj stresit • Renditja dhe shpjegimi i reagimeve të mundshme psikologjike ndaj stresit • Identifikimi dhe shpjegimi i strategjive kognitive në përballimin e stresit dhe promovimin e shëndetit • Identifikimi dhe shpjegimi i strategjive sjellore në përballimin e stresit dhe promovimin e shëndetit
<p>Zhvillimi jetësor (4 orë)</p>	
<p>Përmbajtja programore:</p> <p><i>1. Zhvillimi njerëzor gjatë jetës</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi si proces jetësor • Teknika hulumtuese për mbledhjen e të dhënave për procesin zhvillimor • Teoritë e fazave të zhvillimit • Çështje që lidhen me procesin zhvillimor (natyra/të ushqyerit; vazhdimësi/jovazhdimësi; stabilitet/jostabilitet; periudhat kritike) • Ndikimet e teknologjisë mbi aspektet e zhvillimit jetësor 	<p>Rezultatet e pritura:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimi i ndryshimeve fizike, kognitive dhe sociale nga periudha para lindjes gjatë gjithë jetës • Ekzaminimi i natyrës së ndryshimit gjatë ciklit jetësor • Identifikimi i strukturave komplekse kognitive të gjetura në zhvillimin e foshnjave dhe fëmijëve të vegjël • Aplikimi i parimeve të ciklit jetësor mbi përvojën personale • Skicimi i fazave të teorive të zhvillimit të autorëve teorikë, si Piazeheja, Eriksoni, Kohlbergu, Gilligani, Crossi, Helmsi etj. • Të njohë se si faktorët biologjikë dhe ambientalë lidhen me konceptimet e shoqërisë në formësimin e gjinive dhe të përvojave të meshkujve dhe femrave. • Ekzaminimi i zhvillimit të identitetit etnik • Përshkrimi i rolit të periudhave kritike të zhvillimit • Diskutimi i ndikimit të teknologjisë në cilësinë e jetës • Përshkrimi i rolit të teknologjisë në zgjatjen e ciklit jetësor

Kognitiviteti (14 orë)	
<p>Përmbajtja programore:</p> <p><i>1. Të nxënit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Karakteristikat e të nxënit • Parimet e kushtëzimit klasik • Komponente të të nxënit kognitiv • Roli i biologjisë dhe kulturës në përcaktimin e të nxënit <p><i>2. Kujtesa</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Ruajtja e informacionit në kujtesë • Sistemet afatshkurtra dhe afatgjata të kujtesës • Rikuperimi dhe nxjerrja e informacionit nga kujtesa • Bazat biologjike të kujtesës 	<p>Rezultatet e pritura:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Diskutimi i të nxënit nga pikëpamja psikologjike • Njohja e të nxënit si mjet për promovimin e adaptimit nëpërmjet përvojës • Përshkrimi i paradigmës së kushtëzimit klasik • Përshkrimi i paradigmës së kushtëzimit operant • Shpjegimi i funksionimit të të nxënit vëzhgues • Përshkrimi i qasjeve kognitive të të nxënit • Identifikimi i kontributeve biologjike të të nxënit • Diskutimi mbi rolin e kulturës në atë se çfarë sjelljesh do të mësohen • Zbërthimi se si faktorët biologjikë dhe kulturorë ndërveprojnë të pengojnë ose të zgjerojnë të nxënë • Përshkrimi i natyrës bashkëpunuese të disa formave të të nxënit me kulturën <ul style="list-style-type: none"> • Sjellja e shembujve për dallimin midis procesimit sipërfaqësor dhe atij të thellë • Identifikimi i faktorëve të tjerë që ndikojnë kodimin e informacionit • Përshkrimi i operimit të kujtesës afatshkurtër • Përshkrimi i operimit të kujtesës afatgjatë • Analizimi i rëndësisë së rikuperimit të gjurmëve në kujtesë • Shpjegimi i rolit që luan interferenca në rikuperimin e informacionit • Lidhja e vështirësive që krijohen nga proceset e rikonstruksionit të kujtesës • Identifikimi i strukturave të rëndësishme trunore për kujtesën • Identifikimi i faktorëve që interferojnë me kujtesën

<p><i>3. Të menduarit dhe gjuha</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Përbërësit themelorë të mendimit • Strategjitë dhe pengesat në marrjen e vendimeve dhe zgjidhjen e problemeve • Tipare strukturore të gjuhës • Teoritë dhe fazat zhvillimore të përvetësimit të gjuhës • Lidhje midis të menduarit dhe gjuhës 	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i strategjive për përmirësimin e kujtesës bazuar në kuptimin tonë për të • Përkufizimi i të menduarit si një proces mendor i përfshirë në manipulimin dhe kuptimin e informacionit • Njohja që informacioni klasifikohet sipas kategorive që përmbajnë elementë të ngjashëm dhe që njihen si koncepte • Identifikimi i zgjidhjes së problemeve si një shembull për të menduarit produktiv dhe të drejtuar • Shpjegimi i të menduarit kreativ në zgjidhjen e problemeve • Analizimi i pengesave që pengojnë zgjidhjen e problemeve dhe vendimmarrjen • Përkufizimi i gjuhës si simbole dhe tinguj që përçojnë kuptim dhe lehtësojnë komunikimin • Njohja e faktit që gjuha është e organizuar në strukturë hierarkike • Diskutimi i efekteve të zhvillimit në përvetësimin e gjuhës • Vlerësimi i teorive mbi përvetësimin e gjuhës • Supozimi nëse kafshët e përvetësojnë gjuhën apo jo • Ekzaminimi i ndikimit të gjuhës mbi të menduarit dhe sjelljen
<p><i>4. Gjendjet e vetëdijes</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Karakteristikat e gjumit dhe të teorive që shpjegojnë se pse flejmë ne • Teoritë që shpjegojnë dhe interpretojnë ëndrrat • Fenomeni i hipnozës dhe shfrytëzimi i tij • Kategoritë e drogave psikoaktive dhe efektet e tyre 	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimi i dy cikleve të gjumit • Krahasimi i teorive që shpjegojnë se pse flejmë ne • Identifikimi i tipave të çrregullimeve të gjumit • Demonstrimi i kuptimit të dallimeve individuale përsa i përket përmbajtjes së ëndrrave • Krahasimi i teorive të ndryshme mbi dobinë dhe kuptimin e ëndrrave • Përshkrimi i disa fenomeneve hipnotike • Shpjegimi i shfrytëzimit të hipnozës në

	psikologji <ul style="list-style-type: none"> • Dallimi i kategorive të drogave kryesore psikoaktive dhe efekteve të tyre • Vlerësimi i efekteve të drogave narkotike, depresante, stimuluese dhe halucinative
Sociokultura (19 orë)	
Përmbajtja programore: <i>1. Dallimet individuale</i> <ul style="list-style-type: none"> • Koncepte që lidhen me matjen e dallimeve individuale • Ndikimi dhe ndërveprimi i trashëgimisë dhe ambientit në dallimet individuale • Natyra e inteligjencës • Natyra e testimit të inteligjencës <i>2. Personaliteti dhe vlerësimi i tij</i> <ul style="list-style-type: none"> • Çfarë nënkuptohet me personalitet dhe konstrukte personaliteti • Qasjet dhe teoritë e personalitetit • Mjete vlerësuese të përdorura te personaliteti 	Rezultatet e pritura: <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizimi dhe kuptimi i natyrës së ndërtimit të testeve mbi inteligjencën, kreativitetin dhe personalitetin • Përshkrimi i koncepteve themelore të statistikave të testimit • Shpjegimi se si inteligjenca ndikohet nga trashëgimia dhe ambienti • Lidhja e inteligjencës me përdorimin e shkathhtësive dhe strategjive kognitive • Përshkrimi se si ndryshon inteligjenca me kohën • Përshkrimi i teorive mbi inteligjencën • Diskutimi mbi atë se si testet e inteligjencës pasqyrojnë dallimet midis njerëzve • Shpjegimi se pse testet e inteligjencës mund të parashikojnë arritjet e njerëzve • Shpjegimi i kufizimeve të përdorimit të testeve konvencionale të inteligjencës <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizimi i personalitetit si një mënyrë unike e të ndjerit, të menduarit dhe të vepruarit • Shpjegimi i rolit të konstrukteve të personalitetit si kornizë për organizimin e fenomeneve të sjelljes • Shpjegimi i karakteristikave të qasjeve psikoanalitike, kognitivo-biheviorale, humanistike dhe asaj të trajtave • Identifikimi i kontributeve të rëndësishme në kuptimin tonë mbi personalitetin • Diferencimi midis teknikave objektive dhe

<p><i>3. Çrregullimet psikologjike</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Karakteristikat dhe origjina e sjelljes anormale • Metoda që përdoren në zbërthimin e sjelljes anormale • Kategori kryesore të sjelljes anormale • Ndikimi i çrregullimeve mendore 	<p>projektive në vlerësimin e personalitetit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimi i testeve të përdorura në vlerësimin e personalitetit • Identifikimi i karakteristikave të zakonshme të sjelljes anormale • Citimi i shembujve të sjelljes anormale • Lidhja e gjykimeve mbi sjelljen anormale dhe kontekstit ku shfaqen këto gjykime • Përshkrimi i shpjegimeve kryesore mbi origjinat e sjelljes anormale • Identifikimi i qëllimit të metodave të ndryshme të hulumtimit të sjelljes anormale • Identifikimi i përparësive dhe kufizimeve të metodave të ndryshme të hulumtimit të sjelljes anormale • Diskutimi i kategorive kryesore të anormalitetit • Diskutimi i stigmës që shoqëron anormalitetin • Shqyrtimi i mundësive për një promovim më të madh të kuptimit mbi sjelljen anormale
<p><i>4. Trajtimi i çrregullimeve psikologjike</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Metoda të mirënjohura të përdorura për trajtimin e njerëzve me çrregullime mendore • Lloje të praktikuesve që trajtojnë njerëzit me çrregullime mendore • Çështje etike dhe ligjore që lidhen me trajtimin e njerëzve me çrregullime mendore 	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimi i disponibilitetit dhe përshtatshmërisë së mënyrave të ndryshme të trajtimit të njerëzve me çrregullime psikologjike • Përshkrimi i karakteristikave të trajtimit dhe parandalimit efektiv të çrregullimeve psikologjike • Identifikimi i kategorive të terapistëve në përputhje me arsimimin dhe trajnimin e tyre • Përshkrimi i strategjive për gjetjen e terapistit të duhur për llojet e ndryshme të çrregullimeve • Përshkrimi i lidhjes midis shëndetit mendor dhe ligjit • Zbërthimi i ndikimit të ligjit mbi praktikimin e psikoterapisë

<p>5. <i>Dimensionet sociale dhe kulturore të sjelljes</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Qëndrimet dhe gjykimi social • Kategoritë sociale dhe kulturore • Proceset grupore • Ndikimi social 	<ul style="list-style-type: none"> • Demonstrim kuptimi mbi perceptimin e personit • Përshkrimi i procesit të ndikimit të atribuimeve mbi shpjegimet që japim ne për sjelljen • Identifikimi i burimeve të formimit të qëndrimeve • Vlerësimi i disa metodave që përdoren për ndryshimet e qëndrimeve • Identifikimi i kategorive sociale dhe kulturore • Diskutimi i procesit të ndikimit të kategorive sociale dhe kulturore mbi sjelljen • Përshkrimi i efektit të pranisë së të tjerëve mbi sjelljen individuale • Përshkrimi i asaj se si struktura sociale mund të ndikojë marrëdhëniet ndërgrupore • Zbërthimi i natyrës së njëanshmërisë dhe diskriminimit • Përshkrimi i rrethanave në të cilat është më e mundshme të ndodhin konformiteti dhe obediencia • Diskutimi i natyrës së altruizmit në shoqëri • Diskutimi i domethënies së agresivitetit
---	---

QASJET NDËRLËNDORE

Lënda e psikologjisë për shkollat e mesme ngërthen në vetvete shumë elemente të shkencave dhe fushave të ndryshme të shkencës. Përgjithësisht, qasjet ndërlëndore më të rëndësishme janë:

Në kategorinë për historinë dhe metodat e hulumtimit në psikologji materiali lëndor është i lidhur ngushtë me fushën e statistikave.

Në kategorinë mbi biopsikologjinë materiali lëndor është i lidhur me shkencën e biologjisë, me anatomicën dhe fiziologjinë, me kulturologjinë, si dhe me fushën e shëndetit mendor.

Në kategorinë mbi zhvillimin jetësor një pikëtakim i rëndësishëm është ai me biologjinë dhe fushën teknologjike.

Materiali në kategorinë mbi kognitivitetin është i lidhur ngushtë me biologjinë dhe linguistikën.

Në kategorinë mbi sociokulturën qasjet ndërlëndore kanë të bëjnë kryesisht me kulturologjinë, sociologjinë, fushën e shëndetit mendor dhe më konkretisht me psikiatrinë.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Duket se është e vështirë për mësuesit (sidomos ata që do ta japin për herë të parë lëndën e psikologjisë) që t'i zbatojnë standardet e mësipërme gjatë procesit mësimor. Një nga pikat ku mësuesit mund të mbështeten janë rezultatet e pritura të *sugjeruara*, të cilat mund të përdoren jo vetëm si një bazë e mirë e ndërtimit të aktiviteteve në klasë, por edhe si pikë referimi për planifikimin e kohës, një problem ky me të cilin ka shumë mundësi të përballen mësuesit. Gjithashtu, rezultatet e pritura mund të përdoren fare mirë për një vlerësim sa më objektiv të nxënësve. Nga ana tjetër, këto rezultate shërbejnë për krijimin e një baze solide njohurish nga ana e nxënësit për psikologjinë si shkencë, duke plotësuar kështu një pjesë të rëndësishme të formimit të tyre, që u lejon atyre të njohin më mirë veten dhe të tjerët. Pra, rezultatet e pritura mund të përdoren si pjesë integrale në planin e mësimin të mësuesit për çdo orë të caktuar, ku mund të përfshijnë gjithashtu edhe materialet që i duhen për orën, kohëzgjatjen e saj etj.

Rekomandohet fuqishëm që për planin dhe programin e paraqitur të përdoren mjete audiovizuale për të bërë të mundur kuptimin sa më të mirë të materialeve të dhëna nga ana e nxënësve. Është e vërtetë që materialet didaktike për psikologjinë mungojnë në një masë të madhe në Kosovë, por duhet thënë që gjendja në lidhje me këtë po ndryshon ditaditës. Në këtë kuptim, mësuesit duhet të jenë mendjehapur dhe të jenë të gatshëm për të përdorur mjete audiovizive në orët e tyre të psikologjisë.

Një plan dhe program cilësor dhe i guximshëm mund të zbatohet vetëm duke u mbështetur te mësuesdhënës që nxisin mësimin ndëraktiv, integrojnë elemente teknologjike në mësimdhënie dhe kanë njohuri për hulumtimet e bëra për tema të veçanta. Mësimdhënësit duhet të inkurajojnë shprehjen e mendimeve dhe qëndrimeve të ndryshme gjatë orës së mësimin për të bërë të mundur kuptimin më të mirë të pikëpamjeve individuale dhe kulturore. Ndërkohë që vetë stafi mësimdhënës i lëndës së psikologjisë duhet të shkëmbejë informacion midis njëri-tjetrit, të jetë i trajnuar nga pikëpamja teknologjike dhe të marrë pjesë në ngjarje të ndryshme (konferenca, seminare) që lidhen me psikologjinë në përgjithësi dhe mësimdhënien e saj në veçanti, duke ia hapur kështu dritën e gjelbër zhvillimit profesional.

Kështu, disa nga metodat që rekomandohen për të zbatuar filozofitë e lartpërmendura të mësimdhënies, me qëllim arritjen e standardeve të vendosura për këtë lëndë, do të ishin:

Puna individuale – kjo metodologji pune do të ishte shumë pozitive të përdorej sa herë që mësimdhënësi gjykon se nxënësi duhet të reflektojë në mënyrë individuale në radhë të parë për konceptet dhe çështjet e trajtuara në klasë. Kjo metodologji mund të gërshetohet me punën në çifte.

Puna në çifte – kësaj metodologjie pune zakonisht i paraprin puna individuale. Kjo metodologji pune shfrytëzohet zakonisht për të rikonfirmuar njohuritë e nxënësve dhe për t'u dhënë mundësi atyre të krijojnë një ambient diskutues në mes tyre.

Puna në grupe të vogla – kjo metodologji ndikon që nxënësit nën vëzhgimin e mësuesit të kenë mundësi që t'i diskutojnë idetë e tyre në grup, të formulojnë mendime në mënyrë ekipore dhe t'i prezantojnë ato përpara klasës.

Ndarja e klasës në dy grupe – kjo metodologji pune do të ishte ideale sidomos kur mësimdhënësi synon që të nxisë diskutimin dhe shprehjen e qëndrimeve për koncepte ose çështje të caktuara nga ana e nxënësve.

Pyetje autorit – Kjo metodë është tepër e rëndësishme që nxënësit të reflektojnë me sy kritik ndaj materialit që i ofrohet.

VLERËSIMI

Në mënyrë që vlerësimi të reflektojë objektivisht njohuritë e marra nga nxënësit në klasë, integrimin e tyre në mendimin personal, shprehjen e të njëjtave me anë të të shkruarit metodat e vlerësimit e rekomanduara do të ishin:

Vrojtimi – Kjo metodë do të vlente për të parë dhe vlerësuar aktivitetin në klasë të nxënësve. Mësimdhënësi mund t'i shënojë vrojtimit e tij në ditarin e tij në mënyrë që të ketë sistematizëm në këtë pikë dhe të shmangë mundësinë e harrimit të detajeve për çdo student.

Testi me shkrim – kjo metodë vlerësuese ndoshta do të ishte mirë të aplikohet pas çdo kategorie mësimore si dhe në fund të lëndës.

Eseja – kjo metodë vlerësuese do të përdorej me qëllim që të vërtetohet se sa mund t'i integrojë dhe riprodhojë nxënësi njohuritë e marra

me anë të të shkruarit. Gjithashtu, eseja do të ishte metodë ideale për të parë se ç'qëndrim personal ka nxënësi ndaj koncepteve të trajtuara në klasë. Më tej, kjo metodë vlen edhe si parapërgatitje e nxënësit për një punë akademike më të avancuar, nëse do të vijojë studimet universitare. Normalisht, eseja do të ishte një detyrë që do të jepej në fund të lëndës, por mund të zbatohet edhe teknika e minieseve, nëse shihet e arsyeshme nga mësimitdhënësi.

Testi me gojë – kjo metodë vlerësuese do të ishte e vlefshme për të verifikuar në klasë njohuritë e marra. Gjithashtu, nxënësit do të kishin mundësi t'i përvetësonin edhe më tepër duke folur termat dhe njohuritë specifike të përfituara.

LITERATURA

Nushi, Pajazit, *“Psikologjia” Për klasën II gjimnaz*, Shtëpia Botuese Libri Shkollor, Prishtinë, 2001.

Nushi, Pajazit, *“Psikologjia e përgjithshme II, Njeriu dhe personaliteti i tij në psikologji”*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 1999.

Dragoti, Edmond, *“Psikologji sociale”*, ShB Libri Universitar, Tiranë, 1999.

Pango, Ylli, *“Psikologjia sociale”*, Tiranë, 1997.

Musai, Bardhyl, *“Psikologji edukimi”*, SHB “Pegi”, Tiranë, 1999.

Pettijohn, Terry, *“Psikologjia: Një hyrje koncize”*, Tiranë, 1996.

Një burim i rëndësishëm literature për këtë lëndë do të jetë edhe libri që do të dalë në muajin shtator 2004 i bazuar në këtë plan dhe program.

HYRJE

Tashmë është i njohur fakti se shkenca e psikologjisë dhe profesioni i psikologut janë popullarizuar shumë në botë. Ky popullarizim nuk ka lënë pa përfshirë as shoqërinë kosovare, ku interesi shoqëror për studimin e kësaj dege të shkencës është rritur së tepërmi, sidomos pas luftës. Ky interesim i madh vjen si pasojë e përpjekjeve të përgjithshme njerëzore për të njohur më mirë veten dhe të tjerët, për të kuptuar më mirë sjelljen, për t'u kujdesur më mirë për shëndetin personal, për t'iu përgjigjur më mirë ndryshimeve shoqërore dhe teknologjike, për të krijuar shoqëri të cilat mbizotërojnë respekti për të drejtat e njeriut dhe mirëqenia e përgjithshme, si dhe për të ruajtur vlerat mjedisore të natyrës. Plani dhe programi i prezantuar këtu është një përpjekje për të pasqyruar më së miri pikërisht këtë interes në rritje të të rinjve kosovarë ndaj psikologjisë.

Ky plan dhe program është munduar të pasqyrojë edhe zhvillimet bashkëkohore të shkencës së psikologjisë, duke iu përshtatur nga ana tjetër zhvillimit dhe njohurive të nxënësve kosovarë. Kjo u jep mundësi atyre që t'u bashkohen bashkëmoshatarëve të tyre në botë, të cilët e rendisin psikologjinë si një profesionet më premtuese të shekullit të ri. Dizajni i planit dhe programit paraqet një mundësi të mirë edhe nga pikëpamja e dinamikës mësimore: ai, në fakt, është i hartuar për të lehtësuar ndëraktivitetin në klasë, në mënyrë që nxënësit ta kenë më të lehtë të (1) marrin njohuri për dukuritë dhe konceptet kryesore psikologjike dhe (2) të reflektojnë dhe zbatojnë personalisht mbi ato njohuri dhe marrëdhënien e tyre me to.

Në ndihmë të procesit mësimor në klasë vijjnë edhe *objektivat* e vendosur për çdo temë të trajtuar. Këta objektiva synojnë të 'çmontojnë' proceset mendore dhe sjelljet individuale dhe shoqërore njerëzore si për mësimdhënësit, ashtu edhe për nxënësit. Një ndihmë tjetër për procesin

mësimor dhe atë vlerësues sidomos vjen nga *rezultatet e pritura*. Shënimi i këtyre rezultateve i jep mundësi mësimdhënësit të jetë më objektiv në vlerësimin e tij si dhe të masë më mirë suksesin e procesit mësimor për këtë lëndë. Nga ana tjetër, nxënësve nëpërmjet rezultateve të pritura u ofrohet mundësia të pajisen me një vështrim realist për aftësitë dhe njohuritë e tyre në këtë lëndë dhe të angazhohen sistematikisht për përsosjen e mëtejshme të tyre. Në planin e përgjithshëm, plani dhe programi i psikologjisë për klasat 12 besojmë se jep edhe një ndihmesë modeste në krijimin e një mjedisi diversiv, kulturor dhe edukativ.

QËLLIMET

Qëllimet kryesore të lëndës së psikologjisë për klasën 12 të shkollave të mesme do të ishin:

- 1) Thellimi i njohimit të nxënësve me shkencën e psikologjisë, metodat e saj të hulumtimit dhe fushat tradicionale të saj;
- 2) Kuptimi nga ana e nxënësve i koncepteve dhe termave kryesorë të psikologjisë;
- 3) Njohja dhe kuptimi i nxënësve për rolin dhe ndikimin e faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm në psikikën e njeriut dhe funksionimin e tij psikologjik;
- 4) Aplikimi i njohurive të marra nga nxënësit në botëkuptimet e tyre për veten dhe shoqërinë, që i rrethon.

OBJEKTIVAT

Materiali lëndor i lëndës së psikologjisë për klasën 12 të shkollave të mesme është dizajnuar, që në fund të tij, nxënësi të mund të:

- 1) Të demonstrojë një nivel të kënaqshëm njohurish mbi shkencën e psikologjisë**
 - Në lidhje me drejtimit kryesore të psikologjisë
 - Në planin e dallimeve midis drejtimeve kryesore të psikologjisë përsa i përket mënyrës, se si e studiojnë ato psikologjinë
 - Për metodat e hulumtimit në psikologji

2) Të zbërthejë natyrën e koncepteve psikologjike tek individi dhe shoqëria

- Në lidhje me zhvillimin njerëzor si proces
- Nëpërmjet disa teorive mbi zhvillimin njerëzor
- Shpjegimit të procesit të të nxënit
- Nga pikëvështrimi i fenomenit të kujtesës dhe aspekteve të veçanta të tij
- Në planin e proceseve e të menduarit dhe të gjuhës dhe ndërveprimin midis tyre
- Sipas gjendjeve kryesore të vetëdijes

3) Të shpjegojë fenomene themelore të mësuara të marrëdhënies shoqëri-individ

- Në kuptimin e personalitetit dhe mënyrat e vlerësimit të tij
- Në përshkrimin e karakteristikave të jetës së të rriturve
- Në përshkrimin e ndikimit të dimensioneve sociale dhe kulturore mbi sjelljen
- Në zbërthimin e çështjeve të shëndetit mendor dhe atij fizik
- Në demonstrimin e kuptimit mbi vlerat dhe fenë

4) Të identifikojë procese bazike mendore individuale dhe ndikimin e tyre te situata të caktuara

- Duke identifikuar bazat biologjike të sjelljes
- Në shpjegimin e ndijimit dhe perceptimit dhe aspekteve të veçanta të tyre
- Në përshkrimin e motivacionit dhe emocionit në kontekstin personal psikologjik
- Në njohjen dhe përshkrimin e funksionimit seksual të njeriut dhe formimin e roleve gjinore
- Në kuptimin e fenomenit të stresit dhe aplikimin e njohurive të fituara në lidhje me të mbi jetën personale psikologjike

PËRMBAJTJA PROGRAMORE

KATEGORITË	NËNKATEGORITË	Numri i orëve	%
Historia e psikologjisë dhe metodat e hulumtimit në psikologji	Zhvillimi i psikologjisë si shkencë	10	15.15
	Teoritë kryesore psikologjike		
	Metodat e hulumtimit psikologjik		
Biopsikologjia	Bazat biologjike të sjelljes	19	28.78
	Ndijimi dhe perceptimi		
	Motivacioni dhe emocioni		
	Seksualiteti dhe gjinia		
	Stresi, përballimi i tij dhe shëndeti		
Zhvillimi jetësor	Zhvillimi njerëzor gjatë jetës	4	6.06
Kognitiviteti	Të nxënët	14	21.21
	Kujtesa		
	Të menduarit dhe gjuha		
	Gjendjet e vetëdijes		
Sociokultura	Personaliteti	19	28.78
	Shëndeti mendor dhe ai fizik		
	Dimensionet kulturore dhe sociale të sjelljes		
	Karakteristika të jetës së të rriturve		
	Vlerat dhe feja		

**PËRMBAJTJA LËNDORE SIPAS KATEGORIVE
ME REZULTATET E PRITURA**

Historia e psikologjisë dhe metodat e hulumtimit psikologjik (10 orë)	
<p>Përmbajtja programore:</p> <p><i>1. Ç'është psikologjia dhe ç'ndryshime ka pësuar ajo gjatë zhvillimit të saj</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Disiplina dhe nëndisiplina alternative në psikologji • Koncepte të lidhura ngushtë me hulumtimet psikologjike • Çështje etike të hulumtimit me njerëz dhe kafshë 	<p>Rezultatet e pritura:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimi i pikëpamjeve humaniste, feministe dhe të konstruksionizmit social • Krahasimi i pikëpamjeve humaniste, feministe dhe të konstruksionizmit social • Identifikimi i zhvillimit të koncepteve etike në hulumtimin e njerëzve dhe kafshëve • Numërimi i disa rregullave etike të hulumtimit • Diskutimi mbi zhvillimin e psikologjisë si një shkencë empirike • Rëndësia e parimeve etike për hulumtimet psikologjike
<p>Qasjet ndërlëndore:</p> <p>Në këtë kategori materiali lëndor është i lidhur ngushtë me fushën e statistikave.</p>	
Biopsikologjia (19 orë)	
<p>Përmbajtja programore:</p> <p><i>1. Bazat biologjike të sjelljes</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Sistemi nervor dhe përvoja e vetëdijshme • Trashëgimia dhe mjedisi: kush ka më shumë rëndësi? • Hulumtime mbi trashëgiminë të njerëzve • Sistemi endokrin i njeriut 	<p>Rezultatet e pritura:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i lidhjeve midis sistemit nervor dhe vetëdijshmërisë • Shpjegimi i rolit të hemisferave në jetën psikike të vetëdijshme të njeriut • Përshkrimi se si e përcakton neuro-psikologjia konceptin e 'vetes' • Diskutimi i rezultateve të hulumtimeve për dallimet midis femrave dhe meshkujve në funksionimin e trurit

<ul style="list-style-type: none"> • Hulumtime në lidhje me trurin <p><i>2. Ndiçimi dhe perceptimi</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Orientimi dhe lëvizja • Ndjeshmëria e lëkurës dhe dhembja • Fuqitë e perceptuara: origjina dhe ndikimet • Rebusi i perceptimit dhe diversiteti kulturor <p><i>3. Motivacioni dhe emocioni</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Motivi i dashurisë dhe elemente kulturore të tij • Motivi seksual dhe elemente të tij • Elemente të emocioneve • Agresiviteti: aspekte emocionale dhe motivacionale të tij <p><i>4. Seksualiteti dhe gjinia</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Njohuri, qëndrime dhe sjellje 	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimi dhe diskutimi i rezultateve të hulumtimeve për trashëgiminë të njerëzit • Identifikimi i funksionit të sistemit endokrin të njeriut • Përshkrimi i funksionit dhe i vendndodhjes së gjëndrave të sistemit endokrin <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegimi i koncepteve të orientimit dhe lëvizjes së trupit tonë • Përshkrimi ndjeshmërisë së lëkurës në ndijim • Përshkrimi i dallimeve kulturore në ndijimin e dhembjes • Shpjegimi i aftësive të lindura në perceptim • Shpjegimi i konceptit të perceptimit ekstrashqisor • Përshkrimi i dallimeve kulturore përsa i përket perceptimit <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimi i motivit të dashurisë si një nga motivet bazë të jetës së njeriut • Diskutimi i variacioneve kulturore të jetës emocionale të jetës psikike të njeriut • Zbërthimi i elementeve kryesore të emocioneve • Identifikimi i elementeve psikologjike të dëshirës • Emërtimi i karakteristikave biologjike të dëshirës • Diskutimi i elementeve kulturore të emocioneve • Shpjegimi i fenomenit të agresivitetit dhe i elementeve të tij • Zbërthimi i konceptit të agresivitetit nga pikëvështrimi emocional dhe motivacional <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimi i lidhjes midis qëndrimeve dhe sjelljes seksuale
---	--

<p>seksuale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Çrregullime psikoseksuale dhe identiteti gjinor • Seksualiteti dhe disa forma të shfaqjes së tij <p><i>5. Stresi, përballimi i tij dhe shëndeti</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Faktorët biologjikë dhe emocionalë të stresit • Faktorë personalë dhe ndikimi i tyre te stresi • Faktorët kontekstualë dhe stresi • Ndryshimi i sjelljeve të lidhura me shëndetin 	<ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i simptomave kryesore të çrregullimeve psikoseksuale dhe identitetit gjinor • Përshkrimi i disa formave të shfaqjes të sjelljes seksuale • Identifikimi dhe shpjegimi i burimeve biologjike të stresit • Rënditja dhe shpjegimi i reagimeve të mundshme emocionale ndaj stresit • Rënditja dhe shpjegimi i faktorëve personalë dhe lidhja e tyre me stresin • Identifikimi dhe shpjegimi i faktorëve kontekstualë në shfaqjen dhe rëndimin e stresit • Identifikimi dhe përshkrimi i strategjive për ndryshimin e sjelljeve lidhur me shëndetin
<p>Qasjet ndërlëndore:</p> <p>Në këtë kategori materiali lëndor është i lidhur me shkencën e biologjisë, me anatinë dhe fiziologjinë, me kulturologjinë, si dhe me fushën e shëndetit mendor dhe atij publik.</p>	
<p>Zhvillimi jetësor (4 orë)</p>	
<p>Përmbajtja programore:</p> <p><i>1. Zhvillimi i të rriturve</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • I rrituri: natyra e zhvillimit dhe kalimi te kjo fazë • Pjekuria e hershme dhe ajo e mesme • Pjekuria e vonë dhe mosha e thyer • Karakteristikat e përgjithshme të fazës para vdekjes 	<p>Rezultatet e pritura:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimi i ndryshimeve fizike, kognitive dhe sociale te periudha e pjekurisë deri në vdekje • Shpjegimi i natyrës së zhvillimit në moshën e pjekurisë • Identifikimi i veçorive kryesore të kalimit në moshën e pjekurisë • Teori të fazave të zhvillimit jetësor në pjekuri • Zbërthimi i natyrës së zhvillimit në moshën e thyer • Identifikimi i çështjeve kryesore në lidhje me shëndetin mendor gjatë

	<p>moshës së thyer</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimi i procesit të përballjes me vdekjen personale • Përshkrimi i procesit të përballjes me vdekjen e dikujt tjetër •
<p>Qasjet ndërlëndore:</p> <p>Në këtë kategori një pikëtakim i rëndësishëm i materialit lëndor nga psikologjia me material nga fushat të tjera është ai me biologjinë dhe fushën teknologjike.</p>	
<p>Kognitiviteti (14 orë)</p>	
<p>Përmbajtja programore:</p> <p><i>1. Të nxënit</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Kufizime biologjike të të nxënit • Ndikime kognitive të të nxënit • Modele lidhëse të të nxënit • Analiza e aplikueshme bihejviorale <p><i>2. Kujtesa</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Teoritë mbi kujtesën • Kritika të teorive mbi kujtesën • Harresa dhe karakteristika të saj • Parandalimi i harresës: sa 	<p>Rezultatet e pritura:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimi i disa kufizimeve që sjell biologjia mbi të nxënit • Shpjegimi i disa koncepteve kryesore të kufizimeve biologjike të të nxënit • Identifikimi i ndikimeve kryesore të të nxënit • Diskutimi i teorive kryesore të ndikimeve kognitive mbi të nxënit • Përshkrimi i modeleve lidhëse të të nxënit • Përshkrimi i qasjeve kognitive të të nxënit • Ekzaminimi i përdorimit nga ana e psikologëve të analizës së aplikueshme bihejviorale • Identifikimi i elementeve kryesore të analizës së aplikueshme bihejviorale <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimi i disa teorive kryesore mbi kujtesën • Dallimi i karakteristikave kryesore të teorive të ndryshme mbi kujtesën • Përshkrimi i punës së dy pionierëve të hulumtimeve mbi kujtesën: Ebbinghaus dhe Bartlett • Përshkrimi i disa karakteristikave

<p>është i mundur ky proces?</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përpjekje për gërshetimin e biologjisë dhe psikologjisë së kujtesës <p><i>3. Të menduarit dhe gjuha</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Çështje të arsytimit dhe zgjidhjes së problemeve • Gjykimi dhe vendimmarrja • Prodhimi i gjuhës: koncepte kryesore • Gjuha dhe komunikimi • Gjuha, të menduarit dhe kultura <p><i>4. Gjendjet e vetëdijes</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Zbërthimi i botës së ëndrrave • Ndryshimi i përditshëm i gjendjeve të vetëdijes • Gjendje të tjera të vetëdijes • Hipnoza: natyra e saj dhe teoritë mbi të • Çështje të lidhura me drogat psikoaktive 	<p>kryesore të kujtesës</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sjellja e shembujve personalë të harresës • Identifikimi i teknikave të parandalimit të harresës • Diskutimi mbi parandalimin e harresës • Shpjegimi i dobisë nga gërshetimi i biologjisë dhe psikologjisë në lidhje me kujtesën <ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i karakteristikave kryesore të arsytimit dhe zgjidhjes së problemeve • Numërimi i disa llojeve të të menduarit në lidhje me zgjidhjen e problemeve • Përshkrimi i lidhjeve midis zgjidhjes së problemeve dhe inteligjencës njerëzore • Përshkrimi i lapsuseve të gjuhës • Diskutimi i konceptimit dhe artikulimit të gjuhës • Identifikimi i lidhjeve midis gjuhës dhe komunikimit • Diskutimi i parimeve të bisedave • Identifikimi i dallimeve gjinore të gjuha dhe komunikimi • Diskutimi i relativitetit të gjuhës <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimi i përmbajtjes së ëndrrave • Diskutimi i kuptimit të ëndrrave • Zbërthimi i funksionit të ëndrrave • Zbërthimi i ëndërrimit gjatë ditës • Përshkrimi i formave të ndryshme të gjendjeve të vetëdijes si hipnoza, meditimi, halucinacioni etj. • Shpjegimi i fenomenit të hipnozës • Diskutimi i elementeve të debatit lidhur me drogat psikoaktive
<p>Qasjet ndërlëndore:</p> <p>Materiali lëndor i kategorisë së kognitivitetit është i lidhur ngushtë me biologjinë dhe linguistikën.</p>	

Sociokultura (19 orë)	
<p>Përmbajtja programore:</p> <p><i>1. Personaliteti</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Teoritë psikodinamike dhe humanistike mbi personalitetin • Teoritë e vetëmësimit dhe ato kognitive mbi personalitetin • Teoritë mbi veten • Krahasimi i teorive të personalitetit <p><i>2. Shëndeti mendor dhe fizik</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Shëndeti dhe psikologjia: një sfond historik i marrëdhënies • Përballimi i sëmundjes dhe promovimi i shëndetit • Promovimi i shëndetit mendor komunitar • Parandalimi: vlera dhe karakteristika kryesore të tij <p><i>3. Dimensione sociale dhe kulturore të sjelljes</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Perceptimi i personit për shoqërinë dhe dashurinë • Përcaktorë të përgjithshëm të tërheqjes ndërpersonale 	<p>Rezultatet e pritura:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i elementeve kryesore të teorisë së Frojdit për personalitetin • Shpjegimi i teorive post-Frojdiene mbi personalitetin • Zbërthimi i teorisë humaniste të Roxhersit për personalitetin • Përshkrimi i teorisë së konstruktit personal të Kellit • Identifikimi i teorisë së të mësuarit social (Bandura) • Numërimi i disa aspekteve dinamike të vetë-koncepteve • Vërejtja e disa dallimeve kryesore midis teorive të personalitetit <ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i zhvillimit historik të lidhjeve midis psikologjisë dhe shëndetit • Shpjegimi se si dallohen dhe interpretohen simptomat e sëmundjeve fizike • Citimi i shembujve të dallimit të simptomave të sëmundjeve fizike • Përshkrimi i elementeve kryesore të promovimit të shëndetit mendor komunitar • Shpjegimi i disa koncepteve që lidhen me parandalimin si prevalenca, incidenca etj. • Diskutimi i vlerave dhe ndikimeve të programeve të parandalimit <ul style="list-style-type: none"> • Demonstrim kuptimi mbi perceptimin e personit për shoqërinë dhe dashurinë • Përshkrimi i elementeve kryesore të ndikimit të tërheqjes ndërpersonale te personi • Identifikimi i përcaktorëve kryesorë për

<ul style="list-style-type: none"> • Ruajtja e marrëdhënieve <p><i>4. Karakteristika të jetës së të rriturve</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Fazat kryesore të ciklit jetësor të familjes • Tendenca aktuale të familjeve • Karakteristikat kryesore të përshtatjes në martesë • Lloje mënyre jetese të të rriturve <p><i>5. Vlerat dhe feja</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi moral dhe vlerat njerëzore • Edukimi dhe nxitja e vlerave • Feja dhe psikologjia 	<p>tërheqje ndërpersonale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i disa dallimeve gjinore në pëlqimin ndërpersonal • Shpjegimi i pritjeve në raport me realitetin në marrëdhëniet ndërpersonale • Barazia në marrëdhënie <ul style="list-style-type: none"> • Numërimi i fazave kryesore të ciklit jetësor familjar • Identifikimi i karakteristikave kryesore të çiftëzimit • Shpjegimi i ndryshimeve në jetën e personit që bëhet prind • Përshkrimi i disa dinamikave të familjeve, që kanë anëtarë adoleshentë • Përshkrimi i dinamikave të familjes në rastet kur prindi është adoleshent • Identifikimi i pritjeve që dalin në pah në martesë • Shpjegimi i veçorive të komunikimit dhe konfliktit martesor • Shpjegimi i shkaqeve dhe i pasojave të dhunës në familje <ul style="list-style-type: none"> • Diskutimi për vlerat e psikologjisë si shkencë • Identifikimi i pikave kryesore të fazave të rezonimit moral (Kolbërg) • Diskutimi për kritikën e teorisë së rezonimit moral • Shpjegimi i karakterit të arsimimit dhe edukimit në lidhje me vlerat morale • Përshkrimi i disa elementeve të historisë së psikologjisë së fesë • Diskutimi i natyrës së fesë • Përshkrimi i veçorive kryesore të përjetimit fetar
<p>Qasjet ndërlëndore</p> <p>Në kategorinë e sociokulturës qasjet ndërlëndore kanë të bëjnë kryesisht me kulturologjinë, sociologjinë, fushën e shëndetit mendor dhe, më konkretisht, me psikiatrinë si dhe me teologjinë.</p>	

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Duket se është e vështirë për mësuesit (sidomos ata që do ta japin për herë të parë lëndën e psikologjisë) që t'i zbatojnë standardet e mësipërme gjatë procesit mësimor. Një nga pikat ku mësuesit mund të mbështeten janë rezultatet e pritshme të *sugjeruara*, të cilat mund të përdoren, jo vetëm si bazë e mirë e ndërtimit të aktiviteteve në klasë, por edhe si pikë referimi për planifikimin e kohës, problem ky me të cilin ka shumë mundësi të përballen mësuesit. Gjithashtu, rezultatet e pritshme mund të përdoren fare mirë për vlerësim sa më objektiv të nxënësve. Nga ana tjetër, këto rezultate shërbejnë për krijimin e një baze solide njohurish nga ana e nxënësit për psikologjinë si shkencë, duke plotësuar kështu një pjesë të rëndësishme të formimit të tyre, që u lejon atyre të njohin më mirë veten dhe të tjerët. Pra, rezultatet e pritshme mund të përdoren si pjesë integrale në planin e mësimin të mësuesit për çdo orë të caktuar, ku mund të përfshijnë gjithashtu edhe materialet që i nevojiten për orën, kohëzgjatjen e saj, etj.

Rekomandohet fuqishëm që për planin dhe programin e paraqitur të përdoren mjete audiovizuale për të bërë të mundshëm kuptimin sa më të mirë të materialeve të dhëna nga ana e nxënësve. Është e vërtetë që materialet didaktike për psikologjinë mungojnë në një masë të madhe në Kosovë, por duhet thënë që gjendja në lidhje me këtë po ndryshon ditaditës. Në këtë kuptim, mësuesit duhet të jenë mendjehapur dhe të gatshëm për të përdorur mjete audiovizive në orët e tyre të psikologjisë.

Një plan dhe program cilësor dhe i guximshëm mund të zbatohet vetëm duke u mbështetur te mësuesdhënës që nxisin mësimin ndëraktiv, integrojnë elemente teknologjike në mësimdhënie dhe kanë njohuri për hulumtimet e bëra për tema të veçanta. Mësimdhënësit duhet të inkurajojnë shprehjen e mendimeve dhe qëndrimeve të ndryshme gjatë orës së mësimin për të bërë të mundshëm kuptimin më të mirë të pikëpamjeve individuale dhe kulturore. Ndërkohë që vetë stafi mësimdhënës i lëndës së psikologjisë duhet të shkëmbejë informacion midis njëri-tjetrit, të jetë i trajnuar nga pikëpamja teknologjike dhe të marrë pjesë në ngjarje të ndryshme (konferenca, seminare) që lidhen me psikologjinë në përgjithësi dhe mësimdhënien e saj në veçanti, duke i hapur kështu dritën e gjelbër zhvillimit profesional.

Kështu, disa nga metodat që rekomandohen për të zbatuar filozofitë e lartpërmendura të mësimdhënies, me qëllim arritjen e standardeve të vendosura për këtë lëndë, do të ishin:

Puna individuale – kjo metodologji pune do të ishte shumë pozitive të përdorej sa herë që mësimdhënësi gjykon se nxënësi duhet të reflektojë

në mënyrë individuale në radhë të parë për konceptet dhe çështjet e trajtuara në klasë. Kjo metodologji mund të gërshetohet me punën në çifte.

Puna në çifte – kësaj metodologjie pune rëndom i paraprin puna individuale. Kjo metodologji pune shfrytëzohet rëndom për të rikonfirmuar njohuritë e nxënësve dhe për t'u dhënë mundësi atyre të krijojnë një mjedis diskutues mes tyre.

Puna në grupe të vogla – kjo metodologji ndikon që nxënësit nën vëzhgimin e mësuesit të kenë mundësi t'i diskutojnë idetë e tyre në grup, të formulojnë mendime në mënyrë ekipore dhe t'i prezantojnë ato përpara klasës.

Ndarja e klasës në dy grupe – kjo metodologji pune do të ishte ideale sidomos kur mësimdhënësi synon të nxitë diskutimin dhe shprehjen e qëndrimeve për koncepte ose çështje të caktuara nga ana e nxënësve.

Pyetje autorit – Kjo metodë është tepër e rëndësishme që nxënësit të reflektojnë me sy kritik ndaj materialit që i ofrohet.

VLERËSIMI

Në mënyrë që vlerësimi të reflektojë objektivisht njohuritë e marra nga nxënësit në klasë, integrimin e tyre në mendimin personal, shprehjen e të njëjtave me anë të të shkruarit metodat e vlerësimit e rekomanduara do të ishin:

Vrojtimi – Kjo metodë do të vlente për të parë dhe vlerësuar aktivitetin në klasë të nxënësve. Mësimdhënësi mund t'i shënojë vrojtimit e tij në ditarin e tij në mënyrë që të ketë sistematizëm në këtë pikë dhe të shmangë mundësinë e harrimit të hollësive për çdo student.

Testi me shkrim – kjo metodë vlerësuese ndoshta do të ishte mirë të zbatohet pas çdo kategorie mësimore si dhe në fund të lëndës.

Eseja – kjo metodë vlerësuese do të përdorej me qëllim të vërtetohet sa mund t'i integrojë dhe riprodhojë nxënësi njohuritë e marra me anë të të shkruarit. Gjithashtu, eseja do të ishte metodë ideale për të parë se ç'qëndrim personal ka nxënësi ndaj koncepteve të trajtuara në klasë. Më tej, kjo metodë vlen edhe si parapërgatitje e nxënësit për një punë akademike më të avancuar, nëse do të vijojë studimet universitare. Normalisht, eseja do të ishte një detyrë që do të japej në fund të lëndës, por mund të

zbatohet edhe teknika e minieseve, nëse shihet e arsyeshme nga mësimdhënësi.

Testi me gojë – kjo metodë vlerësuese do të ishte e vlefshme për të verifikuar në klasë njohuritë e marra. Gjithashtu, nxënësit do të kishin mundësi t'i përvetësonin edhe më tepër duke folur termat dhe njohuritë specifike të përfituara.

LITERATURA

- Dragoti, Edmond** (1999) *“Psikologji Sociale”*, ShB Libri Universitar, Tiranë, Shqipëri
- Juniku, Neki** (1994) *“Kaptina nga psikologjia”*
- Musai, Bardhyl** (1999) *“Psikologji edukimi”*, SHB “Pegi”, Tiranë, Shqipëri
- Nushi, Pajazit; Juniku, Neki; & Bërxulli, Dashamir** (2004) *“Psikologjia XI”*, ShB Libri Shkollor, Prishtinë, Kosovë
- Nushi, Pajazit** (2001) *“Psikologjia” Për klasën II gjimnaz*, Botimi III, ShB Libri Shkollor, Prishtinë, Kosovë
- Nushi, Pajazit** (1999) *“Psikologjia e përgjithshme II, Njeriu dhe personaliteti i tij në psikologji”*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, Kosovë
- Pango, Ylli** (1997) *“Psikologjia Sociale”*, Tiranë, Shqipëri
- Pettijohn, Terry** (1996) *“Psikologjia: Një hyrje konçize”*, Tiranë, Shqipëri

Faqe interneti: www.uni-pr.edu/filozofik/psikologji, kjo është faqja zyrtare e Departamentit të Psikologjisë të Universitetit të Prishtinës. Në të mësimdhënësit dhe nxënësit mund të gjejnë ligjërata dhe informacione të ndryshme interesante për psikologjinë në Kosovë dhe më gjerë.

LOGJIKË

**Gjimnazi i shkencave shoqërore
dhe gjimnazi matematikë – informatikë
(2 orë në javë, 66 orë në vit)**

HYRJE

Logjika, që nga lashtësia, është konsideruar çelës apo mjet për të hyrë në të gjitha fushat e dijes, në të gjitha shkencat. Këtë kuptim ajo e ka ruajtur, pak a shumë, deri në ditët e sotme.

Lënda e studimit të logjikës - nocioni, gjykimi, përfundimi, njohja, e vërteta, domethënia, emërtimi, shenjat, simbolet, termat, induksioni, deduksioni, analiza, sinteza, abstraktimi, konkretizimi, gjeneralizimi, specifikimi, definicioni, argumentimi, etj.- shfrytëzohet në të gjitha shkencat, në çdo veprimtari të jetës së njeriut e të shoqërisë njerëzore dhe në jetën e përditshme nga të gjithë njerëzit, qofshin ata dijetarë dhe filozofë, ekspertë dhe specialistë apo njerëz të thjeshtë.

Pa iu përmbajtur ligjësive të logjikës – identitetit, kundërthënies, të tretës së përjashtuar, argumentimit të mjaftueshëm, etj. – nuk do të ishte i mundshme as komunikimi në jetën e përditshme ndërmjet njerëzve të thjeshtë, as komunikimi në fushat më të larta të dijes dhe të shkencës, ndërmjet vetë ekspertëve dhe dijetarëve.

Logjika është hyrje në komunikimin e përditshëm dhe në të gjitha fushat e dijes dhe të shkencës, i përshkon ato dhe, njëkohësisht, ajo është rezultat i komunikimit ndërmjet njerëzve dhe i arritjeve të të gjitha shkencave.

QËLLIMET

Qëllimet e Planit dhe programit mësimor të lëndës së logjikës janë:

1. Kuptimi dhe përvetësimi i nocioneve elementare dhe, njëkohësisht, kryesore të mendimit dhe arsyetimit logjik nga antika deri në kohën bashkëkohore.

2. Formimi i mendimit dhe arsyetimit logjik të nxënësit dhe aftësimi i tyre për ta dalluar mendimin dhe arsyetimin logjik nga mendimi dhe arsyetimi në fusha të tjera të dijes dhe të shkencës në përgjithësi.
3. Aftësimi i nxënësve për përdorimin e shkathët, kritik dhe analitik të mendimit dhe arsyetimit logjik në jetën e përditshme, në të folur dhe në të shkruar

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Objektivat e përgjithshëm të këtij programi dalin nga qëllimet e programit mësimor të lëndës së Logjikës. Ato janë në përputhje me aftësitë mendore-intelektuale të nxënësve të kësaj moshe dhe me nevojat e zhvillimit të përgjithshëm e të gjithanshëm të tyre. Nga qëllimet e programit dalin këta objektiva:

1. Kuptimi i realitetit objektiv dhe i lidhjeve të ndërsjella ndërmjet fushave të tij – natyrës, shoqërisë dhe psikikës, si dhe i lidhjes së ndërsjellë ndërmjet shkencave që merren me studimin e realitetit objekti.
 - Formimi i ideve dhe i koncepteve të qarta për lidhjet ndërmjet realitetit objektiv, mendimit dhe gjuhës;
 - Njohja e pozitës dhe rolit të logjikës në raport me shkencat e tjera dhe në raport me jetën e përditshme të njeriut dhe të shoqërisë;
 - Formimi i ideve dhe i koncepteve të qarta për kategoritë dhe për nënkategoritë logjike;
 - Aftësimi i nxënësve për të dalluar dhe për të demonstruar raporte të tilla, si: ngjashmëritë, lidhjet dhe dallimet ndërmjet kategorive dhe nënkategorive të logjikës.
2. Kuptimi dhe përvetësimi i koncepteve tradicionale – antike dhe klasike si dhe i koncepteve bashkëkohore në fushë të logjikës.
 - Vetëdijësimi i nxënësve për posedimin e njohurive logjike të fituara gjatë jetës – para fillimit të mësimin të lëndës së logjikës;

- Zgjerimi dhe thellimi në sistem i njohurive logjike të fituara gjatë jetës me njohuri të fituara gjatë mësimit të lëndës së logjikës;
 - Formimi i mendimit të pavarur logjik – kritik dhe analitik te nxënësit.
3. Aftësimi logjik-intelektual i nxënësve për punë të pavarura krijuese dhe hulumtuese.
- Aftësimi i nxënësve për të hetuar dhe për t'i evituar gabimet dhe paradokset logjike në jetën e përditshme në të folur, në shkrime dhe në publikime, në interpretime dhe në debate, etj.
 - Aftësimi i nxënësve në përdorimin dhe në zbatimin e shkathët të metodave të ndryshme gjatë hulumtimit shkencor.

STRUKTURA PROGRAMORE

Kategoritë dhe numri i orëve	Nënkategoritë	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme	Ndërlidhja
Hyrje në logjikë 4 orë	Lënda e logjikës	- Kuptimet në jetën e përditshme të fjalës logjikë	-Nxënësi do të mësojë kuptimet që kanë fjalët: logjikë, logjike, i palogjikshëm, etj.	Me: filozofinë, psikologjinë, matematikën, dhe me gramatikën
		- Kuptimi etimologjik i fjalës logjikë	- Nga cila gjuhë rrjedh fjala logjikë dhe domethënia e saj	
		- Lënda e logjikës dhe përkufizimi i saj	- Çka studion logjika dhe përkufizimi i lëndës që ajo e studion	
	Logjika dhe shkencat e tjera	Raporti i logjikës me shkencat e tjera: me filozofinë, me psikologjinë, me matematikën, me gramatikën	- Lidhjet e logjikës me shkencat e tjera – dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet tyre	
Realiteti objektiv 7 orë	- Mendimi për realitetin objektiv	- Realiteti objektiv - natyror, shoqëror dhe shpirtëror	- Nxënësi do ta kuptojë çka është realiteti në përgjithësi dhe cilat janë fushat e tij	Me: fizikën, kiminë, biologjinë, matematikën, filozofinë, sociologjinë, gramatikën

		- mendimi për realitetin objektiv	- Cili është raporti i mendimit me realitetin objektiv	
	- Gjuha dhe mendimi	- gjuha si shprehje e mendimit	- Çka është gjuha, çka është mendimi. - Lidhjet dhe dallimi ndërmjet gjuhës dhe mendimit	
		- mendimi, të menduarit dhe gjuha	- lidhja dhe dallimi ndërmjet gjuhës dhe mendimit	
	- Procesi i njohjes së realitetit objektiv	- Shenjat dhe simbolet	- Ç'është shenja, simboli dhe cili është dallimi ndërmjet tyre	
		- Emërtimi, përshkrimi dhe shpjegimi	Kuptimet dhe dallimet ndërmjet emërimit, përshkrimit dhe shpjegimit	
		- Njohja dhe e vërteta	- Dallimet ndërmjet besimit e njohjes dhe format e njohjes - Ç'është e vërteta, pikëpamjet për të vërtetën dhe kriteri i së vërtetës	
Ligjësitë e të menduarit 4 orë	Llojet e ligjeve të të menduarit	- Nocioni i ligjeve të të menduarit	- Kuptimi i ligjeve të të menduarit dhe dallimi ndërmjet ligjit shkencor dhe ligjit të të menduarit	Me: ontologjinë, psikologjinë, gramatikën
		- Ligji i identitetit	- Dallimi ndërmjet identitetit dhe barazisë - Thelbi dhe rëndësia e ligjit të identitetit	

		- Ligji i kundërthënies	- Kuptimi dhe thelbi i ligjit të kundërthënies - Rastet kur në gjykimet dhe nocionet e kundërta përjashtohet gjykimi ose nocioni i tretë	
		- Ligji i të tretës së përjashtuar	- A mund të jenë dy gjykime të kundërta, në të njëjtën kohë të vërteta Nga dy gjykime të kundërta vetëm njëri mund të jetë i vërtetë	
		- Ligji i argumentimit të mjaftueshëm	- Kuptimi dhe rëndësia e ligjit të arsyes së mjaftueshme - Kur një arsye konsiderohet e mjaftueshme	
Format e të menduarit 20 orë	Nocioni	- Përkufizimi i nocionit	- Çka është nocioni dhe cilat janë vetitë thelbësore dhe ato të përgjithshme të nocionit - Dallimet ndërmjet nocionit dhe përfytyrimit	Me: psikologjinë, filozofinë, gramatikën
		- Nocioni dhe fjala	- Raporti nocion-fjalë	
		- Formimi i nocioneve	- Si formohen nocionet - Çka është abstraktimi dhe gjeneralizimi	
		- Përmbajtja dhe vëllimi i nocioneve	- Çka kuptohet me vëllim dhe çka me përmbajtje të nocionit - Në ç'raport qëndrojnë vëllimi dhe	

			përmbajtja e nocionit	
		- Llojet e nocioneve	- Llojet e nocioneve – nocioni abstrakt, konkret, absolut, relativ, pozitiv, negativ-lidhjet e tyre dhe dallimet	
		- Raportet ndërmjet nocioneve	- Dallimi ndërmjet nocioneve të rëndomta dhe kategorive logjike	
		- Kategoritë	- Pikëpamja e Aristotelit dhe ajo e Kantit për kategoritë	
	Gjykimi	- Përkufizimi dhe struktura e gjykimit	- Cili është thelbi i gjykimit - Struktura e gjykimit dhe dallimi ndërmjet strukturës së gjykimeve dhe dallimi sipas cilësisë dhe sasisë së tyre	Me: filozofinë, psikologjinë, gramatikën
		- Gjykimi dhe fjalia	- Dallimi ndërmjet gjykimit, fjalisë dhe propozicionit	
		- Llojet e gjykimeve	-Kriteret sipas së cilave ndahen gjykimet dhe llojet e tyre	
		- Gjykimet modale (modalitetet e gjykimeve)	- Kuptimi i gjykimeve modale (sa vlejné dhe çfarë vlere kanë gjykimet)	
		- Gjykimet pavetore dhe ato të cunguara	- Kuptimi i gjykimeve që u mungon subjekti dhe i atyre që u mungon predikati	

		Gjykimet e përbëra	- Gjykimet që kanë më shumë S dhe ato që kanë më shumë P dhe llojet e tyre	
		- Marrëdhëniet midis gjykimeve	- Raporti i subalternacionit, i kontraritetit, i subkontraritetit dhe ai i kontradiktës ndërmjet gjykimeve (katrori logjik)	
		- Gjykimi dhe nocioni	- Lidhjet e ndërvarura ndërmjet nocionit dhe gjykimit	
Format e të menduarit 20 orë	Përfundimi	- Përkufizimi i përfundimit	- Thelbi i përfundimit- Si nxirret një gjykim i ri, i panjohur nga një apo më shumë gjykime të njohura - Gjykimi i ri nxirret nga një premisë e vetme dhe ka të njëjtin S dhe P ose mbështetet në dy ose më shumë premisa	Me: filozofinë, psikologjinë; gramatikën, matematikën
		- Llojet e përfundimit	- Llojet e përfundimit: sipas subalternacioni, opozicioni, konverzionit, ekvipolencës dhe sipas kontrapozicionit	
		- Përfundimi i drejtpërdrejtë dhe llojet e tij - Përfundimi i tërthortë	- Dallimi ndërmjet përfundimit të drejtpërdrejtë dhe atij të tërthortë dhe llojet e tyre	
		- Analogjia	- Përfundimi analogjik arrihet mbi mundësitë e ngjashmërive të njohura të gjësendeve	

		- Induksioni	- Me përfundimin induktiv arrihet një përfundim i ri, i përgjithshëm, në bazë të rasteve të veçanta	
		- Deduksioni	- Deduksioni mbështetet në vetitë e përgjithshme të nocioneve për të arritur në përfundimin e vërtetë	
		- Silogjizmi dhe llojet e tij Figurat silogjistike	- Thelbi i përfundimit silogjistik, rregullat, figurat dhe llojet e silogjizmit	
Formimi dhe ndryshimi i bindjeve 2 orë	Argumentimi	- Përkufizimi i argumentimit - Pjesët përbërëse të argumentimit - Llojet e argumentimit	- Nxënësi e kupton ç'është argumentimi logjik, cilat janë elementet dhe llojet e argumentimit dhe cili është dallimi ndërmjet argumentimit dhe përfundimit	Me: filozofinë, metodologjinë
	Përgënjeshtrimi	- Përgënjeshtrimi, elementet dhe llojet e përgënjeshtimit	- lidhjen ndërmjet argumentimit dhe përgënjeshtimit dhe si mund të përgënjeshtrohet një argumentim	
Gabimet logjike 2 orë	Sofizmat dhe paralogjizmat	- Sofizmat dhe paralogjizmat	-Nxënësit do ta kuptojnë thelbin e silogjizmit dhe të paralogjizmit - do ta kuptojnë cilat gabime mund të bëhen me qëllim për mashtrime dhe cilat gabime mund të bëhen për arsye objektive gjatë arsytimit	Me: filozofinë, psikologjinë, gramatikën, metodologjinë
		- Gabimet gjuhësore	- Cilat gabime kanë të bëjnë me rregullat gjuhësore dhe	

		- Gabimet në të menduar	- Cilat gabime kanë të bëjnë me rregullat e të menduarit	
Metodat e njohjes 8 orë	Metodat e veçanta të njohjes	- Metoda analitike-sintetike	- Dallimi ndërmjet analizës dhe sintezës logjike nga kuptimi i rëndomtë i tyre - Qëllimi njohës i analizës dhe i sintezës	Me: filozofinë, psikologjinë, metodologjinë, gramatikën
		- Abstraktimi dhe konkretizimi	- Thelbi i abstraktimit dhe i konkretizimit dhe dallimi ndërmjet tyre	
		- Gjeneralizimi dhe specifikimi	- Lidhja dhe dallimi ndërmjet specifikimit dhe gjeneralizimit dhe thelbi i tyre	
		- Përkufizimi - Rregullat dhe llojet e përkufizimit	- Thelbi i përkufizimit të drejtë, rregullat dhe llojet e përkufizimit	
		- Përkufizimi i nocioneve të përgjithshme dhe i nocioneve të thjeshta	- Cilat janë nocionet e përkufizuara dhe cilat janë të papërkufizuara - Tiparet dalluese të nocioneve	
		- Ndarja dhe klasifikimi	- Ç'është ndarja dhe ç'është klasifikimi. Lidhjet dhe dallimi ndërmjet tyre - Dallimi ndërmjet kualifikimit natyror dhe atij artificial	
		- Metoda induktive	- Thelbi i metodës induktive dhe dallimi i saj prej përfundimit induktiv	

		- Metoda deduktive	Thelbi i metodës deduktive dhe dallimi i saj prej përfundimit deduktiv	
		- Sistemi aksiomatik	-Ç' është sistemi aksiomatik dhe cilat janë elementet e tij	
Metodologjia e hulumtimit shkencor 6 orë	Procesi dhe zhvillimi i njohjes	- Puna hulumtuese shkencore - Veçoritë e veprës shkencore	- Nxënësit do ta kuptojnë dhe do ta dallojnë punën dhe veprën shkencore nga puna dhe nga veprat në përgjithësi	Me: metodologjinë gramatikën shkencat natyrore dhe shoqërore
		- Zgjedhja e temës - Mbledhja e fakteve - Organizimi dhe përpunimi i fakteve	- Nxënësit marrin njohuri elementare për fazat kryesore të punës krijuese dhe aftësohen për punimin e temës së diplomës dhe për punime e publikime të pavarura	
		- Interpretimi dhe përpunimi i fakteve	- Nxënësit do të jenë në gjendje t'i identifikojnë, t'i përpunojnë dhe t'i interpretojnë faktet	
		- Hipoteza dhe ligji shkencor	- Nxënësit do ta kuptojnë ç'është hipoteza, ç'është ligji shkencor dhe dallimin ndërmjet tyre - Dallimin ndërmjet ligjit shkencor dhe ligjeve të tjera	

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Gjatë gjithë mësimdhënies dhe mësimnxënies, që është një dhe i njëjti proces, përdoren disa metoda, të cilat kombinohen dhe plotësohen ndërmjet tyre. Secila veç e veç dhe të gjitha bashkërisht duhet të sigurojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësve në mësimnxënie. Ato duhet ta shndërrojnë mësimdhënien në vetëmësimnxënie.

- Shpjegimi frontal – mund të përdoret vetëm si hyrje në temë
- Bashkëbisedimi aktiv, i rrjedhshëm, i qartë, i kuptueshëm, normal dhe i natyrshëm ndërmjet mësimdhënësit dhe nxënësve;
- Puna në grupe: diskutimi dhe analiza e fragmenteve dhe e teksteve që janë të ndërlidhura me temën që shtjellohet;
- Analiza kritike e temave të zgjedhura nga shtypi ditor dhe ai periodik që përkojnë me temën që shtjellohet;
- Analiza kritike e polemikave, e debateve politike publike, e fjalimeve dhe premtimeve gjatë fushatave zgjedhore, etj., që mund të ilustrojnë dhe që mund ta bëjnë më të qartë përmbajtjen e temës që shtjellohet;
- Teknikat: skicat, figurat për paraqitjen vizuale të raporteve të ndryshme të përmbajtjeve mësimore

VLERËSIMI

Arsimtari duhet ta vlerësojë nxënësin në mbështetje të kriterëve të paracaktuara që në fillim të vitit shkollor dhe nxënësit duhet të informohen me kohë për kriteret e vlerësimit të tyre. Përfshirja e sa më shumë kriterëve vlerësues siguron dhe garanton vlerësim më të saktë, më të drejtë, më të plotë dhe më objektiv të nxënësve.

- Nxënësit përcillen vazhdimisht dhe vlerësohen në çdo orë mësimore dhe gjatë gjithë vitit shkollor;
- Përcillet dhe vlerësohet interesimi i nxënësit për lëndën e logjikës dhe angazhimi i tij gjatë orës dhe gjatë gjithë vitit;
- Bëhet dallimi ndërmjet mësimmarrjes pasive-mekanike dhe asaj aktive-logjike dhe vlerësohet mësimmarrja aktive-logjike;

- Vlerësohet interpretimi i lirë, i ri dhe origjinal i përmbajtjes mësimore nga nxënësi, i shkëputur dhe i pavarur nga arsimtari, dhe zbatimi i tij në situata të reja;
- Vlerësohet aftësia e nxënësve për hartimin e punimeve të pavarura;
- Vlerësohen argumentimi logjik, përmbajtja e mendimeve të nxënësit, shprehja e qartë, e pasur, e rrjedhshme, e pastër gjuhësore e mendimit të nxënësit;
- Vlerësimi bëhet me gojë dhe me shkrim – me teste, në të cilat përfshihet thelbi i përmbajtjeve mësimore.

QASJET NDËRLËNDORE

Kategoritë dhe nënkategoritë që mësohen në lëndën e logjikës mund të ndërlidhen me jetën e përditshme, me të gjitha fushat e dijes, me të gjitha shkencat, qofshin ato natyrore apo shoqërore, por logjika është e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme sidomos me

psikologjinë

filozofinë (ontologjinë, gnoseologjinë - teorinë e njohjes, filozofinë analitike)

matematikën

gramatikën

metodologjinë

LITERATURA

Logjika për kl. III të gjimnazit, nga dr. Ekrem Murtezai, Prishtinë, 1997

Logjika për kl. III të gjimnazit, nga dr. Gajo Petroviq, Prishtinë, 1976

Logjika me metodologji për kl. IV AMO, nga grup autorësh, përkthyer nga dr. Fehmi Agani, Prishtinë, 1984

Logjika nga dr. Bujar Hoxha, Tiranë, 1985

SOCIOLOGJIA

Gjimnazi i gjuhëve (2 orë në javë, 66 orë në vit)

HYRJE

Sociologjia edhe pse është shkencë relativisht e re ka zgjuar interesim të njerëzit. Sot interesimi është duke u rritur edhe më shumë. Problemet dhe vështirësitë që po shfaqen në vendet në zhvillim dhe në vendet e zhvilluara për shkak të ndryshimeve teknike dhe teknologjike janë fakte të mjaftueshme për rëndësinë e të mësuarit të sociologjisë.

Sociologjia është e dobishme për çdo nxënës sepse ndihmon të kuptuarit e drejtë të shoqërisë njerëzore dhe të fenomeneve të saj që ndodhin në të. Mundëson kreativitetet mendor në tërësinë e marrëdhënieve njerëzore dhe të proceseve shoqërore.

Plani dhe programi i sociologjisë për klasat XII të gjimnazit të gjuhëve kapërthen njohuri të mjaftueshme për nxënësit përkitazi me konceptet kryesore të shoqërisë njerëzore.

QËLLIMET

Përmes të mësuarit të lëndës së sociologjisë në klasën XII të gjimnazit të gjuhëve do të arrihen këto qëllime:

1. Që gjatë shtjellimit të temave nxënësve t'u jepen njohuri të mjaftueshme për konceptet e ndryshme shoqërore;
2. Që nxënësit t'i kuptojnë rrjedhat e zhvillimit parcial dhe global të shoqërisë njerëzore;
3. Që të nxisë kreativitetet mendor dhe praktik për raporte të shëndosha shoqërore;
4. Që të jetë në gjendje t'i identifikojë dukuritë negative aktuale në shoqëri dhe t'i luftojë ndërsa ato pozitive t'i avancojë;
5. T'i zhvillojë proceset kognitive në shtjellimin dhe kuptimin e proceseve shoqërore;
6. T'i thellojë dhe t'i zbatojë njohuritë e fituara në rrjedhat shoqërore.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Objektivat për lëndën e sociologjisë në këtë klasë janë:

- 1. Të krijojë njohuri shkencore për transformimin e shoqërisë njerëzore në të kaluarën dhe të hapë rrugë për zhvillimin e sotëm shoqëror;**
 - 1A. Të krijojë njohuri të mjaftueshme për zhvillimin e mendimit sociologjik dhe të sociologjisë si shkencë shoqërore si dhe për metodologjinë e hulumtimit të lëndës së saj;
- 2. Ta mundësojë integrimin e individit në rrjedhat e mirëfillta të zhvillimeve shoqërore;**
 - 2A. Të fitojë njohuri për raportet individ – grup – shoqëri dhe për grupet e tjera shoqërore;
- 3. Të shpjegojë fenomenet dhe proceset shoqërore**
 - 3A. Të gjykojë drejt për fenomenet dhe proceset shoqërore pa marrë parasysh ato a janë pozitive apo negative;
 - 3B. Që fenomenet shoqërore të mos trajtohen dhe të analizohen vetëm nga një dimension, por të trajtohen si fenomene shumë-dimensionale;
- 4. Të kuptuarit e sociologjisë do ta mundësojë shmangien nga interpretimet personale të rrjedhave shoqërore.**
 - 4A. Ta kuptojë thelbin, rolin dhe rëndësinë e institucioneve shoqërore dhe të jetës së institucionalizuar;
- 5. Të japë mendime për tejkalimin e problemeve dhe të vështirësive shoqërore.**
 - 5A. Të kuptojë drejt shtresëzimin shoqëror dhe konfliktet që ndodhin në shoqëri dhe të bëjë të mundshmen e tij për parandalimin e konflikteve.
- 6. T'i kuptojë proceset normale të zhvillimit të shoqërisë bashkëkohore.**
 - 6A. Të kuptojë që ndryshueshmëria në kulturë dhe në format e tjera të vetëdijës të jenë pasuri shpirtërore e jo burim i konflikteve.

STRUKTURA PROGRAMORE

Kategoritë	Nënkategoritë dhe numri i orëve	Përmbajtja programore (njësitë mësimore)	Rezultatet e pritshme	Ndërlidhja
Përkufizimi i sociologjisë dhe metodat e studimit	Lënda e sociologjisë dhe metodat e hulumtimit sociologjik 11 orë 14.86%	<ul style="list-style-type: none"> • Rrethanat shoqërore dhe historike të krijimit të sociologjisë si shkencë • Sociologjia shkencë e krizës shoqërore • Ç'është sociologjia? • emri dhe definimi i sociologjisë, marrëdhëniet e sociologjisë me shkencat e tjera. • Metoda e të vërejturit dhe e eksperimentit • Metoda e anketës dhe e intervistës 	<p>- Nxënësi është në gjendje: t'i përshkruajë ngjarjet në procesin e krijimit të sociologjisë</p> <p>- cila është lënda e sociologjisë dhe rrethanat shoqërore-historike të krijimit të saj</p> <p>- cilat janë disiplinat kryesore të sociologjisë, arsyet e krijimit të tyre si dhe pse ka sociologjia lidhje të ngushta dhe ndihmohet me shkencat e tjera si :</p> <p>me historinë, shkencat ekonomike, psikologjinë</p> <p>- dallon të vërejturit shkencor nga të vërejturit e rëndomtë. Llojet e të vërejturit. Roli i eksperimentit në hulumtimet sociologjike.</p> <p>- Ka njohuri për secilën metodë kur të përdoret dhe cila prej tyre të përdoret. Ka njohuri për përparësitë, por edhe për të metat e secilës metodë veç e veç.</p>	Me historinë, psikologjinë, antropologjinë, shkencat ekonomike, politike dhe juridike.
Historiku i mendimit mbi shoqërinë Përfaqësuesit	Zhvillimi i mendimit sociologjik	<ul style="list-style-type: none"> • Platoni, Aristoteli, Ibn-Khalduni • Forcat intelektuale dhe zhvillimi i teorisë 	- Nxënësi duhet të dijë cilët janë mendimtarët soicalë para themelimit të sociologjisë si shkencë e veçantë shoqërore, pastaj rrethanat historike dhe	Me historinë, filozofinë, shkencat politike, letërsinë dhe biologjinë.

kryesorë të mendimit sociologjik	5 orë 6.75%	<p>sociologjike (iluminizmi, Sen Simoni, O. Kontit, E. Dyrkemi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Burimet e sociologjisë gjermane (Marks, Veberi, Zimli) • Sociologjia britanike (Spenseri) • Sociologjia italiane (Pareto e Moska) • Fillet e sociologjisë amerikane (V.G. Samner, « Shkolla e Çikagos, R. Park) • Teoritë bashkëkohore sociologjike • Funksionalizmi • Strukturalizmi • Marksizmi bashkëkohor-teoria e konfliktit • Fenomenologjia sociale dhe interaksionizmi simboli • Teoria feministe 	<p>shoqërore që nxisin lindjen e sociologjisë së shkencë e krizës ;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë në gjendje të kuptojë ku qëndrojnë dallimet në mënyrën e shpjegimit të shoqërisë në kohërat e ndryshme. - Të dinë cili ishte kontributi i secilit sociolog në shpjegimin e shoqërisë dhe të fenomeneve të saj. 	
Përkufizimi shkencor i shoqërisë njerëzore	Shoqëria njerëzore dhe struktura e saj 15 orë 22.98%	<ul style="list-style-type: none"> • Shoqëria njerëzore dhe zanafilla e saj; • puna dhe ndarjet e punës si forma kryesore të veprimtarisë shoqërore; 	<ul style="list-style-type: none"> - Nx. duhet të kuptojnë se shoqëria është një totalitet i gjerë i marrëdhënieve shoqërore dhe se shoqëria ka kaluar nëpër faza të ndryshme të zhvillimit të saj; - duhet të dinë se puna është aktivitet i vetëdijshëm, i qëllimshëm i planifikuar i 	<p>Me historinë, shkencat ekonomike dhe politike, edukatën qytetare</p>

		<ul style="list-style-type: none"> • raportet individ-grup – shoqëri; • fenomenet dhe proceset shoqërore; • grupet shoqërore; • klasifikimi i grupeve shoqërore; • familja dhe zhvillimi i saj; • funksionet e familjes në shoqërinë bashkëkohore; • format primitive të grupeve etnike (hordha, gjinia dhe fisi); • populli; • kombi; • dukuritë negative në raportet mes kombeve; 	<p>njeriut edhe burim i pasurisë së tij;</p> <ul style="list-style-type: none"> - duhet të dinë se ndarjet e punës (natyrore, shoqërore dhe teknike) mundësojnë zhvillimin e shoqërisë; - që shoqëria është mjaft heterogjene dhe përbëhet prej grupeve të llojllojshme shoqërore, ku secila e ka rëndësinë e vet; - të dinë çka janë fenomenet shoqërore, çka janë proceset shoqërore dhe dallimet mes tyre; - në socializimin e individit rol të rëndësishëm ka familja, rrethi shoqëror, shkolla, masmediat etj. - familja si grup i rëndësishëm shoqëror gjatë zhvillimit të shoqërisë njerëzore ka kaluar nëpër disa forma; nx. duhet t'i kuptojnë funksionet e familjes, por edhe divorcin si dukuri mjaft e pranishme (prezente); - të dinë cilat janë veçoritë e popullit si grup etnik; - të dinë kur dhe si është formuar kombi si bashkësi njerëzore dhe cilat janë veçoritë e tij; - çka kuptojmë me vetëvendosje të kombeve dhe çka janë minoritetet. cilat janë dukuritë dhe tendencat negative që pengojnë zhvillimin e marrëdhënieve 	
--	--	---	--	--

			shoqërore, jo vetëm të kombeve të tjera, por edhe të vetë atij.	
Struktura e shoqërisë	Institucionet shoqërore 8 orë 10.81%	<ul style="list-style-type: none"> • institucionet shoqërore dhe llojet e tyre; • Demokracia; • Elit; • Burokracia; • Partitë politike; • shteti-funksionet dhe ndarja e pushtetit; • tipat dhe format e shtetit; • shteti i së drejtës; 	<ul style="list-style-type: none"> - Të jetë në gjendje ta kuptojë funksionin, rëndësinë dhe respektimi e institucioneve shoqërore dhe politike e veçmas të shtetit; - roli, funksionimi dhe organizimi i partive politike ka rëndësi në jetën politike të njerëzve dhe të shoqërisë në përgjithësi. - Të kuptojë se çka është shteti, cilat janë funksionet e tij dhe si ndahet pushteti në ligdhënës, ekzekutiv dhe në gjyqësor. - dinë se ekzistojnë shumë tipa dhe forma të shtetit dhe secili i ka veçoritë e veta. - të jetë në gjendje të dinë se për ekzistimin e shoqërisë demokratike duhet të respektohen dhe të plotësohen disa kushte (pluralizmi politik, respektimi i ligjit, liritë dhe të drejtat e barabarta të qytetarëve) etj.; 	Me shkencat politike, me historinë e shtetit dhe të së drejtës, edukatën qytetare.
Konflikti dhe pabarazia shoqërore	Shtresëzimi shoqëror 7 orë 9.46%	<ul style="list-style-type: none"> • Stratifikimi social dhe mobiliteti; • Prona dhe fuqia shoqërore; • Format e stratifikimi social (robëria, kastat, rendet dhe klasat); 	- Nxënësit duhet të njihen me rolin dhe me funksionin e pronës në krijimin e shtresëzimit shoqëror. Stratifikimi si lloj i pabarazisë shoqërore veçohet me hierarki vertikale dhe dallon prej diferencimit shoqëror. Klasat shoqërore janë grupe njerëzish që dallohen nga	Me historinë, edukatën qytetare, shkencat politike.

			<p>pabarazia ekonomike. Krijues i teorisë për klasat dhe luftërat klasore është Marksi;</p> <ul style="list-style-type: none"> - teorisë së Marksit i bëri kritikë M. Veberi duke shpjeguar se njerëzit dallohen edhe me status dhe fuqi që kanë në shoqëri; - diferencat mes kastave dhe rangjeve janë të rregulluara me norma religjioze apo ligjore dhe cilat ishin kastat dhe rangjet në shoqëritë konkrete; - të dinë se burokracia është një shtresë shoqërore, por duhet të dinë edhe për dukurinë e burokratizmit; - të dinë se konflikte shoqërore janë konfrontime mes grupeve për shkak të interesave të kundërta apo paragjytimeve të ndryshme; - duhet ditur se ekzistojnë lloje të konflikteve shoqërore të cilat gjithmonë nuk shprehen me dhunë; - të dinë se luftërat janë forma të ashpra të konflikteve dhe cilat janë llojet e tyre. 	
Kultura dhe shoqëria	Kultura dhe format e vetëdijes shoqërore 11 orë	<ul style="list-style-type: none"> • Kultura • Ç'është kultura, llojet e kulturës, subkultura dhe kontrakultura, shenja, simboli, gjuha, norma; • religjioni dhe fazat e 	<ul style="list-style-type: none"> - kuptojnë se kultura dhe shoqëria janë të kushtëzuara nga njëra-tjetra, ç'është kultura dhe funksioni shoqëror i saj; - cilat janë llojet kryesore të kulturës dhe çka janë subkulturat; - duhet të dinë ç'është religjion dhe 	Me historinë, filozofinë, etikën, shkencat juridike, me letërsinë.

Religjioni morali dhe vetëdija	16.21%	<p>zhvillimit hist. të religjionit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • fetë monoteiste; • funksioni shoqëror i religjionit; • morali dhe vetëdija morale; 	<p>format e hershme të besimeve;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të dinë cilat janë fetë monoteiste dhe cilat janë veçoritë e përbashkëta mes tyre; - të kuptojnë se religjioni ka karakter shoqëror; - të kuptojnë çka është shkenca dhe ideologjia dhe cilat janë dallimet mes tyre; - të dinë ç'është e drejta dhe se ajo paraqet nivelin e zhvillimit shoqëror dhe kulturor të shoqërive konkrete; - të jetë në gjendje të identifikojnë komponentet e moralit dhe ndikimin e tyre në shoqëri. 	
Individi dhe shoqëria	Sociopatologjia 5 orë 6.75%	<ul style="list-style-type: none"> • Konformizmi dhe alienimi; • Krimi dhe ndëshkimi; • Sjelljet; sociopatologjike në shoqëri (narkomania, trafikimi i njerëzve dhe korrupsioni, depresioni i të rinjve) 	<ul style="list-style-type: none"> - të dinë çka është konformizmi, shmangia dhe llojet e shmangies - të identifikojnë krimin, cilët faktorë ndikojnë në kryerjen e krimeve dhe llojet e krimeve si dhe ndëshkimet. - të jenë në gjendje të dinë si e shpjegojnë krimin teoria sociologjike dhe psikologjike; - të kuptojnë shkaqet dhe pasojat e shumanshme të njeriut dhe të shoqërisë nga dukuritë negative siç janë: narkomania, prostitucioni dhe korrupsioni. 	
Problemet e shoqërisë	Shoqëria dhe teknologjia	<ul style="list-style-type: none"> • ndikimi i faktorëve të ndryshëm në zhvillimin e 	<ul style="list-style-type: none"> - të dinë cilat janë ndryshimet më të theksuara në shoqëri dhe cilët faktorë i 	Me historinë, demografinë, shkencat

bashkëkohore, ndryshimet sociale	4 orë	shoqërisë së sotme bashkëkohore; <ul style="list-style-type: none"> • automatizmi dhe urbanizmi në rrjedhat e zhvillimit shoqëror; • Migrimet; • Integrimet; • Globalizmi; • Komunikimet; • Ekologjia; 	kanë kushtëzuar; <ul style="list-style-type: none"> - duhet të dinë cilat janë problemet e shtimit të popullsisë në vendet e zhvilluara dhe në vendet në zhvillim dhe disa teori (teoria e Maltusit) në lidhje me këtë çështje; - të dinë se si automatizmi dhe urbanizmi i ndryshojnë rrjedhat e zhvillimit shoqëror; - të kuptojnë cilat janë pasojat e sjelljeve sociopatologjike në shoqëri (të: narkomanisë, trafikimit të njerëzve dhe korrupsionit), vetë nxënësit janë në gjendje t'i identifikojnë dhe t'i flakin dukuritë negative në rrethin e vet shoqëror. - duhet të dinë se grupet e ndryshme dëshirojnë ndikimin më të madh përmes formave të ndryshme e veçmas duke monopolizuar mjetet e informimit. 	juridike, ekonomike dhe me informatikën.
ARTI funksionaliteti dhe socialiteti i tij	3 orë	<ul style="list-style-type: none"> • Llojet dhe përkufizimi i artit • Arti krijues dhe reproduktues • Socialiteti i artit • Faktorët që ndikojnë në artistin dhe veprën artistike • Kiçi 	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit duhet të kuptojnë ç'është arti dhe kush e krijon, funksioni dhe zhvillimi si dhe roli që luajti ai në zhvillimin e shoqërisë; cili është ndikimi i artit në shoqërinë bashkëkohore, arti tradicional dhe avangard etj. 	

Vërejtje: Arsimitarit gjatë vitit i mbeten në dispozicion 2 orë. Gjatë këtyre orëve mund të trajtojnë tema aktuale që kanë karakter të përgjithshëm shoqëror.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Në procesin e mësimdhënies së lëndës së sociologjisë mund të zbatohen metoda të ndryshme. Secila metodë që pëdoret gjatë orës mësimore është në kompetencë të mësimdhënësit. Rëndom mësimdhënësi duhet t'i aplikojë metodat në vartësi nga nevojat dhe kërkesat e nxënësve, veçoritë e përmbajtjes së temës, nga mosha dhe aftësia e nxënësve për absorbim të njohurive të reja si dhe dëshira e arsimtarit që të nxënësit të krijojnë shprehje pune me tekst dhe në mënyrë të pavarur.

Që plani dhe programi të realizohet në mënyrë sa më cilësore, arsimtari duhet të nxitë mësim interaktiv. Të mësuarit e tillë do ta mundësojnë njohuritë paraprake që kanë nxënësit për problemet e përgjithshme shoqërore. Mësimdhënësi duhet t'i inkurajojë nxënësit për shprehje të lirë të mendimeve dhe të pikëpamjeve të tij për problemet shoqërore.

Mësimdhënësi, së bashku me nxënësit duhet të bëjë përpjekje për tejkalimin e mësimdhënies dhe vlerësimit tradicional. Ndhimë për gjetje të metodave më të përshtatshme do të ishte bashkëpunimi mes arsimtarëve të sociologjisë si dhe pjesëmarrja nëpër seminare të ndryshme me karakter didaktik.

Në mënyrë që arsimtari të ketë mësimdhënie cilësore dhe sukses sa më të lartë të nxënësit, mund të përdorë disa metoda dhe teknika, siç janë:

- Shpjegimi
- Puna në grupe
- Diskutime të dobishme në zgjidhjen e problemit (debat)
- Furi (stuhi) mendimesh (brainstormingu)
- Vetëhulumtimi (kërkimi)
- Të shprehurit me gojë etj.

Gjatë procesit mësimor organizimi i nxënësve mund të jetë:

- Puna me grupe
- Puna me tërë klasën
- Puna në çifte dhe
- Puna individuale

Puna në grupe dhe në çifte parapëlqehet me qëllim që nxënësit të lirohen nga emocionet e pakëndshme (frika) dhe së bashku të diskutojnë në grup në mënyrë që të nxjerrin përfundime të sakta dhe me vlerë. Grupi mund të përbëhet nga 4-6 veta. Për temat që nxënësit kanë njohuri para-prake me sukses mund të zbatohen ligjërata interaktive të kombinuara me praktikën shoqërore.

Metoda - diskutim që zgjidh problemin ka për qëllim t'i për probleme të ndryshme nuk ka vetëm një zgjedhje. Atëherë u mundësohet nxënësve të japin sa më shumë zgjidhje alternative dhe në fund të vlerësohet zgjedhja më e mirë.

Metoda - furi mendimesh (brainstorming) ka për qëllim t'i aftësojë nxënësit të japin ide, zgjidhje dhe komente të shpejta për problemin e dhënë.

Arsimtari i përgatitur gjithnjë në qendër të vëmendjes e ka nxënësin dhe përdor strategji të ndryshme që tek ai të zhvillohet të munduarit kritik. Gjithmonë arsimtari duhet që mësimin ta bëjë sa më interesant dhe të mos krijojë monotoni. Arsimtari duhet t'i respektojë parimet didaktike, por që edhe te nxënësit të krijojë shprehi të tillë që duke u nisur: prej të njohurës kah e panjohura, prej të thjeshtës * kah e ndërlikuarja, prej konkretës * kah abstraktja, dhe prej të veçantës * kah e përgjithshmja t'i argumentojë mendimet e veta.

VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësve është pjesë e procesit mësimor. Përmes vlerësimit kuptojmë se sa nxënësit i kanë përfituar njohuritë që dalin nga objektivat e vetë planit dhe programit. Vlerësimi, jo vetëm që është gjykim meritor për matjen cilësore dhe sasiore të njohurive, por shërben edhe si nxitje për punë të mëvonshme. Vlerësimi mund të bëhet:

- me kontroll të pandërprerë të veprimtarive në orë;
- me shkrim përmes testeve të llojeve të ndryshme (testet me përgjigje të shkurtra, me teste alternative, teste me kombinime, teste me përgjigje të shumta etj.), eseve etj.;
- gojarisht (mund të përdoret pjesërisht);
- detyrat e shtëpisë;
- punë praktike.

Vlerësimi duhet të bëhet në mënyrë sistematike (për çdo njësi mësimore), periodik, dhe semestral apo vjetor. Vlerësimi duhet t'i përmbajë këto veçori: **të jetë sistematik, objektiv, i vlefshëm, i besueshëm, i barabartë, i përshtatshëm, formues dhe duhet të bëhet në kohë të duhur.**

- **sistematik** – duhet të vlerësohet pas çdo njësie mësimore apo të një periudhe të caktuar kohore;
- **objektiv** - duhet që vlerësimi të bëhet në mënyrë të paanshme pa marrë parasysh gjininë, prejardhjen etnike apo të farefisnisë;
- **i vlefshëm** – të vlerësohet realisht njohuria në bazë të kriterëve përkatëse;
- **i besueshëm** – vlerësimi të bëhet me të njëjtat standarde që te nxënësi të mos krijohen dilema;
- **i barabartë** – që nxënësve t'u jipen mundësi të barabarta edhe atëherë kur ndoshta përvojat e tyre nuk janë të njëjta;
- **i përshtatshëm** – duhet të vlerësohen në mënyrën që u përshtaten më së miri personalitetit të nxënësve për t'u ikur emocioneve të pakëndshme të nxënësve;
- **Vlerësimi në kohë të duhur** – vlerësimi duhet të bëhet gjatë vitit e jo krejt në fund të semestrit apo vitit, sepse nxënësi nuk ka kohë të përmirësohet.

Tipat e vlerësimit

Detyrë me përgjegjësi e mësimit duhet të planifikimi i vlerësimit dhe kontrollimit të njohurive dhe të vështirësive të nxënësve që të arrihet një sukses më i madh, ekzistojnë disa tipa vlerësimi:

Vlerësimi i mbështetur në kriter: ka për qëllim të kontrollojë njohuritë e nxënësve në bazë të kriterëve standarde. Përgjigjet e testit duhet të përcaktohen me pikë. Varësisht nga përqindja e pikëve të fituara bëhet edhe vlerësimi. Vlerësimi i përgjigjeve mbetet në përgjegjësinë e mësimit.

Vlerësimi formues: ka për qëllim që mësimit të planifikojnë punën e tyre në të ardhmen. Ky vlerësim bëhet në fillim ose gjatë vitit mësimor dhe jo me nota.

Vlerësimi diagnostikues: ka për qëllim t'i zbulojë vështirësitë dhe dobësitë që hasin nxënësit. Paratestet nuk vlerësohen me nota, por shërbejnë vetëm si informacion për vështirësitë dhe dobësitë në të mësuar.

Vlerësimi përmbledhës (kontrollues): ky lloj testimi rëndom bëhet në fund të gjysmëvjetorit të parë dhe në përfundim të mësimit. Ka për qëllim ta vlerësojë dhe ta kontrollojë nivelin e njohurive të fituara gjatë një periudhe të caktuar.

LITERATURA

1. Anthony Giddens, Sociologjia, Shtëpia Botuese: Çabej, Tiranë 2002
2. Dr. Ante Fiamengo, Bazat e sociologjisë së përgjithshme, Rilindja, Prishtinë, 1984
3. Dr. Fehmi Agani dhe dr. Agim Hyseni, Sociologjia për klasën e katërt
4. Zydi Dervishi, Sociologjia, Shtëpia Botuese: Nënë Tereza, Tiranë, 2003
5. Dr. Ismail Hasani, Probleme teorike nga sociologjia e religjionit, Grafoprint, Prishtinë, 1996
6. Zydi Dervishi, Sociologji kulture, Shtëpia Botuese: Jerusalem, Tiranë, 2001
7. Bardhyl Musai, Psikologji edukimi, Shtëpia Botuese: Pegi, Tiranë, 1999
8. Bardhyl Musai, Metodologjia e Mësimdhënies, Tiranë, 2003
9. Isuf Zeneli, Bazat e standardizimit dhe vlerësimit në arsim, Shtëpia Botuese: Libri Shkollor, Prishtinë, 2002

SOCIOLOGJIA

Gjimnazi i shkencave shoqërore (3 orë në javë, 99 orë në vit)

HYRJE

Lënda e sociologjisë mundëson që nxënësit të fitojnë dituri lidhur me rastet, dukuritë, fenomenet dhe proceset në shoqërinë bashkëkohore. Përmbajtjet mësimore kanë për qëllim t'i aftësojnë nxënësit për të qenë të përgatitur për jetë, njëkohësisht që ata të mos ndjehen inferiorë në shoqëri, por të interesuar për të shprehur aftësitë dhe potencialet e tyre individuale dhe të gjeneratës. Sociologjia XII jep dije dhe kulturë shkencore për nxënësit, në mënyrë që ata të ndjehen pjesë aktive dhe krijuese e dinamike të zhvillimit dhe të përparimit të shoqërisë.

Nxënësit do të fitojnë dije duke punuar në përmbajtje tematike dhe po kështu do të aftësohen në aspektin intelektual dhe etik, në mënyrë që të marrin edhe vetë përgjegjësi shoqërore në realizimin e projekteve me interes, jo vetëm për veten e tyre, por edhe për shoqërinë.

Sociologjia krijon njohuri dhe aftësi vlerësimi më të drejtë të të rinjve për dimensionin social të individit dhe grupit, i njeh me teoritë dhe rezultatet më të reja të arritura në sociologjinë bashkëkohore si dhe ua shton përgjegjësinë për të punuar, duke respektuar obligimet, por edhe duke gëzuar të drejtat individuale dhe kolektive. Mendimi sociologjik është zhvilluar përmes hulumtimeve në fusha të ndryshme të shoqërisë dhe rruga më e mirë do të jetë krijimi i mundësive që edhe vetë nxënësit të njohin dhe të hulumtojnë dukuritë sociale.

Programi i sociologjisë XII është një paraqitje e çështjeve dhe problemeve themelore sociologjike pikërisht duke pasur parasysh interesin dhe arsimimin sociologjik të nxënësve të kësaj moshe.

Programi themelor synon të krijojë nxënës që mbërrijnë të nxjerrin vlerësim kritik personal, pastaj njohje me teknologjinë, nocionet më thelbësore të sociologjisë bashkëkohore si dhe që nxënësit të paraqiten në rolin e gjetjes, përpunimit dhe integritit të fakteve sociologjike në qasjet

dhe punimet e tyre autoriale. Do të preferohet edhe ofrimi i përmbajtjeve të shkurtra të teksteve më tipike dhe domethënëse të sociologëve më të njohur për çëhtjet që janë të lidhura me përmbajtjet programore.

Lënda e sociologjisë XII në shkollën e mesme do të mësohet tri orë në javë, përkatësisht 99 orë në vit.

Plani dhe programi i sociologjisë për klasat XII të gjimnazit do të përmbajë njohuri të mjaftueshme për nxënësit.

QËLLIMET

Përmes të mësuarit të lëndës së sociologjisë në klasën XII të drejtimeve të gjimnazit të përgjithshëm, synojmë të arrihen këto qëllime:

1. Të kompletohet fondi i informatave, përmbajtjeve dhe të dhënave që sociologjia ofron si shkencë e përgjithshme shoqërore. Me kursin paraprak, nxënësit janë njoftuar me kategoritë themelore të sociologjisë, kurse me programin e klasës XII, ofrohet një qasje më kritike, por mjaft e avancuar për të rrumbullakuar njohuritë për këtë shkencë.
2. Që nxënësve t'u ofrohen njohuri nga kategoritë sociologjike, të cilat, sidomos në pjesën e parë të programit, janë produkt i krijimtarisë së sociologëve që mësimin për sociologjinë e kanë pavarësuar nga konteksti paraprak filozofik dhe e kanë ngritur në nivelin e teorive të qëndrueshme dhe të mbështetura shoqërore.
3. Me futjen e formave të reja të qasjeve ndaj institucioneve shoqërore, (vizitat, kontaktet e gjalla dhe shkruarjen e eseve, nxënësi në këtë kurs do të ballafaqohet me realitetin e shoqërisë ku jeton në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa ndërmjetës dhe interpretues. Vizitat në institucione kanë për qëllim çmitizimin dhe çmistifikimin e mjediseve, që për nxënësin e kësaj moshe është parakusht i integritit në shoqëri.
4. Që të zhvillojë aftësitë e nxënësve për të menduar në mënyrë kritike dhe kreative për individin, grupin dhe shoqërinë si dhe për vetveten, duke u mbështetur në njohjen dhe në kuptimin e nocioneve themelore sociologjike.
5. Që të jetë në gjendje t'i identifikojë dukuritë negative aktuale në shoqëri dhe t'i luftojë ndërsa ato pozitive t'i avansojë;

6. Që nxënësi të ndjejë më afër realitetin e tëhuajshuar shoqëror dhe politik, të nxitet të mendojë për shoqërinë si i rritur dhe i aftë të japë kontributin e vet në rrjedhat e saj.
7. T'i zhvillojë proceset kognitive në shtjellimin dhe në kuptimin e proceseve shoqërore:
8. Kursi i propozuar për këtë moshë të nxënësve ofron mundësi të thellimit dhe zbatimit të njohurive të fituara në rrjedhat shoqërore. Teoria shoqërore, politika, institucionet, rrjedhat demografike, familja, pozita e femrës etj. Pas këtij kursi të sociologjisë, për nxënësit të mos mbeten brengë e të “rriturve” dhe zyrtarëve, por edhe e tyre.
9. Të zhvillojë shkathhtësi të përhershme të nxënësit për të kuptuar dhe përdorur nocionet dhe rezultatet sociologjike si në të folur ashtu edhe në të shkruar.
10. Të nxitë raporte humane dhe krijuese në: familje, grupe, shkollë, shoqëri.
11. Të përgatitet për studime të mirëfillta dhe serioze në lëmin e shkencave sociale përgjithësisht, mirëpo edhe të shkencave të tjera, pasi që sociologjia është e vetmja shkencë që në arsimin e lartë mësohet në të gjitha fakultetet.
12. Të mposhtë furstrimet dhe ngurrimet, që te shumica e fëmijëve të kësaj moshe manifestohen – si pasojë e formimit në mjedisit familjar patriarkal si prirje për nënshtrim autoriteteve, por edhe nga mosnjoha e specifikave të funksionimit të individëve, grupeve dhe institucioneve në shoqëri.
13. Të inkurajohet e të mos ngurrojë të kyçet në debate dhe paraqitje publike, të shprehë mendimin dhe qëndrimin e vet lirshëm.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Mbështetur në qëllimet që shtrohen në programin për lëndën e sociologjisë XII, përmabjtjet mësimore synojnë të arrijnë këta objektiva:

- 1. Pas njoftimit me kategoritë themelore të sociologjisë, nxënësit në këtë kurs do të avancojnë njohjen dhe pasurojnë diturinë me interpretime shkencore nga pozicione të ndryshme që dalin nga teoricienë që kanë pasur dhe kanë preokupim shoqërinë dhe ligjësitë e funksionimit të saj.**

- 2. Të krijojë njohuri shkencore për transformimin e shoqërisë njerëzore në të kaluarën dhe të hapë rrugë për zhvillimin e sotëm shoqëror;**
 - 2A. Të krijojë njohuri të mjaftueshme për zhvillimin e mendimit sociologjik dhe të sociologjisë si shkencë shoqërore si dhe për metodologjinë e hulumtimit të lëndës së saj;
 - 2B. Të vazhdojë studimin e kategorive të përgjithshme shoqërore në vijimësinë historike të zhvillimit të tyre.
- 3. Të mësojë për mekanizmat e funksionimit shoqëror, krijimin, transformimin dhe avancimin e tyre.**
- 4. Të mundësojë integrimin e individit në rrjedhat e mirëfillta të zhvillimeve shoqërore;**
 - 4A. Të fitojë njohuri për raportet individ – grup – shoqëri dhe për grupet e tjera shoqërore;
 - 4B. Të hetojë rolin e individit dhe grupit në stimulimin e rrjedhave shoqërore, krijimin e jetës institucionale, avancimin dhe tejkalimin e formave tradicionale dhe respektimin e ligjeve pozitive në shoqëri.
 - 4C. Të lirohen nga paragjykimet eventuale që manifestohen si mostolerancë nga gjithë ajo që është ndryshe nga kultura, raca, religjioni, përkatësia gjinore, bindja politike etj
 - 4Ç. Të mos mbeten në pozicionet e mostrave të trashëguara nga mjedise ksenofobe, por të ndihmohet krijimi i mendjes së lirë të nxënësit.
- 5. Të shpjegojë fenomenet dhe proceset shoqërore**
 - 5A. Të gjykojë drejt për fenomenet dhe proceset shoqërore pa marrë parasysh ato nëse ato janë pozitive apo negative;
 - 5B. Që fenomenet shoqërore të mos trajtohen dhe të analizohen vetëm nga një dimension, por të trajtohen si fenomene shumë-dimensionale;
- 6. Të kuptuarit e sociologjisë do ta mundësojë shmangien nga interpretimet personale të rrjedhave shoqërore.**
 - 6A. Ta kuptojë thelbin, rolin dhe rëndësinë e institucioneve shoqërore dhe të jetës së institucionalizuar;

7. Të japë mendime për tejkalimin e problemeve dhe të vështirësive shoqërore.

- 7A. Të kuptojë drejt shtresëzimin shoqëror dhe konfliktet që ndodhin në shoqëri dhe të bëjë të mundshmen e tij për parandalimin e konflikteve;

8. T'i kuptojë proceset normale të zhvillimit të shoqërisë bashkëkohore.

- 8A. Të kuptojë që ndryshueshmëria në kulturë dhe në format e tjera të vetëdijes të jenë pasuri shpirtërore e jo burim konfliktesh.

9. T'i kuptojë ndryshimet shoqërore si nevojë e avancimit të cilësisë së jetës, botëkuptimeve dhe sjelljeve, e jo si shkapërdhje të dhimbshme të strukturave patriarkale, tradicionale dhe të ngurta.

- 9A. Të vetëdijësohet për rolin e vet aktiv në përkrahjen e proceseve shoqërore të cilat çojnë kah ngritja e nivelit të vetëdijes dhe shkapëputja nga mostrat e vjetruara të funksionimit të individit në shoqëri.

STRUKTURA PROGRAMORE

Kategoritë	Nënkategoritë dhe numri i orëve	Përmbajtja programore (njësitë mësimore)	Rezultatet e pritshme	Ndërlidhja
Shoqëria qytetare	Qasjet e ndryshme sociologjike për shoqërinë qytetare, pushtetin, qeverisjen dhe demokracinë 12 orë 11,88%	<ul style="list-style-type: none"> • Botëkuptimet e ndryshme për shoqërinë – lidhje me përmbajtjet e kursit paraprak, (interpretimi marksist, shoqëria qytetare si shoqëri e civilizuar) • Shteti, pushteti dhe qeverisja, filozofia dhe shkencat politike, aspekte sociologjike dhe juridike, • Qasjet funksionaliste dhe marksiste për krijimin e shtetit; 	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi është në gjendje: t'i interpretojë konceptet themelore të qasjeve të ndryshme sociologjike; - cili është interpretimi qytetar dhe marksist, 	Me historinë, filozofinë, antropologjinë shkencat ekonomike, politike dhe juridike.
Politika, legjitimiteti dhe efektiviteti politik	Teoritë e pushtetit Politika si shkathtësi e udhëheqje shoqërore	<ul style="list-style-type: none"> • Shteti dhe shoqëria, • Kur është krijuar shteti; • Qeverisja shtetërore; • Teoritë e pushtetit, • Themelet e politikës, problemet e legjitimitetit, parimet e ndryshme të legjitimitetit, legjitimiteti dhe efektiviteti 	<ul style="list-style-type: none"> - cilit është roli i shtetit dhe si organizohet pushteti; - dallon pushtetin dhe qeverisjen legjitime nga ajo jolegitime; - dallon format e përfaqësimit - çfarë është demokracia dhe cilat janë themelet kryesore dhe cilat procedurat që duhet zbatuar që një shoqëri të jetë pluraliste dhe demokratike; 	
Format e qeverisjes	Monarkia Republika Qeveria e përzier Diktatura	<ul style="list-style-type: none"> • Format e qeverisjes, tipologjia klasike, monarkia dhe republika, tipologjitë e tjera, qeveria e përzier 	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi duhet të njoftohet me format e qeverisjes – duke marrë njohuritë elementare për format historike të organizimit të qeverisjes. Paraqitja e kësaj dukurie shoqërore kërkon një 	

			qasje kronologjike, pasi që ka të bëjë me një laryshi modusesh të realizuara në kontekstin kohor dhe shoqëror. Secila shoqëri ka specifikat e veta të realizimit dhe ushtrimit të qeverisjes, që po ashtu është dëshmi e një dukurie mjaft specifike.	
Demokracia	Llojet e demokracisë Demokracia parlamentare <i>Vizitë asambleve komunale, partive politike, parlamentit</i> <i>Ese</i> <i>Politika dhe shoqëria</i>	<ul style="list-style-type: none"> • Demokracia dhe diktatura, • demokracia në teorinë e formave të qeverisjes, në kohën bashkëkohore • demokracia e drejtpërdrejtë dhe e përfaqësimit, formale dhe thelbësore • diktatura e kohës antike dhe e kohës moderne 		
Teoria pozitiviste e Ogyst Kontit Formalizmi evropian Hyrje në Teorinë e shoqërisë së shkollës së Frankfurtit	Zhvillimi i mendimit sociologjik Teoria mekaniciste Teoria psikologjiste Përfaqësuesit e formalizmit në sociologji Veçoritë e qasjeve të teorive dhe shkollave sociologjike 16 orë 15.84%	<ul style="list-style-type: none"> • Teoritë mekaniciste në sociologji, teoritë biologjiste, teoritë psikologjiste, teoritë individualiste psikologjiste, teoritë kolektive psikologjiste dhe teoritë sociale psikologjiste • Formalizmi në sociologji, - nocioni dhe kufijtë e formalizmit, - përfaqësuesit kryesorë dhe faktorët që ndikuan në paraqitjen e formalizmit • Formalizmi evropian • Ferdinand Tennis, Gustav RI, 	- Nxënësi duhet të dijë se cilat janë teoritë kryesore sociologjike; - të jetë në gjendje të kuptojë se ku qëndrojnë dallimet mes tyre ; - të njihet me sociologët më të njohur ; - të jetë në gjendje vetë t'i shpjegojë teoritë e shoqërisë; - të dinë cili ishte kontributi i secilit sociolog në shpjegimin e shoqërisë dhe të fenomeneve të saj.	Me historinë, filozofinë, shkencat politike, psikologjinë, biologjinë.

		<p>Georg Zimel, Leopold Von Vize dhe Zhorzh Gurviçi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkolla e Frankfurtit, Max Horkheimer, Theodor Adorno, Herbert Markucuze, Erich From, Franc Neuman dhe Jirgen Habermas 		
<p>Religjioni</p> <p>Normat shoqërore</p> <p>Ideologjia</p> <p><i>*Ese për tolerancën ndërjetare</i></p>	<p>Shoqëria njerëzore dhe format e besimit</p> <p>Funksionet e religjionit</p> <p>Fazat e zhvillimit të religjionit</p> <p>Besimi politeist</p> <p>Monoteizmi</p> <p>Llojet e besimeve monoteiste</p> <p>Veçoritë e besimeve monoteiste</p> <p>Ideologjia dhe identiteti</p> <p>14 orë</p> <p>13.86%</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Religjioni • Konceptet themelore, analiza teorike e religjionit, - religjioni dhe ndryshimet sociale, shikimi përpara: religjioni në shekullin XXI • Llojet e normave shoqërore, tradita dhe zakonet, morali; • Funksionet e ideologjisë, orientimet simbolike, legjitimiteti, solidariteti, identiteti; • Ideologjia në shoqërinë moderne, • liberalizmi, • socializmi nacionalizmi; 	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit duhet të kuptojnë se shoqëria është një totalitet i gjerë i marrëdhënieve shoqërore dhe se shoqëria ka kaluar nëpër faza të ndryshme të zhvillimit të saj. - Nxënësit duhet të njoftohen me funksionimin e shoqërive të organizuara, ku mbretërojnë normat dhe ligjet pozitive. - Po ashtu, nxënësit duhet njoftuar edhe me zanafillën e normave, të cilat rëndom në shoqëri të ndryshme kanë karakter dhe përmbajtje të ndryshme, në vartësi nga niveli i zhvillimit të shoqërive të caktuara. - Konteksti i normave përbën një përzierje të normave tradicionale, që burojnë nga zhvillimi historik, specifikat e zhvillimit dhe rrethanave të shoqërive të caktuara dhe normave ligjore të ligjesisë 	<p>Psikologjinë etikën, të drejtën, edukatën qytetare, mjekësinë, demografinë, gjeografinë, arkitekturën, ekonominë, shkencat politike</p>

			pozitive – që janë produkt i organizimit shoqëror.	
Demografia Urbanizmi dhe perspektivat e zhvillimit të tij në shek. XXI	Shkenca e demografisë dhe historiku i zhvillimit të saj Lëvizjet e popullsisë Perspektiva e njerëzimit: agonalitet i resurseve natyrore apo planifikim i familjes? 11 orë 10,89%	<ul style="list-style-type: none"> • Demografia, studimi i popullsisë; <ul style="list-style-type: none"> - historia e shtimit të popullsisë; - nataliteti; - mortaliteti, shtimi natyror i popullsisë, tranzicioni demografik; • Urbanizimi, rritja e qyteteve, urbanizimi si formë e jetës, urbanizimi në shoqëritë e varfëra, shikimi përpara: urbanizimi në shek. XXI; 	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit duhet të njoftohen me specifikat e qasjeve demografike të studimit shoqëror; - Derisa shkencat e ndryshme shoqërore kanë si objekt studimi lëvizjet shoqërore, ndryshimet, zhvillimin dhe pasojat e atyre lëvizjeve, demografia si shkencë ka një qasje specifike shoqërore; - Demografia e ndryshimeve shoqërore që ndodhin si pasojë e lëvizjeve shoqërore, që historikisht ishin të shpeshta dhe të rëndomta, i studion në kontekstin e ndryshimeve ekonomike, potencialit shoqëror që të adaptohet dhe adptojë rrethanat e caktuara të një mjedisi gjeografik, për krijimin e jetës shoqërore në të; - Demografia, po ashtu këto lëvizje shoqërore i studion duke marrë për bazë regjistrimet e popullsisë si matës i bazuar i këtyre ndryshimeve. - Nataliteti, - Mortaliteti, - shtimi natyror dhe koncepte të 	

			tjera, janë gjithnjë të vështruara në kontekstin e mjedisit jetësor, nevojave të përshtatjes së atij mjedisi individit dhe grupit, krijimin e vendbanimeve, infrastrukturës dhe potencialit strehues për nevojat e njeriut.	
Familja <i>*Ese për konfliktin e gjeneratave ose dhunën në familje</i>	Familja si grup themelor shoqëror Fazat e zhvillimit të familjes në kontekstin historik të saj Familja e madhe/ patriarkale Familja moderne Funksionet e familjes Perspektiva e zhvillimit të familjes në botën moderne Specifikat e familjes shqiptare Konceptet themelore të familjes 7 orë 6,93%	<ul style="list-style-type: none"> • Familja, koncepti themelor i familjes, familja dhe ndryshimet shoqërore, shkenca e jetës; 		
Familja dhe moshë Moshë dhe pleqëria,	Konceptet themelore Konflikti i gjeneratave Familja moderne dhe fati i të moshuarve Specifikat e familjeve të mjediseve rurale dhe urbane Kujdesi për të moshuarit,	Të rinjtë dhe gjenerata e re, <ul style="list-style-type: none"> • specifikat e rinisë, - problemet e rinisë në shoqërinë moderne • Moshë dhe pleqëria • Barazia sociale, sigurimi pensional, sigurimi nga fatkeqësitë, sigurimi 	- nxënësi të mësojë për funksionet themelore të familjes - për kujdesin shoqëror ndaj të sëmurëve, pleqve dhe të pafuqishmëve - të njihet me parimet themelore të barazisë sociale,	

Mbrojtja dhe barazia sociale	invalidët dhe fëmijët Edukimi dhe arsimimi i brezave si nevojë e pajustificueshme 5 orë 4.49%	mjekësor, sigurimi i të papunëve. • Mbrojtja dhe ndihma sociale, burimet e solidaritetit, filantropia, kujdesi ndaj të sëmurëve dhe fëmijëve	të njohë forma të sigurimeve dhe të mbrotjes sociale në shoqëri dhe veçmas në vendin tonë-të nxitet te nxënësit ndjenja e humanizmit, solidaritetit dhe filantropisë	
Lëvizjet sociale, shoqëria civile <i>*Vizitë në OJQ KMDLNJ, Kryqi i Kuq etj.</i>	Krijimi i asociacioneve, shoqatave, klubeve, institucioneve joqeveritare Roli i shoqërisë civile në shoqëri Format e organizimit, funksionimit dhe veprimit të shoqërisë civile 8 orë 7.92%	• Lëvizja sociale, lëvizjet reformuese, lëvizjet e rezistencës, qytetare, lëvizjet utopike, mobilizimi i resurseve • Shoqëria civile, shprehja e lirë e interesit të qytetarit, qytetari • Sensibilizimi i institucioneve qeveritare për nevojat e grupeve joformale, individëve dhe shoqatave të ndryshme joqeveritare		demografinë, gjeografinë, arkitekturën, ekonominë politike, psikologjinë sociale, informatikën, ekonominë, kulturën
Gjinia seksualiteti, gjinia, roli gjinor <i>*Ese Barazia gjinore</i>	Vështrim historik i raportit të gjinive Nënshtimi me lindje Raporti i koncepteve “i ndryshëm” dhe i pabarabartë Institucionalizimi i pabarazisë i mbështetur në interpretimet biologjike Barazia gjinore, përkatësia gjinore dhe roli gjinor	• Gjinia dhe seksualiteti • Gjinia dhe roli gjinor • Feminizmi • Seksualiteti • Gay-izmi dhe lezbianizmi • Represioni shoqëror ndaj këtyre dukurive shoqërore • Mostoleranca individuale dhe institucionale ndaj kërkesave të individëve dhe grupeve me orientim seksual të ndryshëm • Rigjediteti i normave shoqërore në botë dhe te ne ndaj dukurive të		

		<p>realizimit të dashurisë dhe seksit brenda së njëjtës gjini</p> <ul style="list-style-type: none"> • Format e organizimit dhe veprimit të këtyre shoqatave për sensibilizimin e opinionit për të drejtat e veta. 		
<p>Kultura funksioni shoq. i kulturës</p> <p>Kultura dhe shoqëria</p> <p><i>*Vizitë në teatër, kino, muze, shoqëri kulturore etj.</i></p>		<ul style="list-style-type: none"> • Kultura dhe shoqëria • Llojet e kulturës • Funkzioni shoqëror i kulturës • Kultura dhe religjioni 	<p>Nxënësit duhet të kuptojnë se kultura dhe shoqëria janë të kushtëzuara nga njëra-tjetra, ç'është kultura dhe funksioni shoqëror i saj;</p> <ul style="list-style-type: none"> - cilat janë llojet kryesore të kulturës dhe çka janë subkulturat; - duhet të dijë se ç'është religjion dhe format e hershme të besimeve; - të dijë cilat janë fetë monoteiste dhe cilat janë veçoritë e përbashkëta mes tyre; - të kuptojë se religjioni ka karakter shoqëror; - të kuptojë çka është shkenca dhe ideologjia dhe cilat janë dallimet mes tyre; - të dijë ç'është e drejta dhe se ajo paraqet nivelin e zhvillimit shoqëror dhe kulturor të shoqërive konkrete; - të jetë në gjendje të identifikojë 	<p>demografinë, gjeografinë, arkitetkurën, ekonominë politike</p>

			komponentet e moralit dhe ndikimin e tyre në shoqëri.	
Mediat dhe shoqëria Vizitë në gazeta, radio, televizion 8 orë 7,92%		<ul style="list-style-type: none"> • Masmediat në shoqërinë moderne, <ul style="list-style-type: none"> - llojet dhe funksioni i masmediave - ndikimi i masmediave në krijimin e opinionëve, publiku medial, publiciteti • Subkultura 	<ul style="list-style-type: none"> - të dijë çka është masmedia, ku qëndron dallimi ndërmjet shtypit dhe mediave elektronike - pse sot mediat konsiderohen forcë e katërt në shoqëri mbas legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit - të kuptojë si ndikojnë mediat në krijimin e opinionëve lokale, rajonale, nacionale dhe globale - të identifikojnë problemet që sjellin përmbajtjet problematike mediale për individin dhe shoqërinë e mediave shmangia dhe llojet e shmangies - të identifikojë subkulturën në mjedisin shoqëror ku jeton 	Me psikologjinë sociale, informatikën, ekonominë, kulturën
Sociologjia e sportit Ese për dhunën në sport	Shoqëria dhe sporti Të rinjtë dhe sporti Afirmimi i sportit si nevojë elementare 6 orë 5,94%	<ul style="list-style-type: none"> • Sporti dhe shoqëria, <ul style="list-style-type: none"> - sporti amator, - sporti profesional, - - marketingu, sponsorizimi, publiku , simpatizuesit ekstremë, etika në sport, nacionalizmi dhe sporti 	<ul style="list-style-type: none"> - të dijë cili është dimension i sportit social - të dallojnë tipat e funksionimit të sporteve; - të dijë cilat janë problemet që paraqiten në raportin sporti publiku - të zhvillojë njohuritë për etikën sportive si formë e tolerancës dhe mirëkuptimit social - të dijë cilat janë dallimet ndërm- 	Me psikologji. mjekësinë, ekonominë, informatikën

			<p>jet gjeneratave, të njohë specifika e rinisë, të cilës për shkak të vetë moshës, u përkasin nxënësit</p> <ul style="list-style-type: none"> - të vërejë mundësitë për të marrë pjesë aktive në proceset shoqërore - të identifikojnë dhe t'i flakin dukuritë negative në rrethin e vet shoqëror. 	
<p>Sociologjia e artit, funksioni shoq. i artit</p> <p><i>*Ese arti dhe shoqëria</i></p>	<p>Sociologjia e artit si disiplinë e veçantë sociologjike</p> <p>Historiku dhe format e zhvillimit</p> <p>Arti dhe shoqëria</p> <p>Funksioni shoqëror i artit</p> <p>Llojet e artit</p> <p>Arti si medium</p> <p>Arti si mjet shprehës</p> <p>6 orë</p> <p>5.94%</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shoqëria dhe arti, <ul style="list-style-type: none"> - ndikimi i artit në shoqëri, - teatri dhe shoqëria, - filmi, libri, muzika 	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësit duhet të kuptojnë se arti është dimension estetik, por edhe social i njeriut - të njihen me format më të zhvilluara të vlerave artistike dhe ndikimin që kanë ato në shoqëri - të dallojnë vetë format dhe ndikimin e artit në vend - të dinë për filmin, teatrin, librin dhe funksionin social të tyre. - në cilat institucione realizohet arti nacional 	

Vërejtje: Arsimtari gjatë vitit i ka në dispozicion 2 orë. Gjatë këtyre orëve mund të trajtojë tema aktuale që kanë karakter të përgjithshëm shoqëror.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Në procesin e mësimdhënies së lëndës së sociologjisë mund të zbatohen metoda të ndryshme. Secila metodë që përdoret gjatë orës mësimore është në kompetencë të mësimdhënësit. Rëndom mësimdhënësi duhet t'i aplikojë metodat në vartësi nga nevojat dhe kërkesat e nxënësve, veçoritë e përmbajtjes së temës, nga mosha dhe aftësia e nxënësve për absorbim të njohurive të reja si dhe dëshira e arsimtarit që të nxënësit të krijojë shprehje pune me tekst dhe në mënyrë të pavarur.

Që plani dhe programi të realizohet në mënyrë sa më cilësore, arsimtari duhet të nxitë mësim interaktiv. Të mësuarit e tillë do ta mundësojë disponimi i njohurive paraprake që kanë nxënësit për problemet e përgjithshme shoqërore. Mësimdhënësi duhet t'i inkurajojë nxënësit për shprehje të lirë të mendimeve dhe të pikëpamjeve të tij për problemet shoqërore.

Mësimdhënësi, së bashku me nxënësit duhet të bëjë përpjekje për tejkalimin e mësimdhënies dhe vlerësimit tradicional. Ndihmë për gjetje të metodave më të përshtatshme do të ishte bashkëpunimi mes arsimtarëve të sociologjisë si dhe pjesëmarrja nëpër seminare të ndryshme me karakter didaktik.

Në mënyrë që arsimtari të ketë mësimdhënie cilësore dhe sukses sa më të lartë të nxënësit, mund të përdorë disa metoda dhe teknika, siç janë:

- Shpjegimi
- Puna në grupe
- Ndarja e klasës në dy grupe
- Diskutime të frytshme në zgjidhjen e problemit (debat)
- Furi (stuhi) mendimesh (brainstormingu)
- Vetëhulumtimi (kërkimi)
- Të shprehurit me gojë etj.

Gjatë procesit mësimor organizimi i nxënësve mund të jetë:

- Puna me grupe
- Puna me tërë klasën
- Puna në çifte dhe
- Puna individuale

Puna në grupe dhe në çifte parapëlqehet me qëllim që nxënësit të lirohen nga emocionet e pakëndshme (frika) dhe së bashku të diskutojnë në grup në mënyrë që të nxjerrin përfundime të sakta dhe me vlerë. Grupi mund të përbëhet nga 4-6 veta. Për temat që nxënësit kanë njohuri paraprake me sukses mund të zbatohet ligjërata interaktive e kombinuar me praktikën shoqërore.

Metoda - diskutim që zgjidh problemin ka për qëllim t'i për probleme të ndryshme nuk ka vetëm një zgjedhje. Atëherë u mundësohet nxënësve të japin sa më shumë zgjidhje alternative dhe në fund të vlerësohet zgjedhja më e mirë.

Metoda - furi mendimesh (brainstorming) ka për qëllim t'i aftësojë nxënësit të japin ide, zgjidhje dhe komente të shpejta për problemin e dhënë.

Arsimtari i përgatitur gjithnjë në qendër të vëmendjes e ka nxënësin dhe përdor strategji të ndryshme që tek ai të zhvillohet të menduarit kritik. Gjithmonë arsimtari duhet që mësimin ta bëjë sa më interesant dhe të mos krijojë monotoni. Arsimtari duhet t'i respektojë parimet didaktike por që edhe te nxënësit të krijojë shprehi të tillë që duke u nisur: prej të njohurës kah e panjohura, prej të thjeshtës kah e ndërlikuara, prej konkretës kah abstraktja, dhe prej të veçantës kah e përgjithshmja t'i argumentojë mendimet e veta.

VLERËSIMI

Vlerësimi nxënësve është pjesë e procesit mësimor. Përmes vlerësimit kuptojmë se sa nxënësit i kanë përfituar njohuritë që dalin nga objektivat e vetë planit dhe programit. Vlerësimi, jo vetëm që është gjykim meritor për matjen cilësore dhe sasiore të njohurive, por shërben edhe nxitje për punë të mëvonshme. Vlerësimi mund të bëhet:

- Me kontroll të pandërprerë të veprimtarive në orë;
- Me shkrim përmes testeve të llojeve të ndryshme (testet me përgjigje të shkrutra, me testet alternative, testet me kombinime, testet me përgjigje të shumta etj.), eseve etj;
- Gojarisht (mund të përdoret pjesërisht);
- Detyrat e shtëpisë;
- Punë praktike.

Vlerësimi duhet të bëhet në mënyrë sistematike (për çdo njësi mësimore), periodike, dhe semestrale apo vjetore. Vlerësimi duhet t'i përmbajë këto veçoria: **të jetë sistematik, objektiv, i vlefshëm, i besueshëm, i barabartë, i përshtatshëm, formues dhe duhet të bëhet në kohë të duhur.**

- **Sistematik** – duhet të vlerësohet pas çdo njësie mësimore apo të një periudhe të caktuar kohore;
- **Objektiv** - duhet që vlerësimi të bëhet në mënyrë të paanshme pa marrë parasysh gjininë, prejardhjen etnike apo të farefisnisë;
- **I vlefshëm** – të vlerësohet realisht njohuria në bazë të kriterëve përkatëse;
- **I besueshëm** – vlerësimi të bëhet me të njëjtat standarde që te nxënësi të mos krijohen dilema;
- **I barabartë** – që nxënësve t'u jepen mundësi të barabarta edhe atëherë kur ndoshta përvojat e tyre nuk janë të njëjta;
- **I përshtatshëm** – duhet të vlerësohen në mënyrën t'u përshtaten më së miri personalitetit të nxënësve për t'u ikur emocioneve të pakëndshme të nxënësve;
- **Vlerësimi në kohë të duhur** – vlerësimi duhet të bëhet gjatë vitit e jo krejt në fund të semestrit apo vitit, sepse nxënësi nuk ka kohë të përmirësohet.

Tipat e vlerësimit

Detyrë me përgjegjësi e mësimit është planifikimi i vlerësimit dhe i kontrollimit të njohurive dhe të vështirësive të nxënësve që të arrihet një sukses më i madh. Ekzistojnë disa tipa vlerësimi:

Vlerësimi i mbështetur në kriter: ka për qëllim të kontrollojë njohuritë e nxënësve në bazë të kriterëve standarde. Përgjegjet e testit duhet të përcaktohen me pikë. Varësisht nga përqindja e pikëve të fituara bëhet edhe vlerësimi. Vlerësimi i përgjigjeve mbetet në përgjegjësinë e mësimit.

Vlerësimi formues: ka për qëllim që mësimit të planifikojnë punën e tyre në të ardhmen. Ky vlerësim bëhet në fillim ose gjatë vitit mësimor dhe jo me nota.

Vlerësimi diagnostikues: ka për qëllim t'i zbulojë vështirësitë dhe dobësitë që hasin nxënësit. Paratestet nuk vlerësohen me nota, por

shërbejnë vetëm si informacion për vështirësitë dhe dobësitë në të mësuar.

Vlerësimi përmbledhës (kontrollues): ky lloj testimi rëndom bëhet në fund të gjysmëvjetorit të parë dhe në përfundim të mësimit. Ka për qëllim të vlerësojë dhe të kontrollojë nivelin e njohurive të fituara gjatë një periudhe të caktuar.

LITERATURA

1. Anthony Giddens, Sociologjia, Shtëpia Botuese: Çabej, Tiranë 2002
2. Dr. Zuvdi Dervishi: Sociologjia e kulturës, Tiranë, 2001,
3. Dr. Ante Fiamengo, Bazat e sociologjisë së përgjithshme, Rilindja, Prishtinë, 1984
4. Bardhyl Musai, Metodologjia e mësimdhënies, Tiranë, 2003
5. Isuf Zeneli, Bazat e standardizimit dhe vlerësimit në arsim, Shtëpia Botuese: Libri Shkollor, Prishtinë, 2002
6. Sociologjia XI (për gjimnaze). LSH, Prishtinë, 2004

FILOZOFI

**Gjimnazi i shkencave shoqërore, Gjimnazi i gjuhëve
(2 orë në javë, 66 orë në vit)**

HYRJE

Lënda e filozofisë përfshihet në programin e klasës XII me qëllim të përgatitjes së nxënësve për jetë, përmbytjes së interesave dhe potencialeve të tyre në zhvillimin e kulturës dhe në krijimin e bazës së koncepteve dhe njohurive për arritjen e qëllimeve individuale, që shpiejnë në drejtim të progresit të përgjithshëm shoqëror.

Të rinjtë kanë nevojë për një filozofi jete, e cila do t'i aftësojë për të jetuar dhe për të vepruar, duke pasur projekte dhe duke qenë të angazhuar në realizimin e tyre. Pikërisht një filozofi të tillë, e cila do të ndihmonte të kuptohet dhe të jetohet jeta, u ofrohet nxënësve të shkollave të mesme. Ajo është njëkohësisht një koncept orientues i qëndrimit të njeriut si qenie sociale, i veprimtarisë së tij praktike e teorike, i sjelljes, por edhe orientues i idealeve të tij shoqërore.

Mendimi filozofik është zhvilluar përmes problemeve filozofike, prandaj mënyra më e natyrshme e paraqitjes së filozofisë për nxënësit është duke e përcjellë rrugën e të filozofuarit vetë.

Në këtë perspektivë, programi paraqet një grup problemesh, një varg mendimesh, duke u nisur nga përvoja e përditshme e nxënësve drejt refleksionit të vërtetë filozofik. Synim i programit është formimi i mendimit kritik filozofik të nxënësve, duke u nisur nga ndërlidhja e dy elementeve kryesore: ofrimit të informatave për nocionet dhe problemet kryesore të filozofisë (nëpërmjet të teksteve të shkurtra nga veprat e filozofëve) dhe mësimi aktiv (të bazuar në reflektimet) i cili njëkohësisht paraqet një nga sfidat kryesore të procesit mësimor.

Po ashtu, programi do të ndikojë në nxitjen e raportit krijues të nxënësve ndaj botës dhe vetvetes.

QËLLIMET

Duke pasur parasysh se në klasën XII nxënësit për herë të parë merren me problematikën e gjerë filozofike, qëllimi i programit mësimor i lëndës së filozofisë është:

1. Zhvillimi i aftësive të nxënësi për të menduar në mënyrë kritike dhe analitike rreth botës dhe vetvetes, duke u mbështetur në njohjen dhe në kuptimin e nocioneve themelore filozofike.
2. Zhvillimi i shkathtësive të përhershme të nxënësit për t'i shprehur qartë nocionet dhe kategoritë filozofike dhe të përgjithshme, në të folur ose në të shkruar.
3. Nxitja e raporteve krijuese ndaj vetvetes dhe shoqërisë të nxënësi, duke u mbështetur në reflektimin dhe në zbatimin e njohurive të përfituara nga lëmi i filozofisë.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Në përputhje me qëllimet e programit për lëndën e filozofisë së klasës XI, objektivat e lëndës janë të orientuara në përfitimet e rëndësishme, duke pasur parasysh gjithmonë nevojat për zhvillimin e nxënësit. Programi mësimor i lëndës së filozofisë synon që në fund të kursit njëvjeçar nxënësi t'i arrijë këta objektiva të grupuar sipas qëllimeve:

1. Për të arritur qëllimin e përfitimit të njohurive dhe zbatimit të tyre nxënësi do të:
 - Kuptojë pozitën dhe rolin e filozofisë në zhvillimin e të menduarit njerëzor, dhe pasurimin reciprok konceptual të filozofisë dhe të shkencave të tjera;
 - Njohë evoluimin e mendimit filozofik duke u ndalur në probleme më themelore të praktikës dhe qëllimeve njerëzore;
 - Dijë të bëjë dallimin mes metodave kryesore të interpretimit të historisë së filozofisë;
 - Zbërthejë nocionet dhe kategoritë kryesore të mendimit filozofik, si përgjithësime të përvojës njerëzore;
 - Jetë i aftë për t'i pranuar mënyrat e ndryshme të zgjidhjes së problemeve, duke zbatuar vazhdimisht më shumë se një këndvështrim dhe pikënisje.

2. Për të arritur qëllimin e përfitimit të aftësive dhe të shkathtësive, nxënësi do të:
 - Dijë ta strukturojë mendimin për të argumentuar qëndrimet e veta rreth çështjeve filozofike dhe praktike;
 - Hartojë punime të pavarura duke integruar informacionin teorik (nga tekste filozofike) dhe praktik.

3. Për të arritur qëllimin e zhvillimit të qëndrimeve dhe të vlerave, nxënësi do të:
 - Analizojë dhe të shpjegojë fenomene dhe procese shoqërore, duke u nisur nga pikëpamjet e përgjithshme filozofike;
 - Vështrojë realitetin në burimin e vet, si bazë për komunikim me të tjerët;
 - Shpjegojë pozitën e vet individuale si pjesë e tërë të qenit të botës.

OBJEKTIVAT E VEÇANTË

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- **Të njohë**
 - vendin dhe pozitën e filozofisë në zhvillimin e përgjithshëm të të menduarit njerëzor;
 - metodat kryesore të interpretimit të filozofisë gjatë historisë së saj dhe të bëjë dallimet midis disiplinave kryesore të filozofisë;
 - aspektet e ndryshme, të veçanta filozofike në studimin e nocionit të njeriut dhe të pozitës së tij në botë;
 - njohjen njerëzore në procesin e zhvillimit të saj brenda teorive të ndryshme filozofike;
 - themelin e metafizikës dhe bazamentin e kritikës ndaj saj;
 - problematikën e vlerave në filozofinë e moralit.
- **Të kuptojë**
 - nocionet themelore të estetikës në teori dhe në praktikë;
 - teoritë kryesore filozofike për shoqërinë, shtetin dhe pushtetin.

- **Të shprehë**
 - mendimin kritik ndaj realitetit, duke u mbështetur në njohuritë e fituara nga lënda e filozofisë.
- **Të hartojë**
 - punime të pavarura duke u mbështetur në tekste burimore filozofike dhe përvojën e tij individuale.

Struktura e përmbajtjeve programore

Aktivitetet	Numri i orëve	%
Prezantimi i materialit tematik	47	63.5
Mësim sipas zgjedhjes	6	8.1
Përsëritje dhe vlerësimi	21	28.4
GJITHSEJ	74	100

Planifikimi i përmbajtjes programore

Kategoritë	Nënkategoritë	Nr. i orëve	%
Filozofia dhe historia e saj	Pozita e filozofisë në zhvillimin e të menduarit njerëzor dhe raporti i filozofisë me shkenca të tjera	5	7.4
	Metodat kryesore në interpretimin e historisë së filozofisë		
Njeriu dhe bota	Nocioni i njeriut	16	23.5
	Pozita e njeriut në botë		
	Njeriu, koha dhe hapësira		
	Njeriu dhe historia		
Njohja dhe arsyeja	Mundësitë ndhe kufijtë e njohjes	11	16.1
	Pragmatizmi dhe veprimtaria e njohjes		
	Aftësia e të gjykuarit		
	Filozofia analitike		
Filozofia dhe metafizika	Themeli dhe kritika e metafizikës	12	17.6
	Çështja e zotit brenda metafizikës		
Etika	Morali dhe vullneti i lirë	9	13.3
	Problemi i vlerave		
Estetika	Kategoritë themelore të estetikës	6	8.8
Filozofia politike	Njeriu dhe shoqëria	9	13.3
	Shteti dhe pushteti		

PËRMBAJTJA LËNDORE

Kategoria	Nënkategoria	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme	Ndërlidhjet programore
I. Filozofia dhe historia e saj	1. Pozita e filozofisë në zhvillimin e të menduarit njerëzor dhe raporti i filozofisë me shkenca të tjera	<p><i>Nxënësi mëson për:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Çka është filozofia? • Disiplinat dhe nëndisiplinat kryesore të filozofisë • Raporti i filozofisë me shkencat e tjera • Filozofia, miti dhe religjioni <p>(3 orë)</p>	<p><i>Nxënësi do të:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojë termin dhe zanafillën e filozofisë • Identifikojë çështjet dhe disiplinat themelore të filozofisë • Diskutojë mbi zhvillimin e filozofisë dhe raportin e saj me shkencat e tjera • Identifikojë elemente të përbashkëta dhe dallime mes filozofisë, mitit dhe religjionit 	Shkencat shoqërore dhe natyrore
	2. Metodatat kryesore në interpretimin e historisë së filozofisë	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti i filozofisë dhe historisë së saj është i veçantë • Metoda historike (kronologjike) dhe metoda problemore të paraqitjes së historisë së filozofisë <p>(2 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Përcaktojë pozitën e filozofisë në raport me historinë e saj • Kuptojë dallimin mes dy metodave kryesore të paraqitjes së filozofisë dhe të historisë së saj 	
II. Njeriu dhe bota	1. Nocioni i njeriut	<ul style="list-style-type: none"> • Çështjet themelore të pyetjes çka është njeriu • Përcaktimi i njeriut përmes frymës • Njeriu si qenie kulturore <p>(2 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kuptojë njeriun si qenie shumëdimensionale (ontologjike, gnoseologjike, etike, estetike, historike etj.) • Shpjegojë si kuptohet njeriu në antropologjinë e Shellerit • Analizojë elemente të gjuhës, mitit, religjionit, historisë dhe shkencës si përcaktues së nocionit të njeriut në filozofinë e Kasirerit 	Historia, linguistika

		<ul style="list-style-type: none"> • Nocioni i ekzistencës • Ekzistenca në raport me thelbin, mendimin dhe lirinë (2 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Kuptojë nocionin e ekzistencës • Diskutojë mbi vendin përparësor të thelbit dhe të ekzistencës • Shpjegojë ekzistencën si pikënisjen e mendimit në filozofinë e Kirkegardit • Identifikojë raportin ekzistenca – liria në filozofinë ekzistencialiste 	
		<ul style="list-style-type: none"> • Tjetri dhe nevoja për tjetrin (2 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojë nocionin e tjetrit dhe nevojën për tjetrin në filozofinë e shekullit XX 	
		<ul style="list-style-type: none"> • Ndërgjegjja, njohja, dhe përvoja • Aspekti psikologjik i ndërgjegjes • Nocioni i të pandërgjegjshmes në teorinë e Frojdit (2 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojë raportin mes ndërgjegjes, njohjes dhe përvojes • Kuptojë ndërgjegjen si të vërtetën e unit në filozofinë e Bergsonit • Përcaktojë ndërgjegjen nga aspekti psikologjik • Përcaktojë pozitën e teorisë së Frojdit brenda mendimit filozofik • Analizojë të pandërgjegjshmen në teorinë e Frojdit • Shpjegojë nocionin dhe sistemin e të pandërgjegjshmes 	Psikologjia
		<ul style="list-style-type: none"> • Vdekja, kuptimi dhe mohimi i saj • Njeriu në situatat kufitare: ballafaqimi me fundin e ekzistencës (2 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojë nocionin e vdekjes në të kuptuarit filozofik • Analizojë nocionin e vdekjes në filozofinë e Lukrecit • Kuptojë vdekjen si ballafaqim i individit me fundin e ekzistencës (K. Jaspers) 	Biologjia
II. Njeriu dhe bota	2. Pozita e njeriut në botë	<ul style="list-style-type: none"> • Ideja e kozmosit në filozofinë greke • Mikrokozmos dhe makrokozmos 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojë kuptimin e kozmosit në filozofinë e Talesit, Anaksimandrit dhe Empedoklit • Kuptojë idenë e mikro dhe makro kozmosit në 	Biologjia, fizika, astronomia

		në Renesansë dhe në Iluminizëm (2 orë)	filozofinë e G. Brunos, Didrosë dhe Bufonit	
II. Njeriu dhe bota	3. Njeriu, koha dhe hapësira	<ul style="list-style-type: none"> • Koha si dimension i shpirtit • Koha dhe hapësira si formë a priori e subjektit • Relativiteti i kohës • Hapësira, zbrazëtira (boshllëku) dhe zoti (2 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Kuptojë nocionin e kohës në filozofinë e Shën Augustinit • Shpjegojë kohën dhe hapësirën si format subjektive të paraqitjes në teorinë e njohjes së Kantit • Shpjegojë kohën sipas Ajnshtajnit • Kuptojë pikëpamje të kundërta për ekzistimin e hapësirës së zbrazët (pikëpamjet atomiste, epikuriste dhe pikëpamjet e Gj. Brunos) 	Fizika
II. Njeriu dhe bota	4. Njeriu dhe historia e tij	<ul style="list-style-type: none"> • Vetëprodhimi njerëzor në histori: historicizmi dhe lineariteti historik • Njeriu si qenie praktike (2 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojë rolin e njeriut në prodhimin e historisë dhe të vetvetës • Kuptojë nocionin e praktikës • Identifikojë njeriun si qenie praktike në filozofinë moderne 	Historia
III. Njohja dhe arsyeja	1. Njohja dhe kufijtë e saj	<ul style="list-style-type: none"> • Dyshimi si pikënisje e njohjes • Njohja e botës dhe njohja e vetvetës • Arsyeja dhe vullneti (2 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Përkufizojë dyshimin në filozofinë e skepticizmit dhe në filozofinë racionaliste të Dekartit • Kuptojë dallimin mes vetëdijes dhe vetëvetëdijes • Klasifikojë përmbajtjen e intelektit: ndarjen e arsyes nga vullneti 	
III. Njohja dhe arsyeja		<ul style="list-style-type: none"> • Përvoja dhe kufijtë e njohjes • Njohja fillon me përvojën, por nuk buron nga ajo • Verifikimi teorik i përvojës dhe verifikimi praktik i hipotezës (3 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojë njohjen në filozofinë empiriste • Kuptojë përvojën duke u nisur nga aspekti filozofik në shpjegimin e perceptimit dhe ndijimit • Kuptojë njohjen a priori në teorinë e njohjes së Kantit 	

			<ul style="list-style-type: none"> • Diskutojë rreth verifikimit praktik të hipotezave (shembulli i astronomisë dhe të ngjashme) 	
III. Njohja dhe arsyeja	2. Pragmatizmi dhe veprimtaria e njohjes	<ul style="list-style-type: none"> • Teoria pragmatike si teori për kuptimin dhe pragmatizmin si metodë • Roli i vullnetit në filozofinë pragmatike (2 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Përcaktojë vendin e pragmatizmit në filozofinë bashkëkohore • Krijojë lidhje mes pragmatizmit si metodë dhe pragmatizmit si teori për kuptimin, në filozofinë e Ç. Persit • Përcaktojë statusin e vullnetit në filozofinë pragmatike të Xh. Uilliamsit 	
III. Njohja dhe arsyeja	3. Aftësia e të gjykuarit	<ul style="list-style-type: none"> • Gjykimi në logjikën formale të Aristotelit • Gjykimi si marrëdhënie, zgjedhje, sanksion • Të mendosh do të thotë të gjykosh (2 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Kuptojë gjykimin në logjikën e Aristotelit • Shpjegojë gjykimin sipas Dekartit • Kuptojë gjykimin në teorinë e Kantit 	Logjika
III. Njohja dhe arsyeja	4. Filozofia analitike	<ul style="list-style-type: none"> • Çka është filozofia analitike? • E vërteta logjiko-matematike (2 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojë parimet themelore të filozofisë analitike • Krahasojë metodën aksiomatike me metodën deduktive • Shpjegojë kuptimin e së vërtetës logjiko-matematike në filozofinë analitike të Vitgenshtajnit 	Logjika, matematika
IV. Filozofia dhe metafizika	1. Themeli dhe kritika e metafizikës	<ul style="list-style-type: none"> • A është metafizika shkencë? (Nocioni i metafizikës, themeli dhe kritika e saj) • Përcaktimet e qenies nga Aristoteli deri te Hajdegeri 	<ul style="list-style-type: none"> • Njohë nocionin e metafizikës, themelin dhe kritikën ndaj saj • Diskutojë për çështjet metafizike • Shpjegojë “filozofinë e parë” në filozofinë e Aristotelit 	

		(6 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Kuptojë përkufizimin e nocionit të qenies në teorinë filozofike nga Aristoteli deri te Hajdegeri 	
IV. Filozofia dhe metafizika	2. Çështja e zotit brenda metafizikës	<ul style="list-style-type: none"> • Dëshmia e ekzistencës së zotit e mbështetur në përvojë dhe në arsye • Refuzimi i fejes • Besimi i përbashkët • A ekziston jeta pas vdekjes? (6 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojë se si provohet ekzistenca e zotit nga përvoja në filozofinë e T. Aquinit • Diskutojë për qëndrueshmërinë e argumentimit ontologjik rreth ekzistencës së zotit të Dekarti • Shpjegojë fenë si sëmundje të qytetërimit në teorinë e Niçes • Kuptojë tentimin për një besim të përbashkët të Xh. Djuj • Diskutojë rreth jetës pas vdekjes në fragmente të Platonit, Hjumit dhe Kirkegardit 	Sociologjia, historia
V. Etika	1. Morali dhe vullneti i lirë	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetja e etikës në natyrën njerëzore • Ligji i moralit: imperativi hipotetik dhe kategorik • A është vullneti i lirë? (teoritë deterministe dhe indeterministe) • Utilitarizmi në filozofinë e moralit (5 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Përkufizojë virtytin në etikën e Aristotelit • Shpjegojë ligjin e moralit dhe detyrimin për të qenë i moralshëm në filozofinë e Kantit • Diskutojë rreth lirisë dhe vullnetit • Diskutojë rreth pikëpamjes ekzistencialiste për lirinë • Kuptojë matësin utilitar në filozofinë e Xh.S. Millit 	Sociologjia, edukata qytetare
V. Etika	2. Problemi i vlerave	<ul style="list-style-type: none"> • Çka janë vlerat në kuptimin filozofik? • Rivlerësimi i të gjitha vlerave (4 orë)	<ul style="list-style-type: none"> • Diskutojë rreth “filozofisë së jetës” në teorinë e Diltaut dhe Bergsonit • Shpjegojë zëvendësimin e parimit apolonian me parimin dionizian në imoralizmin e Niçes 	Sociologjia, edukata qytetare
VI. Estetika	1. Kategoritë themelore të	<ul style="list-style-type: none"> • E bukura në art dhe në natyrë • Krijimtaria artistike 	<ul style="list-style-type: none"> • Kuptojë nocionet themelore të estetikës (e bukura dhe arti) në fragmente nga Platoni dhe 	Arti

	estetikës	<ul style="list-style-type: none"> • Arti dhe realiteti (6 orë) 	Kanti <ul style="list-style-type: none"> • Diskutojë për temën e gjeniut në art te Kanti dhe Niçe • Paraqet mendimin e Hegelit për artin romantik • Kuptojë historinë e artit në teorinë e Benjaminit 	
VII. Filozofia politike	1. Njeriu dhe shoqëria	<ul style="list-style-type: none"> • Baza natyrore e shoqërisë • Prejardhja e shtetit: gjendja natyrore dhe kontrata shoqërore • Detyrimi i njerëzve për të qenë të lirë (4 orë) 	<ul style="list-style-type: none"> • Kuptojë natyrën njerëzore si bazë për organizimin shoqëror në teorinë e Aristotelit • Krahasojë teorinë e Hobsit dhe Rusoit për prejardhjen e shtetit, duke u nisur nga shpjegimi i egoizmit dhe pronës 	Edukata qytetare, sociologjia, historia
IX. Filozofia politike	2. Shteti dhe pushteti	<ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i shtetit ideal • Pushteti, të bërit dhe të diturit • Individit dhe kufijtë e pushtetit shtetëror • Ndarja e etikës nga politika • Demokracia moderne në teorinë filozofike (5 orë) 	<ul style="list-style-type: none"> • Njohë konceptin kryesor të shtetit ideal dhe bazamentin e tij në ndarjen e punës në teorinë e Platonit • Kuptojë të drejtën natyrore dhe shoqërore civile në filozofinë politike të Lokut • Kuptojë pozitën e individit në raport me fuqinë e pushtetit në teorinë e XH.S.Millit • Analizojë cilësitë parësore të sovranit në teorinë e Makiavelit dhe diskutojë për thënien e tij “qëllimi e arsyeton mjetin” • Kuptojë teorinë e Rusoit dhe Toknevitit për demokracinë 	Edukata qytetare, sociologjia, historia

Sqarim: 6 orë mësimore mbeten në dispozicion arsimtarit që t'i organizojë sipas kërkesave të nxënësve dhe dëshirës individuale, duke mbetur në kuadër të përmbajtjeve programore.

Po ashtu, nuk përjashtohet mundësia që në realizimin e disa njësive mësimore të përfshihen edhe arsimtarë të lëndëve të tjera si p.sh., arsimtari i fizikës për nënkategorinë *Njeriu, hapësira dhe koha*, etj.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Qasja problemore

Duke u mbështetur në njërin ndër qëllimet kryesore të mësimdhënies së filozofisë, të zhvilluarit e mënyrës kritike dhe analitike të të menduarit të nxënësit, lënda e filozofisë nuk duhet të ofrojë thjesht përcaktimin e gatshëm, formal të nocioneve, kategorive dhe teorive. Mësimdhënia e filozofisë është gjithmonë shpjegimi, analizimi dhe ndriçimi i një nocioni, problemi apo çështjeje filozofike. Mënyra më frytdhënëse në përvetësimin e nocioneve filozofike mbështetet në përshkrimin e gjenezës së nocionit, ballafaqimin, krahasimin dhe lidhjen me nocione të tjera, duke analizuar format dhe mundësitë e përdorimit të tyre.

Ndërveprimi

Në përvetësimin e filozofisë është shumë me rëndësi të kërkohen dhe shprehen mendimet individuale dhe grupore, gjë që nënkupton prezantimin e mendimeve në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme. Përshkrimi, referimi ndaj teorive të ndryshme, përdorimi i shembujve konkretë dhe krahasimi me shembuj të tjerë janë bazamente dhe tullat kryesore për ndërtimin e mendimit të pavarur të nxënësit dhe lidhjen e pjesës teorike me zbatimin praktik të saj. Në këtë mënyrë do të arrihet edhe qëllimi i dytë i lëndës së filozofisë: ofrimi i një filozofie, e cila do të ndihmonte nxënësit ta kuptojnë dhe ta jetojnë jetën.

Për t'i ikur mundësisë që lënda e filozofisë të shndërrohet në një skollistikë të mërzitshme dhe një monolog, diskutimet për problemet dhe çështjet filozofike duhet të jenë pjesë e pandarë e çdo ore mësimore. Po ashtu, interpretimi dhe shpjegimi i teksteve të shkurtra filozofike, është metodë shumë efikase në krijimin e kontaktit të nxënësit me filozofët e mëdhenj. Çdo mësim duhet të shoqërohet edhe me një fjalor shpjegues të nocioneve filozofike.

Duke u mbështetur në këto metoda, nxënësi duhet të orientohet drejt një bindjeje të qëndrueshme, përmes udhëzimeve se teza e mbrojtur duhet t'u përgjigjet disa kërkesave, duhet të mbështetet nga faktet, të mundësojë parashikime dhe të sugjerojë hulumtime të mëtutjeshme. Nxënësi duhet të ketë mundësi për paraqitjen e qëndrimeve dhe mendimeve të pavarura edhe në formë të punimeve të hartuara, duke integruar në to informacionin teorik (nga tekste filozofike) dhe praktik.

VLERËSIMI

Mësimdhënësi i lëndës së filozofisë gjatë vlerësimit të nxënësit duhet të ketë parasysh disa momente të rëndësishme:

- Mënyrën se si nxënësi di ta strukturojë mendimin për të argumentuar qëndrimet e veta për çështjet e ndryshme filozofike dhe praktike
- Sa është në gjendje të integrojë informacionin teorik dhe shkencor
- Mënyrën se si nxënësi është në gjendje t'i prezantojë materialet e përvetësuara në mënyrë individuale dhe grupore
- Sa është nxënësi në gjendje që përmes teksteve filozofike, të nxjerra nga veprat e filozofëve të mëdhenj, të hartojë punime të pavarura.

Vlerësohen:

- Përgjigjet me gojë
- Prezantimet
- Esetë dhe punimet e pavarura

QASJET NDËRLËNDORE

Vetë fakti se filozofia është pjesë e rëndësishme e zhvillimit të përgjithshëm të mendimit njerëzor, domosdo vendos filozofinë në një rrjetë ndikimesh të ndërsjellta me pjesë të tjera të këtij zhvillimi. Gërshetimi i problemeve shoqërore dhe natyrore drejton filozofinë në arritjet e deritashme brenda lëndëve të tjera të veçanta. Në anën tjetër, në çdo shkallë zhvillimi të shkencave, një sektor i veçantë dhe i gjerë në sistemin e dijeve për botën i takon funksionimit të pavarur të dijeve filozofike.

Në bazë të materialit tematik, i cili do të prezantohet para nxënësve është e nevojshme ndërlidhja e lëndës së filozofisë me këto lëndë sipas kategorive në vijim:

- Filozofia dhe historia e saj: Shkencat shoqërore dhe natyrore
- Njeriu dhe bota: Psikologjia, historia, linguistika, fizika, astronomia, biologjia

- Njohja dhe arsyeja: Logjika, matematika
- Filozofia dhe metafizika: Sociologjia, historia
- Etika: Sociologjia, edukata qytetare
- Estetika: Arti
- Filozofia politike: Edukata qytetare, sociologjia, historia

LITERATURA

1. Filozofia (Historia & Problemet), S. E. Stumpf, Toena, Tiranë
2. Filozofia (për klasën e katërt të gjimnazit), E. Murtezai, Libri Shkollor, Prishtinë, 2001
3. Idetë filozofike të shekullit XX, I. Berlin, Onufri, Tiranë, 2003
4. Një hyrje tek idetë, W. Raeper & L. Smith, Dituria, Prishtinë, 1999
5. Thema nr. 4, Instituti i Filozofisë dhe Sociologjisë, Prishtinë, 1996
6. Buletini i Fakultetit Filozofik, Fakulteti Filozofik, Prishtinë, 2001
7. Fjalori i Filozofisë, E. Murtezai, Instituti i Filozofisë dhe Sociologjisë, Prishtinë, 1995

EKONOMIA

Gjimnazi i shkencave shoqërore (2 orë në javë, 74 orë në vit)

HYRJE

Ndryshimet në shoqërinë kosovare, pjesë përbërëse e rajonit të Ballkanit, të Evropës Juglindore dhe më gjerë, imponojnë nevojën për reformime të tërësishme, në veçanti në lëmin e arsimit dhe të edukimit. Tranzicioni hap shtigje të reja përballë sistemit të dështuar të mëparshëm, si dhe u afrohet zhvillimeve të botës së qytetëruar dhe demokratike. Së këndejmi, nevoja e ndërtimit të planeve dhe programeve të reja, me përmbajtje, metodologji dhe qasje bashkëkohore, mundëson tejkalimin e fazës së tranzicionit me sukses dhe kyçjes në një rend të ri demokratik, politik dhe ekonomik. Ekonomia, është dhe do të jetë shtyllë e rëndësishme për funksionimin e rendit të ri, duke i përfillur liberalizimet e nevojshme, funksionimin e tregut të lirë, me qëllim të dominimit të ekonomisë së tregut.

Kosova pretendon të inkorporohet në rrjedhat e avancuara, si qasje për krijim të mirëqenies së qëndrueshme dhe me perspektivë. Në këtë kontekst, mësimi i ekonomisë edhe në gjimnazin e shkencave shoqërore, përmban risi dhe një opus me dimensione të reja të diturisë, të nevojshme për aftësi në kushtet e konkurrencës dhe të prosperitetit të tërësishëm ekonomik e social.

Plani dhe programi për lëndën Ekonomia për klasën 12 të gjimnazeve të shkencave shoqërore është i disenjuar sipas kërkesave të kohës, të fazës së tranzicionit, për t'i pajisur nxënësit me një bazament me njohuri elementare nga lëmi i ekonomisë. Njësitë metodike janë të formësuara për një fond atraktiv të nxënies dhe krijimit të aftësive për avancimet e mëtejshme, sipas shkallëve të arsimimit dhe pjekurisë së moshave.

Plani dhe programi është kompatibil me vendet e rajonit dhe më gjerë dhe nxënësve u mundëson me lehtësi të kuptojnë këtë materie dhe të kenë disa aftësi zbatuese në praktikë.

Materia përfshirëse në këtë program përmban ndonjë njësi nga programet e kaluara, ndonëse në asnjë mënyrë si përsëritje, por si begatim dhe plotësim i atyreve njësi metodike, të cilat i kanë përvetësuar nxënësit në klasët paraprake. Faktikisht, me këtë bëhet sublimimi optimal i njohurive nga bazat elementare të kuptimeve, të klasifikimeve dhe të mundësive implementuese të çështjeve, të cilat janë dobiprurëse për nxënësit në gjimnazet e drejtimit përkatës, njohuri këto që shërbejnë si bazë për të studiuar më lehtë shkencat ekonomike, ose menjëherë pas përfundimit të gjimnazit, për të ushtruar punë të caktuara nëpër biznese të ndryshme.

QËLLIMI

Qëllimi themelor i programit mësimor të lëndës Ekonomia për gjimnazet e shkencave shoqërore, për klasën 12, është:

1. Përkufizimi i kuptimeve elementare dhe bazike të lëmit të ekonomisë, në funksion të aftësisë dhe krijimit të aftësive të nxënësve për t'u thelluar më tutje në fushën studimore të ekonomisë;
2. Zhvillimi i aftësive të nxënësve për të kuptuar përmbajtjen, funksionet, dobishmërinë dhe problematikën e ekonomisë në përgjithësi;
3. Të kuptojë dhe të ndërtojë shkathësi nxënësi, me qëllim zbatimin të njohurive, në të mirë të përmbushjes së nevojave individuale, në dhënie të kontributit në përmasa të gjera për zhvillimin e shoqërisë.

OBJEKTIVAT

Programi mësimor i lëndës Ekonomia për gjimnazin e shkencave shoqërore përfshin një varg objektivash, të dedikuara për kapacitetet dhe natyrën e të mësuarit, në mënyrë që nxënësi:

1. Të zhvillojë qëndrimet dhe vlerat

- lidhur me përkufizimet, që kanë të bëjnë me fushën e ekonomisë, me pjesët e saj, dobishmërinë dhe nevojën për zhvillimin e shoqërisë;
- që kanë të bëjnë me klasifikimin e nocioneve, të funksioneve dhe të të arriturave në një ekonomi, si pjesë përbërëse e shoqërisë dhe e krijimit të mirëqenies njerëzore;

- nëpërmjet njohjes së vlerave të ndërtojë personalitetin e vet ndaj lëmit të ekonomisë, me qasje kritike dhe pragmatike se çka është në gjendje të veprojë, të arrijë e të krijojë, si dhe të aplikojë për vete dhe për shoqërinë e gjerë.

2. Të njohë

- nocionet, parimet, konceptet, metodat, qasjet klasifikimet në lëmin e ekonomisë,
- ligjshmëritë e ekonomisë, tregun, pronësinë, tregun e lirë dhe konkurrencën,
- firmat, funksionimin, përmbajtjen, nënsistemet që e përbëjnë atë, kostot dhe vlerat që krijohen në të, inputet dhe outputet, kapacitetet;
- elementet bazike të mikroekonomisë, si sublimim nga të mësuarit dhe përvojat e deritashme;
- politikat në makroekonomi dhe modelimet në ekonomitë bashkëkohore;
- gjendjen e nivelit të zhvillimit të ekonomisë së Kosovës, problemet dhe perspektivat;
- veçoritë e ekonomisë botërore dhe ndërvartësitë e ekonomive kombëtare për bashkëpunim të gjithanshëm.

3. Të kuptojë

- kuptimet, metodat, domethëniet, përlllogaritjet, zbatueshmërinë e parametrave kryesorë në lëmin e ekonomisë;
- terminologjinë, strukturat, veprimet që ndodhin në lëmin e mikroekonomisë, si dhe të makroekonomisë;
- strukturën e tregut, ekonominë e tregut, parakushtet për ndërtimin dhe funksionimin e ekonomisë së tregut;
- ligjshmërinë e konkurrencës dhe krijimin e shkathtësive për të krijuar zhvillim dhe prosperitet;
- politikat në makroekonomi, duke i përfshirë tërësitë e llojeve të politikave, të sistemeve ekonomike;
- problemet dhe mundësitë e zhvillimit të ekonomisë së Kosovës;
- ekonominë botërore dhe imponimin për kyçe në rrjedhat e bashkëpunimit dhe në tregun botëror.

4. Të analizojë

- faktorët dhe parimet në mikroekonomi dhe në makroekonomi, veçoritë dhe mekanizmat e tregut;
- veprimtaritë e firmave, shfrytëzimin e kapaciteteve, kostot dhe rentabilitetin e firmave;
- problemet në zhvillimin ekonomik dhe përparësitë, ndërvarësitë e ekonomive të ndryshme nëpër botë;
- shkaqet që ndikojnë në gjendjen e tashme të ekonomisë së Kosovës dhe burimet e forcës shtytëse për një zhvillim të hovshëm e konkurrent.

5. Të zbatojë

- aftësitë e krijuara që janë fundament për ushtrimin e ndonjë funksioni në ekonomi, në jetën e përditshme, në zgjerimin e njohurive të reja për implementime konkrete në praktikë;
- në aktivitetet e krijimit, themelimit të bizneseve dhe manaxhimit e tyre të suksesshëm.

PLANIFIKIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

Kategoritë	Nënkategoritë	Numri i orëve	Struktura %
<i>Ekonomia dhe tregu</i>	Ekonomia dhe zhvillimi i saj	11	16,66%
	Tregu, funksionimi dhe zhvillimi i tij		
	Tiparet e ekonomisë bashkëkohore		
<i>Mikroekonomia</i>	Firmat (ndërmarrjet)	17	25,76%
	Resurset (burimet dhe kapacitetet e firmës)		
	Kostot e firmës		
<i>Makroekonomia</i>	Fushëveprimtaria e makroekonomisë	20	30,30%
	Format themelore të politikave makroekonomike		
	Elementet e kërkesës agregate		
<i>Ekonomia e Kosovës</i>	Aspekti mikroekonomik dhe makroekonomik i ekonomisë së Kosovës	8	12,12%
<i>Ekonomia botërore</i>	Veçoritë e bashkëpunimit ndërkombëtar	10	15,16%

Planifikohet që fondi prej 66 orësh të shpërndahet në 46 orë, ose 67,70 % mësimdhënie, 16 orë ose 24.25 % përsëritje dhe vlerësim të njohurive të nxënësve, si dhe 4 orë ose 6.05 % ushtrime, përkatësisht vizita nëpër firma dhe institucione përkatëse.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Kategoritë	Nënkategoritë	Përmbajtja programore	Rezultatet e pritshme	Lidhja ndërlëndore
EKONOMIA DHE TREGU	Ekonomia dhe zhvillimi i saj	<ol style="list-style-type: none"> 1. Fillet e ekonomisë; 2. Nocioni dhe dimensionet e ekonomisë; 3. Faktorët ndikues në zhvillimin ekonomik nëpër periudha kohore; 4. Historiku i ekonomisë dhe i shoqërisë njerëzore 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të kuptojë domethënien e ekonomisë, fillet dhe nevojën për të, duke e vështruar zhvillimin e saj nëpër periudha kohore, për të bërë vlerësimin e tipareve ekonomike, të dimensioneve të sotme, me dallime të ekonomive të zhvilluara dhe të pazhvilluara aktualisht; - të kuptojë përmbajtjen dhe objektivat e ekonomisë; - të kuptojë nocionin, shkaqet dhe faktorët ndikues në zhvillimin e ekonomisë; - të kuptojë ekonominë në kontekst me nevojat njerëzore; 	Historia (për t'i kuptuar nevojat e zhvillimit), sociologjia (për t'i kuptuar sistemet shoqërore dhe transformimet e tyre), bizneset (për të kuptuar sistemet e bizneseve).
	Tregu, funksionimi dhe zhvillimi i tij	<ol style="list-style-type: none"> 1. Nocioni i tregut dhe tipat e tregut, 2. Të kuptuarit e shkaqeve të orientimit në prodhim, 3. Të kuptuarit e shkaqeve të funksionimit të tregut, 4. Mekanizmat kryesorë të tregut: oferta dhe kërkesa. 	<ul style="list-style-type: none"> - të kuptojë nocionin e tregut, paraqitjen e tij në skenë, tipat e tregut, zhvillimin e tregut, domosdoshmërinë e tregut si inerksion i zhvillimit ekonomik; - të kuptojë nevojat për treg, si dhe fazat e shkaqeve ku më tepër i është dhënë rëndësi orientimit në prodhim e më pastaj orientimit në treg; - të kuptojë ofertën dhe kërkesën, si mekanizma themelore në treg, si dhe ndërvartësia e tyre. 	Matematika, për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve, qofshin numerike të ekuacioneve), apo të grafikëve
	Tiparet e ekonomisë bashkëkohore	<ol style="list-style-type: none"> 1. Veçoritë dhe dominimi i tregut të lirë; 2. Parakushtet për ekonomi 	<ul style="list-style-type: none"> - të kuptojë faktorët që ndikojnë në dominimin e tregut të lirë, - të kuptojë veçoritë e ekonomisë së tregut, 	Shkencat juridike, kadastrale (që të

		tregu: (pronësia, konkurrenca, faktorët e tjerë.)	- të kuptojë pronësinë private dhe veçoritë e saj, - të kuptojë konkurrencën dhe faktorët e tjerë që kanë cilësi të parakushteve për ekonominë e tregut	kuptohet e drejta e pronës dhe vlerat e saj).
MIKRO-EKONOMIA	Firmat (ndërmarrjet)	1. Përkufizime të kuptimit të ekonomisë; 2. Historiku i zhvillimit të ndërmarrjeve; 3. Llojet e ndërmarrjeve (sipas veprimtarive, sektorëve, madhësisë); 4. Ndërmarrja sistem (nënsistemet që e përbëjnë firmën); 5. Funksionimi i ndërmarrjes në kushtet e konkurrencës.	Nxënësit duhet: - të kuptojnë nocionin e ndërmarrjes (firmës); - të kuptojnë historikun e zhvillimit të ndërmarrjeve; - të kuptojnë klasifikimin e ndërmarrjeve sipas aspekteve të ndryshme; - të kuptojnë domethënien e ndërmarrjes dhe nënsistemet që e përbëjnë atë;	Shkencat juridike, për të kuptuar personat fizikë dhe juridikë.
	Resurset (burimet) dhe kapacitetet e firmës	1. Asetet (aktiva), 2. Burimet e aseteve (pasiva), 3. Evidencimi dhe përlllogaritja e aseteve; 4. Përkufizimi i kapaciteteve; 5. Llojet dhe matja e kapaciteteve.	- të kuptojnë faktorët që e përbëjnë firmën; - të kuptojnë domethënien e aktivës dhe të pasivës dhe të bëjnë sqarimet rreth tyre, - të mësojnë evidencimin dhe pasqyrimin e aseteve, madje amortizimin dhe përlllogaritjen e tij; - të kuptojnë nocionin, llojin dhe rëndësinë e kapaciteteve.	Matematika, shkencat teknike.
	Kostot e firmës	1. Kuptimi i kostos; 2. Llojet e shpenzimeve (të kostove); 3. Përlllogaritja e shpenzimeve; 4. Metodot e kalkulimit.	- të kuptojnë nocionin dhe strukturën e kostos të prodhimit, të shërbimeve e të tjerë; - të mësojnë klasifikimin e shpenzimeve; - të mësojnë dhe operacionalizojnë llogaritjen e shpenzimeve; - të mësojnë metodat e përlllogaritjes së shpenzimeve dhe zbatimin e tyre në praktikë.	Matematikë, statistikë (tabela, grafikë, metoda).

MAKRO-EKONOMIA	Fushëveprimtaria e makroekonomisë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Disa përkufizime për makroekonominë 2. Avantazhet e ekonomisë bashkëkohore; 3. Problemet e politikave makroekonomike; 4. Tregu i punës; 5. Krizat ciklike; 6. Inflacioni. 	<ul style="list-style-type: none"> - të kuptojnë fushëdomethënien dhe fushëveprimtarinë e makroekonomisë; - të kuptojnë politikat makroekonomike dhe pjesët përbërëse të saj; - të kuptojnë problemet më madhore në makroekonomi: zhvillimin, tregun e punës, si dhe problemet e tjera, që kanë të bëjnë me krizat ciklike dhe inflacionin. 	Matematika (ekuacione, grafikë).
	Format themelore të politikave makroekonomike	<ol style="list-style-type: none"> 1. Parakushtet për ndërtimin e politikave makroekonomike; 2. Politika fiskale; 3. Politika monetare-kreditore; 4. Politika e masave administrative; 5. Politika e stabilizimit ekonomik; 	<ul style="list-style-type: none"> - të kuptojnë ç'është politika makroekonomike dhe çfarë roli ka në zhvillimin e një vendi; - të kuptojnë llojet e politikave makroekonomike; - të kuptojnë nevojat dhe mundësitë e stabilizimit ekonomik. 	
	Elementet e kërkesës agregate	<ol style="list-style-type: none"> 1. Konsumi individual dhe kursimet; 2. Konsumi shtetëror; 3. Investimet; 4. Eksporti neto; 5. Krijimi i baraspeshave ekonomike; 	<ul style="list-style-type: none"> - të kuptojnë kategorinë e konsumit dhe llojet e konsumit; - të kuptojnë investimet dhe rolin e tyre; - të kuptojnë eksportin neto, si dhe mundësitë e ekuilibreve makroekonomike. 	Matematikë (ekuacione), statistikë (grafikë, tabela).
EKONOMIA E KOSOVËS	Aspekti mikroekonomik dhe makroekonomik i ekonomisë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Niveli i zhvillimit të ekonomisë së Kosovës; 2. Burimet ndikuese për zhvillimin ekonomik të Kosovës; 	<ul style="list-style-type: none"> - të kuptojnë zhvillimin e ekonomisë së vendit të tyre; - të mësojnë për burimet njerëzore dhe natyrore që janë në funksion të zhvillimit ekonomik; - të kuptojnë specifikat rreth politikave dhe 	Statistika, matematika, për pasqyrime, barazime dhe formula të

	së Kosovës	3. Politikat e zhvillimit makroekonomik (fiskale, monetare dhe kreditore); 4. Perspektiva e zhvillimit të ekonomisë së Kosovës; 5. Nevojat dhe mundësitë e zhvillimit dhe të stabilizimit të ekonomisë së Kosovës.	problemeve të zhvillimit; - të kuptojnë perspektivat dhe mundësitë e qëndrueshme për zhvillimin ekonomik në periudhat e ardhshme.	nevojshme.
EKONOMIA BOTËRORE	Veçoritë e bashkëpunimit ndërkombëtar	1. Nevojat për bashkëpunim ekonomik me botën; 2. Politika ekonomike ndërkombëtare; 3. Tregu ndërkombëtar; 4. Financat ndërkombëtare; 5. Tregtia ndërkombëtare; 6. Veçoritë e zhvillimit ekonomik botëror (integrimet dhe globalizimi).	- të kuptojnë se ekonomitë vendore nuk mund të zhvillohen të mbyllura, por duhet të jenë të hapura me botën; - të ndërtohen bindjet për nevojat e bashkëpunimit ndërkombëtar; - të mësojnë për domethënien e financave ndërkombëtare dhe tregtinë ndërkombëtare; - të kuptojnë rolin e tregut ndërkombëtar; - të përfitojnë në të kuptuarit e proceseve të integrimi dhe të globalizimit.	Shkencat ekonomike ndërkombëtare

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Mësimdhënësi i lëndës duhet të përzgjedhë dhe të përdorë metoda mësimdhënie të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin tek ata, të kompetencave sociale e profesionale të plota e të qëndrueshme.

Gjatë procesit mësimor, mësimdhënësi duhet të veçojë konceptet dhe shkathtësitë e domosdoshme që duhet t'i mësojë nxënësit me qëllim të arritjes së rezultateve të të nxënësit që parashikohen në objektiva.

Element kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni është motivimi i nxënësve. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësimdhënësi.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është integrimi i teorisë me praktikën.

Praktikat mësimore kanë treguar se jo të gjithë nxënësit-mësojnë në të njëjtën mënyrë, në të njëjtën kohë dhe me ritëm të njëjtë. Për këtë arsye metodat dhe strategjitë e mësimdhënies duhet të jenë të larmishme dhe t'u përshtaten nevojave dhe interesit të nxënësve. Mësimdhënësi duhet të nxitë bashkëpunimin mes nxënësve me qëllim të përforcimit të dimensionit shoqëror në procesin e të nxënësit.

Format dhe metodat e të mësuarit janë të shumëllojshme dhe mësimdhënësi duhet të përzgjedhë ato që janë më të përshtatshme për kontekstin e tyre konkret.

Të tilla janë: Ligheratat tradicionale, demonstrimi, zgjidhja e problemit teorik, veprimtaritë në grupe etj.

Shpjegimi është një prej metodave që në raste të veçanta është i domosdoshëm, por megjithatë mësimdhënia ndërvepruese ka përparësi në nxitjen dhe në zhvillimin e të menduarit kritik dhe të aftësive.

Puna në grupe dhe çifte parapëlqehet me qëllim që nxënësit të lirohen nga emocionet e pakëndshme (frika) dhe së bashku të diskutojnë në grup, në mënyrë që të nxjerrin përfundime të sakta dhe me vlerë.

Me metodën e diskutimit u mundësohet nxënësve të japin sa më shumë zgjidhje alternative dhe në fund të vlerësohet zgjidhja më e mirë.

Metoda furi mendimesh (brainstorming) ka për qëllim t'i aftësojë nxënësit të japin ide, zgjidhje dhe komente të shpejta për problemin e dhënë.

Mësimdhënësi i përgatitur gjithnjë në qendër të vëmendjes e ka nxënësin dhe përdor strategji të ndryshme që tek ai të zhvillohet të menduarit kritik.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësimmshënësi është fakti që të nxënët nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre.

VLERËSIMI

Sa i përket vlerësimi të nxënësve rekomandohet të përdoren metoda dhe instrumente vlerësimi që të nxisin përparimin e nxënësve, shmangin subjektivizmin në vlerësim dhe të pasqyrojnë arritjen reale të tyre.

Me rëndësi është vlerësimi i vazhdueshëm dhe ai përfundimtar, ku format dhe instrumentet e vlerësimi përzgjidhen apo hartohen nga vetë mësimmshënësi.

Duhet të synohet vlerësimi i arritjeve i mbështetur në kriteret ku arritjet e nxënësit krahasohen me standardet e paracaktuara dhe të shmanget sa më shumë të jetë e mundur vlerësimi i bazuar në renditjen, ku nxënësit krahasohen me njëri-tjetrin.

Format dhe instrumentet e vlerësimi që rekomandohet janë: pyetjet me gojë, pyetjet me shkrim, detyrat me shkrim, vëzhgimi i veprimtarisë së nxënësve, listat e kontrollit etj.

LITERATURA

1. Ahmet Maçellari, Sulo Hadëri, Dhori Kule, Stefan Qirici: HYRJE NË EKONOMI, Pegi, Tiranë, 2000,
2. Dr. Ali Jakupi, dr. Isa Mustafa: EKONOMIA 11, gjimnazi i shkencave shoqërore, Libri Shkollor, Prishtinë, 2004
3. Terli Mings: STUDIMI I EKONOMISË, parimet, konceptet dhe zbatimet (anglisht: The Study of Economics), SHBLU, Tiranë, 1993;
4. Paul Heyne: MËNYRA EKONOMIKE E TË MENDUARIT (anglisht: The Economic Way of Thinking) shblu, Tiranë, 1994;
5. Prof. dr. Musa Limani: HYRJE NË EKONOMI, Prishtinë, 2002
6. Dr. Isa Mustafa, dr. Nail Reshiti, dr. Enver Kutllovci, EKONOMIA 9, Libri Shkollor, Prishtinë, 2003.
7. EKONOMIA E ZBATUAR, Tiranë, 2001, përshtatur dhe ripunuar nga: Prof. dr. Ahmet Maçellari, prof. dr. Sulo Hadëri, prof. dr. Dhori Kule, prof. as. Stefan Qirici, dr. Fatmira Myteberi, Vali Xhixha.
8. ECONOMICS, Paul A. Samuelson, William D. Nordhaus, botimi i katërbëdhjetë;
9. ECONOMICS, John Sloman, Prentice Hall, 2003, botimi i pestë.

ART MUZIKOR

Gjimnazi i Gjuhëve (1 orë në javë, 33 orë në vit)

HYRJE

Muzika është pjesë e jetës së njeriut, ajo është e drejtë dhe nevojë e secilit, prandaj është e paraparë edhe në programin e shkollës së mesme të lartë. Muzika u ofron nxënësve botën e vlerave të saj, u mundëson zhvillim të plotë muzikor duke interpretuar, krijuar dhe dëgjuar muzikë dhe kjo i aftëson për sensibilizim estetik, cilësim dhe vlerësim kritik.

QËLLIMET

Lënda arti muzikor ka për qëllim:

- të nxitë për ta kuptuar muzikën si art kohor në hapësirën tingëllore;
- përmes dëgjimit muzikor të mundësojë përjetimin dhe pranimin e vlerave muzikore të rëndësishme për kulturën kombëtare dhe botërore;
- mundësojë njohjen e krijimtarisë muzikore popullore dhe artistike kombëtare për të ndikuar në ruajtjen dhe në kultivimin e identitetit kombëtar;
- me veprimtari aktive muzikore të zhvillojë dhe të pasurojë potencialet e tyre emocionale intelektuale, psikomotorike, estetike, morale dhe sociale;

përmes muzikës - gjuhës universale të komunikimit, të zhvillojnë aftësitë e bashkëpunimit dhe krijimit të raporteve kulturore mes tyre si dhe mes kulturave dhe popujve të ndryshëm;

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË

Nxënësit:

- **Përfjetojnë dhe njohin muzikën e epokave dhe stileve, gjinive e zhanreve të ndryshme muzikore përmes përjetimit estetik dhe cilësimit kritik:**
 - thellojnë njohuritë për mjetet dhe formacionet interpretuese në veprat muzikore të dëgjuara;
 - vërejnë, dallojnë dhe thellojnë njohuritë për elementet shprehëse muzikore;
 - thellojnë njohuritë për format muzikore përmes dëgjimit dhe interpretimit;
- **zhvillojnë, ngrisin dhe vlerësojnë kulturën e këndimit, duke zbatuar teknikën vokale:**
 - zhvillojnë qëndrimin pozitiv ndaj traditës muzikore kombëtare-këndimit;
 - interpretojnë në instrumente të ndryshme muzikore shoqërimi të këngëve dhe përmbajtje të veçanta instrumentale;
 - interpretojnë vepra vokale dhe instrumentale sipas përjetimit individual;
- **cilësojnë dhe vlerësojnë interpretimet individuale dhe të tjerëve;**
- **zhvillojnë aftësitë kreative individuale duke improvizuar, plotësuar, krijuar tërësi të reja muzikore si dhe duke hulumtuar e krijuar kombinime tingëllore;**
- **orientohen në programet koncertale, ngjarjet muzikore si dhe në mundësinë e manipulimit të muzikës përmes mediave;**
- **njohin lidhjen interdisiplinare të muzikës me letërsinë, artet e tjera si dhe me disiplina të ndryshme shkencore;**

VEPRIMTARITË MUZIKORE, PËRMBAJTJET MUZIKORE DHE BURIMET ARTISTIKE-MUZIKORE

I. DËGJIMI MUZIKOR		
PËRMBAJTJET	REZULTATET E PRITSHME	BURIMET ARTISTIKE
<p>IMPRESIONIZMI NË MUZIKË</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Vepra dhe kompozitorë më të rëndësishëm të këtij stili: Debussy, Ravel, Respigi, Skrjabin <p>MUZIKA E SHEK XX</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Veçoritë themelore (Dodekafonia, atonaliteti, muzika elektronike dhe konkrete) ▪ Kompozitorët e rëndësishëm të këtij stili (Schonberg, Alban Berg, Hindemith, K. Orff, Honeger, Brittn, Prokofjev, Stravinski, Ha[at]urian, Bartok. Gershwin) etj <p>MUZIKA ARTISTIKE</p>	<p>Nxënësit:</p> <p>I.1. Dëgjojnë</p> <ul style="list-style-type: none"> • në mënyrë analitike dhe përjetuese vepra të kompozitorëve nga epokat, stilet dhe zhanret e ndryshme dhe rinjohin veprat , krijuesit dhe interpretët në shembujt muzikorë të dëgjuar ; <p>I.2. thellojnë njohuritë për mjetet dhe formacionet interpretuese (zërat, instrumentet, formacionet interpretuese: vokale, instrumentale, vokalo-instrumentale dhe skenike)</p>	<p>K. Debussy: Poema simfonike- “Deti” Suita për piano: “Piktura”(impresionizmi) M. Ravel: “Rapsodia spanjolle për orkestër. “Ciganja” për violinë dhe orkestër O. Respigi: Poema simfonike Fontanat e Romës” A. Skrjabin: Sonata, etydë për piano (përzgjedhje) ***** Schonberg: Kantata “Të mbeturit gjallë nga Varshava“ Alban Berg: Suitë lirike K. Orff: Carmina Burana A. Honeger: “Pacifik 231“ B. Brittn: „Rekuiemi i luftës“ S. Prokofjev: Koncert për piano dhe orkestër nr. 3 I. Stravinski: “Zogu i zjarrtë“ O. Mesjan: „Zgjiimi i shpezëve“ Aran Hacaturian: „Vallja e shpatave“ Bella Bartok: „Allegro barbaro“ XH. Gershëin: „Amerikani në Paris“ (mjuziklli, muzika për film etj) ***** F. Noli: Poema simfonike “Skënderbeu“ K. Trako“ Poema simfonike“Vendi im“</p>

<p>SHQIPTARE (shek. XX)</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Format dhe gjuha shprehëse muzikore ▪ Kompozitorët më të rëndësishëm: Noli, Th. Nasi, M. Shehu, Deshpali etj. <p>MUZIKA ARTISTIKE SHQIPTARE NË GJ. E DYTË TË SHEK. XX</p> <p>Format, veçoritë stilistike</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Kompozitorët më të spikatur R. Mulliqi, Zadeja, T. Daija, T. Harapi, F. Ibrahim, F. Beqiri, E. Rizvanolli, V. Gjini, M. Kaçinari <p>KOMPOZITORËT AKTUALË TË MUZIKËS ARTISTIKE SHQIPTARE:</p> <p>L. Disdari, Z. Ballata, R. Dhomi, R. Rudi, B. Shehu, A. Koci, GJ. Gjevelekaj, M. Menxhiqi, B. Jashari, A. Peçi, V. Tole, V. Beqiri,</p>	<p>I.3. thellojnë njohuritë për elementet shprehëse (tingulli-heshtja-melodia-ritmi-harmonia)</p> <p>I.4. njohin format e ndryshme muzikore</p>	<p>Prenk Jakova: Aria nga opera“Gjergj Kastrioti“ *****</p> <p>Rexho Mulliqi: Simfonia Kosovare nr.2 Tish Daija: Fragement nga baleti“Halili dhe Hajria“ Ç. Zadeja: Simfonia nr.1 T. Harapi: Poemë për piano dhe orkestër F. Ibrahim: Koncert për violonçel dhe orkestër Pjesë nga baleti: „Plaga e dhjetë e Gjergj Elez Alisë“ F. Beqiri: Sonata për klarinet e piano E. Rizvanolli: Kuarteti i harqeve V. Gjini: Këngë solo“Letrat“ M. Kaçinari: Suita ilire për orkestër</p> <p>*****</p> <p>Limos Disdari: Trio për violinë, violonçel dhe piano Z. Ballata: Sonata në dy kohë (piano) R. Dhomi: “Rondo për violonçel dhe orkestër“ R. Rudi: “Simfonia në dy blloqe“ dhe “Afresket arbëreshe“ A. Shehu: Koncertino (piano e orkestër) Gj. Gjevelekaj: Impresione për orkestër M. Menxhiqi: Oratoriumi: Homazh „Nënës Tereze“ B. Jashari: „Pasakalja për orkestër“ Këngë korale: „Pak në ëndërr pak në zhgëndërr“ V. Tole: pjesë nga opera moderne “Qiriat“ B. Mulliqi: Variacione për dy piano V. Beqiri: Variacione për flaut, klarinet dhe piano Ose kuarteti i harqeve</p>
---	---	---

II. INTERPRETIMI		
PËRMBAJTJET	REZULTATET E PRITSHME	SHEMBUJT PËR KËNDIM
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Këngë një, dy e më shumë zëshe ▪ Përzgjedhje të temave të njohura nga veprat për dëgjim ▪ Këngët artistike shqiptare 	<ul style="list-style-type: none"> ➤ dinë të interpretojnë këngë dhe përmbajtje instrumentale, ➤ kultivojnë këndimin artistik dhe luajtjen në instrumente ➤ vlerësojnë interpretimin vetjak dhe të tjerëve; ➤ përvetësojnë disa nga këngët, temat , meloditë, kanonet dhe përmbajtjet instrumentale të punuara 	<p>Th. Nasi "Vlora o Vlora" K. Kono"Vajza dhe Hëna"</p> <p>L. Antoni: "Çorapet e burrit" K. Trako: Drini plak A. Grimci: Për ty këndo</p> <p>P. Jakova: Marxhelo R. Mulliqi:"Vjeshta", "Një lule"</p> <p>T. Daija: "Me lule të bukura" Ç. Zadeja:" Shkoi djali termal"</p>
III. KRIJIMI MUZIKOR		
PËRMBAJTJET	REZULTATET	NDËRLIDHJA
<i>Eksperiment tingëllor</i>	<i>Improvizojnë, hulumtojnë, zgjedhin dhe kombinojnë tinguj</i>	<i>Akustika</i>
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Krijime të reja ▪ Të shprehurit kreativ 	<p>Krijojnë tema dhe tërësi të reja ritmike-melodike</p> <p>realizojnë disa nga format e propozuara të punës krijuese në përputhje me mundësitë dhe prirjet e tyre individuale;</p>	<p>LETËRSIA, ARTI FIGURATIV, VALLËZIMI, ETJ</p>

IV. THELLIMI I NJOHURIVE PËR ARTIN DHE KULTURËN MUZIKORE			
PËRMBAJTJET	REZULTATET E PRITSHME	BURIMET	NDËRLIDHJA
<p>Muzika në radio dhe në televizion Dukuritë pozitive dhe negative</p> <p>Programi i shfaqjeve kulturore dhe ngjarjet muzikore aktuale</p> <p>Muzika dhe teknologjia</p> <p>Muzika dhe interneti</p>	<p>Njohin mundësitë e manipulimit me muzikën përmes mediave</p> <p>Orientohen në programet koncertale, mendimet dhe komentet për muzikën njohin programet kompjuterike për muzikë dhe incizojnë krijimet e tyre</p>	<p>Produksioni i ri muzikor</p> <p>Programi muzikor në mediat</p> <p>Programet e koncerteve dhe shfaqjeve</p> <p>Literatura dhe publicistica për muzikën</p>	<p>Mjedisi muzikor</p> <p>Ekologjia dhe teknologjia muzikore</p>
Fjalori muzikor, literatura	zgjerojnë fjalorin dhe përdorin terminologjinë përkatëse muzikore	Literatura profesionale muzikore	Gjuha dhe letërsia

UDHËZIME DIDAKTIKO-METODIKE

Realizimi i lëndës - Arti muzikor duhet të ketë parasysh nivelin zhvillimor të nxënësve, veprimtaritë themelore muzikore dhe synimet e objektivat e lëndës për këtë klasë.

Përmbajtja programore e kësaj klase kërkon nga mësuesi planifikim dhe realizim të kujdesshëm të njësive mësimore. Mësuesi në mënyrë kreative sjon njësitë mësimore, duke i ndërlidhur në mënyrë të logjikshme veprimtaritë-dëgjimin, interpretimin dhe krijimin. Këto duhet të jenë tërësi përmbajtësore të rrumbullakësuar ku komunikimi muzikor i drejtpërdrejtë me veprën muzikore përmes dëgjimit dhe interpretimit duhet të përmbushin pjesën më të madhe të orës-(njësisë mësimore).

DËGJIMI

Kjo veprimtari themelore zhvillon aftësinë për njohje përjetuese, analitike dhe vlerësuese të veprave muzikore ku duhet të prijë përjetimi, i cili thëllon vëmendjen dhe përqëndrimin për dëgjim më të gjatë;

Mësuesi nxit përjetimin dhe njohjen me forma të ndryshme të motivimit që nxënësit të mund të:

- Përcjellin veprën muzikore ose pjesët e saj përmes tekstit notal.
- Njohin temat dhe meloditë e rëndësishme që vërejnë (rinjohin) gjatë dëgjimit.
- Kuptojnë porosinë dhe karakterin shprehës të veprës.
- Përmes komentimit gjuhësor ose simboleve grafike shënojnë rrjedhën e veprës.
- Krahasojnë përshtypjet tingullore të pjesëve të caktuara të veprës muzikore.

Gjatë dëgjimit arsimtari duhet të orientojë nxënësit në të vërejturit e mjeteve shprehëse dhe formacioneve interpretuese, të cilat ndihmojnë dëgjuesin për ta kuptuar veprën muzikore, duke i thelluar njëkohësisht njohuritë paraprake, të cilat i kanë marrë përgjatë edukimit muzikor në klasët e mëparshme.

Në kuadër të kësaj shkëmbehen informacione dhe të dhëna për krijuesit, epokën, stilet, zhanret, interpretuesit dhe institucionet muzikore.

Rëndësi të veçantë në këtë nivel i kushtohet vlerësimit të veprës, përjetimit dhe njohjes së saj. Në këtë aspekt është shumë me rëndësi që

temat e caktuara të mësohen me këndim para se të dëgjohet vepra, ngase ajo bëhet mbështetje dhe ndërlidhje për përqendrim të vëmendjes gjatë dëgjimit.

Nxënësit i nxisim dhe i udhëheqim për debat kritik, krahasime dhe vlerësime edhe përmes përcjelljes individuale dhe të organizuar, të programeve koncertale e programeve muzikore në media. Kështu ata njihen me format e ndryshme të ndërlidhjes së artit muzikor me letërsinë dhe artet e tjera, veçanërisht përmes veprave vokale, vokale instrumentale e skenike si dhe të muzikës me program. Ndërlidhja mund të bëhet edhe me lëndët e tjera si me historinë, gjeografinë, etj.

INTERPRETIMI

Edhe në klasën XII këndimi duhet të zë vend të rëndësishëm në realizimin e përmbajtjeve programore, duke përfshirë përmbajtje interesante që i motivojnë nxënësit për këtë formë të punës (këngët, temat, kanonet etj.).

Nxënësit duhet të nxiten për këndim individual dhe në grupe, duke pasur parasysh mundësitë e tyre interpretuese dhe interesimet aktuale të kësaj moshe, por parasëgjithash kujdesin që këngët e përzgjedhura të kenë vlerë artistike;

Këngët interpretohen duke përdorur që të tri mënyrat e përpunimit të këngës (metodën sipas veshit, sipas tekstit notal dhe metodën e kombinuuar. Këndimi duhet të ketë një balancë në kuptim të shoqërimit instrumental, duke pasur kujdes që të mos teprohet me shoqërim në dëm të këndimit të pavarur.

Luajtja në instrumente nënkupton shoqërimin instrumental të këndimit, por edhe interpretimin e përmbajtjeve të veçanta e të përzgjedhura instrumentale (temat nga veprat e dëgjuara, kompozime të thjeshta etj.) sipas mundësive dhe interesimeve të nxënësve. Mësimdhënësi i motivon nxënësit për zgjedhjen e veprave ose përmbajtjeve për luajtje instrumentale, duke u ndihmuar atyre në aranzhimin e ndryshëm gjatë shoqërimit të këngës, por edhe duke siguruar që përmbajtjet e veçanta instrumentale të jenë me kërkesa përkatëse për mundësitë e tyre interpretuese.

Arsimtari i nxit nxënësit për interpretim individual dhe në grupe për të realizuar muzikimin e përbashkët gjithnjë duke insistuar në interpretim sa më artistik.

KRIJIMI

Në veprimtarinë krijuese mësimdhënësi duhet të nxitë nxënësit të shprehin lirshëm përjetimet e tyre në përputhje me moshën dhe interesimet e tyre. Në këtë moshë ata shumë lirshëm mund të provojnë të shprehen përmes poezisë, tregimit ose eseut - me shkrim në bazë të muzikës së dëgjuar por duhet të inkurajohen edhe për komentime gjuhësore mbi këtë bazë. Edhe format e tjera të punës krijuese gjejnë vend sidomos të shprehurit muzikor kreativ përmes improvizimeve dhe krijimit të tërësive të reja muzikore, por në këtë moshë, vijnë në shprehje edhe komentet për veprat e dëgjua, eseja me shkrim për tema të caktuara nga përmbajtjet tematike të mësuara etj.

Gjatë formës së punës ku nxënësit krijojnë tërësi të reja muzikore arsimtari duhet t'i nxitë për vlerësim kritik të krijimeve vetjake dhe krijimeve të të tjerëve, duke pasur kujdes që roli i tij të jetë vetëm inspirues dhe këshillues.

VLERËSIMI

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në lëndën Art muzikor është kompleks dhe i rëndësishëm por edhe specifik për shkak të natyrës së vetë lëndës, e cila në vete përmban veprimtari aktive muzikore.

Vlerësimi objektiv dhe i drejtë i të arriturave të nxënësve kërkon të respektohen kërkesat profesionale-didaktike e psikologjike. Mësimdhënësi duhet të vlerësojë arritjet e secilit nxënës në kuadër të grupit, duke respektuar veçoritë individuale.

Mësimdhënësi duhet të aplikojë vlerësimin përmbledhës për të parë sa kanë arritur nxënësit të realizojnë objektivat e parashtruar.

Elementet më të rëndësishme për vlerësim në lëndën Art muzikor janë:

- përjetimi i shprehjes muzikore të veprës
- aftësia e të vërejturit dhe e të dalluarit të elementeve të ndryshme gjatë dëgjimit muzikor (rinjohja e veprës, përcaktimi i epokave të ndryshme stilistike, formës, gjinisë dhe zhanreve të ndryshëm muzikorë, formacionet interpretuese);
- interpretimi i këngëve dhe përmbajtjeve instrumentale;
- të kuptuarit dhe aplikimi praktik i dukurive muzikore;
- informacionet elementare për krijuesit, interpretuesit ;

- qëndrimi kritik i nxënësve për krijimtarinë muzikore dhe trajtimin e Artit muzikor në mjedisin e tyre;

Instrumentet e vlerësimit në këtë lëndë janë: prezantimi (interpretimi), punimet me shkrim, projektet (detyra hulumtuese të pavarura), testimi, vetëvlerësimi etj.

Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh standardet sipas nivelit dhe rezultatet e arritshmërisë në vartësi nga objektivat e parashtruar.

FORMAT E VEÇANTA TË OBLIGUESHME TË MËSIMDHËNIES MUZIKORE

Puna me kor dhe orkestër është formë e veçantë dhe e obligueshme e edukimit muzikor edhe në shkollën e mesme të lartë. Në kor dhe në orkestër marrin pjesë nxënësit me aftësi muzikore të theksuara dhe në bazë të interesit të tyre.

Këto forma të mësimdhënies muzikore paraqesin nivel të lartë të interpretimit muzikor dhe e përfaqësojnë shkollën në të gjitha shfaqjet publike në shkollë dhe jashtë saj.

Puna me korin dhe me orkestrën e shkollës, si bazë për formimin e jetës artistike, do të jetë e planifikuar dhe e matshme me orar. Mund të formohen kore të niveleve të ndryshme, ora në kor zgjat sa ora mësimore, 45 minuta. Kjo punë e mësimdhënësit llogaritet në normën javore mësimore të tij me fond javor prej 4 orë. Gjatë vitit shkollor kori përgatit dhe prezanton program me kritere artistike-pedagogjike.

ART FIGURATIV

Gjimnazi i gjuhëve (1 orë në javë, 33 orë në vit)

HYRJE

Lënda e Artit figurativ në një sistem të përbashkët me lëndët e tjera është e fokusuar në përgatitjen e të rinjve të marrin përgjegjësinë për jetën e tyre, të inkuadrohen në shoqëri si qytetarë aktivë e kompetentë dhe të angazhohen me sukses në tregun e punës. Lënda e Artit figurativ ka vend të rëndësishëm në sistemin ndërlëndor shkollor, duke u kontribuar në mënyrë të ndërsjellë përmbajtjeve të njohurive përmes konkretizimit vizuel.

Në këtë kontekst lënda e Artit figurativ duhet t'u mundësojë nxënësve:

- të aplikojnë njohuritë e tyre, duke krijuar shprehje origjinale të artit figurativ,
- të zhvillojnë shkathtësitë e komunikimit, duke komunikuar dhe shprehur opinionet personale përmes gjuhës figurative dhe
- të kultivojnë shijet artistike, duke analizuar veprat e veta dhe të tjerëve dhe duke ndërlidhur përvojat artistike me përvojat e tjera që u ofrohen në shkollë dhe në jetën e përditshme.

Arti figurativ zhvillon të vërejturit dhe konceptimin intuitiv të pavarur, duke formuar personalitetin me mendim kritik për të gjykuar e vlerësuar vlerat e krijimeve figurative dhe artistike, të shprehjeve individuale dhe të jashtme, të periudhave historike dhe të kulturave të rrethit ku jeton dhe të botës së gjerë.

Rëndësi e posaçme duhet t'i kushtohet ndërlidhjes me lëndët e tjera, duke pasur qasje integruese ndaj zhvillimit të procesit mësimor. Realizimi i lëndës së artit figurativ lidhet ngushtë:

- me lëndët shoqërore, për sa i përket kulturës së përgjithshme;

- me lëndët shkencore, për sa i përket vizuelizimit të koncepteve dhe materializimit të ideve;
- me gjuhët, për sa i përket zgjerimit të mundësive të komunikimit (relacionet e komunikimit verbal dhe joverbal - konceptet, shenjat, simbolet etj.).

QËLLIMI

Qëllimi i lëndës së Artit figurativ për klasën 12 është arritja e kompletuar e njohurive bazë të artit dhe të kulturës përfundimisht me shekullin XX.

Zhvillimi i shkathtësive themelore për aplikimin e njohurive figurative dhe shprehjen individuale në medime dhe teknika të ndryshme të Artit figurativ dhe multimedial.

OBJEKTIVAT

Nga përmbajtja programore e klasës 12, nxënësi do të jetë në gjendje të arrijë objektivat e përgjithëshme dhe specifike me një përkushtim të nxënësit dhe të mësimdhënësit.

Të përgjithshëm	Specifikë
Të vështrojë	<ul style="list-style-type: none"> • Konceptet figurative dhe njohuritë për rolin dhe zhvillimin historik të arteve figurative. • Fenomenet natyrore dhe shoqërore dhe bën interpretimin artistik.
Të përjetojë	<ul style="list-style-type: none"> • Analizon, hulumton dhe nxjerr kuptime nga veprat artistike, duke përfshirë edhe punimet personale.
Të dallojë	<ul style="list-style-type: none"> • Përparësitë në punë estetike, intelektuale dhe morale.
Të krijojë	<ul style="list-style-type: none"> • Atmosferë pune dhe raporte shoqërore bashkëpunuese. • Përdorë teknikat dhe materialet, i aplikon shkathtësitë artistike, shprehet dhe komunikon në gjuhën figurative.
Të vlerësojë	<ul style="list-style-type: none"> • Për parimet e formësimit dhe cilësitë e tjera artistike. • Për opinionet personale të veprave artistike dhe kritikën e artit.

PLANIFIKIMI I PËRMBAJTJES

Kategoritë	Nënkategoritë
1. Njohuritë dhe shkathësitë artistike	1. Konceptet dhe zgjerimi i koncepteve3 orë
	2. Stilet dhe kulturat4 orë
	3. Periudhat historike10 orë
2. Të shprehurit figurativ dhe kreativiteti	1. Vija dhe trajta4 orë
	2. Ngjyra dhe forma4 orë
	3. Kompozicioni4 orë
3. Analiza dhe vlerësimi i prezantimit figurativ-estetik	1. Analiza e prezantimit2 orë
	2. Vlerësim figurativ-estetik2 orë

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE

<p>I. Kategoria Përvetësimi i njohurive, Njohuritë dhe shkathtësitë artistike 17 orë</p>			
Nënkategoritë	Temat mësimore	Udhëzime metodologjike	Rezultatet e pritshme
1. Konceptet dhe zgjerimi i koncepteve	Elementet e Artit figurativ dhe bazat e kompozicionit: <ul style="list-style-type: none"> • Trajta • Forma • Harmonia • Kontrasti • Ritmi • Lëvizja etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • Realizohet në lëmin e vizatimit, pikturimit-teknikës guash, pastel akuarel, teknikë e kombinuar etj. • Realizohet në klasë duke u ballafaquar me elementin për njohje, nxënie të shprehjes figurative. 	Nxënësi do të jetë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> • Pasurojë fjalorin me terma të Artit figurativ – artistik gjatë punës praktike dhe do të krijojë njohuri personale për artin dhe njëherësh bën sqarimin e koncepteve.
2. Stilet dhe kulturat	<ul style="list-style-type: none"> • Stili nëpër periudha • Krahasime nga jeta e përditshme. 	<ul style="list-style-type: none"> • Konkretizohet në bashkëbisedim me nxënësit për stilet dhe kulturat figurative, duke paraqitur reproduktime përkatëse. 	Nxënësi do të jetë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> • dallojë stilin dhe kulturën e kohës dhe dukuritë e shprehjeve figurative sipas zhvillimit historik
3. Periudhat historike	<ul style="list-style-type: none"> • Impresionizmi • Realizmi i shek. XX • Skulptura e shek. XX • Ekspresionizmi • Kubizmi 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegohet me reproduktime, përmes vizitave apo me konkretizimin e temave mësimore përmes video incizimeve. 	Nxënësi do të jetë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> • Interpretojë konceptet figurative, rolin dhe zhvillimin historik të arteve figurative nëpër periudha

	<ul style="list-style-type: none"> • Surrealizmi • Drejtime të ndryshme të shek. XX në Evropë dhe në Amerikë • Arti kosovar i shek. XX 		historike, duke filluar nga impresionizmi deri në fund të shekullit XX.
II . Zhvillimi i shprehjes, Të shprehurit figurativ dhe kreativiteti 16 orë			
Nënkategoritë	Temat mësimore	Udhëzime metodologjike	Rezultatet e pritshme
1.Vija dhe trajta	<ul style="list-style-type: none"> • Vija në medime të ndryshme natyrore artificiale, gjeometrike, simetrike, asimetrike, ritmike etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • Vija dhe trajta përdoren për shprehje të lirë individuale deri te të vërejturit e tyre në medime të ndryshme. 	Nxënësi do të jetë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> • dallojë vijën në fushën pamore dhe hapësinore; • identifikojë vijën e trajtës dhe veçoritë e saj, t'i përcaktojë vijat e holla e të trasha, të drejta, të lakuara, të pandëprera dhe të gërshetuara dhe trajtat në natyrë dhe në vepra artistike.
2. Ngjyra dhe forma	<ul style="list-style-type: none"> • Veçoritë e ngjyrës dhe të formës • Llojet e ngjyrave dhe të formave • Ngjyra, drita dhe forma 	<ul style="list-style-type: none"> • Konkretizimi i veçorive të ngjyrave dhe formave përmes punës praktike dhe analizës së veprave të tjera nga historia e artit. 	Nxënësi do të jetë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> • njohë, kuptojë, e përjetojë ngjyrën dhe spektrin e saj; • krijojë gamën e ngjyrave individuale apo tipin

	<ul style="list-style-type: none"> • Pikturë • Kolazh • Mozaik • Zgrafito • Vitraji • Skulpturë 		<p>koloristik.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njohë dhe kuptojë format në medime të ndryshme, në natyrë dhe në vepra artistike.
3. Kompozicioni	<ul style="list-style-type: none"> • Bazat e komponimit figurativ, Komponimi dhe formësimi nëpërmjet krijimeve në dy dhe tre dimensione, harmonia në kompozicion, kontrasti, valeri, baraspesha dhe elementet e tjera figurative gjatë punës kreative figurative. 	<ul style="list-style-type: none"> • Temat të ushtrohen përmes punës praktike figurative dhe të krahasohen me reprodukime të periudhave historike. 	<p>Nxënësi do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • dallojë elementet figurative dhe të komponojë vepra artistike në medime të ndryshme sipas preferencës së nxënësit dhe mundësive të klasës; • përjetojë vlerat kompozicionale si veçanti estetike për të arritur nivel figurativ.
<p>III. Kultivimi i aftësive për vlerësim, analizë dhe prezantim figurativ-estetik Analiza dhe vlerësimi i prezantimit figurativ-estetik 8 orë</p>			
Nënkategoritë	Temat mësimore	Udhëzime metodologjike	Rezultatet e pritshme
1. Analizë dhe debate për vlerat figurative	<ul style="list-style-type: none"> • Punimet e ndryshme figurative të nxënësve. • Analiza dhe debate duke nxjerr kuptime për vlerat e punimit figurativ 	<ul style="list-style-type: none"> • Punimet e përzgjedhura të nxënësve merren si shkak për komunikim verbal, duke debatuar, analizuar dhe vlerësuar. • Galeritë, muzetë, ekspozitat 	<p>Nxënësi do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • zhvillojë mendimin kritik dhe për të gjykuar dhe bërë debate rreth prezantimit të artit të mirëfilltë dhe shundit e kësaj.

	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegim • Reprodukime nga historia e artit • Opinione multimediale 	<p>personale të jenë po ashtu vend për analiza debate dhe njëherësh pasurim kulturor në përgjithësi.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në fshatra ku mungojnë muzetë dhe galeritë të shfrytëzohet literatura nga historia e artit që kontribuon në përfocimin e njohurive për artet dhe shprehjen figurative dhe të krahasohen ato me artizanatet dhe format e tjera të njohura për nxënësit në rrethin ku jetojnë. 	<ul style="list-style-type: none"> • prezantojë veprat personale apo shkrimet e veta për veprat e të tjerëve, • hulumtojë dhe të nxjerrë kuptimin nga veprat artistike dhe të analizojë veprat dhe ngjarjet kulturore.
<p>2. Vlerësim dhe shkrime estetike</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerat kulminante artistike të historisë së artit. • Shprehja bashkëkohore, arti i performancës etj. • Shkrime estetike dhe opinione personale për veprat figurative apo për ngjarjet artistike 	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkëbisedime grupore të nxënësve dhe nxjerrja e përfundimeve për vlerat estetike. • Shprehja e mendimit të lirë në formë të shkruar, debate apo reinteretim i veprës përmes shprehjes figurative. 	<p>Nxënësi do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • bëjë shpjegime dhe të mësojë për vlerën e punës së veçantë e të përgjithshme dhe konkurrencën në fushën e kulturës, • arrijë të bëjë vrojtme dhe kërkime të pavarura për të gjykuar vlerat figurative-artistike.

QASJET NDËRLËNDORE DHE NDËRPROGRAMORE

Arti figurativ mundëson që nxënësi të mësojë dhe të praktikojë materializimin e idesë në të gjitha fushat e jetës. Përmes artit figurativ nxënësi mëson: vizuelizimin e ideve, ushtrimin e mendimit kritik, të shprehurit e lirë dhe qasjen individuale, kuptimin më të plotë të periudhave historike dhe kulturave të popujve dhe të individëve në historinë e njerëzimit. Posaçërisht arti figurativ e ndihmon përmbajtjet programore të lëndëve shoqërore (historia, filozofia, sociologjia, psikologjia, etj.) dhe lëndëve të tjera (informatika, gjeografia, matematika, fizika, biologjia, etj).

VLERËSIMI

Vlerësimi është një process i vrojtimit të vazhdueshëm, i dokumentimit të punës së nxënësve dhe ka të bëjë me çdo lloj veprimtarie dhe matjeje që përdoret për të gjykuar punën dhe arritjet e nxënësve.

Në mënyrë që të sigurohen informacione të mjaftueshme për të vlerësuar arritjet e nxënësve në lëndën e artit figurativ duhet të përdoren mjete dhe teknika të ndryshme.

Me rastin e çmuarjes dhe vlerësimit merren parasysh:

- Përvetësimi i koncepteve dhe demonstrimi i zbatimit të tyre,
- Shkathtësitë e prezantimit,
- Aftësitë e vlerësimit dhe analizës (për punën vetjake dhe të të tjerëve),
- Kreativiteti dhe origjinaliteti,
- Pjesëmarrja në orët mësimore,
- Dosja(portfolio) e punimeve-aktiviteteve personale,
- Respektimi i standardeve të sigurisë,
- Trendi personal i zhvillimit të shkathtësive,
- Koha në kryerjen e detyrave,
- Saktësia dhe përpikëria në afate,
- Puna sipas detyrave dhe parametrave,

Të gjitha këto elemente diskutohen me nxënësin, duke nxjerr përfundimin e përbashkët për vlerësimin apo notimin.

BURIMET E DIJES DHE MJETET MËSIMORE

- Tekste shkollore për nivelin përkatës,
- Fotografi dhe reprodukime,
- Video xhirime,
- Vizita dhe udhëtime studimore,
- Pjesëmarrje në ekspozita dhe ngjarje kulturore,
- Hapësirat e shkollës dhe pajisjet në dispozicion,
- Aktivitetet kulturore-hulumtuese (gërmimet arkeologjike, restaurimet, ndërtimet) etj.

Parakushtet për punë praktike (përvoja e të nxënit)

Çdo njësi mësimore zhvillohet me pjesëmarrje aktive të nxënësve dhe duke i praktikuar- realizuar mësimet dhe duke mësuar përmes praktikimit:

- Krijimi i kushteve në klasë, në shkollë dhe në mjedis rreth shkollës,
- Përgatitja e materialeve të nevojshme me pjesëmarrje aktive të nxënësve,
- Puna në grupe dhe qasja individuale ndaj secilit nxënës,
- Krahasimet me lëndët e tjera dhe përvojën e përgjithshme,
- Organizimi i ekspozitave dhe qasja gjithëpërfshirëse ndaj të gjithë nxënësve,
- Angazhimi i nxënësve përmes shkollës në punët praktike (gërmime arkeologjike, hulumtime, restaurime etj).
- Vizita e ekspozitave, koleksioneve etnografike, ngjarjeve kulturore dhe analizimi/debatimi i tyre.

Udhëzimet e nevojshme për punë praktike dhe masat e sigurisë gjatë realizimeve ideore janë pjesë e rëndësishme metodologjike.

TEKNOLOGJIA E INFORMIMIT DHE E KOMUNIKIMIT (TIK)

**Gjimnazi i gjuhëve, gjimnazi i shkencave natyrore
(2 orë në javë, 66 orë në vit)**

HYRJE

Teknologjia e informimit dhe e komunikimit paraqet njërin ndër lëmenjtë kryesorë në jetën bashkëkohore të njeriut, është pjesë e pandarë e veprimtarisë së përditshme të tij dhe sinonim i gatishmërisë për t'u marrë me problemet e të tashmes dhe të ardhmes.

Lënda Teknologjia e informimit dhe komunikimit për klasën 12 është vazhdimësi dhe zgjerim i njohurive paraprake nga kjo fushë dhe ka të bëjë me përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive të nevojshme për përdorimin e suksesshëm dhe të pavarur të pajisjeve të Teknologjisë së informimit dhe të komunikimit (TIK), me përdorimin e internetit, si dhe krijimin, disenjimin dhe publikimin e Web faqeve dhe Web sajtave nëpërmjet Front Page-it.

QËLLIMET

1. Nxënësit duhet të jenë në gjendje t'i njohin pajisjet dhe mundësitë aktuale për publikimin e Web faqeve si dhe të jenë në gjendje të përcjellin zhvillimin dhe zgjerimin e veçorive të tyre.
2. Nxënësit duhet të jenë në gjendje të përdorin programet për disenjim të Web faqeve për prezantimin e të dhënave dhe ideve nga jeta e përditshme.
3. Nxënësit duhet të jenë në gjendje të përdorin Front Page-in me qëllim të organizimit dhe publikimit të të dhënave në internet.

OBJEKTIVAT

1. Nxënësit duhet të jenë në gjendje të zgjerojnë njohuritë për përdorimin e internetit dhe të Web faqeve.
 - 1.1 Nxënësit duhet t'i njohin veprimet dhe urdhërat për përdorimin e internetit.
 - 1.2 Nxënësit duhet të jenë në gjendje të përpilojnë Web prezantime të thjeshta.
 - 1.3 Nxënësit duhet të kuptojnë rëndësinë e përpilimit të Web prezantimit.
2. Nxënësit duhet të jenë në gjendje të përdorin programet aplikative përkatëse me qëllim të paraqitjes së prezantimeve të tyre.
 - 2.1 Nxënësit duhet të jenë në gjendje të dallojnë komandat themelore për punën me internet dhe Front Page.
 - 2.2 Nxënësit duhet të njohin dhe të zbatojnë programin aplikativ Front Page për raste konkrete të prezantimeve të parashtuara.
 - 2.3 Nxënësit duhet të jenë në gjendje të disenjojnë Web faqe profesionale, me formatizim përmes CSS dhe me Web komponente.

ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES PROGRAMORE:

Kategoritë	Nënkategoritë	Nr. i orëve	Përqindja
1. Interneti dhe WWW	1.1 Puna me internet dhe me WWW 1.2 HTML 1.3 Krijimi i Web faqeve në Word	8	12,12%
2. Front Page	2.1 Hyrje – Prezantimi i Front-Page-it 2.2 Krijimi i Web faqes 2.3 Krijimi i Web prezantimit (Web Sajt-it)	58	87,88%

	2.4 Puna me Web faqe 2.5 Formatizimi i Web faqes 2.6 Insertimi i figurave dhe puna me figura 2.7 Puna me linqe (lidhje) dhe pamja e navigimit 2.8 Krijimi i tabelave dhe puna me tabela 2.9 Puna me korniza 2.10 Krijimi i formularëve 2.11 Formatizimi përmes CSS (Cascading Style Sheets) 2.12 Menaxhimi i Web faqeve 2.13 Publikimi i Web faqeve 2.14 Përdorimi i Web komponenteve		
--	--	--	--

	2.4 Puna me Web faqe	<p>2.4.1 Puna me panelin e pamjeve (Views Panel). Puna me Web faqe, në pamje të ndryshme të faqes.</p> <p>2.4.2 Përdorimi i listës së folderëve dhe panelit të navigimit. Navigimi i Web faqeve.</p> <p>2.4.3 Shtypja e Web faqes. Paraqitja e Web faqes në Web browser (shfletues). Ndryshimi i titullit të Web faqes. Fshirja e Web faqes.</p>	Shkathtësi të treguara në përdorimin e pamjeve të ndryshme të Web faqes dhe ndryshimin e të dhënave themelore të Web faqes.	

	2.5 Formatizimi i Web faqes	<p>2.5.1 Përdorimi i formatit bold dhe italic. Ndryshimi i fontit.</p> <p>2.5.2 Ndryshimi i madhësisë së fontit. Ndryshimi i ngjyrës së fontit. Përdorimi i dritares për dialog Font.</p> <p>2.5.3 Ndryshimi i rreshtimit të tekstit të paragrafit. Përdorimi i vizatuesit të formatit (Format Painter-it).</p> <p>2.5.4 Dhëmbëzimi i tekstit. Krijimi i listës me pika rendore dhe me numra rendor. Ndryshimi i ngjyrës së prapavijës. Aplikimi i temave (Theme).</p>	Njohuri të përvetësuar dhe shkathtësi të treguara në krijimin dhe formatizimin e Web faqes.	
	2.6 Insertimi i figurave dhe puna me figura	<p>2.6.1 Insertimi i figurave. Insertimi i ClipArt-eve.</p> <p>2.6.2 Ndryshimi i madhësisë së figurës. Zhvendosja e figurës. Kopjimi i figurës. Shtimi i vijës kufizuese të figurës. Pozicionimi i figurës. Shtimi i figurës në prapavijë.</p> <p>2.6.3 Krijimi i figurës miniaturale (Thumbnail). Insertimi i tekstit alternativ të figurës. Vendosja e hiperlinkut në figurë.</p>	Njohuri të përvetësuar dhe shkathtësi të treguara në insertimin e figurave dhe punën me figura.	
	2.7 Puna me linqe (lidhje) dhe pamja e navigimit	<p>2.7.1 Planifikimi i Web sajtit. Krijimi i lidhjes (linkut) në një faqe tjetër të Web sajtit. Krijimi i lidhjes (linkut) në një faqe tjetër të internetit. Krijimi i lidhjes (linkut) përbrenda Web faqes. Krijimi i lidhjes për E-mail.</p> <p>2.7.2 Testimi i lidhjes në pamjen Pre-</p>	Njohuri të përvetësuar dhe shkathtësi të treguara në krijimin e lidhjeve të Web faqes me Web faqe dhe Web sajte të tjera.	

		view. Largimi i lidhjes. Krijimi i lidhjes me Hover Button (tastet që rrijnë pezull). 2.7.3 Përdorimi i pamjes Hyperlinks. Përdorimi i pamjes së navigimit dhe panelit të navigimit. 2.7.4 Shtimi dhe largimi i faqeve në pamjen e navigimit.		
	2.8 Krijimi i tabelave dhe puna me tabela	2.8.1 Përdorimi i tabelave për shtrirjen e faqes (Page Layout). Insertimi i tabelave. 2.8.2 Modifikimi i tipareve të tabelës. Modifikimi i tipareve të qelulës. Shtimi dhe fshirja e rreshtave dhe e kolonave. 2.8.3 Ndryshimi i lartësisë së rreshtit dhe e gjerësisë së kolonës. Bashkimi dhe ndarja e qelulave. 2.8.4 Ndryshimi i rreshtimit të tekstit në qelulë. Shtimi i figurës në tabelë. Shtimi i ngjyrës së prapavijës në tabelë.	Njohuri të përvetësuar dhe shkathtësi të treguara në krijimin dhe formatizimin e Web faqeve me tabela.	
	2.9 Puna me korniza	2.9.1 Krijimi i kornizave. 2.9.2 Shtimi i faqeve në korniza. 2.9.3 Ndryshimi i tipareve të kornizës. 2.9.4 Ruajtja e kornizës. Korniza për dalje.	Njohuri të përvetësuar dhe shkathtësi të treguara në krijimin dhe formatizimin e Web faqeve me korniza.	
	2.10 Krijimi i formularëve	2.10.1 Krijimi i formularëve. Shtimi i fushave tekstuale (Text Box). Shtimi i fushave për vërtetim (Check Box). 2.10.2 Shtimi i tasteve me opzione (Option Button). Shtimi i listës rënëse (Drop-Down Box). 2.10.3 Qasja në rezultatet e formularit.	Njohuri të përvetësuar dhe shkathtësi të treguara në krijimin e Web faqeve me formularë.	

	2.11 Formatizimi përmes CSS (Cascading Style Sheets)	2.11.1 Krijimi i stilit të zakonshëm. Aplikimi i stilit. Modifikimi i stilit. 2.11.2 Krijimi dhe lidhja e faqes me stile kaskadike (Cascading Style Sheet). 2.11.3 Ridefinimi i HTML etiketave duke përdorur stilet.	Njohuri të përvetësuar dhe shkathësi të treguar në formatizimin e Web faqeve përmes CSS.	
	2.12 Menaxhimi i Web faqeve	2.12.1 Shtimi i detyrave (Tasks). 2.12.2 Shikimi dhe editimi i detyrave. 2.12.3 Startimi ose fshirja e detyrës	Nxënësit duhet të jenë në gjendje që të menaxhojnë Web faqet .	
	2.13 Publikimi i Web faqeve	2.13.1 Zgjedhja e ofruesit të shërbimeve për Web Prezencë (Web Presence Provider). 2.13.2 Specifikimi i fjalëve kryesore (Keywords) të Web faqes. 2.13.3 Transferimi i Web faqeve në Web Server. 2.13.4 Promovimi, përkrahja dhe reklamimi i Web faqes.	Nxënësit duhet të jenë në gjendje që të publikojnë Web faqet.	
	2.14 Përdorimi i Web komponenteve	2.14.1 Kuptimi i Web komponenteve. 2.14.2 Insertimi i komponenteve të Front Page-it. Insertimi i komponenteve të faqeve spreadsheet. 2.14.3 Përdorimi i Dialog Box-it Commands dhe Options. 2.14.4 Importimi i të dhënave në spreadsheet komponente. Insertimi i grafikut të Office-it. Insertimi i PivotTable.	Nxënësit duhet të jenë në gjendje që të përdorin Web komponentet e ndryshme.	

METODOLOGJIA DHE UDHËZIMET DIDAKTIKE

Shpjegimi i përmbajtjes programore për të kuptuar paraqitjen e Web prezantimeve. Të realizohen shembuj konkretë gjatë shtjellimit të lëndës. Nxënësit njoftohen dhe duhet të jenë në gjendje të dallojnë elementet themelore - përpilimin e Web prezantimeve. Nxënësit njoftohen me përdorimin e urdhrave për përdorimin e internetit dhe të programit Front Page.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

1. Ligjërimi i përmbajtjes programore me gjithë prezantimin vizuel të pjesëve përkatëse.
2. Demonstrimi i veprimeve konkrete me kompjuter.
3. Puna individuale dhe grupore me kompjuter (ekzekutimi i operacioneve me kompjuter nga ana nxënësit).
4. Përpilimi i prezantimeve, duke përdorur programin Front Page.

VLERËSIMI

Vlerësimi i të nxënit bëhet në këto mënyra:

1. Vlerësimi i angazhimit të nxënësit gjatë realizimit të përmbajtjes programore
2. Vlerësimi i punës individuale
3. Vlerësimi i kontributit në punën grupore
4. Testimi gjatë procesit të mësimit dhe ai përfundimtar
5. Vlerësimi përmes detyrës projektuese

UDHËZIME NË PËRDORIMIN E LITERATURËS DHE BURIMEVE TË TJERA MËSIMORE

Literatura e propozuar

1. “**FrontPage 2003 Step-By-Step**” – Microsoft Press.
2. “**FrontPage 2002 Bible**” - autorë: David Elderbrock, David Karlins - Hungry Minds Inc., New York.

3. “**Front Page 2000 Basics**” – Course book, Bit Media E – learning solution.
4. “**HTML Basics**” - Course book, Bit Media E – learning solution.
5. “**Kompjuteri për të gjithë**”, autorë: Dr. Agni Dika, Seb Rodiqi.
6. Literatura në gjuhën angleze për: **MS FrontPage**, **MS Office 2000**, **MS Office XP**, etj.
7. Udhëzimet e integruara në **MS FrontPage** dhe **MS Office**.
8. Literaturë dhe shembuj nga **Interneti**.

Pajisjet dhe parakushtet e tjera të nevojshme

1. Kabineti me kompjuterë dhe shtypës
2. Lidhja në internet, rrjeti lokal në kabinet
3. Trajnime për arsimtarë
4. Mirëmbajtja

Kushtet minimale

1. Një kompjuter në shkollë për demonstrim të programit mësimor
2. Trajnime për arsimtarë

VËREJTJE

1. Nëse shkolla nuk ka kompjuterë, të potencohen aspektet teorike të temave të parapara në program dhe demonstrimi kur shkolla ka së paku një kompjuter.
2. Në fondin e paraparë të orëve janë të përfshira ligjërimi, përformimi i lëndës dhe testimi i nxënësve.
3. Nëse shkolla nuk ka kompjuterë, propozohet që fondi i orëve të shpërndahet në temat e tjera për të cilat këto kushte nuk janë të nevojshme.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

1. Theksi në demonstrim dhe punë individuale dhe grupore, p.sh. evokim dhe reflektim 25%, demonstrimi 25%, puna individuale dhe grupore 50%.
2. Inkurajimi i punës individuale dhe i shkëmbimit të dijes dhe shkathësive, puna interaktive.
3. Përsëritja e përmbajtjes përmes detyrave që përfshijnë zbatimin e më shumë njohurive të fituara.

ORIENTIMET PËR PUNË TË PAVARUR

1. Puna grupore dhe individuale
2. Publikimi i një prezantimi, duke përdorur Front Page-in
3. Grupi i programerëve të shkollës

EDUKATA FIZIKE DHE SPORTIVE

Gjimnazi i përgjithshëm (2 orë në javë, 74 orë në vit)

HYRJA

Edukimi fizik dhe sportiv, sikur çdo disiplinë tjetër, ndikon në formimin e personalitetit të të rinjve, duke u mundësuar atyre pjesëmarrje aktive në aktivitetet shoqërore në pasurimin dhe në thellimin e njohurive të përgjithshme dhe atyre specifike, të cilat u mundësojnë atyre të bëhen qytetarë të përgjegjshëm, të hapur, të aftë për t'u integruar në një shoqëri demokratike. Përmes aktiviteteve fizike, sportive e artistike formojmë qytetarë të kultivuar, të pavarur, të cilët dinë të kontrollojnë zhvillimin e tyre trupor gjatë shkollimit dhe gjatë tërë jetës, të rregullojnë raportet shoqërore, të jenë aktorë aktivë dhe kritikë të asaj çfarë ndodh me ta dhe rreth tyre.

Përmes aktiviteteve fizike e sportive nxënësit e kësaj moshe fitojnë njohuri të reja teknike dhe taktike nga dega e caktuar sportive, adaptohen në situata të reja specifike dhe fitojnë përvoja të reja, duke bërë përpjekje për gjetjen e zgjedhjeve më të mira në situatat specifike të aktiviteteve fizike.

Njohuritë e fituara përmes aktiviteteve fizike u mundësojnë nxënësve të dinë të sillen brenda grupit, të njohin dhe të përdorin rregullat e sjelljes, por edhe në hartimin e atyre rregullave të cilat do t'i respektojnë.

Po ashtu do të vijnë në shprehje edhe aftësitë e tyre organizative pasi ata do të organizojnë gara, do t'i gjykojnë ato duke përjetuar njëkohësisht emocione të shumta si pjesëmarrës në ato gara.

QËLLIMET

Edukimi fizik dhe sportiv është i orientur, veçanërisht në:

- Zhvillimin e aftësive lëvizore dhe funksionale të adaptuara sipas sporteve individuale dhe kolektive;

- Edukimi fizik dhe sporti, si dhe regjimi (jeta) sportiv të ndikojnë në jetë të shëndoshë;
- Zhvillimin e vetëbesimit dhe vullnetit gjatë pjesëmarrjes me sport;
- Formimin e krijimtarisë lëvizore në sporte të ndryshme;
- Përjetimet pozitive në sport për pasurimin shpirtëror.
- Zhvillimi, kultivimi dhe ruajtja e mjedisit;
- Mirëmbajtja dhe përparimi i shëndetit trupor, mendor dhe shpirtëror për përballimin e sfidave të ndryshme në jetën e përditshme.

OBJEKTIVAT

Zhvillimi trupor, zhvillimi i aftësive lëvizore dhe funksionale

- Të zhvilluarit e aftësive lëvizore,
- Të dinë të zgjedhin në mënyrë të pavarur përmbajtjet lëvizore dhe të dozojnë ngarkesat për zhvillimin e aftësive lëvizore (forca, shpejtësia, koordinimi i lëvizjeve, baraspesha, saktësia, qëndrueshmëria);
- Të dinë të zgjedhin në mënyrë të pavarur përmbajtjet lëvizore dhe të dozojnë ngarkesat për zhvillimin e aftësive funksionale (qëndrueshmëria aerobe dhe anaerobe);
- Të dinë të zgjedhin në mënyrë të pavarur përmbajtjet lëvizore për kultivimin dhe zhvillimin e drejtë të trupit dhe formimin e qëndrimit të drejtë trupor;
- Të zhvilluarit e qëndrueshmërisë aerobe përmes aktiviteteve me kohëzgjatje të madhe të karakterit aerob në përputhje me ngarkesat individuale;

Përforcimi i njohurive të ndryshme sportive deri në atë masë që mundëson kyçjen në aktivitetet sportive brenda dhe jashtë shkollës

- Përforcimi dhe zgjerimi i njohurive themelore sportive;
- Të dinë të lidhin në mënyrë kreative përmbajtjet lëvizore;

- Të dinë të gjejnë zgjedhje të qëlluara taktike në situata të ndryshme të lojës;
- Të njohurit, të mësuarit dhe përforcimi i sporteve zgjedhore.

Njohja me njohuritë teorike

- Të kuptuarit e ndikimit të sportit në njeriun nga aspekti fiziologjik, psikologjik dhe sociologjik;
- Të njohurit dhe të kuptuarit e fenomenit të përgatitjes së rregullt fizike dhe të zhvillimit trupor;
- Të njohurit me mjete dhe metoda të ndryshme për zhvillimin e qëndrueshmërisë, lëvizshmërisë, forcës dhe shpejtësisë;
- Të njihen parimet themelore të ushtrimit fizik (sportiv).

Përjetimi i këndshëm i sportit, formimi i qëndrimit të drejtë të trupit

- Të formuarit e qëndrimit të drejtë ndaj shëndetit vetjak (marrja e rregullt me sport në shkollë dhe gjatë kohës së lirë, kultivimi i trupit, ushqimi i shëndoshë);
- Të zhvilluarit e pavarësisë me rastin e zgjedhjes së përmbajtjeve të ndryshme lëvizore;
- Nxitja e pjesëmarrjes së ndërsjellë dhe shoqërimit;
- Të zhvilluarit e raportit kulturor ndaj natyrës dhe mjedisit;
- Të respektuarit e sjelljes sportive (fair play);
- Përjetimi i ndikimit relaksues të ushtrimit fizik (sportiv).

PËRMBAJTJA PROGRAMORE

KATEGORITË	NR. I ORËVE	%
Teoria e edukimit sportiv	2 ORË	2.7
ATLETIKA	12	16.2
GJIMNASTIKA SPORTIVE DHE RITMIKE	10	13.5
SPORTET KOLEKTIVE	26 ORË	35.13
SPORTET INDIVIDUALE	10 Orë	13.5
Aktivitetet në ujë	7-10 ditë	
Skijimi	5-7 ditë	
Garat sportive	10 Orë	13.5
Pikniku-dalja në natyrë	2 DITË	
ANTROPOMETRIA DHE MOTORIKA	4 ORË	5.4

TREGUESIT THEMELORË TË PROGRAMIMIT

Sporti i zgjedhur 2\3 e programit mësimor. Mësimi i obliguar 1\3. Si kriterë bazë për realizimin e programit të obliguar dhe të programit zgjedhor janë: baza materiale, terrenet sportive, si dhe kushtet klimatike.

Së bashku me përmbajtjet e programit zgjedhor dhe atij të obliguar, duhet përfshirë edhe garat sportive për sportet kolektive dhe ato individuale, që duhet të organizohen në të gjitha nivelet, duke filluar nga ai mes paraleleve deri në nivelin kombëtar.

Mësimi i notit dhe skijimit organizohet në terren të përshtatshëm në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës, prindërit dhe institucione të tjera.

PËRMBAJTJET PROGRAMORE

Kategoritë	Nënkategoritë	Përmbajtjet programore	Standardet e arritshmërisë	Lidhshmëritë me lëndët e tjera
Teoria e edukimit sportiv	Aftësitë funksionale dhe lëvizore	Ushtrime për përforcimin e forcës shpërthyesë, repetitive, shpejtësisë, koordinimit të lëvizjes, lëvizshmërisë dhe të qëndrueshmërisë, si dhe përmirësimin e aftësive funksionale dhe veçorive trupore.	Standardet e arritshmërisë: Nxënësit zhvillojnë nivelin e aftësive lëvizore dhe funksionale në shkallën e cila i përgjigjet dhe është në pajtim me zhvillimin normal të trupit	Biologjia Informatika
Atletika	Vrapimet Kërcimet Hedhjet	Ushtrime për përforcimin e teknikës së vrapimit, të startit, vrapimit sprint, vrapimit të qëndrueshmërisë në natyrë me temp të kontrolluar, dorëzimin e stafetës, kërcimi në gjatësi, kërcimi në lartësi, hedhjet; Vrapimi me pengesa-përsosje; Kërcim së gjati me “Hapa në ajër”; Hedhja e diskut.	Nxënësit, në pajtim me aftësitë e tyre, pandërprerë të rrisin gjatësinë e shtegut të vrapimit të gjatë (qëndrueshmërisë) me temp të caktuar. Përforcimi i teknikës dhe i rezultatit në vrapimin e sprintit, në kërcimin në gjatësi me hov, kërcimi në lartësi dhe përmirësimin e teknikës dhe rezultatit të hedhjeve.	Biologjia, Kimia, Fizika Informatika
Gjmnastika me gjmnastikën ritmike	Ushtrime në dysHEME	Përsëritja e elementeve të përvetësuara në klasën 11. Vertikalja mbi duar; kapërdimi para dhe prapa; kapërdimi fluturimthi; vertikalja mbi duar (me forcë) nga qëndrimi këmbë-hapur; Rrotullimi para; Sallto para.	Nxënësit të dinë në mënyrë të pavarur t’i zgjedhin komplekset e ushtrimeve gjmnastikore në bazë të nevojave dhe aftësive vetjake; Të dinë të lidhin përmbajtje të ndryshme akrobatike, ritmike me muzikë.	Muzika

	Kërcimet	Përsëritja e kërcimeve të përvetësuar në klasën 11 (kërcimi i kaluqit për së gjati këmbëhapur, mbledhur dhe me shpalosje); Kërcimi i kalit këmbë-hapur; Kërcimi i kalit këmbë-mbledhur.		
	Hekuri	Nga lëkundja në varje me kapje nga lart dalje me varje i shaluar. Rrotullimi para nga mbështetja shaluar. Nga mbështetja para shtytje me dalje prapa.		
	Paralelet	Përsëritja e elementeve të klasës 11. Nga pozita ndenjor këmbë-hapur mbi drushta, kapërdimi para, këmbët anash; Nga pozita ndenjor këmbë-hapur mbi drushta, kapërdimi para, këmbë-mbledhur me mbështetje mbi krahë; Nga pozita ndenjor këmbë-hapur mbi drushta, ngritja me forcë në vertikale mbi supe.		
	Paralelet e shkallëzuara	Nga varja në drushtën e lartë me kapje nga lart, lëkundja para-prapa me kapje nga lart; Lëkundje para-prapa, kalim këmbë-mbledhur mbi drushtën e ulët; Nga mbështetja shaluar mbi drushtën e ulët-rrotullim para, ardhje në pozitën shaluar; Nga mbështetja shaluar mbi drushtën e ulët rrotullim prapa.		
	Trari	Përsëritja e elementeve në klasën 11		

	Unazat	(mbështetja mbi tra këmbë-mbledhur mbi tra, ekuilibri ballor, dalja para me trup me hark me krahë lart; Komponimi i pesë elementeve mbi tra. Varje e thjeshtë, krahë para të mbledhur; Luhatje para-prapa me krahë të mbledhur; Luhatje para-prapa nga varja e lirë; Nga varja e lirë, kalim në varje palosur; Nga luhatja para-prapa në varje të palosur		
	Vallëzimi	Lëvizje vallëzuese me ritëm dhe temp të ndryshëm; vallëzimet shoqërore; disko-vallëzime dhe vallëzimeve të ndenjave (party-dance), aerobikë.	Nxënësit të dinë bazat e vallëzimeve shoqërore deri në atë shkallë sa të mund t'i kryejnë me lehtësi. T'i përvetësojnë elementet bazë të aerobikës.	Muzika Psikologjia Sociologjia
Sportet kolektive	Basketbolli	Pasimet dhe rrëmbimet e topit në situata të ndryshme të lojës, udhëheqja, ndaljet, pivotimi, zbulimi, kryqëzimi, gjuajtja në shportë, lojë 3:3 në një shportë dhe lojë 5:5 në dy shporta me detyra të ndryshme taktike në mbrojtje dhe në sulm.	Nxënësit të dinë elementet bazë teknike dhe kombinimet taktike në mbrojtje dhe në sulm deri në atë shkallë sa të jenë në gjendje të luajnë me sukses në një shportë dhe në dy shporta. Të marrin pjesë në përgatitjen dhe organizimin e garave mes paraleleve dhe në garat shkollore.	
	Volejbolli	Pasimi dhe ngritja e topit dhe gjuajtja "Penalti" nga pozicioni 3, Gjuajtja paralele dhe diagonale, Nga pozicioni 4 dhe 2.	Nxënësit të dinë elementet bazë teknike dhe kombinimet taktike në mbrojtje dhe në sulm deri në atë masë që	

		Mbrojtja grupore-ekipore me ndërrimin e pozicioneve gjatë lojës. Sulmi nga pozicionet 4, 2 dhe 3, Loja 6:6 me zbatimin e rregullave elementare.	mundëson lidhjen e tyre me situata dinamike të lojës në lojën 6:0 dhe kalimi i ngadalshëm në lojën 5:1. Të marrin pjesë në përgatitjen dhe organizimin e garave mes paraleleve dhe në garat shkollore.	
	Futbolli	Pasimi dhe pranimi i topave me kundërshtar gjysmaktiv dhe aktiv Mashtimet me kundërshtar aktiv dhe goditja në portë, Vendosja dhe lëvizjet e portierit në mbrojtje, Mbrojtja grupore dhe ekipore, Sulmi grupor dhe ekipor, Futboll i vogël 7:7 me zbatimin e rregullave elementare	Nxënësit të dinë elementet bazë teknike dhe kombinimet taktike në mbrojtje dhe në sulm deri në atë masë që mundëson lidhjen e tyre me situata dinamike të lojës si dhe lojën e futbollit të vogël. Të marrin pjesë në përgatitjen dhe organizimin e garave mes paraleleve dhe në garat shkollore.	
	Hendbolli	Përforcimi i lëvizjeve themelore me top përmes me shpejtësi dhe forcë shpërthyesë më të madhe (me kërcime) mes gjuajtjeve të topit bashkëlojtarit dhe goditjeve në portë; Stërvitja e përbërësve të taktikës individuale në sulm: mashtrimeve nga alot me goditje në portë, mashtrimeve me kërcim në goditje etj. Taktika e mbrojtjes individuale: pengimi i goditjeve, prerja e topave, ruajtja e pivotit, etj. Taktika kolektive: përsëritja e kundërsulmit individual, e grupor (me 2 e 3), kundërsulmi	Nxënësit të dinë elementet teknike dhe kombinimet taktike deri në atë masë që u mundëson lidhjen e tyre me situatat dinamike të lojës, si dhe loja me sulme të ndryshme kundër mbrojtjes individuale dhe zonale. Marrin pjesë në përgatitjen dhe në organizimin e garave mes paraleleve dhe brenda	

		<p>kolektiv, sistemi i sulmit me 1 dhe 2 pivotë. Mbrotjtja: përsëritja e mbrotjtjes 6:0 me kalim në 5:1 dhe stërvitja e zonës 4:2; Loja 5:5, 6:6 dhe 7:7 me gjyqtar. Pasimet kapjet dhe rrëmbimet e topit; Gjuajtja në portë, teknika e mbulimit të lojtarit, bazat e mbrotjtjes individuale dhe zonale, taktika e sulmit kundër mbrotjtjes zonale; loja me vendosjen zonale dhe me mbrotjtje zonale 6:0.</p>	<p>klasave të shkollës.</p>	
Sportet individuale	<p>Sportet luftarake Karate-vetëmbrotjtja</p>	<p>Elementet themelore të vetmbrotjtjes me kundërshtar gjysmaktiv dhe aktiv Përsosja e elementeve taktike të vetëmbrotjtjes me kundërshtar gjysmaktiv dhe aktiv</p>	<p>Të dinë elementet teknike dhe taktike të vetëmbrotjtjes.</p>	<p>Biologji</p>
	<p>Sportet me raketë tenisi</p>	<p>Goditja e topit me forhend spin, bekhend spin, Përforcimi i shërbimit dhe pranimit të shërbimit Lojë.</p>	<p>Të dinë goditjet e topit me raketë si: spini me forhend , spini me bekhend, shërbimi dhe elementet tekniko-taktike të lojës.</p>	<p>Matematikë</p>
Noti dhe aktivitetet në ujë	<p>Teknikat e notit Kthimet</p>	<p>Përvetësimi i teknikave të notit krol, krol në shpinë, bretkosë dhe delfin me nisje dhe kthime sipas rregullave.</p>	<p>Nxënësit të zotërojnë 1-2 teknika të notit; Notim në distancë 100 m duke zbatuar rregullat e notit.</p>	<p>Biologji Kimi</p>
Skijimi dhe aktivitetet në borë	<p>Disiplinat alpike Disiplinat nordike</p>	<p>Elementet e shkollës së skijimit, skijimi në terrene të rregulluara, bazat e vrapimit me ski, rrëshqitja me dërrasë.</p>	<p>Nxënësit të dinë të rrëshqasin sigurt në terrene të rregulluara, të përforcojnë edhe më tej vrapimin me ski në largësi më të madhe; të rrëshqasin me dërrasë (snow board).</p>	

Garat sportive	Gara në sportet kolektive dhe individuale Garat në atletikë dhe Gjymnastikë Krosi	Së paku në dy sporte kolektive, Garat në tenis, pingpong, karate etj. Gara në vrapime të shkurtra dhe të mesme, në hedhje dhe në kërcime. Gara në dysHEME dhe në vegla. Krosi pranveror dhe vjeshtor. Garat duhet të zhvillohen në kuadër të shkollës, në mes të paraleleve, klasave dhe ndërmjet shkollave të komunës.	Nxënësit të aftësohen për organizimin e garave, të dinë të zbatojnë rregullat dhe sjelljen sportive fair-play, Të dinë të referojnë.	Sociologji Psikologji
Pikniku dhe shëtitja	Shëtitje në natyrë dy herë në vit	Së paku dy pikniqe gjatë vitit, ku do të përfshihet ecja në terrene malore.	Nxënësit të dinë rregullat e sigurisë në terrenet malore.	Gjeografia Biologjia Arti figurativ
ANTROPO-METRIA DHE MOTO-RIKA	Vlerësimi i veçorive antropometrike dhe aftësive lëvizore	Pesha e trupit Lartësia e trupit Kërcim nga vendi në gjatësi Kërcim nga vendi në lartësi Vrapim 100 metra Vrapim 800-1000 m. Mund të shtohen edhe teste të tjera	Shkalla e përparimit (vlerësimi fillestar dhe përfundimtar i veçorive psikomotorike)	Matematikë Edukimi shëndetësor

Nga katër sportet kolektive të ofruara shkolla duhet të zgjedhë së paku dy, varësisht nga kushtet dhe kuadrin që ka.

Përmbajtjet shtesë:

Vozitja me roshula, me biçikletë, tenis, badminton etj. Zgjedhjen e këtyre përmbajtjeve e bën mësimdhënësi dhe shkolla në bazë të kushteve materiale, kadrovike dhe traditës së regjionit ku ndodhet shkolla.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Klasa e dymbëdhjetë karakterizohet me një ngadalësim të mëtejshëm të procesit të rritjes dhe të zhvillimit të organizmit të nxënësve. Organizmi i nxënësve të kësaj grup-moshe është në gjendje t'i përballojë ngarkesat më të mëdha, duke ndikuar kështu në rritjen e aftësive motorike në nivel më të lartë.

Mësimdhënësi duhet të ketë parasysh dallimet ndërmjet gjinive, që janë më shumë të shprehura se në nivelet e tjera shkollore.

Motivimi i nxënësve për aktivitete sportive mbetet ndër qëllimet kryesore të mësimdhënësit. Ai këtë duhet ta arrijë përmes zgjedhjes përkatëse të përmbajtjeve programore, përkatësisht me nxitjen dhe vlerësimin e përparimit në arritjet e nxënësve. Detyrat e shtruara nga mësimdhënësi duhet të jenë të tilla që nxënësi të mund t'i kryejë ato. Po ashtu të nxënësit nuk duhet të zhvillohet së tepërmi rëndësia e fitores, e humbjes apo e garës me të tjerët. Pra, qëllimi kryesor i mësimdhënësit duhet të jetë përforcimi dhe përsosja e njohurive sportive, aftësive trupore dhe motorike.

Mësimdhënësi, në këtë grup-moshë, duhet të marrë parasysh interesimin e nxënësve për degë të caktuara sportive, pasi një pjesë e madhe e programit mësimor përfshin sportin zgjedhor. Ky fakt favorizon organizimin e mësimin në grupe, sipas aftësive dhe nevojave, duke pasur kujdes që asnjëri nga ata të mos mbetet pa u përfshirë në procesin mësimor.

VLERËSIMI

- Vlerësimi i zhvillimit trupor bëhet me instrumente antropometrike
 - dy herë në vit (lartësia e trupit dhe pesha e trupit);
- Vlerësimi i aftësive lëvizore bëhet me sistemin CGS- dy herë në vit (kërcim nga vendi në gjatësi, kërcim nga vendi në lartësi, vrapim i shpejtësisë 100 m dhe vrapim i qëndrueshmërisë 1000 m (vajzat), 1200 m (djemtë).
- Niveli i informatave të mësuara vlerësohet individualisht dhe gjatë
- situatës së lojës;
- Vlerësohet respektimi i rregullave të lojës dhe aftësia e
- bashkëpunimit dhe kooperimit në sportet kolektive;

- Vlerësimi i nivelit të përvetësimit të elementeve teknike dhe taktike.

LITERATURA

1. Hasangjekaj, Gjinolli, E., Nixha, M. Rakovica, H. Puka, J.
2. Allajbegu, M.: Edukata fizike për klasën 1-2 të arsimit të mesëm
3. Fehmiu, A. Koshi, N.: Edukata fizike për vitin e parë të shkollës së mesme.
4. Gjinolli, E., Çitaku F., Rakovica, H. Hasangjekaj, Bajçinca, Sh.: Edukata fizike dhe sportive, klasa 10, Prishtinë, 2004.
5. Gjinolli, E., Çitaku F., Rakovica, H. Hasangjekaj, B.: Edukata fizike dhe sportive, klasa 11, Prishtinë, 2004.

EDUKATA FIZIKE DHE SPORTIVE

**Gjmnazi i shkencave të natyrës, Gjmnazi i shkencave shoqërore
Gjmnazi i gjuhëve, Gjmnazi matematikë dhe informatikë
(2 orë në javë, 66 orë në vit)**

HYRJA

Edukimi fizik dhe sportiv, sikur çdo disiplinë tjetër, ndikon në formimin e personalitetit të të rinjve, duke u mundësuar pjesëmarrje aktive në aktivitetet shoqërore në pasurimin dhe në thellimin e njohurive të përgjithshme dhe atyre specifike, të cilat u mundësojnë të bëhen qytetarë të përgjegjshëm, të hapur, të aftë për t'u integruar në një shoqëri demokratike. Përmes aktiviteteve fizike, sportive dhe artistike formojmë qytetarë të kultivuar, të pavarur, të cilët dinë të kontrollojnë zhvillimin e tyre trupor gjatë shkollimit dhe gjatë tërë jetës, të rregullojnë raportet shoqërore, të jenë aktorë aktivë dhe kritikë të asaj çfarë ndodh me ta dhe rreth tyre.

Përmes aktiviteteve fizike e sportive nxënësit e kësaj moshe fitojnë njohuri të reja teknike dhe taktike nga dega e caktuar sportive, adaptohen në situata të reja specifike dhe fitojnë përvoja të reja, duke bërë përpjekje për gjetjen e zgjedhjeve më të mira në situatat specifike të aktiviteteve fizike.

Njohuritë e fituara përmes aktiviteteve fizike u mundësojnë nxënësve të dinë të sillen brenda grupit, të njohin dhe të përdorin rregullat e sjelljes, por edhe në hartimin e atyre rregullave të cilat do t'i respektojnë.

Po ashtu do të vijnë në shprehje edhe aftësitë e tyre organizative pasi ata do të organizojnë gara, do t'i gjykojnë ato duke përjetuar njëkohësisht emocione të shumta si pjesëmarrës në ato gara.

QËLLIMET

Edukimi fizik dhe sportiv është i orientur, veçanërisht në:

- Zhvillimin e aftësive lëvizore dhe funksionale të adaptuara sipas sporteve individuale dhe kolektive;

- Edukimi fizik dhe sportiv, si dhe regjimi (jeta) sportive të ndikojnë në jetë të shëndoshë;
- Zhvillimin e vetëbesimit dhe vullnetit gjatë pjesëmarrjes me sport;
- Formimin e krijimtarisë lëvizore në sporte të ndryshme;
- Përjetimet pozitive në sport për pasurimin shpirtëror.
- Zhvillimi, kultivimi dhe ruajtja e mjedisit;
- Mirëmbajtja dhe përparimi i shëndetit trupor, mendor dhe shpirtëror për përballimin e sfidave të ndryshme në jetën e përditshme.

OBJEKTIVAT

Zhvillimi trupor, zhvillimi i aftësive lëvizore dhe funksionale

- Të zhvilluarit e aftësive lëvizore
- Të dinë të zgjedhin në mënyrë të pavarur përmbajtjet lëvizore dhe të përcaktojnë ngarkesat për zhvillimin e aftësive lëvizore (forca, shpejtësia, koordinimi i lëvizjeve, baraspesha, saktësia, qëndrueshmëria);
- Të dinë të zgjedhin në mënyrë të pavarur përmbajtjet lëvizore dhe të përcaktojnë ngarkesat për zhvillimin e aftësive funksionale (qëndrueshmëria aerobe dhe anaerobe);
- Të dinë të zgjedhin në mënyrë të pavarur përmbajtjet lëvizore për kultivimin dhe zhvillimin e drejtë të trupit dhe formimin e qëndrimit të drejtë trupor;
- Të zhvilluarit e qëndrueshmërisë aerobe përmes aktiviteteve me kohëzgjatje të madhe të karakterit aerob në përputhje me ngarkesat individuale;

Përforcimi i njohurive të ndryshme sportive deri në atë masë që mundëson kyçjen në aktivitetet sportive brenda dhe jashtë shkollës

- Përforcimi dhe zgjerimi i njohurive themelore sportive;
- Të dinë të lidhin në mënyrë kreative përmbajtjet lëvizore;

- Të dinë të gjejnë zgjidhje të qëlluara taktike në situata të ndryshme të lojës;
- Të njohurit, të mësuarit dhe përforcimi i sporteve zgjedhore.

Njohja me njohuritë teorike

- Të kuptuarit e ndikimit të sportit në njeriun nga aspekti fiziologjik, psikologjik dhe sociologjik;
- Të njohurit dhe të kuptuarit e fenomenit të përgatitjes së rregullt fizike dhe të zhvillimit trupor;
- Të njohurit me mjete dhe metoda të ndryshme për zhvillimin e qëndrueshmërisë, lëvizshmërisë, forcës dhe shpejtësisë;
- Të njihen parimet themelore të ushtrimit fizik (sportiv).

Përjetimi i këndshëm i sportit, formimi i qëndrimit të drejtë të trupit

- Të formuarit e qëndrimit të drejtë ndaj shëndetit vetjak (marrja e rregullt me sport në shkollë dhe gjatë kohës së lirë, kultivimi i trupit, ushqimi i shëndoshë);
- Të zhvilluarit e pavarësisë me rastin e zgjedhjes së përmbajtjeve të ndryshme lëvizore;
- Nxitja e pjesëmarrjes së ndërsjellë dhe shoqërimit;
- Të zhvilluarit e raportit kulturor ndaj natyrës dhe mjedisit;
- Të respektuarit e sjelljes sportive (fair play);
- Përjetimi i ndikimit relaksues të ushtrimit fizik (sportiv).

PËRMBAJTJA PROGRAMORE

KATEGORITË	NR. I ORËVE	%
Teoria e edukimit sportiv	2 orë	2.7
ATLETIKA	12	16.2
GJIMNASTIKA SPORTIVE DHE RITMIKE	8	12.12
SPORTET KOLEKTIVE	24 orë	36.36
SPORTET INDIVIDUALE	8 orë	12.12
Aktivitetet në ujë	7-10 ditë	
Skijimi	5-7 ditë	
Garat sportive	8 orë	12.2
Pikniku-dalja në natyrë	2 ditë	
ANTROPOMETRIA DHE MOTORIKA	4 orë	5.4

TREGUESIT THEMELORË TË PROGRAMIMIT

Sporti i zgjedhur 2\3 e programit mësimor. Mësimi i obliguar 1\3. Si kriterë bazë për realizimin e programit të obliguar dhe të programit zgjedhor janë: baza materiale, terrenet sportive, si dhe kushtet klimatike.

Së bashku me përmbajtjet e programit zgjedhor dhe atij të obliguar, duhet përfshirë edhe garat sportive për sportet kolektive dhe ato individuale, që duhet të organizohen në të gjitha nivelet, duke filluar nga ai mes paraleleve deri në nivelin kombëtar.

Mësimi i notit dhe skijimit organizohet në terren të përshtatshëm në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës, prindërit dhe institucione të tjera.

PËRMBAJTJET PROGRAMORE

Kategoritë	Nënkategoritë	Përmbajtjet programore	Standardet e arritshmërisë	Lidhshmëritë me lëndët e tjera
Teoria e edukimit sportiv	Aftësitë funksionale dhe lëvizore	Ushtrime për përforcimin e forcës eksplozive, repetitive, shpejtësisë, koordinimit të lëvizjes, lëvizshmërisë dhe të qëndrueshmërisë, si dhe përmirësimit të aftësive funksionale dhe veçorive trupore.	Standardet e arritshmërisë: Nxënësit zhvillojnë nivelin e aftësive lëvizore dhe funksionale në shkallën e cila i përgjigjet dhe është në pajtim me zhvillimin normal të trupit	Biologjia informatika
Atletika	Vrapimet Kërcimet Hedhjet	Ushtrime për përforcimin e teknikës së vrapimit, të startit, vrapimit sprint, vrapimit të qëndrueshmërisë në natyrë me temp të kontrolluar, dorëzimin e stafetës, kërcim në gjatësi, kërcim në lartësi, hedhjet; Vrapimi me pengesa-përsosje; Kërcim së gjati me “Hapa në ajër”; Hedhja e diskut.	Nxënësit, në pajtim me aftësitë e tyre, pandërprerë të rrisin gjatësinë e shtegut të vrapimit të gjatë (qëndrueshmërisë) me temp të caktuar. Përforcimi i teknikës dhe i rezultatit në vrapimin e sprintit, në kërcimin në gjatësi me hov, kërcimi në lartësi dhe përmirësimi i teknikës dhe rezultati i hedhjeve.	Biologjia, kimia, fizika informatika
Gjymnastika me gjymnastikën ritmike	Ushtrime në dysHEME	Përsëritja e elementeve të përvetësuara në klasën 11. Vertikalja mbi duar; kapërdimi para dhe prapa; kapërdimi fluturimthi; vertikalja mbi duar (me forcë) nga qëndrimi këmbë-hapur; Rrotullimi para; Salto para.	Nxënësit të dinë në mënyrë të pavarur t’i zgjedhin komplekset e ushtrimeve gjymnastikore në bazë të nevojave dhe aftësive vetjake; Të dinë të lidhin përmbajtje të ndryshme akrobatike, ritmike	Muzika

	Kërcimet	Përsëritja e kërcimeve të përvetësuara në klasën 11 (kërcimi i kaluqit për së gjati këmbë-hapur, mbledhur dhe me shpalosje); Kërcimi i kalit këmbë-hapur; Kërcimi i kalit këmbë-mbledhur.	me muzikë.	
	Hekuri	Nga lëkundja në varje me kapje nga lart dalje me varje i shaluar. Rrotullimi para nga mbështetja shaluar. Nga mbështetja para shtytje me dalje prapa.		
	Paralelet	Përsëritja e elementeve të klasës 11. Nga pozita ndenjor këmbë-hapur mbi drushta, kapërdimi para, këmbët anash; Nga pozita ndenjor këmbë-hapur mbi drushta, Nga pozita ndenjor këmbë-hapur mbi drushta, ngritja me forcë në vertikale mbi supe.		
	Paralelet e shkallëzuara	Nga varja në drushtën e lartë me kapje nga lart, lëkundja para-prapa me kapje nga lart; Nga mbështetja shaluar mbi drushtën e ulët-rrotullim para, ardhje në pozitën shaluar; Nga mbështetja shaluar mbi drushtën e ulët rrotullim prapa.		
	Trari	Përsëritja e elementeve në klasën 11 (mbështetja mbi tra këmbë-mbledhur mbi tra, ekuilibri ballor, dalja para me trup me hark me krahë lartë; Komponimi i pesë elementeve mbi tra		

	Unazat	Varje e thjeshtë, krahë para të mbledhur; Luhatje para-prapa me krahë të mbledhur; Luhatje para-prapa nga varja e lirë; Nga varja e lirë, kalim në varje palosur; Nga luhatja para-prapa në varje të palosur		
	Vallëzimi	Lëvizje vallëzuese me ritëm dhe temp të ndryshëm; vallëzimet shoqërore; disko-vallëzime dhe vallëzime të ndejave (party-dance), aerobikë.	Nxënësit të dinë bazat e vallëzimeve shoqërore deri në atë shkallë sa të mund t'i kryejnë me lehtësi. T'i përvetësojnë elementet bazë të aerobikës	Muzika, Psikologjia, sociologjia
Sportet kolektive	Basketbolli	Pasimet dhe rrëmbimet e topit në situata të ndryshme të lojës, udhëheqja, ndaljet, pivotimi, zbulimi, kryqëzimi, gjuajtja në shportë, lojë 3:3 në një shportë dhe lojë 5:5 në dy shporta me detyra të ndryshme taktike në mbrojtje dhe në sulm.	Nxënësit të dinë elementet bazë teknike dhe kombinimet taktike në mbrojtje dhe në sulm deri në atë shkallë sa të jenë në gjendje të luajnë me sukses në një shportë dhe në dy shporta. Të marrin pjesë në përgatitjen dhe në organizimin e garave mes paraleleve dhe në garat shkollore.	
	Volejbolli	Gjuajtja paralele dhe diagonale, Nga pozicioni 4 dhe 2. Mbrojtja grupore-ekipore me ndërrimin e pozicioneve gjatë lojës. Sulmi nga pozicionet 4, 2 dhe 3, Loja 6:6 me zbatimin e rregullave elementare.	Nxënësit të dinë elementet bazë teknike dhe kombinimet taktike në mbrojtje dhe në sulm deri në atë masë që mundëson lidhjen e tyre me situata dinamike të lojës në lojën 6:0 dhe kalimi i ngadalshëm në lojën 5:1.	

			Të marrin pjesë në përgatitjen dhe organizimin e garave mes paraleleve dhe në garat shkollore.	
	Futbolli	Pasimi dhe pranimi i topave me kundërshtar gjysmë aktiv dhe aktiv Mashtrimet me kundërshtar aktiv dhe goditja në portë, Vendosja dhe lëvizjet e portierit në mbrojtje, Mbrojtja grupore dhe ekipore, Sulmi grupor dhe ekipor, Futboll i vogël 7:7 me zbatimin e rregullave elementare	Nxënësit të dinë elementet bazë teknike dhe kombinimet taktike në mbrojtje dhe në sulm deri në atë masë që mundëson lidhjen e tyre me situata dinamike të lojës si dhe lojën e futbollit të vogël. Të marrin pjesë në përgatitjen dhe organizimin e garave mes paraleleve dhe në garat shkollore.	
	Hendbolli	Përforcimi i lëvizjeve themelore me top përmes me shpejtësi dhe forcë eksplozive më të madhe (me kërcime) mes gjuajtjeve të topit bashkëlojtarit dhe goditjeve në portë; Stërvitja e përbërësve të taktikës individuale në sulm: mashtrimeve nga alot me goditje në portë, mashtrimeve me kërcim në goditje etj. Taktika e mbrojtjes individuale: pengimi i goditjeve, prerja e topave, ruajtja e pivotit, etj. Taktika kolektive: përsëritja e kundërsulmit individual, e grupor (me 2 e 3), kundërsulmi kolektiv, sistemi i sulmit me 1 dhe 2 pivotë. Mbrojtja: përsëritja e mbrojtjes 6:0 me kalim në 5:1 dhe stërvitja e zonës 4:2; Loja 5:5, 6:6 dhe 7:7 me gjyqtar.	Nxënësit të dinë elementet teknike dhe kombinimet taktike deri në atë masë që u mundëson lidhjen e tyre me situatat dinamike të lojës, si dhe loja me sulme të ndryshme kundër mbrojtjes individuale dhe zonale. Marrin pjesë në përgatitjen dhe në organizimin e garave mes paraleleve dhe brenda klasave të shkollës.	

		Pasimet, kapjet dhe rrëmbimet e topit; Gjuajtja në portë, teknika e mbulimit të lojtarit, Bazat e mbrojtjes individuale dhe zonale, taktika e sulmit kundër mbrojtjes zonale; loja me vendosjen zonale dhe me mbrojtjen zonale 6:0.		
Sportet individuale	Sportet luftarake- Karate- vetëmbrojtja Sportet me raketë tenisi	Elementet themelore të vetëmbrojtjes me kundërshtar gjysmaktiv dhe aktiv. Përsosja e elementeve taktike të vetëmbrojtjes me kundërshtar gjysmaktiv dhe aktiv. Goditja e topit me forhend spin, bekhend spin. Përforcimi i shërbimit dhe pranimit të shërbimit Lojë.	Të dinë elementet teknike dhe taktike të vetëmbrojtjes Të dinë goditjet e topit me raketë si: spini me forhend, spini me bekhend, shërbimi dhe elementet tekniko-taktike të lojës.	Biologji Matematikë
Noti dhe aktivitetet në ujë	Teknikat e notit Kthimet	Përvetësimi i teknikave të notit krol, krol në shpinë, bretkosë dhe delfin me nisje dhe kthime sipas rregullave.	Nxënësit të zotërojnë 1-2 teknika të notit; Notim në distancë 100 m duke zbatuar rregullat e notit.	Biologji, kimi
Skijimi dhe aktivitetet në borë	Disiplinat alpike Disiplinat nordike	Elementet e shkollës së skijimit, skijimi në terrene të rregulluara, bazat e vrapimit me ski, rrëshqitja me dërrasë.	Nxënësit të dinë të rrëshqasin sigurt në terrene të rregulluara, të përforcojnë edhe më tej vrapimin me ski në largësi më të madhe; të rrëshqasin me dërrasë (snow board).	
Garat sportive	Gara në sportet kolektive dhe individuale Garat në atletikë dhe në	Së paku në dy sporte kolektive, Garat në tenis, pingpong, karate etj. Gara në vrapime të shkurtra dhe të mesme, në hedhje dhe në kërcime.	Nxënësit të aftësohen për organizimin e garave, të dinë të zbatojnë rregullat dhe sjelljen sportive fair-play, Të dinë të referojnë.	Sociologji, psikologji

	gjimnastikë Krosi	Gara në dysHEME dhe në vegla. Krosi pranveror dhe vjeshtor. Garat duhet të zhvillohen në kuadër të shkollës, mes paraleleve, klasave dhe shkollave të komunës.		
Pikniku dhe shëtitja	Shëtitje në natyrë dy herë në vit	Së paku dy pikniqe gjatë vitit, ku do të përfshihet ecja në terrene malore.	Nxënësit të dinë rregullat e sigurisë në terrenet malore.	Gjeografia, biologjia, arti figurativ
ANTROPO-METRIA DHE MOTORIKA	Vlerësimi i veçorive antropometrike dhe aftësive lëvizore	Pesha e trupit, Lartësia e trupit, Kërcim nga vendi në gjatësi, Kërcim nga vendi në lartësi, Vrapim 100 metra, Vrapim 800-1000 m, Mund të shtohen edhe teste të tjera.	Shkalla e përparimit (vlerësimi fillestar dhe përfundimtar i veçorive psiko-motorike)	Matematikë, edukim shëndetësor

Nga katër sportet kolektive të ofruara shkolla duhet të zgjedhë së paku dy, në vartësi nga kushtet dhe kuadrin që ka.

Përmbajtjet shitesë:

Vozitja me roshula, me biçikletë, tenis, badminton etj. Zgjedhjen e këtyre përmbajtjeve e bën mësimdhënësi dhe shkolla në bazë të kushteve materiale, kadrovike dhe traditës së rajonit ku ndodhet shkolla.

UDHËZIME METODOLOGJIKE

Klasa e dymbëdhjetë karakterizohet me një ngadalësim të mëtejshëm të procesit të rritjes dhe të zhvillimit të organizmit të nxënësve. Organizmi i nxënësve të kësaj grup-moshe është në gjendje t'i përballojë ngarkesat më të mëdha, duke ndikuar kështu në rritjen e aftësive motorike në nivel më të lartë.

Mësimdhënësi duhet të ketë parasysh dallimet ndërmjet gjinive, që janë më shumë të shprehura se në nivelet e tjera shkollore.

Motivimi i nxënësve për aktivitete sportive mbetet ndër qëllimet kryesore të mësimdhënësit. Ai këtë duhet ta arrijë përmes zgjedhjes adekuate të përmbajtjeve programore, përkatësisht me nxitjen dhe me vlerësimin e përparimit në arritjet e nxënësve. Detyrat e shtruara nga mësimdhënësi duhet të jenë të tilla që nxënësi të mund t'i kryejë ato. Po ashtu të nxënësit nuk duhet të zhvillohet së tepërmi rëndësia e fitores, e humbjes apo e garës me të tjerët. Pra, qëllimi kryesor i mësimdhënësit duhet të jetë përforsimi dhe përsosja e njohurive sportive, aftësive trupore dhe motorike.

Mësimdhënësi, në këtë grup-moshe, duhet të marrë parasysh interesimin e nxënësve për degë të caktuara sportive, pasi një pjesë e madhe e programit mësimor përfshin sportin zgjedhor. Ky fakt favorizon organizimin e mësimin në grupe, sipas aftësive dhe nevojave, duke pasur kujdes që asnjëri nga ata të mos mbetet pa u përfshirë në procesin mësimor.

VLERËSIMI

- Vlerësimi i zhvillimit trupor bëhet me instrumente antropometrike
 - dy herë në vit (lartësia e trupit dhe pesha e trupit);
- Vlerësimi i aftësive lëvizore bëhet me sistemin CGS- dy herë në vit (kërcim nga vendi në gjatësi, kërcim nga vendi në lartësi, vrapim i shpejtësisë 100 m dhe vrapim i qëndrueshmërisë 1000 m (vajzat), 1200 m (djemtë)).
- Niveli i informatave të mësuara vlerësohet individualisht dhe gjatë
- situatës së lojës;
- Vlerësohet respektimi i rregullave të lojës dhe aftësia e
- bashkëpunimit dhe kooperimit në sportet kolektive;
- Vlerësimi i nivelit të përvetësimit të elementeve teknike dhe taktike.

LITERATURA

1. Hasangjekaj, Gjinolli, E., Nixha, M. Rakovica, H. Puka, J.
2. Allajbegu, M.: Edukata fizike për klasën 1-2 të Arsimit të mesëm.
3. Fehmiu, A. Koshi, N.: Edukata fizike për vitin e parë të shkollës së mesme.
4. Gjinolli, E., Çitaku F., Rakovica, H. Hasangjekaj, Bajçinca, Sh.: Edukata fizike dhe sportive, klasa 10, Prishtinë, 2004.
5. Gjinolli, E., Çitaku F., Rakovica, H. Hasangjekaj, B.: Edukata fizike dhe sportive, klasa 11, Prishtinë, 2004.